Shefki Ollomani

ÇËSHTJA KOMBËTARE SHQIPTARE /Publicistikë/

(Shkruar: Gusht - Dhjetor 2007)

Editor
Azam Dauti

Recensent
Dr.Nehat Sadiku

Shefki Ollomani

ÇËSHTJA KOMBËTARE SHQIPTARE

/ Publicistikë/

(Shkruar: Gusht - Dhjetor 2007)

Shkupi

Shkup - Mars 2008

"Horoskopi Shtetformues" Shqiptar:

SHQIPËRIA ETNIKE -
NË VITIN 2012 APO 2512?

Shqipëria u bë Shtet më 1912.
Kosova më 2008, pas 96 vitesh.

Sipas këtij itinerari shqiptar, Ilirida do të bëhet shtet përafërsisht më 2110-12, Kosova Lindore më 2210-12, Malësia e Madhe më 2310-12, Çamëria më 2410-12, kurse Shqipëria Etnike më 2512.

Dhe vetëm një vit pas kësaj, në vitin e mbrapsht 2513 do të bëhet Kiameti-Apokalipsa-Përmbytja e Dytë e Madhe dhe kështu do të rifillojë nga e para shtetformimi i popujve dhe kombeve!

Kuptohet atyre popujve që do ta mbijetojnë Përmbytjen e Madhe, e cila këtë herë nuk do të jetë Përmbytje Ujore e shkaktuar nga Natyra, por do të jetë Përmbytje Atomike (Bërthamore) e shkaktuar nga egërsia dhe çmenduria e Njeriut!

SQARIM PËR LEXUESIT

Të gjithë artikujt e këtij Libri janë shkruar në periudhën kohore: Gusht - Dhjetor 2007, dhe janë të publikuar në disa Faqe Shqiptare në Internet, kurse shumë prej tyre janë botuar edhe në disa gazeta të përditshme dhe periodike shqiptare.

Përjashtim nga kjo periudhë kohore bën shkrimi në Kapitullin I, me titull: **Gjendja historiko-politike e trojeve shqiptare**, i cili është shkruar më 10 gusht 2002 dhe përbën embrionin e MEMORANDUMIT të FBKSH-së dërguar institucioneve e opinionit vendas dhe botëror për Çështjen Kombëtare Shqiptare më datë 25 gusht 2002. Përjashtim nga kjo periudhë kohore bën edhe artikulli me titull: **Ilirida**, në Kapitullin III, i cili është shkruar në Maj 2006 dhe është marrë nga Libri: Shefki Ollomani-SHQIPËRIA ETNIKE (Ëndërr apo Realitet?!), botuar nga Shtëpia Botuese SHKUPI, Shkup - Tetor 2007.Përjashtim nga kjo periudhë kohore bëjnë pjesë edhe dy shkrimet me tituj: **Shqipëria Etnike dhe Maqedonia Etnike** dhe **Republika Federative e Vardarit - alternativa e vetme paqësore**, në Kapitullin III, të cilët janë marrë nga Libri: Shefki Ollomani - NË RRUGË DREJT LIRISË, Shkup 2004. Përjashtim nga kjo periudhë kohore bën edhe Kapitulli VI - **Shtojca (Aneksi)**, në fund të Librit, i cili është marrë nga Libri im më i hershëm me titull: NË RRUGË DREJT LIRISË, botuar në Shkup në vitin 2004, nga e njëjta Shtëpi Botuese. Kjo shtojcë është bërë për shkak të aktualitetit të këtyre shkrimeve të shkruara e të botuara shumë kohë më parë. Rradhitja e artikujve në Libër nuk është bërë sipas kohës së shkrimit apo datës së publikimit të tyre, por sipas një kriteri tjetër.

Një numër i madh i artikujve të këtij Libri, më parë, janë publikuar nëpër shumë Faqe Shqiptare të Internetit dhe janë botuar në disa gazeta e revista shqiptare, ditore e periodike, të nënshkruar me pseudonimet (nofkat): Titan Tivari (7 artikuj) dhe Tomorr Toplica (4 artikuj).

AUTORI

I - ÇËSHTJA KOMBËTARE

GJENDJA HISTORIKO-POLITIKE E TROJEVE SHQIPTARE

Kombi Shqiptar dhe trojet e tij etnike ende janë të pushtuara, të kolonizuara, të copëtuara dhe të robëruara nga shtetet fqinje: Serbia, Mali i Zi, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM) dhe Greqia, qysh nga viti 1912 dhe konfirmuar edhe në vitin 1919 dhe 1946 në dy Konferenca të Parisit pas Luftës I Botërore, pas Luftës II Botërore, si dhe pas përfundimit të luftës së ftohtë më 1989 (pas rrëzimit të murit të Berlinit).

Çështja koloniale shqiptare në Ballkan, jo vetëm që nuk është zgjidhur, por ajo as nuk është prekur, as nuk është aktualizuar fare, as nga politika shqiptare, as nga ajo ndërkombëtare. As edhe pas përmbylljes së konflikteve të armatosura në hapësirat e ish-Jugosllavisë, përfundimisht me ndërhyrjen ushtarake të NATO-s kundër caqeve ushtarake të "RFJ"-së më 24 mars 1999, për shkak të kryerjes së gjenocidit luftarak mbi popullsinë civile shqiptare të Kosovës dhe të dëbimit dhe të deportimit me dhunë të mbi 800.000 mijë shqiptarëve nga Kosova në Maqedoni dhe në Shqipëri nga ana e regjimit serb të ish-kryetarit të të ashtuquajturës "RFJ", Sllobodan Millosheviç.

Shqiptarët në Kosovë luftuan, u vranë, u dogjën, u masakruan, iu nënshtruan gjenocidit e pastrimit etnik dhe u zhdukën pa gjurmë që Kosova të fitojë pavarësinë dhe ribashkimin kombëtar, kjo çështje ende ka ngelur "pezull" dhe e padefinuar si e tillë, edhepse të gjitha kushtet janë plotësuar si në aspektin politiko-juridik të së drejtës vendore, ashtu edhe të së drejtës ndërkombëtare. Por, një gjë e tillë nuk ndodhi e nuk po ndodhë.

Shqiptarët në IRMJ luftuan dhe kërkuan të drejta të barabarta me sllavo-maqedonët që të jenë komb shtetformues dhe për ribashkim kombëtar. Megjithë "Marrëveshjen e Ohrit", gjendja aspak nuk ndryshoi,

sepse ajo edhe si e tillë kurrë nuk u implementue tërësisht. Si rrjedhim, shqiptarët atje mbetën edhe më tej qytetarë të rendit të dytë, duke siguruar kështu vetëm statusin e dikurshëm të minoritetit kombëtar, edhepse për nga numri i strukturës së popullsisë, shqiptarët janë më shumë se sa vetë maqedonët. Mirëpo, këtë statistikë shteti sllavomaqedon, si gjithmonë më parë, edhe tani e ka falsifikuar, duke i regjistruar dhe duke i pasqyruar të gjitha pakicat tjera sllave si maqedonë.

Shqiptarët në Kosovën Lindore (Preshevë, Bujanoc e Medvegjë) luftuan për t'u çliruar nga sundimi i egër kolonial serbosllav dhe për t'u ribashkuar me Kosovën. Por, kjo nuk ndodhi në praktikën e përditëshme, as edhe pas Marrëveshjes së Konçulit, e cila njihte disa të drejta njerëzore e kombëtare të shqiptarëve atje, nuk u implementua asnjëherë në praktikë.

Brenda një periudhe katërvjeçare, pjesa e popullit të okupuar shqiptar zhvilloi tri luftëra për liri, demokraci dhe barazi kombëtare, por asnjërën nga ato luftëra dhe nga ato të drejta nuk i fitoi në favorin e vet. Pse ndodhi kjo? Për shkak të indiferencës dhe miopisë së politikës së koekzistencës primitive pacifiste kosmopolite shqiptare, mosorganizimit të Kryengritjes së Përgjithshme Shqiptare, si dhe për shkak të mospërkrahjes totale dhe të sinqertë të faktorëve politikë relevantë të bashkësisë ndërkombëtare.

Kombi shqiptar i okupuar nga Serbia, IRJM, Mali i Zi dhe Greqia është i pakënaqur me gjendjen dhe pozitën e tanishme juridiko-politike të tij dhe të trojeve shqiptare të kolonizuara dhe të aneksuara në kohëzgjatje më shumë se një shekull nga këto katër shtete.

Kombi shqiptar në Ballkan nuk ka hequr dhe nuk do të heqë dorë kurrë nga format e luftës dhe të rezistencës antikoloniale, të garantuara me normat dhe me ligjet e së drejtës ndërkombëtare, si dhe të Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara, sipas të cilave parashikohet realizimi i drejtpërdrejtë, legjitim dhe legal i aspiratave dhe e drejta e tij legjitime për vetëvendosje, për liri,

demokraci, çlirim dhe ribashkim kombëtar në një shtet të vetëm shqiptar në Ballkan.

Kombi shqiptar, ndër shekuj, ka luftuar dhe përsëri do të luftojë me të gjitha mjetet politike, demokratike dhe me kryengritje të përgjithshme popullore deri në ribashkimin kombëtar shqiptar në një Shqipëri të Bashkuar Etnike. Kombi shqiptar është i lodhur dhe i rraskapitur nga pushtimi dhe robëria mbi njëshekullore e shovinistëve sllavo-grekë. Kombi shqiptar dita-ditës po e humb durimin dhe gjakftohtësinë. Kombi shqiptar dita-ditës po e humb shpresën dhe besimin te faktorët relevantë ndërkombëtarë se ato do ta zgjidhin shpejt dhe drejtë çështjen shqiptare.

Kombi shqiptar dita-ditës po ndërgjegjësohet politikisht, po organizohet ushtarakisht dhe po përgatitet për Kryengritje të Përgjithshme Popullore Mbarëshqiptare për çlirim antikolonial dhe ribashkim kombëtar, po përgatitet për zgjidhjen përfundimtare të çështjes shqiptare - për ribashkimin dhe riformimin e Shqipërisë së dikurshme Etnike.

Kombi shqiptar, sipas të drejtës ndërkombëtare dhe të rendit të Ri Botëror, nuk i përmbushë asnjë nga standardet dhe kriteret e tyre, të parashikuara, që të integrohet as në shkallë europiane, as në shkallë ndërkombëtare më të gjerë, sepse ende ka statusin e popullit vasal dhe të kolonizuar (në zemër të Europës së qytetëruar demokratike, edhepse është një nga popujt më të vjetër të Europës) nën sundimin kolonialist shtypës të shteteve hegjemoniste sllave ballkanike.

Prandaj, si i tillë, me "rekuizita" të robit nën rrethanat nënshtruese anticivilizuese, antidemokratike, antieuropiane dhe të papranueshme për mbarë botën e sotme të civilizuar, ligjërisht nuk është kandidat "i përshtatshëm" dhe së këndejmi, as i gatshëm dhe as i vullnetshëm që të pranojë ndonjë "ofertë" për të aderuar në integrimet europiane për shkak se nuk pranon të hyjë në Europën e Bashkuar me territoret e tij, edhe sot në fillim të shekullit të XXI, të kolonizuara dhe të pushtuara

nga shtetet fqinje. Kjo është arsyeja kryesore pse kombi shqiptar nuk pranon të integrohet në Europën e Bashkuar me një popull të kolonizuar dhe të copëtuar në katër shtete fqinje dhe me një Shqipëri të sotme të cunguar 50% si për nga numri i popullsisë, ashtu edhe për nga sipërfaqja e territorit etnik të saj, si pasojë e veprimit njëshekullorë të imperializmit serbosllav në Ballkan.

Vetëm pasi të jetë zgjidhur statusi kolonial i shqiptarëve në Ballkan, atëherë do të krijoheshin kushte dhe mundësi reale dhe të justifikueshme, që kombi shqiptar si shtet etnik, sovran dhe i pavarur brenda kufinjve të vet territorialë natyrorë, të integrohej në një Europë të Bashkuar, gjë që ky edhe është imperativ i popullit shqiptar dhe i Shqipërisë së Ribashkuar.

Gjendja politike dhe e sigurisë në Ballkan, aktualisht, i ngjanë një vullkani të pashuar, një vullkani që mund të shpërthejë papritur dhe Kryellava e tij - Çështja Kombëtare Shqiptare në Ballkan, të djegë paqen e brishtë e të përkohëshme që është vendosur në këtë regjion. Pa shuarjen e këtij "vullkani" nuk do të ketë kurrë paqë të qëndrueshme në Ballkan dhe në Europë. Ky "vullkan" nuk shuhet me improvizime politike, me pacifikim të përkohshëm të situatës, me zgjidhje parciale e gjysmake, por zgjidhet me shprehjen e vullnetit të lirë të popujve për vetëvendosje, me zgjidhjen drejt e përfundimisht të çështjeve kombëtare të popujve të Ballkanit dhe me formimin e shteteve etnike kombëtare në këtë Gadishull të trazuar. Në këtë gjendje amullie dhe anarkie në të cilën ndodhet Ballkani, në këtë realitet objektiv ku dominon shtypja koloniale dhe apartheidi sllavo-grek dhe diskriminimi ndëretnik, shkelja e të drejtave politike kombëtare dhe njërëzore, arsimore dhe kulturore; ku mbretëron papunësia, varfëria, korrupsioni, kriminaliteti ekonomiko-politik dhe perspektiva e errët - luftërat ndëretnike janë të pashmangshme.

Në këtë kuadër dhe në këtë gjendje pushtimi, kolonizimi, copëtimi dhe robërie, në të cilën ndodhet

kombi shqiptar, një kryengritje e përgjithshme, një luftë çlirimtare për ribashkim kombëtar në një Shqipëri të Bashkuar Etnike, është e pashmangshme, është vetëm çështje kohe se kur dhe në çfarë rrethanash dhe përmasash do të shpërthejë kjo luftë antikoloniale mbarëshqiptare.

Kombi shqiptar është shumë i shqetësuar me gjendjen shpërthyese që mbretëron në Ballkan dhe është shumë i pakënaqur me moszgjidhjen deri më sot të çështjes kombëtare shqiptare. Prandaj, në çdo çast, situata shpërthyese mund të dalë jashtë kontrollit, populli shqiptar gjendet në prag të humbjes së durimit.

Prandaj, për parandalimin e luftërave të reja ndëretnike në Ballkan;

Për ruajtjen dhe forcimin e paqes aktuale; Për vendosjen e stabilitetit, demokracisë dhe paqes së qëndrueshme;

Për zgjidhjen drejtë dhe përfundimisht të çështjeve kombëtare në Ballkan, përfshirë këtu posaçërisht çështjen kombëtare shqiptare; si dhe:

Për shkak të paqes, të lirisë dhe të shprehjes së lirë të vullnetit të popujve për Vetëvendosje, duhet të rishqyrtohen dhe të anulohen të gjitha vendimet e Konferencave dhe Kongreseve të viteve: 1913, 1919 dhe 1946, në të cilat u konfirmua pushtimi dhe copëtimi i trojeve shqiptare të Shqipërisë Etnike nga ana e shteteve shoviniste të Ballkanit: Serbisë, Greqisë, Malit të Zi dhe më pas edhe nga ana e Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë (IRJM). Duhet të inicohet, të përgatitet dhe të thirret një Konferencë Ndërkombëtare për Ballkanin, në të cilën do të merrnin pjesë të gjitha delegacionet e shteteve ballkanike dhe përfaqësuesit e intitucioneve të lartëshënuara botërore, në të cilën do të debatoheshin dhe do të shtroheshin për zgjidhje të gjitha çështjet e konfliktet ndëretnike dhe ndërshtetërore të Ballkanit. Kjo Konferencë do t'i zgjidhte drejtë, me marrëveshje, në mënyrë demokratike dhe paqësore të gjitha çështjet e hapura e të pahapura kombëtare dhe ndërshtetërore të

Ballkanit, përfshirë këtu edhe zgjidhjen përfundimtare të çështjes kombëtare shqiptare.

Do të vendoste për Shqipërinë e Bashkuar, për Bullgarinë e Bashkuar, për Serbinë e Bashkuar, për Kroacinë e Bashkuar - dhe ky do të ishte Ballkani i Bashkuar që do të integrohej natyrshëm në Europën e Bashkuar.

Pas zgjidhjes së drejtë dhe përfundimtare të çështjeve kombëtare ballkanike, të cilat janë burim i shfaqjes së krizave permanente në Ballkan, për shkak të gjeopolitikës dhe të gjeostrategjisë imperialiste sllave në Ballkan - do të shuheshin përfundimisht luftërat ndëretnike, do të zhvillohej ekonomia dhe demokracia, do të mbretëronte paqa dhe liria në mbarë Ballkanin dhe Europën.

Duke i çmuar lartë vlerat fundamentale të bashkësisë ndërkombëtare, siç janë: liria, paqja, sigurimi, bashkëpunimi, rendi, drejtësia, barazia, mirëqenia..., si dhe duke vlerësuar lartë interesin kombëtar dhe shtetëror të shqiptarëve në Ballkan, konsiderojmë se ka ardhur koha që bashkësia ndërkombëtare, në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare dhe të sistemit juridik pozitiv ndërkombëtar, shqiptarëve të kolonizuar dhe të copëtuar në katër shtete (Serbia, Mali i Zi, Maqedonia (IRJM) dhe Greqia), t'ua njohë të drejtën legjitime dhe legale të vetëvendosjes dhe të drejtën e pamohueshme historike të Ribashkimit Kombëtar.

A do të triumfojë në Ballkan paqa mbi luftën, liria mbi robërinë, drejtësia mbi padrejtësinë, demokracia mbi antidemokracinë,... do të zgjidhen apo nuk do të zgjidhen çështjet kombëtare në Ballkan - kjo është varet nga Kombi Shqiptar, nga Popujt e Ballkanit dhe nga vullneti i Fuqive të Mëdha të kohës moderne. Vetëm këta tre faktorë relevantë Ballkanin – këtë ”fuçi baroti” – mund ta shndërrojnë në një Oazë të Paqes, të Lirisë dhe të Demokracisë.

Shkruar: 10 gusht 2002

DIALEKTIKA E NGJARJEVE

Ligji i të kundërtave

Nga ligjet e shkencave natyrore e dialektike është e njohur se ngjarjet dhe fenomenet natyrore e shoqërore janë të lidhura dhe në varshmëri me njëra-tjetrën.

Njëri nga ligjet dialektike të zhvillimit dhe të transformimit të materjes dhe të shoqërisë njerëzore, është edhe **ligji i luftës dhe i unitetit të të kundërtave**. Në kornizat e këtij ligji hyn edhe lufta nacionalçlirimtare e popullit të pushtuar kundër luftës robëruese të agresorit. Luftë kundër luftës. Robëria është negacion i lirisë, kurse lufta për liri është mohim i robërisë.

Gjërat e kundërta zhvillojnë vazhdimisht ndërmjet tyre luftën e të kundërtave. Kurrë nuk ka pasur dhe nuk mund të ketë pajtim në mes gjërave dhe fenomeneve të kundërta. Me vullnet apo jashtë tij, të gjithë janë të detyruar t'i nënshtrohen, por edhe të ndeshen, me ligjin natyror të luftës së të kundërtave.

Ligji i luftës së të kundërtave nuk njeh indiferentizëm, as neutralitet, në ndeshjen e madhe dhe konstante të luftës së të kundërtave. Ky ligj, poashtu, nuk njeh neutralitet politik apo uashtarak gjatë zhvillimit të luftës së të kundërtave: luftës ndërmjet lirisë dhe robërisë, luftës midis popullit çlirimtar dhe armikut pushtues.

Robëria e një populli fillon nga çasti i shkeljes së çizmes së parë të ushtarit armik mbi tokën e popullit që sulmohet për t'u robëruar. Ndërsa lufta për liri fillon nga momenti i pushtimit të atdheut nga ushtritë e huaja invaduese.

Pushtimi dhe robëria imponojnë domosdoshmërinë e fillimit të luftës për liri të popullit të pushtuar e të robëruar. Ky është një proces historik i pashmangshëm, në të cilin fenomenet dhe ngjarjet janë të ndërlidhura ngushtë me njëra-tjetrën, kushtëzojnë njëra-tjetrën dhe

njëkohësisht luftojnë deri në fund njëra-tjetrën. Pushtimi sjellë robërinë, robëria luftën, lufta çlirimin, çlirimi lirinë, liria pavarësinë.

Legjimiteti, drejtësia dhe domosdoshmëria e qëndresës, rezistencës dhe e luftës së armatosur të popullit të robëruar daton nga dita e rënies së tij nën zgjedhën e huaj. E drejta dhe detyra e popullit të robëruar është që të qëndrojë, të rezistojë, të protestojë dhe të luftojë, për të shkëputur prangat e robërisë, për të nxjerrë jashtë atdheut pushtuesët dhe për të fituar lirinë dhe pavarësinë kombëtare.

Asnjë pushtues nuk heq dorë vullnetarisht nga pushtimi, shtypja kombëtare dhe shfrytëzimi ekonomik ndaj popullit e vendit tjetër. Asnjë popull nuk e don luftën dhe gjakderdhjen, por asnjë popull nuk e duron robërinë e huaj, nuk e pranon zhdukjen dhe nuk e nënshkruan nënshtrimin. Çdo popull dëshiron dhe ka të drejtë të jetojë i lirë në atdheun e vet.

Paqja

Paqë, në jetën e përditshme, do të thotë pastërti, mirësi, rregull, meritë,…

Paqë në politikë do të thotë joarmiqësi, joshqetësim, joturbullirë, marrëdhënie miqësore, gjendje pa luftë, pa grindje, pa konflikte, pa ndeshje në mes të popujve apo shteteve.

Paqja nuk mund të arrihet kur mungon liria. Paqe nuk ka për popullin e pushtuar dhe të robëruar. Paqe kurrë nuk mund të ketë ndërmjet pushtuesit e të pushtuarit. Paqja në robëri nuk është paqe, por robëri e re. Paqja në emër të stabilitetit dhe sigurisë, kur vendi dhe populli janë nën pushtim të huaj nuk është paqe.

Paqja mbretëron vetëm midis dy vendeve dhe popujve të lirë e sovranë.

Paqja ekziston brenda-përbrenda një shoqërie, populli apo shteti të lirë e sovran.

Paqja prishet kur brenda të njëjtit popull nuk ka drejtësi, barazi, mirëqenie sociale, punësim e zhvillim, shtet juridik dhe kur ka sundim e shfrytëzim të egër të një klase mbi klasën tjetër shoqërore.

Paqja është paqë kur dominon drejtësia, ligji, demokracia e barazia në rradhët e një shoqërie apo të një shteti. E kundërta e paqes në të këtilla raste është Revolucioni, i cili është rrebelim dhe kryengritje e dhunshme brenda shoqërisë dhe popullit.

Atje ku nuk ka liri, drejtësi, barazi,... ka rrebelim e kryengritje.

Atje ku nuk ka paqe të vërtetë, ka luftë të armatosur.

Ata që bëjnë thirrje për paqë, stabilitet e siguri, me çdo kusht, edhe në rrethana të një robërie e pushtimi klasik të vendit e të popullit, ata s'janë gjë tjetër pos antikombëtarë dhe shërbëtorë të pushtimit të huaj. Por edhe ato qeveri demokratike të botës, që i bëjnë thirrje për paqë e siguri një populli që është i pushtuar e i robëruar, nuk janë liridashës dhe demokratë të vërtetë. Pa liri e paqë kolektive, nuk ka as liri e paqë individuale.

Aktualisht në Shqipërinë Etnike, jashtë Shqipërisë londineze të Tiranës, mbretëron një "paqë" nën robëri! Prandaj kjo lloj paqe është e brishtë dhe e përkohshme. Me gjithë manipulimet dhe kërcënimet "shqiptaro"-ndërkombëtare për ruajtjen e kësaj "paqe", kjo nuk është e mundur dhe heret a vonë kjo "paqe" do të shndërrohet në rrebelim, në kryengritje e luftë çlirimtare. Kjo është jo vetëm e ligjshme, por edhe e natyrshme, ligj i pashkruar i natyrës që nuk kanë çka t'i bëjnë as superfuqitë botërore e jo më pushtuesit e vegjël dhe bashkëpunëtorët e tyre.

Kryengritja

Kryengritja është revoltë, rezistencë, shpërthim me zemërim e me dhunë, luftë nacionalçlirimtare e armatosur e një populli kundër pushtimit dhe pushtuesve të huaj, për të çliruar vendin dhe për të fituar lirinë dhe pavarësinë kombëtare.

Ata që organizojnë kryengritjen quhen kryengritës, luftëtarë të lirisë, ushtarë popullorë, çlirimtarë, atdhetarë, liridashës, idealistë, revolucionar,…

Këto kryengritës armiqtë pushtuesë dhe të lirisë gjithmonë i etiketojnë, duke i quajtur: rrebelë (tekanjozë), ekstremistë, radikalë, fundamentalistë, ilegalë, njerëz me maska apo me thasë në kokë, terroristë,…

Pjesëtarët e një populli të robëruar, të cilët e duan lirinë, por në rrugë paqësore, quhen **pacifistë** dhe i takojnë rrymës politike të **pacifizmit**, e cila predikon paqen me çdo kusht, duke mohuar çdo lloj lufte, sidomos luftërat nacionalçlirimtare dhe revolucionet, me qëllim të ruajtjes së Status Quo–së, të marrëdhënieve kapitaliste, shtypjes e shfrytëzimit të popujve dhe ruajtjen e gjendjes së pushtimit e të robërisë.

Lufta

Lufta është ndeshje e armatosur ndërmjet shtetesh apo forcash kundërshtare që kalon përmes një numëri betejash dhe përleshjesh. Lufta është përplasje e ashpër sistemesh të ndryshme shoqërore-politike, klasash antagoniste, grupesh shoqërore e partishë kundërshtare për ruajtjen apo për marrjen e pushtetit.

Llojet e luftërave:

1.Luftë e drejtë: çlirimtare, kombëtare, popullore, revolucionare, luftë mbrojtëse,…

2.Luftë e padrejtë: imperialiste, pushtuese, grabitqare, aneksuese, robëruese, invaduese, sulmuese,…

Ekzistojnë edhe luftërat civile (qytetare), luftërat bërthamore (kimike, bilologjike, atomike). Pastaj: luftërat tokësore, detare, ajrore. Kemi edhe luftërat e nxehta (me armë), luftërat e ftohta (pa armë) dhe luftërat paqësore.

Ekzistojnë edhe luftërat e brendshme (civile) dhe luftërat e jashtme (midis dy apo më shumë popujve e shteteve). Kemi luftërat midis dy sistemeve të ndryshme shoqërore-politike. Pastaj: luftën e të kundërtave, luftën klasore, luftën e mendimeve, luftën ideologjike, luftën politike, ekonomike, diplomatike, psikologjike (speciale), fetare,...

Revolucioni

Përveç luftërave nacionalçlirimtare ekzistojnë edhe revolucionet, të cilët janë të shumëllojshëm, të dhunshëm, të cilët shpërthejnë nga masat e gjera popullore për përmbysjen me forcë të një rendi ekzistues shoqëror-politik dhe zëvendësimin e tij me një rend të ri. Me anë të revolucioneve hiqet nga pushteti një klasë sunduese dhe vjen në pushtet një klasë e re sunduese. Në politikë ekzistojnë revolucione borgjeze, demokratike, popullore dhe socialiste. Revolucionet zakonisht janë progresive, përparimtare, sepse kalohet nga një shkallë më e ulët e zhvillimit shoqëror-politik të shoqërisë njerëzore në një shkallë më të lartë të zhvillimit shoqëror, politik, ekonomik e juridik të shoqërisë dhe të shtetit.

Revolucionet i organizojnë dhe i udhëheqin revolucionarët, të cilët janë pjesëmarrës në revolucion, anëtarë të partisë revolucionare që udhëheq revolucionin, janë përkrahës dhe simpatizanët të tij, por janë edhe luftëtarë të vendosur për triumfin e së resë dhe përmbysjen e së vjetrës. Revolucionarët janë edhe luftëtarë të lirisë për çlirim dhe pavarësi kombëtare.

Ekzistojnë edhe **kundërrevolucionet**, të cilët janë regresivë, reaksionarë e konservativë, sepse e kthejnë

zhvillimin shoqëror të popullit e të shtetit prapa, në të kaluarën, në të vjetrën dhe në kohën e prapambeturisë e të padrejtësisë.

Marrëveshja

Pas luftës paqja është marrëveshje për ndërprerjen e armiqësisë dhe të luftës.

Marrëveshja është pajtim mendimesh midis dy apo më shumë palëve. Apo qëndrim i përbashkët e identik i dy ose më shumë palëve për një çështje të caktuar, për zgjidhjen e një problemi apo konflikti.

Ekzistojnë dy lloje marrëveshjesh:

1.Marrëveshje e përhershme për ndërprerjen e luftës, afatgjate, marrëveshje paqësore, dhe

2.Marrëveshje e përkohshme, afatshkurtër, marëveshje për armëpushim, e cila shërben për ndërprerjen e përkohshme të luftës.

Marrëveshjet e përkohshme më të fundit janë Marrëveshja e Konçulit dhe Marrëveshja e Ohrit. Këto dy marrëveshje nuk e kanë sjellë paqen e përhershme midis palëve nënshkruese, por vetëm atë të përkohshmen, sepse nuk e kanë zgjidhur përfundimisht shkakun për të cilin u zhvilluan luftërat dhe shkakun për të cilin u lidhën këto dy marrëveshje. Meqenëse janë armpushim e jo përfundim i luftës, si të tilla ato janë të pa zbatueshme dhe të dështuara që në fillim.

Bota dhe njerëzimi në fillim të fillimit, në Zanafillën Parahistorike, kanë qenë në paqë e harmoni, tani janë në luftë e armiqësi. Pas luftës ose do të vjen përsëri paqa, ose do të vjen shkatërrimi, përmbysja, apokalipsa, kiameti…

Këtë askush nuk e di me saktësi.

20 nëntor 2007

ÇËSHTJA KOMBËTARE

Jo vetëm që në shumë pjesë të botës ende nuk është zgjidhur çështja nacionale e shumë popujve, të cilët vuajnë nga pushtimi dhe neokolonializmi, por një gjë e tillë ndodhë edhe në Europën e civilizuar e demokratike.

Çështja kombëtare nuk është zgjidhur ende edhe në Europë. Çështje kombëtare e konflikte ndëretnike ka në Irlandën e Veriut (Britani e Madhe), në Baski e Kataloni (Spanjë), në Korzikë (Itali). Pastaj konflikte ndërshtetërore për territore, të heshtura e të hapura, ka ndërmjet Gjermanisë e Francës, Gjermanisë e Polonisë, Polonisë e Bellorusisë, Gjermanisë e Çekisë, Hungarisë e Rumanisë, Turqisë e Greqisë, Sllovenisë e Kroacisë,... Pakënaqësi dhe tendenca separatiste ka në Skoci e Uells të Britanisë së Madhe, në Bosnjë e Hercegovinë, në Qipro, në Vojvodinë, në Sanxhak, në Moldavi etj. Të mos flasim për çështjen e dhimbshme kombëtare euro-aziatike të Kurdistanit. Në këtë mes çështja kombëtare shqiptare është shembulli më drastik, më tragjik dhe më i hapur i moszgjidhjes së çështjeve kombëtare në Ballkan dhe në Europë.

Çështja e zgjidhjeve nacionale dhe e formimit të shteteve të reja të pavarura nuk varet vetëm nga lufta çlirimtare që bën një popull, por varet po aq edhe nga raporti i forcave të interesit të Fuqive të Mëdha botërore dhe marrëveshjet apo mosmarrëveshjet e tyre për ndarjen e zonave të interesit.

Shtetet ballkanike sllave dhe Greqia gjithmonë kanë pasur aleat të fortë dhe besnik Rusinë cariste, e cila i ka ndihmuar vazhdimisht për çlirimin e tyre nga Perandoria Turke, si dhe pastaj i ka ndihmuar në pushtimin dhe aneksimin e tokave të Shqipërisë Etnike. Kurse populli ynë nuk ka pasur asnjëherë aleatë të përhershëm dhe miq besnikë në luftën e tij për liri dhe pavarësi kombëtare, sepse edhe vetë Europa ka qenë jo e bashkuar në

politikën e saj të jashtme dhe nuk ka pasur interesa të mëdha në Ballkan.

Disa shtete europiane, herë pas here na kanë përkrahur, por pjesërisht dhe përkohësisht, në momentet e caktuara historike. Shqiptarët dhe Shqipëria asnjëherë nuk kanë pasur aleatë dhe miq të përhershëm në Europë, prandaj edhe ne nuk kemi fituar asnjëherë plotësisht lirinë dhe pavarësinë kombëtare. Tek tani, nga vitet e 90-ta të shekullit XX dhe fillimi i këtij mijëvjeçari, po duket se më në fund edhe Shqiptarët dhe Shqipëria Etnike janë duke fituar miq dhe aleatë permanentë, afatgjatë e strategjikë, siç janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Anglia e ndonjë tjetër.

Por kjo miqësi dhe aleancë natyrore ende është e brishtë dhe e pakonsoliduar plotësisht, prandaj është jo reale nga ne që të presim dhe të kërkojmë përkrahje të qind për qind e pa rezerva në luftën tonë për bërjen e Shqipërisë Etnike. Është ende shumë heret të pretendohet që këta aleatë e miq të na ndihmojnë drejtpërdrejt që tani në çlirimin dhe ribashkimin e trojeve tona etnike në një Shtet Kombëtar Shqiptar. Kjo përkrahje dhe ndihmë do të vjen në një etapë dhe kohë më të vonshme, kur të jenë ndërruara disa rrethana politike dhe ushtarake në nivel europian dhe botëror. Kur epërsia e Perëndimit ndaj Lindjes të jetë në një shkallë më të lartë e më të sigurt se tani.

Nga kjo del se faktori i brendshëm politik shqiptar dhe faktori i jashtëm politik ndërkombëtar, ende janë të papjekur dhe jo në nivel të duhur të përgjegjësisë për zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare dhe të çështjeve tjera nacionale në Europë dhe më gjerë.

Çështjet kombëtare, formimi i shteteve të reja, në të shumtën e rasteve, bëhet me faza, shkallë-shkallë e hap pas hapi, nëpër etapa e jo përnjëherësh. Kjo del nga

historia e shtetformimit dhe bashkimit kombëtar prej shumicës së shteteve europiane. Dallimi është se disa shtete kanë qenë më të hershëm e disa më të vonshëm në formimin e shtetit të tyre kombëtar.

Shqiptarët janë nga ata popuj që kthesat historike i kanë gjetur të vonuar, të papërgatitur, të pabashkuar e të paorganizuar sa duhet. Prandaj kanë fituar pak. Në një gjendje të tillë i ka gjetur shqiptarët e Shqipërisë Etnike edhe fillimi i këtij shekulli e mijëveçari të ri, prandaj edhe këtë herë janë duke fituar shumë pak. Shqiptarët dhe partitë e tyre politike nuk mund të merren vesh as për gjëra shumë të vogla të zhvillimit të brendshëm e jo më të merren vesh për një vepër kolosale e vigane siç është bërja e Shqipërisë Etnike.

Mosmarrëveshja, urrejtja, mosuniteti, karrierizmi dhe mungesa e ulët e vetëdijes kombëtare po e brejnë nga brenda, si krimbi mollën, kombin tonë. Pa i bashkuar shqiptarët zemrat dhe kokat, nuk mund t'i bashkojnë as tokat e ndara të Atdheut. Me mendësi të vjetra mesjetare dhe me përçarje të reja nuk zgjidhet çështja kombëtare shqiptare.

5 tetor 2007

"KOMBI KOSOVAR"

Kosova dhe populli i saj shumicë nuk lufton për identitet kombëtar, por për Shtet Kosovar, sepse identitetin kombëtar Kosova e ka qysh me mijëra vite përpara dhe ai është identiteti Iliro-Shqiptar. Kosova është Shqiptare, por nuk ka pavarësi, nuk është shtet, ndaj ajo lufton për Liri, Pavarësi dhe Shtet. Për të qenë Kosova shtet, nuk është e domosdoshme që të krijohet një komb i ri brenda saj me emrin "Kosovar", sepse në Kosovë veç është formuar dhe ekziston shekuj më parë kombi Shqiptar. Kombet nuk mund të formohen brenda natës, ata rrugëtojnë nëpër shekuj derisa marrin formën përfundimtare. Kombet formohen përmes proçeseve të gjata historike, të natyrshme dhe evolutive. Edhe simbolet shtetërore të Kosovës do të jenë simbole shtetëroe dhe jo kombëtare. Të gjitha tentativat për zëvendësimin e identitetit kombëtar dhe simboleve kombëtare të Kosovës me identitete e simbole tjera do të dështojnë, sepse janë antikombëtare dhe antihistorike.

Shkurtpamësia e shqiptarëve dhe dobësimi i identitetit kombëtar shqiptar shprehet përmes tentativave për krijimin e një identiteti të ri kombëtar – identitetit ***Kosovar***, krahas formimit të shtetit të Kosovës. Sot nga ndërkombëtarët dhe antikombëtarët tanë, përpiqet të imponohet e të krijohet artificialisht i ashtuquajturi "njeriu i ri" në Kosovë, që do të quhet KOSOVAR. Ky është projekt i madh eksperimentues, laboratorik dhe i dhunshëm në dëm të qenies sonë kombëtare shqiptare.

Krijimi i "Kombit Kosovar" e përjashton bashkimin kombëtar të Kosovës me Shqipërinë, tani dhe në të ardhmen. Aktualisht prioritet është bërja e Kosovës shtet sovran e të pavarur dhe jo krijimi artificial i "Kombit Kosovar".

Filiza e kombit "Kosovar" ka nisur të shpërthejë, në heshtje, që nga viti 1974, me krijimin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe me përpilimin e Kushtetutës së saj. Kjo Krahinë atëherë kishte kufijtë e saj administrativë, kishte qeverinë, flamurin e disa simbole krahinore që u gjasonin atyre shtetërore. Kombin "Kosovar" e ka imponuar edhe jeta dhe zhvillimi shoqëror politiko-ekonomik i Kosovës ndaras nga Shqipëria këto njëqind vitet e fundit. Kombin "Kosovar", ashtu si edhe Shtetin e Kosovës, po e imponon edhe pamundësia për t'u bashkuar me Shqipërinë, mohimi nga bashkësia ndërkombëtare që populli shqiptar i Kosovës të shprehi vullnetin e tij përmes të drejtës demokratike të Vetëvendosjes së kombeve.

Aktualisht, forca dhe drejtësia nuk janë në anën e Vetëvendosjes së shqiptarëve, të ribashkimit të tyre kombëtar dhe të formimit të Shqipërisë Etnike. Prandaj, sot për sot, e vetmja alternativë e Kosovës është që të bëhet Shtet i pavarur dhe sovran, me simbolet e tij institucionale dhe shtetërore. Por, kjo nuk do të thotë se patjetër duhet të krijohet kombi "Kosovar", të ndërrohet identiteti Shqiptar i kosovarëve dhe të mohohen simbolet kombëtare shqiptare. Kosova mund të ekzistojë si shtet i popullit të saj shqiptar dhe i pakicave tjera kombëtare që jetojnë në të, pa mohuar përkatësinë shqiptare, historinë, gjuhën, kulturën dhe simbolet kombëtare shqiptare.

Kombet nuk janë krijuar dhe nuk mund të krijohen me dekrete dhe me anë të ligjeve të ndryshme politike shtetërore. Ata krijohen përmes një proçesi të gjatë historik dhe në mënyrë spontane dhe evolutive. “Kosovarit” tentohet t'i imponohet një kulturë, një letërsi si dhe një gjuhë tjetër nga Shqiptarët tjerë të Shqipërisë Etnike. "Kombi Kosovar" edhe nëse imponohet nga brenda apo nga jasht, nuk do të jetë komb i mirëfilltë, por do të

jetë një komb politik. Do të jetë një komb kancelarishë botërore, nuk do të jetë komb i mbirë nga dheu shqiptar i Kosovës dardane.

Sipas kohës dhe mënyrës së formimit të tyre, ekzistojnë dy lloj kombesh: Komb natyror (etnik) dhe Komb artificial (politik). Kombi natyror lind, formohet e zhvillohet në mënyrë evolutive, gjatë një periudhe kohore të gjatë qindra-mijëravjeçare. Kombi artificial paraqitet e "formohet" brenda natës, gjatë një kohe shumë të shkurtër, me anë dekretesh e kontratash politike.

Shumica e kombeve të Ballkanit dhe të Evropës janë formuar mbi baza të nacionalizmit etnik. Edhe kombi shqiptar ka pasur të njëjtën bazë dhe të njëjtin rrugëtim historik drejt formimit të tij. Kombi ynë është formësuar mbi bazën e botëkuptimit politik, luftarak e kulturor të Pellazgëve, Ilirëve dhe shekujve tjerë të Mesjetës dhe të Modernes që pasuan më pas. Në Kosovë të gjitha lëvizjet politike dhe luftarake pas vitit 1912, që nga Azem Galica dhe deri te Adem Jashari, kanë pasur karakter dhe përmbajtje etnike kombëtare, atë të nacionalizmit shqiptar.

Kombi natyror (etnik) ka një origjinë, gjuhë, histori, kulturë dhe simbole të përbashkëta dhe prejardhjen e ka nga një bashkësi e njëjtë njerëzore apo fisesh. Kurse Kombi artificial përbëhet nga disa bashkësi apo fise, nga disa popuj apo kombe, të cilët i bashkon interesi politik ditor apo momental dhe vendosin, me marrëveshje e kontrata të ndryshme, që të formojnë kombin politik brenda një territori të caktuar.

Kombi politik është bashkëjetesë popujsh apo kombesh në një shtet të përbashkët, me të drejta dhe përgjegjësi të barabarta kushtetuese e ligjore. Shembull tipik të kombit politik kemi kombin Amerikan, kombin Zvicerian etj. Në këtë rrugë don të shkojë edhe i

ashtuquajturi ”Komb Kosovar”, por as kushtet dhe rrethanat politike, as realitetet historike dhe ekonomike nuk janë të ngjashme si ato të Amerikës dhe Zvicrës, prandaj ka tepër pak gjasa që ky ”Komb Kosovar” të mund të formohet dhe të funksionojë.

Në Kosovë, prej shekujsh, është formuar kombi etnik shqiptar dhe që të ndërtohet tani në Kosovën-Shtet një komb politik ”Kosovar” duhet që paraprakisht të shembet kombi ekzistues shqiptar. Dhe që të bëhet ky akt, duhet që të ndërrohet apo të falsifikohet e gjithë historia mijëravjeçare e Kosovës dhe e Shqiptarëve, të ndërrohet gjuha, kultura, alfabeti e folklori dhe të krijohen të reja. Pra, duhet që të burgoset e vërteta dhe të thurren gënjeshtrat! Shtrembërime të këtilla të realitetit objektiv historik dhe transformime të kësaj natyre nuk mund të bëhen në shoqëritë dhe sistemet demokratike, pos në shoqëri e sisteme totalitare, fashiste dhe diktatoriale. Vetëm në këtë rast Kosova do të shndërrohej në një laborator gjigant eksperimentimi, ku viktima nuk do të ishin minjtë, por shqiptarët.

Edhe po të arrihet deri te formimi artificial e laboratorik i kombit politik ”KOSOVAR”, me anë të lajkave, mashtrimeve, falsifikimeve e kërcënimeve, kjo do t’i ngjante ndërtimit pa leje të një shtëpie në pronën e huaj. Kosova nuk ka vend për dy kombe. Pronar i tokës së Kosovës është Kombi SHQIPTAR. Dhe nëse është e saktë ajo që trumbetojnë demokratët vendas dhe të huaj se, ”prona është e shenjtë”, atëherë askush nuk ka të drejtë ligjore dhe morale që këtë pronë t’ia rrëmbejë dhe t'ia tjetërsojë kombit Shqiptar të Kosovës.

Ky komb i ri Kosovar imponon pastaj edhe përcaktimin e Flamurit dhe të Hymnit kosovar, të ndryshëm nga simbolet kombëtare shqiptare. Dhe si rezultat i gjithë kësaj do të tentohet që të vjen edhe deri te

flakja e gjuhës së unjësuar letrare shqipe dhe krijimin e gjuhës letrare gegërishte kosovare.

Flamuri është simbol i identitetit të kombit, i identitetit të shtetit, është simbol i unitetit të popullit. Flamuri është ndjenja, morali dhe nderi i një kombi. Flamuri është shenjë e shenjtë e Atdheut, që nuk mund të zëvendësohet dhe të ndryshohet pa u ndryshuar dhe asimiluar më parë vetë kombi. Flamuri ynë Kombëtar është Antika, Mesjeta dhe Koha jonë Moderne. Flamuri ynë vjen kështu siç është që nga Lashtësia dhe kështu do të vazhdojë, i këtillë siç është, në Përjetësi. Askush nuk ka të drejtë morale as ligjore ta prekë Flamurin tonë Shqiponjë dhe Feniks.

Në këtë Flamur është gjaku, mendja, ideali dhe zemra e miliona dëshmorëve dhe heronjve të kombit tonë që nga Pellazgjia dhe deri te Shqipëria. Ky Flamur është Flamuri i Zeusit të Pellazgjisë, i Lekës së Madh të Maqedonisë, i Pirros së Mollosisë (Epirit), i Gjergj Kastriotit - Skënderbeut të Arbërisë dhe Flamuri i Ismail Qemalit të Shqipërisë.

Dikur, ndarjen e letërsisë dhe gjuhës shqipe të Kosovës nga letërsia dhe gjuha shqipe e Shqipërisë, e kërkonte me këmbëngulje Jugosllavia Federative dhe Serbia. Madje, Serbia dhe shqipfolësit pushtetarë të asaj kohe, ndoqën dhe torturuan qindra e mijëra shqiptarë të Kosovës, shpeshherë deri në vdekje, të cilët kishin guximin të thonin e të shkruanin hapur se kultura dhe gjuha shqipe është një dhe e pandarë për të gjithë shqiptarët, pavarërisht se në cilat shtete jetojnë.

Teza mbi ekzistencën e dy kombeve: atij “allbanci” (në Shqipëri) dhe “shiftari” (në ish-Jugosllavi) është tezë e vjetër e politikave shoviniste serbe. Rezistenca ndaj këtyre përpjekjeve gjithmonë ka qenë e fuqishme dhe pushteti serb nuk ka arritur asnjëherë ta jetësojë këtë qëllim të tij.

Sot, pas krijimit të rrethanave të reja, tezat mbi ndarjen e kombit shqiptar dhe mundësisë së krijimit të një identiteti të posaçëm kombëtar – atij Kosovar, janë ringjallur në një masë të shumëfishuar. Të ndihmuara edhe nga bashkësia ndërkombëtare këto teza herë pas here po dalin në sipërfaqe në opinionin tonë publik.

*****

Identiteti kosovar ekziston, por vetëm në kuadër të hapësirës kombëtare shqiptare, si identitet regjional apo krahinor, me veçoritë e tij kulturore, dialektore, etnografike, zakonore, tradicionale etj., ashtu siç, ekzistojnë edhe shumë identitete tjera krahinore brenda kombit dhe atdheut tonë, si p.sh.: identiteti i Malësisë së Madhe, identiteti i Pollogut, identiteti i Mirditës, identiteti i Labërisë, identiteti i Çamërisë,... por ajo që i bashkon ata është Identiteti Kombëtar Shqiptar. Janë i njëjti Komb dhe formojnë të njëjtin Atdhe - Shqipërinë Etnike.

Po të tentonim që të gjithë këto identitete krahinore t'i kthejmë në identitete kombëtare, atëherë Kombi Shqiptar do të shpërbëhej, do të zhdukej dhe ora jonë historike do të kthehej prapa në kohën e fiseve primitive. Koha jonë nuk është koha e fiseve, por është koha e kombeve. Ideali dhe luftërat e pandërprera të kosovarëve, ndër shekuj, kanë qenë për çlirimin dhe pavarësinë e Shqipërisë Etnike. Kurse këto 100 vitet e fundit, kosovarët kanë luftuar për çlirim dhe bashkim me pjesën tjetër të kombit dhe shtetit shqiptar, me Shqipërinë.

Asnjëherë kosovarët nuk kanë luftuar për t'u formuar si komb Kosovar. Nuk mund të formohet një Komb Kosovar, por në të njëjtën kohë ta ruaj Gjuhën, Flamurin, Historinë dhe Letërsinë Shqiptare.

Po të heqë dorë dhe t'i mohojë këto, atëherë ai do të jetë kombi më i mjerë dhe më i varfër i botës, sepse do të ngelë pa gjuhë, pa letërsi, pa flamur dhe pa histori. Kosova dhe Kosovari do të ngelë pa poetë e shkrimtarë, sepse të gjithë këta veten e kanë ndier dhe e kanë quajtur Shqiptarë.

Nuk mundesh ta quajsh veten "Komb Kosovar" dhe të përvetsosh çdo gjë që është Shqiptare.

Kosova do të ngelë edhe pa dëshmorët dhe heronjtë e vet kosovarë, sepse ata nuk kanë luftuar dhe derdhur gjakun për "Kombin Kosovar", bile as për Kosovën-Shtet, por ata kanë luftuar dhe rënë për çlirim dhe bashkim kombëtar, për bërjen e Shqipërisë Etnike. Në këtë mënyrë shqiptarët e Kosovës nga Kosovarë do të shndërroheshin në "Kosovrarë", në vetëvrasës!

Po ta emërtojnë veten shqiptarët e Kosovës si Kosovarë, në bazë të emrit gjeografik ku jetojnë - Kosovës, atëherë sipas kësaj "logjike" shqiptarët e Malësisë së Madhe në Mal të Zi veten duhet ta quajnë Malazezë, shqiptarët e Kosovës Lindore në Serbi veten duhet ta quajnë Serbë, shqiptarët e Iliridës në Maqedoni veten duhet ta quajnë Maqedonas dhe shqiptarët e Çamërisë veten duhet ta quajnë Grekë.

Pra, sipas emrit gjeografik të shtetit ku jetojnë, shqiptarët e këtyre shteteve duhet të heqin dorë nga përkatësia e tyre kombëtare, nga etnia e tyre dhe identiteti kombëtar shqiptar dhe të vetëasimilohen, të shkombëtarizohen dhe të tjetërsohen.

Pra, sipas "logjikës" së "Kombit Kosovar" shqiptarët në trojet entike jashtë Shqipërisë londineze duhet të bëjnë vetëvrasje!

Kjo s'ka për të ndodhur kurrë. Shqiptarët nuk janë nga ata popuj që asimilohen as vullnetarisht, as me mashtrime dhe as me dhunë e gjenocid ushtarako-policor.

Këtë e ka vërtetuar katërcipërisht historia jonë e lavdishme dhe heroike. Këtë do ta vërtetojnë edhe vitet, dekadat, shekujt dhe mijëvjeçarët që do të vijnë. Vetëm të marrët, mercenarët dhe tradhëtarët mund të mendojnë e të veprojnë ndryshe.

*****

Si pasojë e gjithë këtyre ndryshimeve rrënjësore: krijimi i "Kombit Kosovar", ndërrimi i Flamurit, Historisë, Gjuhës Letrare dhe Hymnit Kombëtar, me kalimin e dekadave dhe me ndërrimin e gjeneratave në Kosovë, ka rrezik që të vjen edhe deri te largimi kulturor e shpirtëror i Kosovarëve nga Shqiptarët, nga pjesa tjetër e kombit tonë dhe një ditë të caktuar ata jo vetëm nuk do ta quajnë më veten shqiptarë, por edhe do ta luftojnë me të madhe një emërtim të tillë, do ta urrejnë një emër të tillë dhe do të krenohen që janë e që quhen Kosovarë!

Në këtë mënyrë do të krijohen dy taborre, dy palë, dy popuj të cilët me kalimin e kohës do të largohen gjithnjë e shumë nga njëri-tjetri, të cilët do të kenë qëllime e interesa të ndryshme, si dhe do të fillojnë të shfaqen edhe divergjencat e thella midis tyre, kahjet e ndryshme politiko-ekonomike, mënyra e ndryshme e jetesës dhe e të menduarit dhe më në fund do të lindin edhe xhelozitë, garat, fërkimet dhe konfliktet e ndryshme në marrëdhëniet ndërshtetërore. Do të krijohet një realitet i ri brendashqiptar.

Si pasojë e këtij realiteti do të bëhet largimi, ftohja, përçarja dhe ndarja përfundimtare në dy pjesë e kombit shqiptar, do t'i thyhej krahu Shqiponjës, duke mbetur me një kokë e me një krahë. Shteti i Kosovës, po nuk u bashkua me Shqipërinë brenda një periudhe dhjetëvjeçare pas formimit të tij, pas kësaj kohe do të jetë vonë, sepse

do të fillojnë të ndryshojnë zemrat, mendjet dhe shpirti i njerëzve të të dyja shteteve. Shqiptarët nuk duhet assesi që të lejojnë që të ndodhë kjo tragjedi e kjo mynxyrë! Kjo vdekje për së gjalli!

Por, në fund të fundit, të të gjitha fundeve, populli shqiptar i Kosovës e ka vetë në dorë vetveten e tij se a do të mbesë Shqiptar apo do të bëhet Kosovar. Kjo është e drejta legjitime dhe e patjetërsueshme e tij.

Askush nuk ka të drejtë ligjore e morale që të ndërhyjë në mënyrë arbitrare dhe manipulative që t'ia imponojë me presion, me mashtrime e teorizime filozofike identitetin kombëtar popullit shqiptar të Kosovës. Asnjë parti, asnjë qeveri, asnjë parlament dhe asnjë lider i Kosovës nuk mund të vendosë për identitetin kombëtar të kosovarëve.

Kosovarët, po të jetë nevoja dhe kur të jetë e domosdoshme, do ta shprehin haptas vellnetin e tyre sovran me anë të Referendumit dhe Vetëvendosjes se çka duan të jenë dhe si duan të quhen: Shqiptarë apo Kosovarë.

Vetëvendosja, liria dhe pavarësia e vendeve dhe popujve të ndryshëm etnikisht, është e drejtë Universale dhe si e tillë duhet të zbatohet në të gjitha konfliktet ndërtetnike të botës.

Vetëvendosje do të thotë vullnet, liri, pavarësi, sovranitet, shtet, prosperitet, paqë, zhvillim ekonomik, fqinjësi e mirë në mes shteteve e kombeve…

Politika e të mëdhenjve për disa është nënë e për disa është njerkë. Disa popujve ua lejoi referendumin e vetëvendosjen, disave ua mohoi e ua mohon ende një gjë të tillë! Kjo është politikë me dy kute, shpatë me dy teha! Është thjeshtë padrejtësi dhe pseudodemokraci!

5 gusht 2007

FAKTORI I BRENDSHËM
DHE I JASHTËM POLITIK

Bërja apo mosbërja e Shqipërisë Etnike, në rradhë të parë varet nga faktori i brendshëm politik, varet nga pjekuria politike e kombëtare e popullit shqiptar. Varet nga uniteti ynë i brendshëm, varet nga organizimi ynë politiko-ushtarak dhe nga vendosmëria e gatishmëria jonë për të luftuar deri në fund, me të gjitha mjetet, për ta çliruar dhe ribashkuar Shqipërinë Etnike.

Mandej, në rradhë të dytë, por shumë i rëndësishëm, vendimtar po aq sa i pari, është edhe përkrahja, ndikimi dhe ndihma që do të na japë faktori i jashtëm politik për ta përfunduar e konsoliduar luftën dhe fitoren tonë për Shqipërinë Etnike.

Ashtu siç ia imponoi lufta e UÇK-së faktorit ndërkombëtar intervenimin e NATO-s kundër ushtrisë serbe, poashtu, në të ardhmen, ne duhet, me luftën tonë këmbëngulëse, t'ia imponojmë po këtij faktori politik të jashtëm që të intervenojë në Ballkan dhe ta përkrahë e ta zgjidhë përfundimisht çështjen kombëtare shqiptare, me formimin dhe njohjen e Shtetit Kombëtar Shqiptar - Shqipërisë Etnike.

Shqipërinë londineze, me gjithë luftërat e parreshtura çlirimtare të popullit shqiptar, e ndihmoi që të bëhet shtet Austro-Hungaria dhe e mbrojtën nga zhbërja (Traktati i fshehtë i Londrës i vitit 1915) disa vite më vonë SHBA-të me Presidentin Wilson. Ky është fakt historik. Kosovën e çliroi Amerika (SHBA) dhe Anglia përmes intervenimit dhe bombardimeve të NATO-s kundër Serbisë dhe UÇK-ja me luftën e saj heroike. Dhe sot janë po këta faktorë politik që formojnë dhe shformojnë shtete: SHBA, NATO dhe BE. Me bërjen e Kosovës Shtet do të zgjidhet një pjesë e çështjes sonë kombëtare, e cila do të jetë një shtytje e madhe për të ecur më shpejt e më lehtë

përpara në zgjidhjen e tërësishme e përfundimtare të çështjes kombëtare shqiptare në Ballkan.

Prandaj politika shqiptare, gjithë forcat e organizuara legale e ilegale shqiptare, nuk duhet ta injorojnë këtë të vërtetë, nuk duhet që të sillen mosmirënjohës për ndihmën kolosale që kanë dhënë këta faktorë politik dhe aleatë të kombit tonë, në rradhë të parë për mbijetesën tonë dhe në rradhë të dytë edhe për bërjen shtet të Shqipërisë dhe të Kosovës.

Atdhetarët, revolucionarët e luftëtarët shqiptarë anembanë Shqipërisë Etnike nuk janë të kënaqur fare me Kosovën e pavarur dhe me disa të drejta njerëzore, politike e kulturore që kanë fituar shqiptarët në Maqedoni, Serbi apo Mal të Zi, por ata janë të vetëdijshëm se realiteti i ri, i jashtëm, që u krijua nga viti 1990, nuk përputhet aspak me realitetin dhe mentalitetin e vjetër që ende dominon në mesin e popullit shqiptar në nivel mbarëkombëtar.

Mentaliteti bizantino-otoman i principatave, feudeve e pashallëqeve ende dominon në mendjet e shqiptarëve kundrejt aspiratës dhe idealit për bërjen e Shqipërisë Etnike. Shqiptarët kanë të drejtë të mos jenë të kënaqur me sjelljen e faktorëve politik ndërkombëtarë ndaj çështjes shqiptare, por së pari ata duhet të jenë të pakënaqur me vetveten e tyre, sepse deri tani kanë bërë shumë pak për bërjen e Shqipërisë Etnike. Faktori politik i jashtëm, bashkësia ndërkombëtare, nuk mund të luftojë për Shqipërinë Etnike, këtë duhet ta bëjë vetë kombi shqiptar, me një zë dhe si një trup i vetëm. Kurse faktori i jashtëm dhe aleatët tanë mund vetëm të na përkrahin dhe ndihmojnë përanësh në luftën dhe rrugën tonë të ligjshme drejt Shqipërisë Etnike.

Ne duhet të kemi besimin se po këta aleatë natyrorë do të na ndihmojnë, kur të piqen kushtet, edhe për bërjen

e Shqipërisë Etnike. Ata nuk deklarohen para kohe, por kur të vi momenti historik, ata do të reagojnë në stilin që vetëm ata e dinë. Nëse për një çast do ta rikujtonim të kaluarën e pa shpresë dhe tragjike të kombit tonë këto 100 vitet e fundit dhe ndihmën direkte e indirekte që na kanë dhënë faktorët ndërkombëtarë antisllav, atëherë do të kuptonim më mirë të sotmen dhe të ardhmen tonë.

Po ashtu, nëse do të bënim një analizë të gabimeve politike që bashkërisht i bëmë, të përçarjes dhe mosunitetit tonë, në të gjitha kthesat historike dhe në të gjitha hapësirat shqiptare, atëherë do të kuptonim se faktori ndërkombëtar, aleatët tanë natyrorë, megjithatë, na ndihmuan më shumë se sa e meritonim. Sepse në disa raste ata kanë bërë më shumë për ne, se sa ne për vetveten. Kush e njeh mirë historinë shqiptare, ballkanike dhe europiane e di mirë këtë gjë.

Të gjithë në rradhët e Shqiptarëve ankohen dhe hedhin "gur e dru" mbi ndërkombëtarët se nuk lejuan apo nuk lejojnë që populli shqiptar e posaçërisht ai i Kosovës të vetëvendosë për fatin e tij. Dhe të gjithë harrojnë, apo më saktë nuk janë të sinqertë dhe bëhen sikur harrojnë se, kombi shqiptar në tërësi dhe pjesët e tij në veçanti: në Kosovë, Iliridë, Malësi të Madhe e në Kosovën Lindore vetë e kanë fajin, sepse nuk kanë kërkuar me vendosmëri e me gjithë mend Vëtëvendosje dhe Bashkim Kombëtar. Ata kanë kërkuar herë republikë, herë shtet, herë autonomi e herë bashkim me Shqipëri. Kurse klasa politike e Shqipërisë vetëm ka përkrahur teorikisht këto kërkesa të shqiptarëve jashtë saj dhe kurrë Kuvendi, Qeveria apo populli i saj nuk është deklaruar vetë se është për ribashkim kombëtar dhe për Shqipërinë Etnike.

Edhe ato deklarime që i kanë bërë deri më sot, kanë qenë me një gjysmë zëri dhe gjysmake. Të gjitha deklarimet dhe referendumet që kanë mbajtur Shqiptarët e Kosovës, Maqedonisë e Kosovës Lindore për do farë republikash e autonomish politiko-territoriale, më pastaj

vetë i kanë braktisur ato ide dhe nuk kanë vepruar konform atyre vendimeve që kanë marrë.

Pastaj këto referendume e deklarata për shtete (të Kosovës), për republika autonome (të Iliridës), për autonomi politiko-territoriale (të Kosovës Lindore) nuk kanë pasur fare të bëjnë me të drejtën e Vetëvendosjes për Bashkim Kombëtar. Shqiptarët e Shqipërisë londineze apo Shqiptarët e Shqipërisë së robëruar Verilindore, kurrë këto 20 vitet e fundit nuk kanë kërkuar Vetëvendosje për Bashkim Kombëtar! Këtë e kanë kërkuar dhe e kërkojnë vetëm disa grupe dhe organizata herë ilegale e herë legale, të cilat nuk janë përfillur e përkrahur nga shumica dërrmuese e popullit shqiptar këtej e andej kufirit shqiptaro-shqiptar.

Prandaj është jo korrekte, joserioze dhe jo fitimprurëse që ne të rrijmë ditë e natë duke qarë e vajtuar se jemi për Vetëvendosje e Bashkim Kombëtar, por ja që Europa e bota nuk na lejojnë. Me luftën tonë për Vetëvendosje, për çlirim e ribashkim kombëtar, për bërjen e Shqipërisë Etnike ne do të kishim mundur që faktorit politik ndërkombëtar t'ia imponojmë zgjidhjen e çështjes sonë kombëtare, por një gjë të tillë Shqiptarët nuk e bëjnë, sepse kjo punë do sakrifica e flijime, kurse Shqiptarët ende nuk janë të gatshëm që t'i bëjnë këto sakrifica në shkallë kombëtare, si një trup i vetëm, si komb. Kjo do të thotë se populli ynë ende nuk është në nivel të detyrave të tij, vetëdija kombëtare e të cilit ende nuk mjafton për përmbushjen e një vepre aq madhore, siç është ribashkimi kombëtar - bërja dhe formimi i Shqipërisë Etnike.

Ende, mjerisht, ka shumë shqiptarë (ndoshta gjysma e kombit) që rrudhin krahët, ngrysin vetullat dhe thartojnë fytyrën kur ua përmend nevojën dhe domosdoshmërinë për bërjen e Shqipërisë Etnike. Një realitet të këtillë ne ose e dimë e nuk e pranojmë, ose nuk e dimë. Por ama, të jemi të sigurt se këtë gjë faktorët relevantë ndërkombëtarë dhe aleatët tanë natyrorë e dinë.

Nëse ne nuk e njohim vetëveten, të jemi të sigurt se të tjerët na njohin shumë mirë.

Shkurt e shqip, kombi shqiptar, deri më sot, e ka dëshmuar me vepra se ende nuk është i gatshëm të luftojë (me të gjitha mjetet) dhe ende nuk është i pjekur për të bërë Shqipërinë Etnike. Kur të jemi gati dhe kur të piqemi, atëherë gjërat do të ndryshojnë brenda ditës, kurse qëndrimi i faktorëve politik ndërkombëtar do të ndryshojë brenda natës në favor të zgjidhjes së Çështjes sonë Kombëtare.

Ta ndryshojmë vetveten, që të ndryshojnë edhe të tjerët. Atë që na takon që ta bëjmë ne për veten tonë, nuk duhet të presim që të na e bëjnë ndërkombëtarët. Parazitizmi është sëmundje nga e cila duhet të ruhemi. Dhe mbi të gjitha, liria fitohet e nuk dhurohet. Liria e sjellë në pjatë nga të tjerët, është gjysmëliri, çerekliri, gatiliri, liri e rrejshme..., është neokolonializëm ose robëri e re.

Pra, bashkëveprimi, ndërlidhja dhe bashkëpunimi ndërmjet faktorit të brendshëm politik shqiptar dhe faktorit të jashtëm politik ndërkombëtar do të jetë vendimtar për bërjen apo mosbërjen e Shqipërisë Etnike.

12 shtator 2007 *(Tomorr Toplica)*

MOSUNITETI I SHQIPTARËVE

Shqiptarët të shumtën e kohës janë të përçarë. Ata bëhen bashkë vetëm gjatë ngjarjeve të mëdha historike, gjatë luftërave, gjatë tronditjeve të mëdha kombëtare apo gjatë sulmeve frontale ushtarako-policore të armiqve tanë. Shqiptarët nuk kanë unitet ndërmjet veti.

Shqiptarët më së shumti i bashkon vdekja se sa jeta apo lufta për liri dhe ribashkim kombëtar! Prandaj në popull shpesh dëgjon togfjalshin: "Ra kjo vdekje dhe u pamë"! Pra, shqiptarët, politikanët, fqinji me fqinj, njerëzit e thjeshtë, gjatë shumicës së kohës nuk shihen, nuk flasin me njëri-tjetrin, grinden e përlahen me njëri-tjetrin, shkojnë keq me njëri-tjetrin dhe ata pajtohen, takohen e shihen vetëm në rast të vdekjes së dikujt ose në rast të krizave e gjëmave të mëdha kombëtare kur rrezikohet ekzistenca e gjithë popullit nga xhelatët pushtuesë sllavo-grekë!

E meta më e madhe e shqiptarëve është se, ata lidhin Besën dhe bashkohen në kohë rreziqesh kolektive dhe përçahen, ndahen e armiqësohen përsëri me njëri-tjetrin posa kalon rreziku i cili i ka bashkuar! Por uniteti i shpejtë nuk sjellë ndonjë sukses në qëndresën e tyre përballë armiqve pushtuesë, sepse bëhet aty për aty, me një organizim dosido, i cili nuk sjellë fitore.

Shqiptarët nuk duhet të jenë bashkë e në unitet vëllazëror e politik vetëm në vdekje e në luftë, por ata kanë nevojë dhe duhet të jenë të bashkuar gjatë gjithë kohës, si në paqë ashtu edhe në luftë, si në hidhërime ashtu edhe në gëzime, si në mbrojtje ndaj armiqve, ashtu edhe në ndërtimin dhe zhvillimin e vendit.

Mosuniteti i shqiptarëve erdhi në shprehje edhe gjatë luftërave çlirimtare që u zhvilluan në hapësirat shqiptare

të Shqipërisë Etnike, si në Kosovë (1997-999), në Kosovën Lindore (2000-2001) dhe në Iliridë (2001).

Siç shihet edhe nga vitet e luftimeve, këto tri luftëra u zhvilluan ndaras dhe në kohë të ndryshme, gjë që flet për mosunitetin flagrant të shqiptarëve. Flet për përçarjen, papjekurinë, lokalizmin, bajraktarizmin, karrierizmin e klasës politike shqiptare dhe për mungesën e programit mbarëkombëtar për veprimtari dhe luftë të përbashkët të kombit shqiptar për çlirim dhe ribashkim kombëtar të Shqipërisë Etnike. Flet për mentalitetin mesjetar e feudal të udhëheqësve partiakë shqiptarë! Shqiptarët ende duhen të piqen.

Një situatë përçarëse e konfuze dominon në Malësi të Madhe, në Iliridë, në Kosovë dhe në Shqipëri, ku numri i madh i partive politike është në shpërputhje flagrante me numrin e përgjithshëm të banorëve shqiptarë të këtyre krahinave e shteteve shqiptare. Dhe kur t'i shtosh kësaj se, shumica e partive politike shqiptare nuk e kanë në programin e tyre zgjidhjen e çështjes shqiptare dhe ribashkimin e Shqipërisë Etnike, atëherë gjendja bëhet edhe më e rëndë, më tragjike dhe më alarmante.

Tani për tani shqiptarët më shumë po mendojnë dhe punojnë për ekonomi, për pasuri e standard personal e familjar, se sa që mendojnë e përpiqen për çlirim e bashkim kombëtar. Kurse partitë politike shqiptare më tepër po luftojnë për pushtet se sa për shtet. Ata me papërgjegjësinë e tyre po rrezikojnë edhe shembjen edhe të këtij shteti të vogël që kemi (si në vitin 1997), e jo më të angazhohen e të luftojnë për ribashkimin e Shqipërisë Etnike!

Vetëdija politike dhe ndërgjegjja kombëtare te shumica dërrmuese e udhëheqjeve të partive politike shqiptare, anembanë trojeve etnike shqiptare është në një nivel shumë të ulët! Dhe ç'është më keq, ky nivel i ulët i

vetëdijes dhe ndërgjegjes kombëtare të partive politike është reflektuar edhe te një pjesë bukur e madhe e popullit shqiptar! Kjo do të thotë se, shqiptarizmi dhe atdhetarizmi te shqiptarët, këto 15 vitet e fundit ka shënuar rënie drastike.

Kombi shqiptar ka ende shumë politikanë, qeveritarë, liderë e udhëheqës kozmopolitë, globalistë dhe internacionalistë, që fatkeqësisht janë në pushtet apo në krye të partive politike shqiptare në Tiranë, Prishtinë, Shkup, Preshevë e Ulqin, të cilët ose punojnë për pasurimin e vetvetes, ose veprojnë për forcimin e shteteve fqinje!

Shqipërisë Etnike i duhen politikanë, liderë e udhëheqës të mirëfilltë, kombëtarë e atdhetarë, që të mendojnë globalisht dhe të veprojnë shqiptarisht, që të mendojnë internacionalisht, por të veprojnë kombëtarisht. Politikanë që dijnë t'i shfrytëzojnë taktikat – Shtetin e Kosovës, Republikën e Iliridës, Autonominë e Kosovës Lindore, të Malësisë së Madhe e të Çamërisë për të realizuar strategjinë politike – Shqipërinë Etnike.

Partitë politike shqiptare nuk angazhohen për formimin e Shqipërisë Etnike, sepse ato janë të angazhuara për njohjen dhe konsolidimin e shteteve fqinje sllave me ndihmën e trojeve etnike shqiptare, siç është rasti më i freskët i Maqedonisë (1993) dhe Malit të Zi (2006). Çdo njohje nga shqiptarët dhe partitë e tyre politike, si dhe nga shteti i Shqipërisë i këtyre shteteve, është automatikisht mohim flagrant i Shqipërisë Etnike, vetvetiu është veprimtari antikombëtare. Apo mosnjohja e çështjes Çame e të Çamërisë nga Shteti Shqiptar, duke e denigruar këtë çështje madhore të kombit tonë në një çështje "ligjore e pronësore"(!), është vetvetiu mohim i Shqipërisë Etnike nga Shqipëria londineze! Dhe kur e

mohon vetveten, është vetëvrasje, së cilës nuk ka Zot as mjek që ia gjen ilaçin.

Një realitet tjetër i dëmshëm dhe në disfavor të Shqipërisë Etnike është edhe mosuniteti, grindja dhe mosbashkëpunimi i partive shqiptare në Shqipëri, Kosovë, Iliridë, Malësi të Madhe dhe në Kosovën Lindore kur është në pyetje zgjidhja e çështjes kombëtare shqiptare.

Është e natyrshme që këto parti kanë programe të ndryshme politiko-ekonomike për të ardhë në pushtet, por në momentet e caktuara kohore dhe gjatë kthesave të mëdha historike ato duhet të kenë një qëndrim, një unitet dhe një program të përbashkët kombëtar. Këtë opcion dhe synim mbarëkombëtar për çlirimin dhe bashkimin e Shqipërisë Etnike partitë politike shqiptare ende nuk e kanë.

Kjo përçarje dhe ky konflikt ndërpartiak ekziston si në nivel krahinor, ashtu edhe në nivel mbarëkombëtar. Edhe formimi i shumë partive politike brenda Shqipërisë Etnike ka krijuar më tepër përçarje se sa unitet.

1 tetor 2007

SHUMË FÉ, NJË ATDHÉ!

Këto kohët e fundit, nga kalemxhinj pa ndërgjegje kombëtare, pa aftësi intelektuale, pa besim të pastër fetar dhe lloj-lloj injorantësh e delirantësh, nuk ka mbetur religjion pa u sharë e përdhosur, nuk ka mbetur dëshmorë e hero i këtij populli pa u kontestuar e denigruar! U sha e u mohua edhe gjuha e përbashkët letrare, u mohua identiteti kombëtar dhe u mohua dhe po mohohet Shqipëria Etnike dhe ribashkimi i saj! Kaq larg kanë shkuar liderët politikë e fetarë shqiptarë, kaq poshtë kanë rënë "intelektualët" shqiptarë! Aq larg, sa janë afruar buzë humnerës e greminës së tjetërsimit, fetishizimit, shkombëtarizimit, asimilimit, zhdukjes kombëtare dhe shpartallimit të Atdheut! Edhe të kësaj çerek Shqipërie që kemi si shtet sovran!

Këto vitet e fundit të "demokracisë" janë zhvilluar e po zhvillohen shumë debate dhe polemika rreth besimeve fetare të popullit tonë. Ka pasur dhe ka debate konstruktive, të sinqerta dhe të paanëshme, por shumica e tyre kanë qenë dhe janë debate e polemika destruktive, arbitrare, tendencioze, propagandistike, qëllimkëqija, përçarëse, antikombëtare dhe antishqiptare!

Këto debate e polemika, që për temë shqyrtimi kanë pasur religjionin dhe besimin apo mosbesimin e shqiptarëve në Zot, më tepër kanë përhapur konfuzion se qartësi, më tepër kanë shkaktuar dëm se sa dobi kombit tonë dhe zgjidhjes së çështjes sonë kombëtare. Por, gjithashtu, këto debate e polemika rreth besimeve fetare, jo vetëm që nuk u kanë bërë nderë religjioneve për të cilat është debatuar, por përkundrazi, u kanë bërë dëm, i kanë përgojuar e deformuar aq shumë, sa që po të ishin sot gjallë Krishti dhe Muhamedi do t'i kishin "dënuar" e shpallë si heretikë e ateistë të gjithë ata kontestuesë të këtyre religjioneve, sepse Krishterizmi dhe Muhamedanizmi, Bibla dhe Kur'ani, janë të padiskutueshëm, atyre vetëm u duhet besuar ashtu siç

janë dhënë nga Zoti, ashtu siç janë zbuluar nga të Shenjëtit Krisht dhe Muhamed.

Religjioni, besimi në Zot bëhet dhe pranohet me zemër, me sinqeritet, me çiltërsi dhe jo me tru, sepse truri nuk beson kurrë, ai vetëm analizon, logjikon, dyshon, kundërshton dhe mohon. Ata priftërinj e hoxhallarë, ata teologë të krishterë e myslimanë, ata intelektualë të krishterë e myslimanë, por edhe teologë e intelektualë të religjioneve të tjera, që kundërshtojnë, sulmojnë dhe kontestojnë fenë dhe besimin religjioz të njëri-tjetrit, ata jo vetëm që nuk janë fetarë e besimtarë të vërtetë, por ata janë armiqtë numër një të religjionit të vet dhe armiq numër dy të religjioneve e besimeve tjera. Pra, nuk janë as besimtarë, as intelektualë, as dijetarë dhe as njerëz normalë! Dhe në fund, nuk janë as shqiptarë as atdhetarë, por janë demagogë e përçarës!

Çështja e besimit apo mosbesimit në Zot është çështje private, çështje individuale e njerëzve të kësaj bote dhe askush nuk duhet të kërkojë nga njerëzit, qofshin këta besimtarë apo ateistë, të krishterë apo budistë, myslimanë apo protestanë, që ata të flakin një besim, një religjion dhe të përqafojnë një besim apo religjion tjetër. Një fe, një besim e religjion nuk përhapet me imponim, me mashtrim, me lajka, me dhunë, me para apo duke sharë e mohuar religjionet tjera. Feja përhapet **vetëm me predikim.**

Ai fetar që shanë fenë e tjetrit, shanë edhe fenë e vet. Ai besimtar që poshtron besimtarin e fesë tjetër, ai së pari poshtron vetveten dhe pastaj tjetrin. Të gjitha të këqijat, sharjet, dëmet dhe krimet që i bën tjetrit, të kthehen ty, por të shumëfishuara, sepse e mira dhe e keqja veprojnë automatikisht në stilin e Bumerangut: bë mirë, mirë do të gjejsh; bë keq, keq do ta pësosh.

Çështja e fesë, çështja e besimit, është çështja më e ndijshme, më intime, më private dhe më neuralgjike e njerëzve dhe e kombit. Ajo duhet të mbetet e paprekshme, e shenjtë, e papërfolur dhe e papërlyer nga gojkëqinjtë dhe nga dashamirët, sepse feja dhe besimi janë pasuri

univerzale të njerëzimit, për të cilat vendos çdo njeri për vete në qetësi shpirtërore e logjike. Me fushata imponimi, me debate denigruese dhe polemika poshtëruese nuk nderohet, por poshtërohet feja dhe besimi tjetër. Asgjë nuk mund të ndërtohet mbi themele të huaja dhe mbi shpinë e në dëm të tjetrit. Nuk lavdërohet krishterizmi, duke sharë e kritikuar islamizmin dhe nuk lavdërohet islamizmi duke sharë e kritikuar krishterizmin.

Ekziston vetëm një Zot, një Njerëzim dhe një Besim. Të tjerat janë politikë, dominim, përçarje vëllavrasëse dhe synime luftënxitëse. Janë antiKrisht dhe antiMuhamed. Krishti nuk i ka kritikuar e mohuar Pejgamberët (Të Dërguarit e Zotit) para Tij. As Muhamedi nuk i ka kritikuar dhe mohuar Pejgamberët e besimit në Zot para Tij. Atëherë kush janë këta ”Apostuj” e "Apologjetë, ”Pejgamberë” e beterë të rinj, ”moderrnë” e më ”të mençur” që mohojnë Pejgamberët dhe Apostujt e njëri-tjetrit?! Kush janë këta të krisur dhe heretikë, që në emër të religjioneve dhe të Zotit po veprojnë kundër Zotit dhe të Dërguarëve të Tij?! Ata s’janë as të krishterë, as myslimanë, as besimtarë dhe as njerëz! Ata janë Djalli vetë!!! Nuk ka religjion e besim të keq që beson në një Zot. Por ka jobesimtarë, besimtarë naivë, besimtarë injorantë dhe besimtarë dinakë e mercenarë, të cilët në emër të Zotit punojnë për Djallin!

Thonë se historia përsëritet, por ajo kurrë nuk kthehet prapa. Historia, ashtu sikurse jeta, rrjedh vetëm përpara, është e papërsëritshme.

Kombi Shqiptar ka dhënë, jep dhe do të japë dëshmorë e heronj për lirinë dhe mbrojtjen e Atdheut të vet, nga të gjitha religjionet të cilat tanimë janë pjesë e besimit dhe jetës së tij. Çdo mohim apo nënçmim i dëshorëve dhe heronjve tanë mbi baza fetare është antishqiptarizëm dhe tradhëti kombëtare.

Kombi shqiptar nuk filloi me lindjen e Krishtit dhe përhapjes së besimit të Krishter (katolik, otodoks, protestan…). Kombi shqiptar dhe Shqipëria nuk filloi me lindjen e Muhamedit dhe përhapjes së fesë Islame (me të

gjitha sektet e saj). Kombi shqiptar daton që nga lindja e parë e Njeriut mbi këtë Dhe që quhet planeti Tokë. Ai daton që nga Atlantida e besimeve pagane, që nga Pellazgjia e "Perëndive" të Olimpit dhe Zeusit. Që nga Iliria e hershme kur nuk kishte lindur as Krishti as Muhamedi dhe besimet e tyre fetare. Mos njerëzit dhe Shqiptarët e para 2007 viteve nuk kanë qenë njerëz, pasi nuk kanë ekzistuar këto dy religjione monoteiste?! Mos vallë heronjtë e Pellazgjisë e të Ilirisë si: Leka i Madh, Pirrua, Bardhyli, Agroni, Teuta e shumë të tjerë, kanë qenë më pak atdhetarë e shqiptarë, sepse nuk kanë qenë të krishterë e myslimanë?!

Ç'janë këto dokrra e këto insinuata?! Ç'janë këto polemika e zënka fëmijësh?! Ç'janë këto humbje energjishë pa fund, kur kombi e Atdheu rënkojnë nën thundrën barbare të sllavo-grekëve?! Ç'janë këto diskutime e debate të nxehta e të pafund për religjione e besime, kur Shqipëria Etnike po fundoset e zhbëhet për çdo ditë e më tepër?! Si do ta ushtrojë besimin e vet kombi ynë, si do t'i ruajë besimet e tij, kur do ta humbë Atdheun, kombësinë, gjuhën e gjakun e tij, kështu siç po veprojnë e sillen sot liderët dhe intelektualët e tij, të cilët punojnë e përpiqen vetëm për privilegje, për pasuri, për fe e religjione, duke u shërbyer direkt e indirekt armiqve tanë pushtuesë dhe interesave të popujve tjerë të botës, të cilët nuk çajnë kokën për kombin dhe Atdheun tonë, por janë të interesuar që të na shpërlajnë trurin me ideologjitë dhe fetë e tyre, që të na shkombëtarizojnë dhe asimilojnë, që ta zhdukin nga faqe e dheut rracën e parë njerëzore mbi këtë planetë – rracën Pellazgo-Iliro-Shqiptare.

Nuk duhet dhe nuk guxojmë që të lëvdojmë një religjion dhe të shajmë tjetrin. Nuk duhet që të theksojmë ndihmën që i ka dhënë kombit tonë në shekuj e mijëvjeçarë njëra fe, duke harruar të theksojmë edhe meritat e tjetrës ose tjerave, nëse janë më shumë se dy. Ndihmat dhe pengesat që i kanë bërë kombit tonë, Atdheut tonë dhe përgjithësisht çështjes sonë kombëtare religjionet, është e pamundur që t'i rradhisim të gjitha,

por mbi të gjitha është e pamundur që t'i rradhisim paanshmërisht dhe drejt, prandaj është më e udhës që të mos i hyjmë kësaj rruge pa shteg, sepse vetëm do ta dëmtojmë Atdheun, do ta përçajmë unitetin e popullit dhe nuk do ta ribashkojmë kurrë Shqipërinë Etnike.

Çështja e besimit dhe e religjioneve është çështje e vullnetit të popullit. Lëreni të qetë popullin që të besoj ashtu siç don ai, t'i besojë Zotit të vet dhe të ushtrojë këtë besim e nderim përmes religjionit që zgjedh ai vetë.

Të gjitha fetë monoteiste janë të mira dhe të gjitha në mundësinë e vet e kanë ndihmuar zhvillimin shpirtëror e kombëtar të popullit tonë. Por meritat dhe jomeritat e religjioneve gjatë historisë sonë kombëtare mos tentoni që t'i vendosni mbi Peshojë, se ajo nuk mban, se ajo nuk mund të masë rolin e religjioneve gjatë shekujve. Nuk ka Peshojë në botë që mund të vlerësojë e të masë përmasat e religjioneve. Pesha, vlera dhe roli i tyre matet vetëm me zemër të pastër njerëzore, e cila rrespekton në maksimum mendimin e kundërt dhe fenë tjetër.

Tani, sot, nuk është koha e religjioneve, sepse ato veç ekzistojnë të konsoliduara në botë dhe brenda popullit shqiptar. Lërini ato aty ku janë dhe ashtu siç janë. Tani, sot, nuk ekziston i konsoliduar dhe i bashkuar kombi shqiptar, prandaj të gjitha forcat intelektuale, materiale e ushtarake duhet t'i fokusojmë në arritjen e këtij bashkimi.

Tani, sot, nuk ekziston i çliruar dhe i ribashkuar Atdheu ynë – Shqipëria Etnike. Prandaj, të bashkojmë mendjet dhe zemrat tona, të mobilizojmë popullin për të riçliruar dhe ribashkuar këtë atdhe të ndarë e të pushtuar nga sllavo-grekët! Të shpëtojmë këtë Shqipëri të copëtuar e të robëruar, që trupi i kullon gjak nga plagët e marra gjatë shekujve nga armiqtë e saj të shumtë!

*****

Nuk ka fe të vjetër, as të re. Të gjitha janë fe që i drejtohen Zotit dhe janë të diktuara nga Ai. Nuk ka fe të keqe dhe fe të mirë, nëse ato burojnë nga i njëjti Krijues i

Gjithësisë dhe i Njerëzimit. Por, ama, ka Perandori të këqia të kësaj bote, të vjetra e të reja, sepse janë të krijuara e të formuara nga Njeriu, i cili nuk është qenje perfekte dhe është i gabueshëm.

Ndaj, askush le të mos marrë guximin dhe gabimin që të lavdërojë e të mbrojë perandoritë pushtuese, çnjerëzore e mizore të antikës dhe të moderrnes. Asnjë perandori nuk është formuar për të mirë të njerëzimit dhe të popujve, por për të sunduar, shfrytëzuar dhe pushtuar ata.

Asnjë perandori në trojet e Ilirisë, të Arbërisë dhe të Shqipërisë nuk ka ardhë me lule, por me hordhi ushtarake të armatosura gjer në dhëmbë. Kanë ardhur me shpatë e bajoneta, me zjarr e hekur dhe kanë vrarë e përgjakur popullin tonë! Kanë djegur e shkretëruar atdheun tonë dhe ia kanë marrë lirinë njerëzore dhe pavarësinë kombëtare. Kush është normal, që di shkrim e lexim dhe që ka lexuar historinë tonë dhe atë botërore, e di plotësisht një të vërtetë të këtillë të dhimbshme e tragjike.

Asnjë perandori e njerëzimit nuk ka qenë humane dhe çlirimtare për popujt dhe vendet tjera ku ato kanë kryer ekspeditat e tyre ushtarake, invaduese e pushtuese. Ne duhet të jemi më tepër se antikombëtarë, duhet të jemi të çmendur fare nëse i quajmë si ”përparimtare”, ”civilizuese”, ”shpëtimtare” apo ”çlirimtare”,... perandori të tilla mizore, si: Perandoria e Maqedonisë së Lekës së Madh, që shtrihej nga Egjypti e deri në Indi, Perandoria Persiane, Perandoria Arabe, Perandoria Mongole, Perandoria Romake, Perandoria Bizantine, Perandoria e Car Dushanit, Perandoria e Samuilit, Perandoria Osmane apo Perandoria Sovjetike. Këtu bënë pjesë edhe miniperandoria serbomadhe e ish-Jugosllavisë. Të gjitha këto perandori dhe shumë të tjera si këto, janë themeluar e zgjeruar në shpinë të popujve të pafajshëm, mbi gjakun dhe eshtrat e tyre, në tokë të huaj!

Ata kalemxhinj injorantë që lavdërojnë një perandori për të mbrojtur një perandori tjetër pushtuese e gjakatare,

ata bëjnë të njëjtin gabim sikurse kur përpiqen që përmes sharjes së një religjioni të mbrojnë religjionin tjetër. Perandoritë që janë zgjeruar në kurriz të popujve dhe tokave të huaja, me zjarrë e hekur, me gjak e luftë, nuk ka telall e papagall, nuk ka avokat e psikopat që mundet t'i arsyetojë dhe t'i mbrojë. Dielli me shoshë nuk mbulohet. Ndaj hiqni dorë nga marrëzira të këtilla të errëta, antikombëtare, antihistorike, antishkencore, antinjerëzore e anticivilizuese.

Kur tjetri të vjen në vatër, të hynë në shtëpi, të vret pleq e të ri, të grabit tokën e të djegë kullën, të imponon ligjet dhe religjionin e vet, ta pushton Atdheun dhe të shkombëtarizon me shpatë e helm, me pushkë e top, me ushtri e xhandarmëri,… këtë askush le të mos tentojë që ta quaj si mision "paqësor" e "civilizues", si ekspeditë "miqësore" e "shpëtimtare", por ashtu siç është – fushatë dhe invadim barbar.

Zëvendësimi i një perandorie të huaj pushtuese me një perandori tjetër të huaj po aq mizore, nuk mund të quhet kurrë çlirim, shpëtim apo zgjidhje fatlume për një vend dhe për një popull. Pushtuesi është pushtues, i huaji është i huaj dhe robëria që sjellë ai me vete është robëri e njëjtë me atë të paraardhësit të tij. Nuk ka pushtuesë të mirë dhe pushtuesë të këqinj, apo pushtuesë "pak më të mirë".

Është befasuese dhe irrituese që të lexosh dhe të dëgjosh idiotizma të këtilla për çdo ditë nëpër mediat tona të shkruara dhe elektronike. Dhe kur këto naivitete, por edhe ide tendencioze, antikombëtare dhe armiqësore i dëgjon dhe i lexon nga njerëz intelektualë, kjo të bënë që të shkulësh leshrat e kokës e të gjoksit, ashtu siç bëri Lekë Dukagjini, kur i ra shumë vonë ndërmend për humbjen e madhe kombëtare që shkaktoi vdekja e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, të cilin nuk e përkrahu gjithmon dhe sa duhej kur ai ishte gjallë dhe luftonte me armiqtë osmano-venedikas të Arbërisë. Kështu veprojmë ne sot, duke luftuar njëri-tjetrin dhe duke sharë religjionin e njëri-tjetrit, ne s'bëjmë asgjë tjetër pos që shajmë vetveten

tonë, dëmtojmë atdheun tonë dhe bëjmë vetëvrasje të ngadalshme e të sigurt kombëtare!

Kur flitet e shkruhet për çështjen tonë kombëtare, por edhe për religjionet që ushtrohen brenda kombit tonë, duhet të flasim e të shkruajmë pa emocione, pa frustrime, pa impulse instiktive, pa maska, pa demagogji, pa djallëzi, pa interes, paanshmërisht, pa inat, pa xhelozi dhe pa urrejtje, ndaj njëri-tjetrit dhe ndaj fesë dhe ideologjisë së njëri-tjetrit, sepse të gjithë një mendim dhe një ide nuk mund të kemi. Është jo vetëm jodemokratike, por as edhe nuk është e mundur realisht e shkencërisht që të gjithë të mendojmë dhe të besojmë njësoj.

Duhet të shkruajmë e të flasim me zemër të pastër, me sinqeritet, me vetëdije kombëtare, me ndërgjegje njerëzore, me mendje të kthjellët dhe me logjikë të shëndoshë shkencore. Vetëm kështu thuhet e vërteta dhe triumfon drejtësia. Vetëm kështu dëshmohet shqiptarizmi dhe atdhedashuria jonë. Vetëm kështu dëshmohet para Zotit dhe para popullit dashuria, rrespekti dhe besimi në Krijuesin tonë e të Gjithësisë dhe ndaj atdheut tonë – Shqipërisë Etnike.

Të gjithë ata kalemxhinj që veten e quajnë gazetarë, publicistë, shkrimtarë, politikanë, intelektualë e patriotë, priftërinj e hoxhallarë,... dhe që tentojnë të rishkruajnë historinë tonë kombëtare sipas interesave të tyre ideologjike dhe fetare, duke i ndarë edhe heronjtë e kombit tonë në të krishterë e myslimanë, apo sipas përkatësisë së tyre eventuale partiake e ideologjike, këta s'janë asgjë tjetër pos injorantë e pseudoshqiptarë, janë shërbëtorë e mercenarë të të huajve.

Dëshmori është dëshmor. Ai ka derdhur gjakun për lirinë e popullit dhe të atdheut dhe jo për ndonjë ideologji apo religjion të caktuar. Prandaj, ata së pari janë shqiptarë e kombëtarë, pastaj mund të jenë ithtarë të ndonjë ideologjie apo besimtarë të ndonjë feje. Të gjithë heronjtë e kombit tonë kanë dhënë jetën për liri dhe atdhe dhe jo për ndonjë fé. Ndaj mos ua lëvizni eshtrat dhe mos ua trazoni shpirtin heronjve tanë të lavdishëm e të

pavdekshëm, sepse do t'ju djegë zjarri i kësaj dhe asaj bote! Mos bëheni gjykatës të religjioneve, të popujve dhe të njëri-tjetrit, se nuk është detyra as e drejta e juaj. Falja dhe dënimi është vetëm në duar të Krijuesit tonë e të Gjithsisë.

Merruni me veten tuaj, me predikimin paqësor e dinjitoz të besimeve fetare. Ndihmoni kombin e atdheun të çlirohet e të bashkohet, sepse vetëm kështu do ta kryeni detyrën tuaj ndaj Zotit që u krijoi, ndaj Prindërve që u lindën, ndaj Popullit që u rriti dhe ndaj Atdheut që u burrëroi.

Duke ndarë dëshmorët dhe heronjtë e kombit tonë sipas përkatësisë së tyre fetare e partiake, ne bëjmë me vetëdije apo pa vetëdije, ndarjen e kombit dhe dobësimin e atdheut. Tipa të këtillë nuk janë as fetarë, as besimtarë dhe as shqiptarë. Këta Zoti i marroftë dhe populli i dënoftë!

Popullit dhe atdheut tonë i duhen bijtë e bijat e djeshme, bijtë e bijat e sotme dhe bijtë e bijat e nesërme – qofshin këta të krishterë apo myslimanë, sepse të gjithë janë shqiptarë e atdhetarë, që për liri e Shqipëri të marrin gjak në ballë. Riçlirimit dhe ribashkimit të Shqipërisë Etnike i duhen të gjithë bijat dhe bijtë e saj, përveç: injorantëve, fanatikëve fetarë, monistëve ideologjikë, mercenarëve të shitur dhe tradhtarëve bastardë.

Ata shqiptarë që duan të kontribuojnë sot për bashkimin e popullit e të Shqipërisë Etnike, si dhe për mbarëvajtjen e zhvillimit politiko-ekonomik të vendit tonë, nuk duhet të kapen për perandorive të huaja, nuk duhet të përçajnë popullin mbi baza fetare dhe nuk duhet të merren me ideologjitë e ndryshme dhe sistemet shoqërore-politike të njerëzimit. Sepse asnjë ideologji filozofiko-politike dhe asnjë sistem shoqëror-politik deri më sot nuk ia ka sjellë njerëzimit lirinë, pavarësinë, drejtësinë dhe mirëqenien që e meriton. Ideologjitë kanë qenë dhe janë në shërbim të shtetit e të partive, kurse shtetet e partitë kanë qenë e janë në shërbim të klasave sunduese shtypëse e shfrytëzuese të popujve, pavarësisht nga koha

dhe ngjyra e tyre. Por edhe religjionet dhe religjiozët nuk kanë qëndruar gjithmon anash, të përhapin vetëm fjalën dhe besimin e Zotit, por shpesh gjatë historisë janë përzier në punët e popullit, të politikës dhe të shtetit.

Duhet ta njohim të kaluarën për të ndërtuar të ardhmen tonë e të njerëzimit. Por, nuk duhet të merremi shumë me të kaluarën, të bëhemi peng të saj, sepse nuk mund të ecim në të tashmen dhe nuk do ta arrijmë kurrë të ardhmen. Kurrë nuk duhet të harrojmë se çdo gjë në këtë botë është jo vetëm kalimtare dhe e përkohshme, por është edhe relative. Asgjë nuk ka absolute. E mira dhe e keqja bashkëjetojnë. E vërteta dhe gënjeshtra janë të përziera. Drejtësia dhe padrejtësia plotësojnë njëra-tjetrën. Asgjë nuk është e ndarë me shpatë. Bota dhe jeta është një tërësi me dy faqe: bardhë e zi, të cilat ndihmojnë dhe plotësojnë njëra-tjetrën. Liria ime nuk duhet të jetë robëria jote. Unë kam të drejtë aq sa nuk e cënoj të drejtën tënde. Aty ku mbaron e drejta ime, aty fillon e drejta jote. Liria, e vërteta dhe drejtësia nuk njohin rraca, gjini dhe religjione.

Në rradhët e popullit tonë nuk ka vetëm sllavofilë e serbofilë, grekofilë e rusofilë, por ka me shumicë edhe turkofilë e arabofilë. Nuk ka vetëm fundamendalistë islamikë, por ka edhe fundamentalistë të krishterë. Ka fanatikë e reaksionarë të të gjitha llojeve, të cilët duan ta kthejnë rrotën e historisë shumë prapa - në kohën e kryqëzatave fetare, në errësirën e mesjetës dhe të primitivizmit parahistorik!

Ata shqiptarë, apo grupe shqiptarësh, që më tepër thirren në fé se në atdhé, ata më tepër janë fetarë se sa kombëtarë. Ata i kanë të ngatërruara konceptet, parimet dhe prioritetet. Nuk luftohet për atdhe me flamurin e fesë, por me Flamurin Kombëtar të Atdheut. Për fe luftohet me Bibël e Kur'an, kurse për liri me pushkë e jatagan.

Feja pranohet me zemër e bindje shpirtërore, ajo nuk mbillet me dhunë e imponime ligjore. Një populli të tërë, një kombi trim e luftarak si populli ynë nuk mund t'i imponosh asgjë me dhunë: as kombësinë dhe as

religjionin. Një popull të zgjuar, si ky i yni, as nuk mund ta mashtrosh e as ta lajkatosh, që ai të pranojë diçka jashtë vullnetit dhe vetëdijes së tij njerëzore.

Çka pranohet me vullnet, me vullnet mbahet. Çka imponohet me dhunë, me urrejtje flaket. Koha dhe historia e kanë bërë të veten: Kombi shqiptar sot përbëhet nga tri fe e disa sekte fetare, si dhe nga dy Kryedialekte (Gegë e Toskë), nga shumë dialekte e nëndialekte, nga shumë fise e nënfise, nga shumë krahina e treva, nga një mozaik veshjesh kombëtare plotë kolorit, por kjo nuk është varfëri por pasuri, nuk është shëmtim por madhështi, që shumë popuj e kombe në botë e përreth ndoshta ia kanë lakmi e zili popullit dhe atdheut tonë.

Feja nuk është komb, as kombi nuk është fe. Të jesh fetar nuk do të thotë apriori se je kombëtar e atdhetar. Të jesh atdhetar e kombëtar nuk do të thotë apriori se je fetar. Atdhetarët e kombëtarët mund të jenë fetarë, por ata nuk mund t'u përkasin të gjitha feve përnjëherë. Një shqiptarë nuk mund të jetë edhe katolik, edhe mysliman, edhe ortodoks, edhe protestan, edhe budist, etj., por çdo pjesëtarë i këtyre feve mund të jetë atdhetar e kombëtar i vërtetë e i devotshëm. Ndaj të gjithë katolikët, myslimanët e ortodoksët shqiptarë janë Shqiptarë e kombëtarë, këtu nuk ka asnjë dyshim. Jemi degë të një rrënje, të një trungu, të një lisi, të një kombi, të një Atdheu.

Nuk ka fe pa komb, nuk ka komb pa atdhe, nuk ka Shqipëri pa Shqiptarë. Përpara është krijuar nga Zoti Toka, pastaj Atdheu, pastaj Kombi Shqiptar, pastaj religjionet. Ndaj vëllezër e bashkëkombas, mos harroni:

Ne kemi shumë fé, por vetëm një Atdhé.

5 nëntor 2007

Post Festum:

URIME FESTAT - GËZUAR ROBËRINË!

Festat e Nëntorit erdhën, u festuan, u lavdëruan, u lartësuan, u përkujtuan dhe shkuan, kurse varfëria, përçarja, copëtimi dhe robëria mbetën!

Kështu ishte dje dhe kështu mbeti sot. Dhe kështu do të jetë edhe nesër, edhe Nëntorin tjetër, sepse Shqiptarët i biejnë të njëjtit fyell, të njëjtit tupan dhe hedhin të njëjtën valle qe 95 vjet me rradhë!

Shqiptarët (qeveritarët, zyrtarët, politikanët, liderët e historianët) rrafsh një shekull po merren me të kaluarën, me të djeshmen, duke mos mësuar asgjë nga e kaluara dhe nga e djeshmja e historisë sonë kombëtare! Ata dijnë vetëm të ankohen dhe të vajtojnë për të kaluarën tragjike të kombit tonë dhe copëtimin e Shqipërisë Etnike! Ata dijnë vetëm të flasin e të shkruajnë për gjendjen e sotme neokolonialiste të Shqipërisë Etnike të robëruar nga sllavo-grekët dhe aq! Ata vetëm dijnë të sjellin konkluzione për varfërinë dhe mjerimin e trojeve shqiptare, përçarjet e liderëve dhe pushtetarëve shqiptarë dhe aq!

Shqiptarët e njohin realitetin tragjik të Shqipërisë Etnike, e dijnë diagnozën e sëmundjes së saj, por nuk janë të gatshëm e në gjendje që ta ofrojnë ilaçin për shërimin e plagëve të Atdheut! Ata flasin e bërtasin çdo Përvjetor dhe pastaj heshtin, bëjnë gjumë tërë vitin! Ata shkruajnë e flasin dy-tre ditë para Festave të Nëntorit për çështjen kombëtare shqiptare dhe pastaj festojnë e ngrejnë dolli për këtë çerek Shqipërie të cunguar që na ka mbetur!

Shumë u fol e u përfolë këto ditë para dhe gjatë Festave të Nëntorit për të kaluarën, për historinë e përgjakur e dramatike të kombit shqiptar dhe të Shqipërisë. Pak u fol e u shkruajt edhe për të tashmen tragjike të kombit shqiptar dhe të Shqipërisë Etnike. Por asgjë, fare asgjë nuk o fol dhe nuk u shkruajt nga

titullarët kompetentë: politikanët, liderët, historianët, akademikët e intelektualët tanë për ardhmërinë, për perspektivën, për rrugën që duhet të ndjekë kombi ynë për të çliruar dhe ribashkuar Trojet e copëtuara e të robëruara Shqiptare të Shqipërisë Etnike!

Të gjithë folën e shkruajtën për të kaluarën, shumë pak për të tashmen dhe aspak për të ardhmen! Pushtetarët dhe intelektualët shqiptarë duan ta lënë kombin dhe Atdheun tonë pa të ardhme, pa liri, pa ribashkim, pa sovranitet e dinjitet kombëtar! Askush nuk guxoi ta thotë një fjalë se çka duhet të bëjmë sot që të kemi një të ardhme nesër! Udhëheqësit shqiptarë dhe akademikët e intelektualët e kombit tonë nuk kanë ideal kombëtar dhe nuk kanë guxim qytetar që të flasin e të shkruajnë hapur, pa dorëza, për të ardhmen e kombit dhe Atdheut të vet! Vetëdija dhe ndërgjegjja e tyre kombëtare është nën çdo nivel normal!

Kur lexojmë e dëgjojmë, kur shohim e analizojmë të tashmen, të sotmen e popullit dhe Atdheut tonë, e kemi bukur të lehtë që ta vlerësojmë të kaluarën dhe ta parashikojmë të ardhmen e tij. Kur vërejmë çdo ditë sjelljen antipopullore e antikombëtare të parlamentarëve dhe të qeveritarëve tanë në Tiranë, Prishtinë e Shkup, e kemi shumë të lehtë që të konkludojmë se përse populli ynë dhe Atdheu i tij gjenden në këtë gjendje të mjerueshme politike dhe ekonomike! E kuptojmë fare lehtë se përse nuk fituam dje, përse nuk fitojmë sot dhe përse është në pikëpyetje që do të fitojmë edhe nesër lirinë dhe ribashkimin kombëtar të Atdheut tonë të pushtuar!

Pushtetarët shqiptarë nuk çajnë kokën për çlirimin dhe ribashkimin e Atdheut! Atyre nuk u ha palla për varfërinë dhe vuajtjen e popullit! Atyre nuk u bëhet vonë për asgjë! Ata vetëm kujdesen për pasurimin dhe karrierën e tyre politike! Kurse, mjerisht, populli ynë

manipulohet lehtë, mashtrohet në vazhdimësi dhe votën ua jep xhelatëve të vet!

Për të dalë nga situata e pushtimit, robërisë, copëtimit dhe mjerimit ekonomik, për t'i dalë zot popullit dhe Atdheut dalin, herë pas here, në skenën politike dhe ushtarake disa grupe, organizata, parti dhe "ushtri", të cilat, të udhëhequra nga idealistët dhe atdhetarët më të devotshëm të këtij populli, janë përpjekur dhe përpiqen që ta shpëtojnë popullin dhe Atdheun nga kjo gjendje katastrofale në të cilën gjendet aktualisht. Mirëpo, me gjithë sakrificat dhe flijimet e panumërta fitorja nuk është arritur, por pishtari i lirisë është mbajtur ndezur, falë gjakut të dëshmorëve të kombit. Ky flakadan lirie na jep shpresë e forcë se liria dhe ribashkimi kombëtar është i mundur dhe nuk është shumë larg.

Por këta idealistë e luftëtarë lirie, nga qeveritarët shqiptarë dhe miopët e ndryshëm politikë që veten e quajnë intelektualë, analistë e çkamos, etiketohen si: "leckamanë", barkcullakë", "kalamaj", "studentë të dështuar", "aventurierë", "naivë", "ekstremistë", "njerëz me maska e thasë në kokë", "terroristë", dhe shumë epitete tjera denigruese, me qëllimin e vetëm që këta patriotë e liridashës t'i izolojnë nga populli dhe të pamundësojnë realizimin e programit të tyre për çlirim e ribashkim kombëtar të popullit e të Shqipërisë Etnike.

Dhe, fatkeqësisht, deri tani kanë pasur sukses në veprimtarinë e tyre pacifiste, disfatiste dhe antikombëtare! Tani për tani taborri anti-bashkim kombëtar është në epërsi! Qoftë faktori i brendshëm, qoftë ai i jashtëm janë kundër ribashkimit të Shqipërisë Etnike! Ndaj duhet shumë punë, shumë organizim, shumë propagandë dhe shumë sakrifica tani dhe në të ardhmen për t'i kthyer këto dy faktorë në përkrahje të zgjidhjes së drejtë e

përfundimtare të Çështjes Kombëtare Shqiptare në Ballkan.

Edhe këtë Nëntor festash kombëtare u gëzuam për 2 ditë dhe do të vuajmë për 12 muaj, deri në Nëntorin e vitit 2008. Dhe kështu rutinë, qark vicioz festimi dhe robërie! Dhe raporti liri - robëri është 12 me 2 për robërinë! Ky është realiteti i hidhur e real i kombit tonë dhe Shqipërisë sonë të copëtuar! Prandaj, me njërën gotë në dorën e djathtë, plot shend e verë, ngritëm dollinë e ëmbël sheqer: Urime Festat!, kurse me tjetrën gotë në dorën e majtë, vetëm pas pak, ngritëm dollinë tjetër farmak: Gëzuar Robërinë!

Pra, Urime Festat - Gëzuar Robërinë!, Shqipëria ime luftarake dhe paqësore, vend i shqiponjave dhe korbave, vendi i kontrasteve dhe çudirave, vendi paradoksal i paradokseve!

3 dhjetor 2007

II - KOSOVA

PACIFIKIMI DHE ZGJIMI I KOSOVËS

Qëllimi, synimi dhe strategjia afatshkurtër dhe afatgjatë e çdo pushtuesi dhe sundimtari është nënshtrimi, tjetërsimi, frikësimi e pacifikimi i popllit të robëruar, pastaj shfrytëzimi ekonomik i pasurive nën e mbitokësore të vendit të okupuar dhe në fund fare asimilimi ose dëbimi i popullit autokton dhe përjetësimi i pushtimit.

Këtë taktikë dhe strategji politike e ushtarake kanë ndjekur Serbia, Greqia dhe të tjerët para dhe pas pushtimit të Shqipërisë Etnike. Këtë politikë shkombëtarizuese, gjenocidale dhe të përvetësimit të tokave tona po vazhdojnë të ushtrojnë edhe sot e kësaj dite shovenistët pushtuesë sllavo-grekë në trojet tona etnike të pushtuara.

Por, ajo që është më tragjike dhe më e dhimbshme është fakti se këtij sundimi dhe kësaj politike antishqiptare të armiqve tanë i kanë ndihmuar, në të gjitha kohërat dhe periudhat, edhe vazalët, shërbëtorët dhe puthadorët tanë shqipfolës!

Unë nuk do të shkoj larg në thellësitë e errëta të historisë së këtij vazaliteti antikombëtar të pushtetarëve e bajraktarëve tanë, por do të ndalem vetëm në kohën tonë më të re të kësaj historie vazaliteti dhe fataliteti antishqiptar të shqipfolësve tanë pushtetarë.

Unë nuk do të ndalem të shkruaj për periudhën e zgjimeve dhe pacifikimeve të Kosovës gjatë sundimit të regjimeve ish-jugosllave, sepse për to është folur e shkruar mjaft, siç është Lëvizja Kaçake e viteve 1914-1925, Lufta Antifashiste 1940-1945, Demonstratat Revolucionare të Nëntorit 1968, Demonstratat

Revolucionare të Pranverës së vitit 1981 dhe Demonstratat e Punëtorëve të vitit 1989.

1.Pacifikimi I i Kosovës – 1989-1997 (Rugovizmi)

Atë që nisi frontalisht me polici e ushtri, pacifikimin dhe nënshtrimin e shqiptarëve, ish-Jugosllavia dhe Serbia millosheviçiane pas Demonstratave të vitit 1981 e 1989, e vazhdoi me vazalitet mesjetar e devotshmëri të pashoqe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me disa partiza të vogla aleate të saj në vitet 1989-1997!

Që nga themelimi dhe në vazhdimësi LDK-ja përqafoi me fanatizëm të shfrenuar filozofinë pasive paqësore e ”gandiste” të ”luftës” për Pavarësinë e Kosovës. Kjo ”filozofi” paqësore jo vetëm që nuk arriti kurrë sukses, sepse me një armik mijëravjeçarë, siç është sllavizmi, nuk mund të bisedohet kurrë paqësisht e jo më të fitohet në rrugë paqësore, por kjo politikë bëri efektin e kundërt në popull. Ajo e frikësoi popullin, e pacifikoi atë, ia humbi besimin në forcat e veta, ia topiti vetëinisiativën, ia vrau guximin, e pasivizoi deri në maksimum, duke e lënë në mëshirë të armikut pushtues dhe të politikës antishqiptare të Evropës. Motoja e LDK-së dhe satelitëve të saj ishte: ”Ne do të fitojmë çka të na japë Evropa”! Ishte kjo një politikë pa dinjitet, pa bosht kurrizor, një politikë inferiore e nënçmimit kombëtar dhe e lëmoshës!

Shumë nga popujt e ish-Jugosllavisë po luftonin dhe mbronin me armë në dorë lirinë dhe pavarësinë e tyre gjatë viteve 1991-1995, kurse LDK-ja e mbante popullin tonë peng të politikës së saj ”gandiste” dhe nën një terror të vazhdueshëm psiqik, duke e frikësuar me terrorin dhe gjenocidin e Serbisë! Në këtë mënyrë në vitet 1990-1995 nga Kosova u shpërngulën rreth gjysmë milioni (500 000)

shqiptarë në shtete të ndryshme të botës! Edhe atëherë kur, më në fund, pas një përpjekjeje titanike 5 vjeçare 1992-1997 Adem Jashari me UÇK-ën arritën që ta vrasin frikën dhe rrokën armët, LDK-ja dhe aleatët e saj e quanin UÇK-në dhe Kryekomandantin Legjandar Adem Jasharin "dorë e zgjatur e UDB-së dhe e Serbisë"! LDK-istët e sabotuan me të gjitha mjetet në disponim luftën çlirimtare të UÇK-së, deri edhe me armë, duke formuar "ushtrinë" e tyre fantome - FARK-un! E tmerrshme, por e vërtetë!

Megjithë kundërvënien UÇK-së dhe popullit liridashës nga ana e LDK-së dhe aleatëve të tyre, lufta për liri dhe bashkim kombëtar e popullit të Kosovës nuk u ndal, por ajo u gjymtua shumë rëndë nga pacifistët, sepse ata me shantazhet, propagandën anti-luftë çlirimtare e anti-UÇK arritën që ta demoralizojnë e çorientojnë popullin që ai të mos futet në mënyrë masovike në rradhët e UÇK-së, por të marrë udhën e braktisjes së atdheut, të shpërnguljes masive dhe të ikjes në Shqipëri dhe në Iliridë!

2.Zgjimi I i Kosovës – 1997-2001 (Epopeja e UÇK-së, UÇPMB-së

Pacifikimin fatal që ia bëri Kosovës politika pasive pacifiste dhe injorante e LDK-së, e ndërpreu lufta dhe qëndresa heroike e Familjes atdhetare Jashari, në Kullat e Jasharajve, e udhëhequr nga Kryekomandanti i UÇK-së, Heroi Adem Jashari, në Mars të vitit 1997. Këtë muaj e këtë vit të bekuar dhe historik Kosova u zgjua, u këndellë, e vrau frikën, u shkund nga pacifizmi rugovian dhe përqafoi rrugën luftarake të Adem Jasharit e të UÇK-së për të kthyer në vend dinjitetin e nëpërkëmbur kombëtar dhe për të fituar lirinë e vërtetë kombëtare.

Zgjimi patriotiko-revolucionar e luftarak i Kosovës zgjati më pak se dy vite e gjysmë, mars 1997 - qershor 1999, sepse intervenimi i NATO-s kundër ushtrisë serbe e ndërpreu luftën çlirimtare të UÇK-së dhe të popullit shqiptar të Kosovës për çlirim dhe bashkim kombëtar. Intervenimi i NATO-s pati dy qëllime: 1.ndërprerjen e gjenocidit ushtarako-policor të Serbisë mbi popullsinë civile shqiptare të Kosovës dhe 2.ndërprerjen e luftës çlirimtare për bashkim kombëtar të UÇK-së.

Dikush në Evropë dhe në botë nuk e shihte me sy të mirë forcimin dhe rritjen e vazhdueshme të UÇK-së, mbështetjen e saj në rritje nga populli dhe programin politik e ushtarak të saj për çlirim dhe bashkim kombëtar me Shqipërinë. Prandaj u mor vendimi nga Fuqitë e Mëdha për ndërprerjen e luftës shqiptaro-serbe me intervenimin ushtarak të NATO-s, pasi dështuan përpjekjet diplomatike evro-amerikane për ndërprejen paqësore të luftës nga refuzimi i Serbisë. Intervenimi i NATO-s qe shpëtim për Serbinë dhe millosheviçizmin, i cili mbijetoi dhe sot po udhëheq me shtetin serb në emër të Koshtunicës, Sheshelit, Nikoliçit e Tadiçit. Kështu, sot Fuqitë e Mëdha bëjnë negociata me millosheviçizmin pa Millosheviçin dhe e lusin atë që mundësisht ta pranojë Pavarësinë e mbikqyrur (tredhur) të Kosovës!

Fuqitë e Mëdha i trembeshin përhapjes së luftës edhe në territoret tjera shqiptare në Iliridë, në Kosovën Lindore dhe në Malësi të Madhe, prandaj intervenuan kundër Serbisë që në këtë mënyrë edhe të ndërpresin luftën çlirimtare për bashkim kombëtar të shqiptarëve. Ata e dinin se me kalimin e kohës do të bëhej homogjenizimi dhe bashkimi luftarak i mbarë kombit shqiptar të Shqipërisë Etnike dhe do të hapej fronti i vërtetë i luftës shqiptaro-serbe, edhe me futjen e Shqipërisë (londineze) në luftë, dhe kështu shqiptarët do të bënin bashkimin

kombëtar. Por kjo nuk i konvenonte Evropës berlineze, londineze e versajase, prandaj në emër "të mbrojtjes së popullit të Kosovës" nga Serbia, ata ndëhynë, intervenuan ushtarakisht dhe e ndërprenë luftën regjionale e krahinore të Kosovës që të mos shndërrohej në një Kryengritje të Përgjithshme Shqiptare për bërjen e Shqipërisë Etnike.

Megjithatë, shtrirja e luftës në Iliridë dhe në Kosovën Lindore nuk mundi të ndalet, ajo shpërtheu edhe atje gjatë viteve 2000-2001, por me vonesë të madhe, e papërgatitur sa duhet dhe e pa koordinuar në nivel mbarëkombëtar, sepse tanimë lufta e Kosovës ishte ndërprerë, kurse UÇK-ja e saj ishte çarmatosur dhe shpërbërë nga Faktori Ndërkombëtar. Por as në luftën e Kosovës Lindore dhe të Iliridës Fuqitë e Mëdha nuk ndejtën duarkryq, por intervenuan me rrugë diplomatike, ndërhynë me shantazhe e kërcënime kundër UÇPMB-së e UÇKombëtare dhe me manipulime e demagogji, se gjoja shqiptarët në Kosovën Lindore e në Iliridë do të fitojnë të drejtat e tyre kombëtare, arritën deri te ndërprerja e luftës, te nënshkrimi i Marrëveshjes së Konçulit dhe Marrëveshjes së Ohrit, të cilat "Marrëveshje" nuk u realizuan, nuk u zbatuan e nuk u implementuan kurrë në praktikë as sot e kësaj dite dhe, siç duket, nuk do të zbatohen plotësisht asnjëherë! Kështu, Zgjimi I i shqiptarëve për liri e bashkim kombëtar përfundoi pa sukses.

3.Pacifikimi II i Kosovës - 1999-2007 (KFOR-UNMIK)

Me largimin e ushtrisë serbe nga Kosova dhe me instalimin atje të KFOR-it dhe të UNMIK-ut filloi faktikisht Pacifikimi II i shqiptarëve të Kosovës, por këtë herë jo nga

serbët po nga ndërkombëtarët, nga aleatët dhe miqtë tanë të rrejshëm!

Punën e parë që bënë forcat ushtarake (KFOR) dhe civile-politike (UNMIK) në Kosovë ishte ndarja e Kosovës veriore në lumin Ibër nga trungu integral i Kosovës. Pastaj vazhdoi me maltretimin e nacionalistëve shqiptarë, ish-ushtarëve të UÇK-së, ndalimin e Flamurit Kombëtar, heqjen e fotografive të Adem Jasharit nga vendet publike, shpërbërjen e UÇK-së, inkriminimin e luftës çlirimtare të UÇK-së, duke burgosur komandantët e saj, me qëllim që të barazojë viktimën me xhelatin, me qëllim që të rehabilitojë luftën pushtuese dhe gjenocidin fashist serb mbi Kosovën! Më tej KFOR-i dhe UNMIK-u vazhduan me moslejimin e mbajtjes së Referendumit Popullor të premtuar në Konferencën e Rambujesë, mohimin e të drejtës së Vetëvendosjes së Kosovës dhe në këtë mënyrë mohoi dhe vazhdon të mohojë edhe të drejtën e shpalljes dhe të njohjes ndërkombëtare të Shtetit të Pavarur e Sovran të Kosovës!

Përmes KFOR-it dhe UNMIK-ut u mundësua hartimi i Pakos së Ahtisaarit, e cila e ndau edhe njëherë Kosovën brenda-përbrenda saj me të ashtuquajturin ”decentralizim” i pushtetit vendor (lokal)! Ky ishte copëtimi i dytë i Kosovës (nga ndërkombëtarët), pas atij të ndarjes së 25% të territorit të saj në Veri të lumit Ibër në qershor të vitit 1999!

Tani, me të ashtuquajturat ”negociatat shtesë” për 120 ditë të Kosovës me Serbinë, deri më 10 dhjetor 2007, faktori ndërkombëtar tenton që ta ulë edhe më poshtë ”pazarin” e Kosovës, duke e shantazhuar atë që të pranojë ose Autonominë ”Substanciale” në kuadër të Serbisë, ose Unionin Kosovë-Serbi si ”Republikë Bananesh”, ose ndarjen e Kosovës veriore, por pa u kompenzuar kjo ndarje me bashkimin e Kosovës Lindore me Shtetin

gjysmak të Kosovës! Cilën alternativë kobzezë do ta pranojë Grupi ”ynë” Negociator, do ta tregojë shumë shpejtë e ardhmja! Por shqiptarët e Kosovës nuk do ta pranojnë as njërën dhe as tjetrën alternativë. Pazaret bëhen pa ”mullixhinë”, pa të zotin e vendit – kombin shqiptar! Prandaj edhe të gjitha ”pazaret” do të dështojnë me turp. Alternativa e vetme që e pranojnë shqiptarët e Kosovës dhe mbarë kombi shqiptar është bashkimi kombëtarë i shqiptarëve dhe trojeve të tij në një Shqipëri Etnike të Bashkuar.

Faktori politik ndërkombëtar, me ndihmën e KFOR-it dhe UNMIK-ut, po punon hapur e fshehtas kundër Pavarësisë së Kosovës, për pacifikimin përfundimtar të saj dhe në fund futjen e Kosovës (në një mënyrë apo tjetër) nën ombrellën e Serbisë! Kurse shqiptarët janë hipnotizuar aq shumë nga KFOR-i, UNMIK-u dhe aleatët e miqtë tanë të rrejshëm (sikurse në kohën e Rugovës), sa që për ta është temë tabu, e paprekshme, e shenjtë kritika ndaj KFOR-it, UNMIK-ut apo disa miqve tanë, para hundëve të të cilëve Kosova u nda dy herë dhe ata nuk ndërmorrën asgjë!

Kosova nuk u bë dhe nuk bëhet Shtet i Pavarur qe 8 vjet rresht dhe ”miqtë e aleatët” tanë nuk çajnë kokën! Edhe këto bisedime për gjoja ”pavarësi” e statusin e ardhshëm të Kosovës, që nisën më 2006-ën, janë rezultat i atyre viktimave shqiptare që humbën jetën në përleshje me fashistët serbë, të cilët bllokonin rrugët e shqiptarëve anembanë Kosovës kur t’u kujtohej, kurse KFOR-i dhe UNMIK-u nuk ndërmerrnin asnjë masë kundër atyre fashistëve për zhbllokimin e rrugëve! Dhe kur shqiptarët tentuan t’i hapin vetë rrugët e bllokuara, ata u gjuajtën me breshëri plumbash të KFOR-it dhe u përgjakën e u vranë me dhjetëra djem e vajza të Kosovës nga forcat ushtarako-policore të UNMIK-ut, sikur të ishin bubrreca e

jo njerëz në tokën e vet, që kërkonin të jetojnë të lirë në tokën e vet!

Po të ishte KFOR-i aleati ynë, ai do ta bashkonte Kosovën menjëherë pas ndarjes së saj më 1999! Por këtë nuk e bën, sepse nuk e lejon Marrëveshja e fshehtë e Kumanovës e bërë me Millosheviçin për ndarjen e Kosovës dhe në dëm të shqiptarëve e të Kosovës! Po të ishte KFOR-i e UNMIK-u aleati ynë nuk do ta shpallnin Kosovën "multietnike" me vetëm 10% të popullsisë së saj me pakica kombëtare! Kur dihet se shumica e shteteve evropiane që i thonë vetes shtete kombëtare kanë një numër dy-tre fish më të madh të pakicave tjera etnike dhe nuk emërtohen si shtete multietnike. Por Kosova, sipas kurthave antishqiptare të Evropës dhe të tjerëve, "duhet" të jetë multietnike, serbe, sllave e gjithëçka tjetër, por vetëm shqiptare nuk guxon të quhet dhe as të mbesë! Ky ishte dhe është misioni politiko-ushtarak i Fuqive të Mëdha dhe "aleatëve" e "miqëve" tanë – shpërbërja etnike e Kosovës, mosbërja e saj Shtet dhe vdekja e ngadalshme, klinike, e saj!

Aty ku e la politika pacifiste e disfatiste e LDK-së, punën e saj për shpërfytyrimin dhe pacifikimin e Kosovës, nga aty e vazhdoi dhe e vazhdon KFOR-i, UNMIK-u dhe vazalët e mercenarët e shumtë shqipfolës të tyre, të cilët vegjetojnë si krimbat e mëndafshit në Qeveri, në Kuvend dhe në Grupin Negociator!

4.Zgjimi II i Kosovës – 2008-2010-2012... (FBKSH-AKSH-VETËVENDOSJA...)

Populli shqiptar i Kosovës, Iliridës, Kosovës Lindore dhe Malësisë së Madhe asnjëherë nuk ka mbetur jetim, pa bij e bija, pa luftëtarë të lirisë. Edhe pse me manipulimet e shantazhet e të huajve dhe me gabimet e lëshimet e

shqiptarëve, u bë çarmatosja e luftëtarëve të lirisë dhe shpërbërja e tri UÇK-ëve, populli shqiptar i Shqipërisë së robëruar Etnike kurrë nuk u çarmatos, kurrë nuk u dorëzua, kurrë nuk e ndërpreu luftën për liri, por u organizua dhe u mobilizua në rradhët e Frontit për Bashkim Kombëtar Shqiptar (FBKSH) dhe u rreshtua si ushtarë në rradhët e Armatës Kombëtare Shqiptare (AKSH).

Aktualisht, krahas Organizatës VETËVENDOSJA dhe ndonjë tjetre, FBKSH-ja dhe AKSH-ja janë forcat më të organizuara politiko-ushtarake në nivel kombëtar, të cilat janë aktive dhe veprojnë vazhdimisht për mobilizimin dhe përgatitjen e popullit tonë për tu zgjuar përsëri, për tu ngritur në këmbë dhe për të shpërthyer në Kryengritje të Përgjithshme Kombëtare, për të fituar përfundimisht lirinë dhe për të çliruar e bashkuar Atdheun e copëtuar – Shqipërinë Etnike.

Aty ku e lanë luftën çlirimtare tri UÇK-të, prej aty e vazhduan dhe po e çojnë përpara qëndresën dhe luftën çlirimtare FBKSH-ja, VETËVENDOSJA dhe AKSH-ja. Në këtë mënyrë, AKSH-ja nuk është diçka e re, e huaj apo e paqenë, ajo është vazhdimësi e tri UÇK-ve por me emër tjetër, ajo mbiu nga dheu ilirian i Shqipërisë Etnike dhe doli nga gjiri i këtij populli të robëruar, por liridashës dhe luftarak. Ashtu siç është i pavdekshëm populli ynë, ashtu është e pamposhtur edhe AKSH-ja.

FBKSH-ja dhe AKSH-ja, por edhe VETËVENDOSJA, kanë një Platformë Politike e Ushtarake Mbarëkombëtare, kanë një Program Atdhetar e Çlirimtar dhe janë të vendosura që ta realizojnë pikë për pikë Platformën dhe Programin e tyre, janë të vendosura që ta çojnë deri në fund amanetin e brezave dhe ta bëjnë realitet idealin e dëshmorëve dhe heronjve të panumërt të kombit tonë, të

cilët luftuan, derdhën gjakun dhe dhanë jetën ndër shekuj për lirinë e Shqipërisë Etnike.

Vetëm lufta e armatosur e AKSH-së do të bëjë të mundshëm realizimin e Betimit të Luftëtarëve të Lirisë për një shtet dhe komb shqiptar të bashkuar e të lirë. Rrugë tjetër nuk ka. Ose luftë për liri e bashkim kombëtar me AKSH-në në ballë, ose robëri, pushtim, copëtim e skllavëri. Është në dorën dhe në vullnetin e kombit shqiptar se cilën rrugë do të zgjedhë: Rrugën e nderit e të luftës për liri, apo rrugën e turpit, të nënshtrimit e të robërisë.

Pacifikimit të turpshëm e të dështuar të Kosovës nga vendorët dhe të huajtë po i vjen fundi. Edhe sunimit të Serbisë në Kosovë, përmes dorës së saj të zgjatur – UNMIK-ut, poashtu po i vjen fundi. Pushtetarëve të vjetër e të rinj, vazalëve e mercenarëve shqipfolës po u rrëshqet toka nën këmbë për çdo ditë e më shumë. Neokolinializmit unmikistanez të Kosovës po i afrohet fundi. Kosova dhe shqiptarët kanë filluar të lëvizin, të ndihen gjallë. Kosova dhe shqiptarët po zgjohen e kthjellohen për çdo ditë e më tepër për t'i dalë zot vetvetes dhe atdheut të tyre që është në rrezik. Zgjimi II i Kosovës dhe i mbarë Shqipërisë Etnike ka filluar dhe do të shpërthejë së shpejti. Shqiptarët nuk kanë më kohë për të humbur. Shqipëria Etnike nuk ka më territore për të falur fqinjëve fashistë e pushtuesë. Ora e Zgjimit të Madh Kombëtar ka filluar të numërojë dhe shumë shpejtë do të dëgjohet e do të ushtojë Kushtrimi Mbarëkombëtar për Liri, Bashkim Kombëtar dhe për bërjen e Shqipërisë Etnike.

5 shtator 2007 (Titan Tivari)

KOSOVA – RAST UNIK DHE PRECEDENT!

Në qarqet politike e diplomatike botërore, me daljen në rend të ditës të statusit të Kosovës, u shfaqën papritur edhe dy shprehje diplomatiko-politike:

1.Kosova është **rast unik**
2.Kosova është **precedent**

-*Rast unik* do të thotë të jesh i veçantë, specifik, special, i papërsëritshëm, sui generis,…

-*Precedent* do të thotë: justifikim, argumentim, arsyetim, referencë, pretekst, kopjim, shkak,…

Ç'është rast unik?

Rast i veçantë apo unik do të thotë që Kosova dhe populli i saj të kërkojnë diçka të veçantë, diçka speciale, diçka të jashtëzakonshme e të panjohur deri më sot nga njerëzimi. Por kjo nuk është e vërtetë, sepse Kosova kërkon liri e pavarësi, si të gjithë popujt tjerë të botës, qofshin këta tanimë të lirë apo ata që janë ende të robëruar.

Nisur nga emri i saj si Kosovë dhe popull shqiptar, Kosova edhe është rast i veçantë, sepse asnjë vend tjetër në botë nuk ka këtë emër. Por nga aspekti i përmbajtjes dhe thelbit të kërkesës së saj për liri, pavarësi dhe shtet sovran është i njëjtë, jo unik por identik me të shumtën e rasteve tjera, të popujve tjerë të botës që luftojnë për liri e pavarësi kombëtare. Liria dhe pavarësia kombëtare është identike për të gjithë popujt e pushtuar e të robëruar të botës.

Kosova emërtohet si rast "unik" jo vetëm për të mohuar lirinë dhe pavarësinë e popujve të tjerë në botë, por edhe për të mohuar bashkimin kombëtar dhe ribërjen e Shqipërisë Etnike. Po të mos ishte cilësuar Kosova si rast "unik", atëherë ajo do të ishte rast i përgjithshëm e normal dhe si rrjedhojë logjike e ligjore do të kishte të drejtën e Vetëvendosjes dhe Referendumit Popullor për mes të cilëve populli i saj do të vendoste lirisht,

vullnetarisht dhe demokratikisht për ardhmërinë e vendit të tij. Dhe, permes shprehjes së vullnetit të saj, sot Kosova ose do të ishte shtet vërtetë i pavarur e sovran, ose do të ishte bashkuar me trungun amë - Shqipërinë.

Por jo, ajo është shpallur dinakërisht rast "unik" nga Fuqitë e Mëdha, ndaj ajo nuk ka të drejtë për Vetëvendosje e Referendum, sepse Karta e OKB-së nuk parasheh përdorimin e kësaj të drejte për vendet dhe rastet "unike, "të veçanta e speciale", siç është kategorizuar me djallëzi Kosova! Kosova është nxjerrë jashtë kontekstit planetar, është përjashtuar nga bashkësia e popujve dhe kombeve të kësaj Toke, duke iu dhënë atribute jashtëtokësore e kozmike! Ajo është shpallur "unike", e paprekshme, "mollë e ndaluar", e pakapshme, joreale, mitike, jashtë kohës dhe hapësirës së globit tonë! Kosovën, porsi Anteun "perënditë" dredharake të Olimpit, Fuqitë Neokolonialiste Evro-Aziatike duan që ta shkëpusin nga Toka-Mëmë, ta ngrejnë pezull, ta shndërrojnë në ireale, ta dobësojnë, ta mposhtin dhe në fund ta asgjësojnë, duke e asimiluar e tjetërsuar identitetin e saj pellazgo-iliro-shqiptar!

Kosova nuk është aspak rast i veçantë për zgjidhjen e një problemi politik e kombëtar, ajo është diçka e shpikur. Si mund të jetë rast i veçantë e unik në këtë botë të madhe që gumëzhinë nga luftërat ndëretnike, kolonialiste, pushtuese e antipopullore në të katër anët e Globit tokësor?! Kosova nuk është vendi i vetëm në botë që është i robëruar dhe që kërkon liri e pavarësi, prandaj edhe nuk mund të jetë rast i veçantë, por është rast i përgjithshëm, njëri ndër rastet e shumtë në botë që kërkon zgjidhje politike, demokratike e kombëtare.

Kosova nuk është rast unik për veten e saj, ajo është rast unik për Fuqitë e Mëdha, të cilat nuk duan që t'ua njohin popujve të pushtuar e të shtypur lirinë dhe pavarësinë kombëtare. Dhe sajojnë pastaj lloj-lloj terminesh politiko-diplomatike për të justifikuar sjelljet, qëndrimet dhe vendimet e tyre në disfavor të lirisë, barazisë dhe pavarësisë së popujve.

Nga cilësimi i Kosovës si rast unik ajo humb ribashkimin kombëtar, lirinë e vërtetë, sovranitetin dhe integritetin territorial. Për këtë flet qartë e ashtuquajtura "Pakoja e Ahtisaarit"! Rast "unik", por edhe Pako "unike", enklaviste, dezintegruese e antishqiptare! Rast "unik", por edhe status "unik", pavarësi "unike" (të kufizuar, gjysmëpavarësi)! Kosova rast "unik", por edhe "shtet unik" me pavarësi të mbikqyrur, të mbikomanduar, të mbikontrolluar, neokoloni moderne, me mbikëqyrje të maskuar e kamufluar dhelpërisht! Kosova rast "unik" do të thotë që edhe liria e pavarësia e saj të mos jenë reale dhe të vërteta si të shteteve e kombeve të civilizuara të Europës, por të jetë një "shtet" me kuaziliri, me pseudopavarësi dhe me sovranitet të kufizuar!

Çka është precedenti?

Precedenti është justifikim, arsyetim për veprimet e një partie, qeverie, shteti apo populli për të vërtetuar drejtësinë e aspiratave, synimeve dhe kërkesave të një shteti apo populli.

Me anë të precedentit një qeveri, shtet apo popull bën krahasimin ndërmjet veprimit e luftës së tij dhe luftës së mëparshme të popujve të tjerë.

Precedenti shërben për popujt tjerë në botë që të kërkojnë liri, vetëvendosje, pavarësi, ashtu siç ka kërkuar një vend e popull tjetër përpara tij.

Precedenti apo justifikimi përdoret edhe nga Kosova për të sqaruar dhe argumentuar para opinionit publik ndërkombëtar dhe para faktorëve politik vendimmarrës kërkesën e saj, vullnetin e saj legjitim për liri e pavarësi kombëtare.

Precedentin nuk e përdor e para Kosova dhe kombi shqiptar për liri, pavarësi dhe bashkim kombëtar. Dhe poashtu, ne nuk jemi dhe as nuk do të jemi të fundit që do ta përdorim argumentin e precedentit për të përforcuar aspiratat tona kombëtare.

Precedenti është pikëmbështetëse dhe pikë referimi e një partie, qeverie, shteti apo populli për të realizuar programin politik për pushtet, zhvillim, liri e pavarësi.

Precedentin e përdorin të gjithë popujt e robëruar të botës, ashtu siç e përdorin edhe shtetet agresore për të justifikuar sulmin dhe pushtimin e shtetit tjetër.

Rastin më të freskët të precedentit agresiv e kemi vendimin e Parlamentit të Turqisë për të okupuar Irakun Verior nën pretektin e asgjësimit të "terroristëve" kurdë në pjesën e Kurdistanit të pushtuar nga Iraku!!!

Çështja e lirisë dhe e pavarësisë së Kosovës krijon dhe është e natyrshme të krijojë precedent, sepse të gjithë popujt e robëruar janë njerëz, janë të barabartë dhe kanë të njëjtat të drejta njerëzore e kombëtare që të jenë të lirë e sovranë në atdheun e tyre. Për shembëll, pse pakica serbe prej 5-6% e Kosovës të ketë gjithë ato të drejta, të drejtat e kombit shtetformues, kurse kjo t'i mohohet pjesës së kombit shqiptar në Maqedoni që përbën rreth 45% të popullsisë së këti vendi?! A ka logjikë të shëndoshë filozofike, politike e juridike që mund ta arsyetojë këtë diferencim flagrant?! Ky është precedenti i parë që populli shqiptar mund ta përdor në përpjekjet e tij për t'u bërë faktor shtetformues në Maqedoni. Ose pse Serbia për 5% të pakicës serbe kërkon statusin e kombit në Kosovë, kurse 7% të shqiptarëve në Kosovën Lindore nuk ua njeh një të drejtë të tillë politiko-territoriale dhe juridike?! Pse të mos formohet Krahina e Sanxhakut Republikë Autonome në Serbi, siç është Republika Serbe në Bosnjë e Hercegovinë?! Ja precedenti tjetër. Ballkani dhe bota janë të mbushur përplot raste të tilla gjithandej rruzullit tokësor!

Liria dhe pavarësia e dikujt automatikisht krijon precedent te popujt e robëruar, kjo është jo vetëm njerëzore dhe e natyrshme, por edhe e drejtë dhe e ligjshme.

Liria është liri, pavarësia është pavarësi dhe sovraniteti kombëtar është sovranitet kombëtar. Dhe këto

janë të njëjtë për të gjithë vendet dhe kombet e botës. Pavarësisht i pëlqen apo nuk i pëlqen dikujt.

*****

Robëria është robëri dhe pushtimi është pushtim. Nuk ka shumë lloj robërishë e pushtimesh, por ka një vargan të pambarim me PSE?

Pse Turqia, Irani, Siria e Iraku mund të jetë pushtuesë “më të mire” se Serbia dhe duhet ta mbajnë Kurdistanin nën copëtim, pushtim dhe robëri?!

Pse Greqia u pranua anëtare e "Bashkimit" Europian, me Çamërinë e pushtuar dhe kur e ka shpallë veten si shtet të pastër etnik, duke mohuar ekzistencën dhe të drejtat demokratike e njerëzore të pakicave tjera etnike në Greqi?!

Pse Rumania u cilësua si shtet “demokratik” dhe i “plotësoi” kushtet për anëtarësim në "Bashkimin" Europian, kur nën pushtim mbanë Transilvaninë hungareze me mbi 3 miljon hungarez?!

Pse nuk paska të drejtë Kurdistani e Baskia për shtete të pavarura, kur ata popuj e vende nuk kanë asgjë të përbashkët me shtetet që i mbajnë në robëri, përveç se janë vende e popuj fqinj?!

Pse Transilvania nuk paska të drejtë të bashkohet me Hungari, dhe as Moldavia me Rumani?!

Pse pati të drejtë Timori Lindor të shkëputet nga Indonezia, kurse një të drejtë të tillë nuk e ka krahina e Acehut po nga ky shtet?!

Pse u krijua shtet nga hiçi Republika Serbe në Bosnjë e Hercegovinë, kurse Krahina e Vojvodinës nuk paska të drejtë të ngritet në rangun e një Republike të tillë si ajo?!

Pse patën të drejtë 400.000 malazezët që të mbajnë Referendum për shtet sovran, kurse 3 miljon Shqiptarët e ish-Jugosllavisë nuk paskan këtë të drejtë?!

Pse paskan të drejtë krahinëzat si Osetia Jugore dhe Abkhazia që të shkëputen nga Gjeorgjia, kurse Çeçenia që

veç është njëfarë Republike Autonome, nuk paska të drejtë të shkëputjes dhe të pavarësimit të saj nga Federata e Rusisë?!

Pse duhet që Tajvani të bashkohet me Kinën, kurse Tibeti dhe 1/3 e Mongolisë nuk paska të drejtë të shkëputen dhe të pavarësohen nga Kina?!

Pse nuk ka të drejtë Kashmiri, që është i ndarë përgjysmë ndërmjet Indisë e Pakistanit, që të bashkohet në një shtet sovran e të pavarur?!

Pse nuk ka të drejtë Irlanda e Veriut të bashkohet me Irlandën, kurse dy Vietnamët dhe dy Gjermanitë patën të drejtë ribashkimi?!

Pse nuk ka të drejtë të ribashkohet Shqipëria Etnike, e cila aktualisht është e ndarë nga katër shtete shoveniste fqinje?!

Ç'janë këto të "drejta" simetrike, asimetrike, arbitrare, parabolike e diabolike, që na shfaqen herë si "Engjëll" e herë si Djallë?!

Sepse Fuqitë e Mëdha janë kundër vetëvendosjes së popujve, kundër lirisë dhe pavarësisë kombëtare të tyre!

Të gjithë këto kanë të "drejtë", sepse nuk ka drejtësi, nuk ka demokraci e demokratë, nuk ka sinqeritet! Sepse të drejtë ka ai që është më i fortë, më i egër dhe më dinak!

*****

Të gjitha çështjet e hapura kombëtare nëpër botë dallohen sipërfaqësisht e në nuanca të vogla nga njëra-tjetra, por në thelb ato janë të njëjta dhe identike me njëra-tjetrën, sepse liria është liri, pavarësia është pavarësi, drejtësia është drejtësi dhe vetëvendosja është vetëvendosje. Këto vlera njerëzore, demokratike, juridike e politike vlejnë dhe duhet të vlejnë njësoj për të gjithë njerëzit, për të gjithë popujt dhe kombet e njerëzimit.

Dallimet historike dhe gjeopolitike janë aq të vogla ndërmjet këtyre popujve e vendeve që kërkojnë vetëvendosje e pavarësi, sa që ato janë të papërfillshme. Së paku kështu duhet të jenë, por në fakt ato "nuk janë"

të tilla, sepse nuk duan që të jenë kështu Fuqitë e Mëdha, të cilat fabrikojnë e shpikin lloj-lloj terminesh diplomatiko-politike në dëm të lirisë dhe të pavarësisë së popujve dhe në favor të interesave të tyre ekonomiko-politike shtypëse e shfrytëzuese!

Si për zgjidhjen e statusit të Kosovës, si për zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare, ashtu edhe për zgjidhjen e të gjitha çështjeve tjera kombëtare dhe konflikteve ndëretnike nëpër botë, tanimë ekziston formula e zgjidhjes së tyre – ajo është Karta e Kombeve të Bashkuara mbi Vetëvendosjen e Popujve me të drejtë shkëputjeje e pavarësie. Por, për çudi të të gjithëve, kjo anashkalohet, injorohet, nuk zbatohet dhe në vend të kësaj Karte Univerzale Fuqitë e Mëdha të kohës fabrikojnë e shpikin "karta" e "rregulla" të tjera se si duhet të zgjidhen çështjet kombëtare dhe konfliktet e ndryshme etnike në botë!

Ata të cilët i kanë aprovuar Ligjet Ndërkombëtare, po ata i shkelin me të dyja këmbët ato ligje, duke e zhytur njerëzimin në një det prej gjaku nga luftërat dhe përleshjet e përditshme midis popujve dhe grupeve të ndryshme etnike!

Vetëvendosja, liria dhe pavarësia e vendeve dhe popujve të ndryshëm etnikisht, është e drejtë universale njerëzore dhe si e tillë duhet të zbatohet në të gjitha konfliktet ndërtetnike të botës.

Vetëvendosje do të thotë vullnet, liri, pavarësi, sovranitet, shtet, prosperitet, paqë, zhvillim ekonomik, fqinjësi e mirë në mes shteteve e kombeve…

Politika e të mëdhenjve për disa është nënë e për disa është njerkë. Disa popujve ua lejoi referendumin e vetëvendosjen, disave ua mohoi e ua mohon ende një gjë të tillë! Kjo është politikë me dy kute, shpatë me dy teha! Kjo është thjeshtë padrejtësi, pseudodemokraci, barbari e jocivilizim!

Fuqitë e Mëdha me një subjektivizëm të theksuar, por edhe me një egoizëm të papresedent të interesit shtetëror po pengojnë dhe ngadalësojnë proceset progresive, ndërprerjen e konflikteve ndëretnike dhe

zgjidhjen e çështjeve të hapura kombëtare anë e mbanë botës, duke shpikur njëqint “arsyetime” e “shkaqe”!

Nëse shteti i Kosovës vërtetë do të shërbente si shembëll frymëzimi, si model, si precedent edhe për popujt tjerë të pushtuar e të robëruar të globit për të fituar lirinë dhe pavarësinë e tyre, atëherë ky do të ishte një frymëzim përparimtar, një precedent pozitiv dhe model dobiprurës.

Ç’të keqe ka bota dhe njerëzimi nga liria dhe pavarësia edhe e vendeve dhe popujve tjerë të botës, përveç Kosovës? Asgjë, veç të mira do të ketë. Bota do të bëhet më e qetë dhe popujt më paqësorë.

Nuk është çështja e statusit të Kosovës, rasti i parë e unik në botë që është paraqitur para bashkësisë ndërkombëtare dhe OKB-së për zgjidhje. Sa e sa raste, konflikte e çështje koloniale e kombëtare ka pasur përpara saj, shumica prej të cilave janë zgjidhur në vitet 50-të e 60-të nga OKB-ja.

Fuqitë e Mëdha nuk kanë pse të shpikin metoda të reja, formula diabolike diplomatike dhe ligje të “reja” për zgjidhjen e çështjeve kombëtare në botë, kur ata veç e kanë Kartën Univerzale të OKB-së për Vetëvendosjen e Popujve dhe anekset ligjore të saj.

Fabrikimi nga ana e Fuqive të Mëdha të të ashtuquajturit ”Precedenti” i Kosovës dhe atij se Kosova është "Rast unik" e “i veçantë (“sui generis”), s’është asgjë tjetër pos manovrim i tyre për vonimin sa më shumë të zgjidhjes së çështjes së Kosovës! Është thjeshtë një manovrim dhe lojë diplomatike që zhvillohet midis Fuqive të Mëdha, të cilat nuk përpiqen për lirinë dhe vetëvendosjen e popujve të shtypur, por punojnë për interest dhe dominimin e vet!

Tanimë është e qartë për të gjithë njerëzit e logjikshëm se pengesë për statusin e Kosovës nuk është askush tjetër përveç Fuqive të Mëdha, të cilat nuk mund të merren vesh për rindarjen e zonave të tyre të interesit e të dominimit pas mbarimit të Luftës së Ftohtë.

Përderisa SHBA-të janë më të përgatitura e të gatshme për zgjidhjen e statusit të Kosovës, Rusia është e papërgatitur, sepse asaj i duhet kohë që ta rimarrë veten ekonomikisht dhe ushtarakisht, që të shndërrohet sërish në një Superfuqi botërore, që pastaj të hyjë e barabartë me SHBA-të për "zgjidhjen" e problemeve etnike, gjegjësisht për rindarjen e botës.

Kurse "Bashkimi" Europian, që bashkim i thënçin, është një konglomerat shtetesh dhe një mozaik laraman kombesh, që kurrë nuk do të stabilizohet deri në atë shkallë sa të zhvillojë një politikë unike të brendshme dhe të jashtme, sepse nuk është i sinqertë ndaj vetvetes, nuk ka guximin dhe gatishmërinë që t'i zgjidhë çështjet kombëtare brenda Europës që të mundet pastaj si shtet unik e i fortë të paraqitet si Superfuqia e tretë botërore dhe të vendosë për Rendin e "Ri" Botëror.

"Bashkimi" Eoropian është dhe do të mbetet edhe gjatë nën tutelën dhe kupolën mbrojtëse ushtarake të SHBA-ve. Europa e "Bashkuar" edhe më tej do të mbetet një anije pa kapiten e pa busullë që dallgët e politikës dhe të interesit do ta përplasin sa nga Perëndimi (SHBA-të), sa nga Lindja (Rusia)!

Kosova është edhe rast unik edhe precedent.

Mbi të gjitha Kosova është e vetvetes, është pjesë integrale e Shqipërisë Etnike dhe ajo kërkon liri, pavarësi, shtet dhe bashkim kombëtar.

22 tetor 2007

MASKAT DHE MASKARENJTË

Ç'janë maskat?

Maskat janë mbulesa në trajtë të trupit dhe të fytyrës. Janë copa apo pjesë prej kartoni, letre, pëlhure, lëkure, plastike, qelqi, allçie, gome..., etj., të cilat përdoren për të fshehur trupin e fytyrën, për të mbrojtur trupin: kokën, fytyrën, gjymtyrët dhe organet tjera të njeriut.

Llojet e maskave

Sipas meje, të paktën, ekzistojnë katër grupe të maskave, të cilat unë po i emërtoj, përafërsisht, kështu:

1.Maskat trupore, siç janë: maskat e mirëfillta, maskat për maskim, maskat për fshehje të trupit, të fytyrës, të kokës dhe të identitetit personal.

2.Maskat mbrojtëse, siç janë: maskat nënujore, maskat kundër gazërave helmues, maskat e saldimit, maskat kirurgjike kundër infektimit, maskat kundër pickimit të bletëve,...

3.Maskat dëfryese, siç janë: maska maskarade (balloje të vallëzimit), maska karnavalesh, maska teatrore, maska ciku,... dhe

4.Maskat shpirtërore, siç mund të jenë: maskat e ndjenjave, maskat e sjelljes, maskat e mendimeve, maskat e ideve, maskat e grimasës së fytyrës, maskat e veprimit, maskat e qeshjes, maskat e qarjes, maskat e miqësisë, maskat e solidaritetit, maskat e demokracisë, maskat e trimërisë, maskat e diturisë, maskat e sinqeritetit, maskat e atdhetarizmit,...

Në këtë shkrim unë do të flas vetëm për llojin e parë dhe për llojin fundit të maskave:

1.Maskat trupore, dhe për

2.Maskat shpirtërore

MASKAT TRUPORE

Maskat trupore janë të prekshme, të dukshme, shihen me sy, janë fizike, janë materiale, janë zakonisht nga pëlhura, lëkura ose edhe nga ndonjë material tjetër si plastika, goma etj. Maskat trupore janë mjet për t'u maskuar, për të fshehur fytyrën nga armiqtë, nga pushtuesët dhe nga shërbimet sekrete të armiqve. Maskat trupore shërbejnë për të fshehur identitetin personal dhe fizik për shkaqe sigurie. Për njerëzit që bartin maska trupore thuhet se janë ***njerëz me maska***.

Maskat trupore, përveç të tjerëve, përdoren edhe nga këto tre grupe njerëzish:

1.nga policia speciale e një shteti,
2.nga individët dhe grupet terroriste, kriminale, mafioze e plaçkitëse... dhe,
3.nga luftëtarët e lirisë

1.Maskat i përdorin policitë sekrete e speciale të ashtuquajtura "antiterror", të cilat kur sulmojnë çerdhet, bazat e grupeve të ndryshme kriminale e kontrabandiste, apo kur shkojnë për të arrestuar ndonjë pjestar të grupeve mafioze e trafikante, ata vënë maskat në kokë që të mos identifikohen nga bandat kriminale dhe farefisi i tyre, që në këtë mënyrë t'i shmangen hakmarrjes së këtyre bandave ndaj pjesëtarve të shërbimit sekret policor antiterrorr, si dhe të mbrojnë edhe familjet e tyre nga ndonjë hakmarrje e mundshme.
Asnjë pjesëtar i shërbimit sekret nuk dëshiron që t'i dalë fytyra në gazeta e televizion, kur ai është në një aksion të tillë goditës e asgjësues ndaj bandave kriminale apo edhe ndaj individëve me bagazh antiligjor gjatë arrestimit të tyre. Ai e mbron identitetin e tij me anë të maskës speciale trupore, sepse në këtë mënyrë mbron edhe jetën e vet të nesërmen kur shërben pa maskë. Në këtë mënyrë mbron edhe nderin dhe jetën e familjes së vet nga hakmarrjet e bandave, nga vrasjet dhe kidnapimet e tyre.

2.Maskat trupore i përdorin edhe hajnat, plaçkitësit dhe trafikantët e ndryshëm gjatë aksionit të tyre kriminal për përfitime personale dhe për dëmtimin e individëve, pronës private apo pronës shtetërore. Këta persona i keqpërdorin maskat trupore për arritjen e qëllimeve të tyre të errta e antiligjore. Këta janë individë pa fytyrë, pa shpirt e pa ndjenja njerëzore.

3.Maskat trupore i përdorin edhe guerrilët, luftëtarët e lirisë, zakonisht në fillimet e luftës, me qëllim të mos identifikimit nga armiku dhe për t'ia bërë kundërshtarit të pamundur asgjësimin e tyre pas aksionit luftarak.

Gati për të njëjtat qëllime mbrojtëse dhe parandaluese i përdorin maskat trupore luftëtarët e lirisë, ashtu siç i përdorin pjesëtarët e shërbimeve sekrete policore. Sepse edhe luftëtarët e lirisë kanë identitet personal dhe kanë familje për të cilat duhet të kujdesen që të mos hakmerret armiku, duke ua dëmtuar familjet. Nuk thotë kot ajo fjala e urtë se: "Kur nuk ke çka i bënë gomarit, i mëshon samarit"! Pra, kur armiku nuk mundet të zbulojë, të kapë e asgjësojë luftëtarin e lirisë, ai me egërsinë e ligësinë që e karakterizon gjithmon, shkon e arreston apo vret familjen e luftëtarit të lirisë në shenjë hakmarrje. Kush ka kujtesë të freskët nga e kaluara jonë e afërt e di shumë mirë këtë formë të veprimit ç'njerëzor të armiqve tanë. Në çdo luftë tonën çlirimtare më së shumti ka pasur viktima civile, të pafajshme e të paarmatosura, se sa ushtarë e luftëtarë të lirisë kombëtare.

Luftëtarët e lirisë nuk janë banditë, kriminelë e hajna, por ata nuk janë as budallenj e injorantë që të dalin për fushë, hapur e pa maska që në fillim të luftës çlirimtare, kur ende kjo luftë nuk është masivizuar dhe kur ende kjo luftë nuk ka kaluar në një fazë më të lartë – të luftës frontale. Pra, maskat kamufluese e mbrojtëse trupore përdoren në fillim të çdo lufte, kurse ato hiqen në vazhdim dhe në përfundim të saj, kur lufta çlirimtare kalon në një fazë tjetër të zhvillimit, të forcimit dhe të pjekurisë së saj.

Ashtu siç kanë familje dhe identitet civil e njerëzor pjesëtarët e shërbimeve sekrete policore antiterror, të njëjtën gjë kanë edhe luftëtarët e lirisë. Ata, pas aksioneve luftarake, heqin maskat trupore, kthehen në gjirin e popullit e të familjes dhe bëjnë jetën e zakonshme qytetare. Kështu, mund të thuhet se luftëtarët e lirisë bëjnë një jetë të dyfishtë. Ata, p.sh. natën, të maskuar e të armatosur, kryejnë aksione e sulme kundër armikut pushtues, kurse ditën, pa maska, punojnë në fabrikë, lëvrojnë tokën, punojnë në ndonjë zyrë apo shkojnë në shkollë e fakultet. Ndodhë shpesh që luftëtari i lirisë natën lufton me maskë në fytyrë si ushtar, kurse ditën demonstron si civil në rradhët e popullit demostrues kundër terrorit, shtypjes dhe padrejtësive të okupatorit.

Në luftë kundër armikut vlen deviza taktike: ”Shtatë hile e një trimëri”. Në njërën nga këto shtatë hiletë bëjnë pjesë edhe maskat. Murit me kokë nuk i bihet, por as edhe armikut ballë-përballë gjithmon nuk i dilet. Sidomos në fillim të luftës, kur epërsia në ushtarë, municion dhe në armatim e kundërshtarit është më e madhe se e luftëtarëve të lirisë. Armikut duhet fillimisht t’ia marrësh anën, krahët dhe pastaj ta godasësh ballë-përballë e në lule të ballit. Të gjitha luftërat nacionalçlirimtare të popujve të robëruar kanë filluar e fillojnë me luftë guerrile, me maska e pa maska dhe përfundojnë me luftën e përgjithshme mbarëpopullore, me triumfin e lirisë dhe të pavarësisë kombëtare.

Nga kjo veprimtari e dyfishtë del në pah domosdoshmëria e përdorimit të maskave trupore. Pra, maskat trupore janë nevojë e jo luks apo modë. Përdorimi i maskave trupore nuk është shenjë frikësimi apo jotrimërie e luftëtarëve të lirisë, por është mjet mbrojtës, është pjesë e armatimit të tij. Përderisa ato i përdorë shteti, armiku pushtues, pse të mos i përdorë edhe luftëtari i lirisë dhe ushtria popullore kombëtare. Luftëtarët e lirisë nuk janë naivë që ta ”thirrin ujkun në torishtë”, duke i thënë hapur: ”ja ku jami ne, ecë e na arresto, ecë e na sulmo, na asgjëso”! Ata dijnë kur të

luftojnë me maska dhe kur të luftojnë pa maska. Ata janë të urtë e të zgjuar dhe për këtë gjë vendosin vetë, në bazë të rrethanave politiko-ushtarake që krijohen me kohën. Luftëtarët e lirisë dijnë të sulmojnë dhe dijnë të mbrohen. Dijnë të luftojnë, por edhe dijnë të fitojnë.

MASKAT SHPIRTËRORE

Kurse për njerëzit që bartin maska shpirtërore thuhet se janë **maskarenj**.

Maskat shpirtërore janë të padukshme. Janë të paprekshme, të pakapshme me dorë. Ato janë të ndërtuara nga fije të padukshme, të cilat quhen ndjenja. Por, përveç ndjenjave, maskat shpirtërore janë të ndërtuara edhe nga idetë, bindjet filozofike e politike të individit.

Maskat shpirtërore janë shumë më të ndërlikuara se maskat materiale. Përderisa maskat materiale mbulojnë pamjen e jashtme fizike të njeriut, maskat shpirtërore fshehin pamjen e brendshme të individit, mbulojnë karakterin e tij, shpirtin e tij, idetë, mendimet, ndjenjat, qëllimet dhe veprimet e njerëzve që bartin maska shpirtërore.

Përderisa maskat trupore përdoren për shkaqe sigurie, maskat shpirtërore përdoren për shkaqe shpirtligësie, për interesa e përfitime personale.

Përderisa maskat trupore përdoren për të fshehur fytyrën, maskat shpirtërore përdoren për të fshehur shpirtin.

Ashtu siç mund të hiqen në kohën e përshtatshme maskat trupore, poashtu, me kohën, hiqen edhe maskat shpirtërore. Por këtu ka një dallim të madh midis këtyre dy lloj heqjesh të maskave: për njeriun me maskë trupore zakonisht thuhet: ”E hoqi maskën”, pra, i maskuari e heq vetë maskën në kohën dhe në çastin e duhur për të. Kurse për individin me maskë shpirtërore thuhet: ”I ra maska”, pra, i maskuari shpirtëror demaskohet pa vullnetin e tij, atij i çirret maska, i bjen maska në tokë

dhe ai del lakuriq para popullit, ashtu siç është: i pafytyrë, faqezi, i poshtër, i pacipë, i pandershëm..., maskara!

Gjithmon maskat shpirtërore maskarenjve u bien gjatë kthesave të mëdha historike, gjatë ngjarjeve tronditëse, gjatë shpërthimeve e vlimeve popullore, gjatë luftërave nacionalçlirimtare, gjatë momenteve kur maskarenjve u mbyllen të gjitha rrugët, të gjitha shtigjet e shpëtimit, të gjitha format e manovrimit, mbështeten për murit dhe detyrohen të zgjedhin ndërmjet dy rrugëve: ose me popullin ose kundër tij, ose me atdheun ose kundër tij, ose me lirinë ose kundër saj, ose patriot ose tradhtar… Kjo **ose-ose** është armiku numër një dhe vdekjeprurës i maskave shpirtërore dhe i maskarenjve.

Kjo ose-ose është njëkohësisht edhe armiku i neutralitetit, paanshmërisë dhe indiferencës së njerëzve, të cilët edhe në kthesa të mëdha historike për popullin dhe atdheun e tyre përpiqen të mbesin të "pavarur", "neutralë",… duke mos ia prishur "terezinë" vetvetes! Këto hanë me dy lugë dhe ulen në dy karrike në të njëjtën kohë. Këta janë maskarenj të dyfishtë. Edhe maskarenj fizik edhe shpirtëror!

Këto individë apo grupe shoqërore ndryshe quhen hipokritë (dyftyrësh), pseudopatriotë, oportunistë, demagogë, gënjeshtarë, karrieristë, tregtarë flamujsh, egoistë, matrapazë, kameleonë, dezertorë, varrmihës, kolonë e pestë,… dhe shpesh përfundojnë në kolaboracionistë të armiqve pushtuesë.

Ky grup individësh janë **maskarenj të dyfishtë**, sepse ato me fjalë, në teori, paraqiten si patriotë e luftëtarë lirie (maska trupore) dhe në vepër, në praktikë, veprojnë si sabotatorë e bashkëpunëtorë të armikut (maska shpirtërore). Maskarenjtë e dyfishtë apo dubëlmaskarenjtë janë shumë më të rrezikshëm për luftën çlirimtare se sa maskarenjtë me vetëm maskë shpirtërore.

Në grupin e maskarenjve të dyfishtë zakonisht bëjnë pjesë tregtarët (tuxharët, biznesmenët) dhe politikanët.

Për mendim timin vendin e parë në listën e maskarenjve e zënë politikanët.

Tregtarët gënjejnë shumë, mashtrojnë dhe vjedhin popullin dhe myshterinjtë me qëllim që të pasurohen. Këtë e bëjnë shumica e tyre, sepse pa qenë maskara është e vështirë që të bëhesh pasanik (milioner apo miljarder). Por, ka edhe tregtarë që punojnë shumë, vrapojnë e djersiten tërë ditën që t'u ecë tregtia mbarë, që t'u shtohet pasuria. Pra, bukur shumë tregtarë e kombinojnë maskarallëkun me punë personale dhe kështu arrijnë të pasurohen. Pastaj, ka tregtarë që herë pas here, ndajnë nga pasuria e tyre dhe ndihmojnë institucione të ndryshme humanitare dhe familje të varfëra. Të gjithë tregtarët dhe pasanikët nuk janë pasuaruar me vjedhje, por disa prej tyre edhe nga puna, zgjuarsia dhe inteligjenca e tyre.

Ndërsa te politikanët puna qëndron krejt ndryshe. Ata janë më të shëmtuar se tregtarët matrapazë. Politikani është gnjeshtar e maskara i klasit të parë. Është tinzar që thurr vetëm kurtha për t'u ngjitur sa më lart në shkallaret e hierarkisë pushtetare. Politikani është parazit që jeton e majmet në kurriz të taksave të popullit dhe në bazë të korrupsionit që e krijon vetë. Politikani nuk punon fare, nuk djersitet duke punuar, nuk lodhet as fizikisht as psiqikisht, ai vegjeton e pasurohet vetëm mbi bazë të maskarallëkut të tij, në bazë të premtimeve boshe që i bën çdo ditë para qytetarëve dhe në bazë të maskave shpirtërore që i ndërron orë e çast.

Politikani çka thotë paradite, nuk thotë pasdite. Çka pështynë sot, e lëpinë nesër! Politikani është aq pakurrizor e i pabesë, sa që nuk mund të përshkruhet me fjalë. Është i pamoralshëm dhe ka një piskarakter. Politikani 24 orë është në shit-blerje. Ai çdo moment mund të shitet dhe atë çdo moment mund ta bleshë. Paraja, posti dhe pushteti për të janë nënë e babë, janë zot e perëndi, janë gjithçka. Politikani është djalli vetë, por pa brirë, sepse brirët i fsheh me 1001 maskat e tij shpirtërore!

Gjithkush nuk mund të bëhet politikan. Politikanët nuk bëhen politikanë, ata lindin të tillë. Ata janë pjellë e satanasë. Politikani sot shfaqet si engjëll me krah pëllumbi, kurse nesër shfaqet si dreq me brirë të përgjakur! Ai i ndërron sjelljet, fjalët, veprimet dhe maskat shpirtërore pandërprerje, sa herë ia don interesi i tij personal, egoja e tij e sëmurë dhe shtazarake.

Politikani është tregtari më i madh, shitësi më i paturpshëm i vetvetes, shitësi i familjes së tij. Është shitësi i popullit dhe i atdheut të tij. Ai shet gjithçka që i bjen në dorë me qëllim që të kënaq egon e tij, epshet e tij satanike për para, famë e pushtet!

Politikani jo vetëm që është një maskara, i cili gënjen natë e ditë, keqpërdor pozitën e pushtetin, por ai është në gjendje të tradhtojë popullin e atdheun, është në gjendje të vrasë shokët e tij dhe gjithkend përrreth, për të arritë qëllimet e tij të errta e ç'njerëzore! Pra, përveç se një maskara, politikani është edhe një kriminel ordiner. Krijesë më të neveritshme se politikani zor se mund të gjejsh mbi faqe të dheut. Ai mund të krahasohet vetëm me Djallin dhe me askend tjetër.

Ktheheni për një çast kujtesën prapa në historinë e kombit tonë dhe do të kuptoni se sa dëme, sa vuajtje, sa gjëma makabre i kanë shkatuar popullit dhe atdheut tonë politikanët e mëhershëm. Rrotulloni kokën rreth e qark dhe shikoni se ç'bëjnë sot politikanët modern të popullit tonë, se sa dëme të pallogaritshme i kanë shkatuar dhe po i shkatojnë çdo ditë zhvillimit ekonomik e politik të kombit tonë dhe sa plagët po i hapin përditë zgjidhjes së çështjes sonë kombëtare, të lirisë e të bashkimit kombëtar të Shqipërisë Etnike.

Të gjitha të këqijat, dështimet e robëritë popullit dhe atdheut tonë, pikë së pari, i kanë ardhur dhe i vijnë nga liderët tanë politikanë të maskuar me maska shpirtërore me emra të ndryshëm, si: "patriot", "atdhetar", "luftëtarë lirie", "ish-ushtar", "ish-komandant", "demokrat",... etj. Fatkeqësisht, asgjë e mirë, deri më sot, nuk i ka ardhur popullit dhe atdheut tonë nga politikanët maskarenj. Ata

janë më të dëmshëm e më të rrezikshëm se armiku, sepse armiku dihet se është armik e pushtues, kurse politikanët tanë janë me maska, janë maskarenj dhe është e vështirë që të identifikohen, të demaskohen e të asgjësohen. Edhe atëherë kur bëhet demaskimi i tyre, ose është vonë, ose kihet mëshirë ndaj tyre dhe nuk marrin dënimin e merituar. Dhe haraçin e veprimtarisë së tyre antipopullore e antikombëtare prej maskarai e tradhtari e paguan populli dhe atdheu.

Deri kur do t'ju shkojë "kungulli mbi ujë" politikanëve maskarenj askush nuk e di, por vetëm një gjë dihet se,

Bota është e maskarenjve, kurse Shqipëria është e Shqiptarëve.

15 tetor 2007

KOT E KANË TË GJITHË...!

Kot e kishin dje armiqt pushtuesë të Shqipërisë Etnike, kot e kanë edhe sot pushtuesët e rinj të saj, sepse Shqiptarët dhe Shqipëria i mbijetuan me stoicizëm heroik të gjitha pushtimet dhe gjenocidet e tyre gjatë shekujve e mijëvjeçarëve të historisë së përgjakur kombëtare dhe njerëzore!

Kot e kanë matrapazët, tregtarët politik,... dhe të gjithë shitësit e trojeve shqiptare, sepse trojet tona as nuk shiten dhe as nuk blehen, ata janë pronë hyjnore e Kombit Shqiptar të dhuruar nga Zoti i Qiellit dhe nga "Perënditë" e Olimpit të Pellazgëve të Pellazgjisë.

Kot e kanë të gjithë maskarenjtë, demagogët dhe djallëzorët shqipfolës, që mundohen në emër të mirëqenies dhe demokracisë të përfitojnë për vete pasuri e privilegje, në kurriz të popullit dhe të pasurive mbitokësore e nëntokësore të tokës shqiptare!

Kot e kanë të gjithë bajraktarët, karrieristët, pseodokombëtarët,... të cilët në emër të popullit e të atdheut, në emër të shqiptarizmit dhe demokracisë, përpiqen që të marrin pushtetin, të shesin shtetin dhe të bojkotojnë ribërjen e Shqipërisë Etnike!

Kot e kanë të gjithë antishqiptarët e pseudoaleatët të cilët nën maskën e "miqësisë" dhe të "demokracisë" përpiqen të na lënë në robërinë e vjetër!

Kot e kanë sllavo-grekët, të cilët nuk kanë hequr ende dorë nga pushtimi dhe ricopëtimi i trojeve shqiptare të Shqipërisë Etnike, që me mijëra manovrime demagogjike, veshur me lëkurë të "qingjit", mundohen që të bindin faktorët relevantë ndërkombëtarë se ata janë konvertuar në "paqësorë" dhe "demokratë"!

Kot e kanë tradhtarët e mercenarët "shqiptarë", që jo vetëm atdheun, por edhe "shpirtin" e tyre ia kanë shitur e falur armikut dhe djallit!

Kot e kanë edhe këto Pranga të Reja të Robërisë së Kosovës, të cilat janë hartuar nga të huajtë dhe nga "tanët":

1.Marrëveshja e Rambujesë (Parisit)

2.Marrëveshja Ushtarake - Teknike e Kumanovës midis Forcave të NATO-s dhe Forcave Ushtarake të Serbisë

3.Rezoluta 1244 e KS të OKB-së

4.Demobilizimi i UÇK-së dhe shndërrimi i saj në organizatë civile me emrin Trupat Mbrojtëse të Kosovës

5.Pushteti pa pushtet e pa shtet i organeve dhe institucioneve të Kosovës: Kuvendit të Kosovës, Qeverisë së Kosovës, Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK), Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK), Shërbimit Gjyqësor të Kosovës, etj.

6.Të drejtat e pakufizuara të Shefit të UNMIK-ut

7.Ndalimi i lidhjeve diplomatike të Kosovës me botën dhe lidhjet telekomunikative dhe ekonomike të Kosovës me botën përmes kodit të Serbisë

8.Korniza Kushtetuese e Kosovës

9.Agjensia Kosovare e Mirëbesimit (AKM)

10. Shpikja e kushtit - Standardet para Pavarësisë

11.Përkufizimi i Kosovës si vend "multietnik"

12. Pakoja e Ahtisarit

13."Decentralizimi" apo Ndarja dhe Enklavizimi i Kosovës

14. Traktati i Miqësisë me Serbinë i Grupit Negociator të Kosovës

15. Deklarata e Nju Jorkut e 28 shtatorit 2007

16.14 Pikat e Treshes: SHBA-BE-Rusi

17. Pakoja e Ahtisarit “Plus”, që është duke u hartuar nga Treshja, e cila në fakt parashihet që jetë gjoja “Pakoja e Ahtisaarit” Minus Pavarësia e Kosovës!

Askush nuk e di edhe sa “Marrëveshje e Deklarata”, sa “Pako e Pika” do të hartohen e përpilohen nga ndërkombëtarët dhe kosovarët, derisa Kosova

përfundimisht të hy përsëri nën zgjedhën neokolonialiste të robërisë serbe!

Është koha e atomit dhe internetit, koha e robotëve dhe informatikës, është koha e dritës dhe jo errësirës, prandaj të kotë e kanë të gjithë mashtruesit, pushtuesit, hartuesit e farkëtuesit e prangave të "reja" të robërisë për Kosovën dhe për të gjithë trojet tjera shqiptare të Shqipërisë Etnike.

Nuk ka pranga, as zinxhirë, që mund t'i detyrojnë Shqiptarët të jetojnë në errësirë. Nuk ka "Marrëveshje" as "Korniza", nuk ka "Pako" as paketa që mund të bindin Shqiptarët të heqin dorë nga trojet e veta. Nuk ka "Deklarata" as "Traktate", nuk ka "Pika" as thika, nuk ndihmon as dhuna as frika, që të detyrohen Shqiptarët të heqin dorë nga liria, pavarësia dhe bashkimi kombëtar i Shqipërisë Etnike.

E drejta vonon, por fiton. E vërteta vonon, por triumfon.

Kot e kanë të gjithë,... Shqipëria Etnike do të riçlirohet dhe do të ribashkohet.

2 nëntor 2007 (Titan Tivari)

III - ILIRIDA

ILIRIDA

Ilirida - Shqipëria Verilindore ose Maqedonia Perëndimore, ka qenë e banuar që në periudhën më të lashtë parahistorike, të Neolitit, nga populli bartëse të Kulturës Mediterane. Më vonë, nga kjo populli parahistorike u formuan Pellazgët dhe fiset Ilire, të cilët në Iliridë, përveç tjerash, ndërtuan edhe këto qytete historike: Oeneu (Tetova), Draudaku (Gostivari) dhe Uskana (Kërçova) të cilët banosheshin nga fisi Ilir i Penestëve. Linkestët dhe Enkelejtë banonin rreth qyteteve Strugë dhe Ohër (Lyhnidis). Kurse pjesa veriore e Maqedonisë, Shkupi (Scupi), Kumanova, etj., ka qenë e banuar nga fiset ilire të Dardanëve dhe Paionëve.

Në Enciklopedinë serbe theksohet: "Maqedonia në periudhën antike ishte shtet i pavarur, i banuar me fise iliro-thrakase, nga maqedonasit iu dha emri MAQEDONI". Më poshtë thuhet: "Shtrihej rreth brigjeve të Detit Egje. Në histori është njohur me emrin Maqedonia, me kryeqytet Selanikun. Më vonë Filipi II, i ati i Lekës së Madh, i zgjeroi kufijtë në Veri. Kjo njihej me emrin Maqedonia II, me kryeqytet Stobi (Shtipi). Kufiri i Maqedonisë II shtrihej deri te lumi Astibo dhe rrjedha e poshtme e lumit Erigon".

(Malla Enciklopedija, Prosveta, Beograd, 1978, f .461).

Pra, siç shihet, Maqedonia asnjëherë nuk është shtrirë në veri të lumit Erigon (Crna Reka), dhe se në perëndim asnjëherë nuk e ka pasur territor të saj Maqedoninë e sotme Perëndimore. Ata ishin të banuara me fiset tjera ilire, si: dardanët, paionët, lynkestët, penestët, enkelejtë etj. Këtë e dëshmojnë edhe gërmadhat e vendbanimeve të vjetra dhe objektet e shumta

arkeologjike të zbuluara anekënd hapësirës së Maqedonisë së sotme.

Kurse, sa iu përket maqedonasve pellazgo-ilirë, një historian do të theksonte: ”Herët u paraqitën në histori dhe shumë herët u zhdukën”. Kjo tregon, se maqedonasit antikë nuk patën jetë të gjatë në histori. Në shek. III p.e.s nuk u dëgjuan më fare, ndërsa Leka i Madh vazhdoi të "veprojë" në arenën historike. Ai bëri bujë dhe la gjurmë të thella në histori. Edhe sot është i pranishëm në lëminë e historisë. Për të dihet se është i biri i Filipit II e i nënës Olimpi dhe se mësues e ka pasur Aristotelin (aristokrat Telin, filozof ilir). Leka i Madh ishte kushëri i Pirros së Epirit. Që në moshë 6 vjeçare mbet jetim dhe e mori në mbrojtje dhe e rriti mbreti i Taulantëve, Glauku, i cili më pas i ndihmoi që të bëhet mbret i Maqedonisë. Çka është me rëndësi, Leka i Madh, ishte mbret i Maqedonisë prej v. 336 deri në v. 323 p.e.r., pra, deri në vdekjen e tij. Përkatësinë etnike maqedonase, askush nuk mund ta injorojë, prandej edhe quhet Leka i Maqedonisë (Aleksandri i Maqedonisë).

Pra, më mirë do të ishte që historianët dhe politikanët sllavo-maqedonas të mos merren me kuazishkencë, sepse kjo sjell huti brenda vetë popullit sllavo-maqedonas. Përpjekjet e tyre që të jenë pasardhës të një populli të stërlashtë, me të cilin mburret historia antike dhe historia më e re, janë pretendime të kota, sepse nuk munden të jenë edhe sllavo-maqedonas edhe maqedonas antikë. Nuk munden të jenë në të njëjtën kohë edhe sllavë edhe ilirë, sepse maqedonasit e Lekës së Madh kanë jetuar në një hapësirë dhe në një kohë krejtësisht tjetër. Fisi i Maqedonëve të Lekës së Madh ka qenë fis pellazgo-ilir. Këtë e dëshmojnë vetë historianët dhe filozofët helenë (grekë) të asaj kohe, duke i quajtur

Maqedonët, ashtu si edhe Ilirët, fise "barbare", pra fise të huaja, jo greke, që nuk kishin gjuhën dhe etninë e tyre.

*****

Shteti që sot zyrtarisht quhet Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM), për herë të parë si gjysmështeti, si Republikë e ish-Federatës Jugosllave, u konstitua në vitin 1945.

Republika e Maqedonisë u nda nga ish-Federata Jugosllave pas mbajtjes së Referendumit të 8 shtatorit 1991, duke shpallur po atë vit edhe pavarësinë shtetërore. Ende pa përmbushur kushtet e parashtruara nga Komisioni i Badinterit u bë njohja e Maqedonisë si shtet i pavarur, dhe më 1993 ajo u pranua anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Me gjithë njohjen e saj si shtet i pavarur nga OKB-ja, Republika e Maqedonisë (apo zyrtarisht: IRJM - FYROM) ende ka shumë probleme të pazgjidhura me fqinjët e saj.

Kështu, Bullgaria nuk ia njeh kombësinë (etninë), duke pretenduar se në Maqedoni ka vetëm pjesë të kombit bullgar e jo ndonjë komb maqedonas. Greqia nuk ia njeh as etninë, as emrin shtetit sllavomaqedonas, duke pretenduar se ajo është e vetmja "trashëgimtare" e emrit antik "Maqedon dhe Maqedoni". Serbia Maqedonisë nuk ia njeh pavarësinë e Kishës Ortodokse Maqedonase, duke tentuar që ta mbajë gjithmonë nën sqetullën e saj këtë kishë. Kosova nuk ia njeh kufijtë Maqedonisë, sepse Serbia mbolli "mollën e sherrit" midis dy vendeve kur ia dhuroi Maqedonisë një pjesë të madhe të tokës së Kosovës. Republika e Shqipërisë e njeh Maqedoninë si shtet të pavarur e sovran dhe nuk ka probleme ndërshtetërore me të, por populli shqiptar i Iliridës nuk e njeh Maqedoninë si shtet të vetin, sepse nuk është i

barabartë me popllin sllavo-maqedonas, sepse nuk është popull shtetformues në këtë republikë.

*****

Pas ardhjes në pushtet të VMRO-DPMNE, kjo parti dhe qeveria e saj përpiloi një program pune ku pjesën më të madhe të këtij programi e përbën problemi ekonomik dhe zgjidhja e këtij problemi. Kurse problemi politik lihet nën hije të ekonomisë. Çështjet e pazgjidhura etnike, implementimi i plotë i Marrëveshjes së Ohrit etj., lihen në plan të dytë, edhepse ato janë problemet numër një me të cilat përballet shteti i Maqedonisë. Në këtë mënyrë qeveria e VMRO-s po ikë nga problemet e mprehta reale politike dhe shkon e fshihet pas problemeve ekonomike, të cilat poashtu janë të mëdha dhe duan zgjidhje urgjente, por jo në kurriz të problemeve etnike dhe të pabarazisë ligjore ndërmjet etnive.

Duhet theksuar se, në mars-prill të vitit 2001, Kryeministri i atëhershëm i Maqedonisë kërkoi ndarjen e saj, por shqiptarët nuk e pranuan këtë tezë, sepse Kryeministri i atëhershëm sllavomaqedonas u jepte shqiptarëve vetëm dy-tre komuna të këtij shteti, kurse pjesën e ”luanit” të trojeve shqiptare të Iliridës propozonte ta mbante për vete! Kurse në maj të po atij viti (2001), kur UÇK kishte shti në dorë luginën e epërme të Vardarit dhe ishte afruar te portat e Shkupit, Kryeministri u tërhoq nga ideja dhe ngarkoi Akademinë e Shkencave të Maqedonisë për ta elaboruar më tej tezën e ndarjes së saj. Nuk vonoi shumë dhe gazeta Veçer e datës 25 maj 2001 botonte hartën e ndarjes së Maqedonisë. Ky skenar jorealist e antishqiptar nuk u realizua atëherë, por skenari vazhdon të qëndrojë në sirtarët e kësaj partie sllavomaqedonase.

Sllavomaqedonasit VMRO-istë duan ta ndajnë Maqedoninë, por faji përballë Europës dhe botës ”duhet” t’u mbetet Shqiptarëve, që ne të etiketohemi e anatemohemi nga faktorët politik relevantë ndërkombëtarë si ektremistë, nacionalistë, separatistë, paqeprishës,… deri edhe terroristë! Por, faktikisht dhe historikisht, Maqedoninë (ta quajmë kushtimisht) Etnike e kanë ndarë vetë ideologët sllavomaqedonas të VMRO-së së shekullit të kaluar: Jane Sandanski (nga Maqedonia e Pirinit), Goce Dellçevi (nga Maqedonia e Egjeut), Nikolla Karevi, etj., të cilët nuk luftuan në koalicion me shqiptarët e Hasan Prishtinës për të krijuar Shqipërinë Etnike dhe Maqedoninë Etnike, por luftuan për të pushtuar sa më shumë territore të Shqipërisë Etnike në prag të shekullit të kaluar.

Ndaj tani Maqedonia sllavomaqedonase e Pirinit gjendet nën Bullgari, kurse Maqedonia sllavomaqedonase e Egjeut gjendet nën Greqi. Dhe jo vetëm kaq, por politika antishqiptare e VMRO-së së sotme moderne dhe e të gjitha partive tjera politike sllavomaqedonase ende vazhdon me avazin e vjetër. Ata me ngulm po përpiqen të mbajnë të pushtuara tokat shqiptare të Shqipërisë Etnike (Iliridën) dhe po vazhdojnë të injorojnë të vetmit aleatë të tyre natyrorë në Ballkan – Shqiptarët, me të cilët i bashkon idea për krijimin e Shqipërisë Etnike dhe Maqedonisë Etnike. Dhe Maqedonia Etnike e tyre nuk shtrihet në tokat shqiptare të Iliridës, por gjendet në Bullgarinë e Pirinit dhe në Greqinë e Egjeut, si dhe në Maqedoninë e sotme juglindore (rrjedha e poshtme e Vardarit).

Sllavomaqedonasit dhe Shqiptarët kanë të përbashkët të njëjtin pushtues shovenist – Greqinë, por këtë fakt pushtetarët sllavomaqedonas të Shkupit nuk e marrin parasyshë dhe vazhdojnë të armiqësohen më tej

me Shqiptarët, duke mos qenë të vetëdijshëm se në këtë mënyrë ata po godasin, më shumë se Shqiptarët, vetveten dhe çështjen e tyre kombëtare. Me apo pa "aleatët" sllavomaqedonas, kombi shqiptar do të vazhdojë rezistencën dhe luftën e tij për bërjen e Shqipërisë Etnike.

Mosimplementimi i plotë i Marrëveshjes së Ohrit dhe vazhdimësia e diskriminimit të shqiptarëve të Iliridës nga pushtetmbajtësit sllavomaqedonas të Shkupit, vetëm se do ta shpejtojë ndarjen dhe shpërbërjen e Republikës së sotme të Maqedonisë (IRJM-FYROM). Dhe faji do të rëndojë mbi ta, sepse bota demokratike nuk është as e verbër e as naive që të mos e identifikojë fajtorin e kësaj ndarjeje.

*****

Republika e Maqedonisë është shtet unitarist multietnik, ku pushteti ushtrohet nga lart – poshtë, dhe ku sundon etnia sllavomaqedonase mbi etninë shqiptare dhe mbi pakicat tjera kombëtare. Ky lloj pushteti etnocentrist është burim i konflikteve të vazhdueshme ndëretnike. Multietniciteti i shtetit është njëherit dhe pasuri e atij vendi, por vetëm kur bëhet decentralizimi i pushtetit qendror, kur pushteti dhe të drejtat e qytetarëve ushtrohen nga poshte-lartë. Kjo formë e qeverisjes bën të mundur që etnitë dhe pakicat e ndryshme që nuk kanë etni, gjuhë, fe e as tradita të përbashkëta, megjithatë mund të bashkëjetojnë në paqë dhe harmoni ndëretnike në një shtet të tillë ligjor.

Gjithë kohën ka pasur premtime të pushtetit maqedonas se do t'i plotësojë kërkesat dhe të drejtat e shqiptarëve, por nuk i ka plotësuar kurrë. Poashtu tërë kohën, sidomos gjatë fushatave elektorale, ka pasur premtime të partive shqiptare për zgjedhësit shqiptarë se

do t'i avansojnë të drejtat e tyre kombëtare, se do t'i përmbushin kërkesat e tyre politike, kombëtare, ekonomike, të arsimit etj., por kur kanë hyrë në qeverisje nuk i kanë mbajtur premtimet. E gjithë politika e sllavomaqedonasve dhe e partive shqiptare është ndërtuar dhe është zhvilluar mbi premtime gojore dhe shumë pak gjëra janë të shkruara e të inkorporuara në ligj. Edhe ato të drejta të sanksionuara në kushtetutë dhe ligjet e shtetit nuk janë realizuar fare ose tepër pak në praktikë.

Çdo shtet jodemokratik njëherit është edhe ilegjitim për etninë që shtypet e shfrytëzohet politikisht dhe ekonomikisht. Pjesëmarrja e partive politike të etnive tjera në Parlament dhe në Qeveri, pa përmbushur standardet demokratike, pa rrespektuar dhe zbatuar marrëveshjet paraprake dhe ligjet në fuqi, nuk e bën një shtet legjitim. Përfaqësuesit e shqiptarëve në pushtetin maqedonas, deputetë apo ministra, deri më sot kanë shërbyer vetëm si dekor dhe për të legalizuar pushtetin e sllavomaqedonasve karshi botës. Pushteti legal kur është jodemokratik, ai automatikisht është pushtet ilegjitim, i paligjshëm dhe i papërfillshëm nga etnia apo pakicat që janë objekt i padrejtësive të pushtetit legal.

Shqiptarët në Maqedoni, që nga viti 1945 e deri më sot, nuk kanë qenë të barabartë me sllavomaqedonasit, prandaj kurrë nuk e kanë pranuar atë si shtet të vetin, sepse janë nëpërkëmbur e diskriminuar vazhdimisht nga të gjitha qeveritë e Shkupit. Për këtë shkak, më 24 mars 1990 shqiptarët që jetojnë në trojet e tyre në Maqedoni e shpallën Iliridën Republikë Autonome, por nuk e vazhduan punën e mëtejshme për jetësimin e saj në vepër! Kurse në pranverë të vitit 2001 shqiptarët e Iliridës iu bashkangjitën thirrjes së Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK) për luftë nacionalçlirimtare dhe ndarje nga Maqedonia.

*****

Asnjë marrëveshje nuk mund të ketë karakter të përjetshëm. Ajo, çka është edhe më keq, Marrëveshja e Ohrit as nuk është implementuar në tërësi as edhe pas kaq vitesh të përpilimit të saj. Kjo Marrëveshje është shumë e vështirë që të implementohet në tërësi, sepse kundër saj ka qenë gjysma e popullit sllavomaqedonas. Këtë e dëshmoi edhe Referendumi Popullor i 7 nëntorit 2004, i organizuar nga partia aktuale në pushtet - VMRO-DPMNE, ku rreth 445.000 qytetarë sllavomaqedonas votuan kundër Marrëveshjes së Ohrit!

Marrëveshja e Ohrit është Marrëveshje për ekzistencën e Maqedonisë, ajo nuk është marrëveshje vetëm e shqiptarëve, por edhe e sllavomaqedonasve. Prandaj pushtetarët VMRO-istë të Shkupit janë të obliguar që ta implementojnë atë deri në shkronjën e paragrafin e fundit tä saj, nëse nuk duan shpërbërjen apo ndarjen e Republikës aktuale të Maqedonisë.

Marrëveshja e Ohrit ka luajtur rolin historik të ndërprerjes së luftës dhe tani është obligim i të gjitha forcave politike që të angazhohen për zgjidhjen e çështjeve të hapura dhe ende të pazgjidhura politike e kombëtare në Maqedoni. Një gjë e tillë mund të realizohet vetëm përmes një dialogu konstruktiv, ku hiqen “temat tabu” dhe me ndihmën e forcave demokratike ndërkombëtare të gjenden format dhe mënyrat e zgjedhjes së problemeve pa gjakderdhje të reja. Republika Shqiptare e Iliridës ende është opcion politik dhe kombëtar i popullit shqiptar të Iliridës.

Si duket pushteti maqedonas nuk ka mësuar asgjë nga konflikti ushtarak shqiptaro-maqedonas i vitit 2001! E meta e historisë është se ajo, në një formë apo në një

tjetër, përsëritet. Historia përsëritet kur njerëzit, partitë politike apo pushtetet shtetërore nuk mësojnë apo nuk duan të mësojnë asgjë nga ngjarjet historike. Dhe atëherë historia përsëritet, por përsëritet me një egërsi, intenzitet dhe përmasa shumë më të mëdha se sa herën e kaluar.

Prandaj, si dje edhe sot, Maqedonia po përballet me konflikte të hapura e të fshehura ndëretnike. Ky shtet nuk është demokratik dhe si i tillë nuk ka të ardhme. Ardhmëria e Maqedonisë qëndron vetëm në decentralizimin demokratik të pushtetit qendror, i cili shprehet përmes konceptit të demokracisë konsensuale, autonomisë rajonale, federatës apo konfederatës. Dhe rruga tjetër është vetëvendosja demokratike e popullit shqiptar të Iliridës, përmes Referendumit Popullor dhe ndarja e tij nga Maqedonia, duke formuar shtetin e ri - Iliridën, me të drejtë bashkimi me Shqipërinë ose Kosovën.

Përndryshe, Ilirida është Shqipëri Verilindore, e banuar në masën 90% nga shqiptarët autoktonë pellazgo-ilirë që nga antika dhe deri në ditët tona. Kurse në nivel republikan Shqiptarët përbëjnë rreth 45% të numrit të përgjithshëm të popullsisë së Maqedonisë.

Ilirida është pjesë integrale e Shqipërisë Etnike.

Maj 2006

MAQEDONIA ETNIKE
DHE SHQIPËRIA ETNIKE

Maqedonia e sotme Lindore, Maqedonia e Pirinit dhe Maqedonia e Egjeut janë tri krahinat e mëdha gjeografike që përbëjnë Maqedoninë antike të fisit pellazgo-ilir të Maqedonëve, të cilët në historinë e lashtë identifikohen me mbretin e tyre Filipin II dhe birin e tij, Lekën e Madh, apo Aleksandrin e Maqedonisë.

Sot, këto tri treva, regjione apo krahina të Maqedonisë antike pellazgo-ilire: Maqedonia Lindore, Maqedonia e Pirinit dhe Maqedonia e Egjeut formojnë atë që nacionalistët sllavomaqedonas e quajnë herë Maqedonia e Madhe, e herë Maqedonia Etnike.

Pas dyndjeve, djegëjeve e shkatërrimeve të mëdha të hunëve, mongolëve, gotëve, vikingëve, sllavëve etj., në Gadishullin Ilirik dhe në Maqedoninë antike ilire (para erës sonë dhe në fillim të erës sonë), maqedonët ilirë u larguan me dhunë nga vendi i tyre, shumë u vranë në luftë mbrojtëse që zhvilluan, kurse një pjesë e tyre u asimiluan në sllavë dhe grekë. Nga ata fise sllave që depërtuan dhe u ngulitën në Ilirik janë edhe sllavët e sotëm që banojnë në trevat e Maqedonisë së dikurshme antike, të cilët më vonë e quajtën veten **maqedonas,** sipas emrit të vendit ku banojnë. Prandaj, që këta maqedonas të sotëm, për t'i dalluar nga maqedonët antikë pellazgo-ilirë, në terminologjinë e sotme politike, në të shumtën e rasteve, emërtohen si **sllavomaqedonas.**

si të thuash Dardania Jugore. Dardania antike fillonte nga Tregu i Ri e Nishi në veri dhe mbaronte në Ohër e Manastir në jug dhe kryeqendër kishte Shkupin. Prandaj, edhe sot, kufiri në mes të Maqedonisë Etnike dhe Shqipërisë Etnike gjarpëron përmes fushash e brigjesh nga Kumanova, nëpër Veles e deri në Manastir, për të vazhduar pastaj në drejtim të Florinës, Janinës e Artës në Greqi. Kjo vijë gjeografike antike, është njëkohësisht edhe vija kufitare ndërmjet Maqedonisë Lindore

sllavomaqedonase dhe Maqedonisë Veri-Perëndimore shqiptare.

Tanimë janë të njohura botërisht aspiratat kombëtare e shtetërore të lëvizjeve e partive politike sllavomaqedone dhe shqiptare për krijimin e shteteve të tyre kombëtare, për çlirimin dhe bashkimin e trojeve të tyre etnike, të pushtuara dhe të kolonizuara nga popujt fqinjë: serbët, bullgarët dhe grekët, e cila arrihet vetëm me formimin e Shqipërisë Etnike dhe të Maqedonisë Etnike.

Perëndimore, apo Ilirida, siç i thonë sot shqiptarët, është tokë shqiptare, pjesë e shkëputur me dhunë nga Shqipëria Etnike. Dhe dihet që, shteti kombëtar nuk krijohet e nuk mund të mbahet me toka e me popuj të huaj, sepse nuk ka ardhmëri dhe jetë të gjatë.

përjetësisht politikisht dhe ekonomikisht nga shtetet rretherrotull, sepse, shteti pa det, është sikurse shtëpia pa dritare. Prandaj, rruga, puna dhe angazhimi i vetëm i drejtë i popullit maqedonas dhe udhëheqësve të tij është përpjekja intenzive dhe konkrete për zgjidhjen përfundimtare të çështjes maqedone, është lufta politike për bashkimin kombëtar e territorial të maqedonëve dhe të Maqedonisë Etnike.

Pushtetarët maqedonas, të të gjitha ngjyrave politike e ideologjike, nuk duhet të humbin kohë dhe energji duke ndjekur, diskriminuar e shtypur shqiptarët, sepse shqiptarët nuk janë armiqtë e maqedonëve, sepse shqiptarët dhe maqedonët kanë të njëjtin problem pa zgjidhur: formimin e shtetit etnik kombëtar. Sepse shqiptarët dhe maqedonët nuk janë armiq të njëri-tjetri, por kanë armiqtë e përbashkët.

Populli maqedonas dhe politikanët e tij nuk duhet të luftojnë kundër shqiptarëve, sepse armiqtë e tyre janë serbët. Ata të cilët, në bashkëpunim me shovenistët bullgarë dhe grekë pas vitit 1912, e pushtuan dhe e ndanë Maqedoninë etnike midis tyre në tri pjesë, duke e

quajtur pjesën e tyre Juzhna Srbija (Serbia Jugore)! Janë serbët ata që kanë sjellë me dhjetëramijëra kolonë serbë në kohën e Jugosllavisë së kralëve për ta kolonizuar e serbizuar Maqedoninë! Janë serbët ata që mbollën farën e shovenizmit, të urrejtjes e të përçarjes midis maqedonëve e shqiptarëve me qëllim të sundimit të tyre më të lehtë e më të sigurt! Janë serbët ata të cilët edhe sot nuk e njohin Pavarësinë e Kishës Ortodokse Maqedone! Janë shovenistët serbë ata që ende në arkivat e tyre sekrete mbajnë të fshehura planet për aneksimin dhe serbizimin e Maqedonisë, prandaj edhe me aq ngurrim dhe vonesë e njohën pavarësinë e saj, pas shpërbërjes së Jugosllavisë!(Kurse Shqipëria ishte shteti i parë në botë që njohu Maqedoninë si shtet të pavarur e sovran, pas daljes së saj nga ish-Jugosllavia). Janë serbët, edhe sot, ata që po hiqen si "aleatët" e "miqtë" e popullit maqedonas e të Maqedonisë, duke e frikësuar atë me "gogolin" e shtetit të Kosovës, duke u përpjekur që të shtijnë pyka helmuese midis shqiptarëve e maqedonëve dhe me politikën e tyre të hapur antishqiptare dhe të fshehtë antimaqedone tentojnë që t'i fusin në luftë të armatosur e të përgjakshme dy popujt tanë, me synimin përfundimtar që të fitojnë ata, që ta shtrijnë përsëri sundimin e tyre në Maqedoni!

As bullgarët e Bullgaria nuk janë lule, nuk janë miqtë e vërtetë e të sinqertë të Maqedonisë dhe maqedonëve, sepse edhe ata kanë qëllime pushtuese ndaj tyre, si dhe nuk e njohin kombin maqedonas, gjuhën, historinë dhe kulturën e tij kombëtare! Ata edhe sot ua mohojnë të drejtat kombëtare, njerëzore e kulturore maqedonasve në Maqedoninë e Pirinit, të cilën e kanë pushtuar padrejtësisht, në aleancë me serbo-grekët, gjatë Luftërave Ballkanike në vitet 1912-1914! Edhe ndihmën "vëllazërore" që ia dha Bullgaria Maqedonisë në konfliktin e vitit 2001 kundër shqiptarëve, duke i falur armatim të vjetëruar, e kishte me hile, sa për sy e faqe dhe, sikurse serbët, për të armiqësuar maqedonët me shqiptarët, për t'i dobësuar ata dhe në fund për t'i pushtuar e për t'i sunduar ata!

Të mos flasim për Greqinë, këtë aleate tinëzare të Serbisë, e cila që nga formimi i saj si shtet, me ndihmën kolosale të luftëtarëve e kryekomandantëve arvanitas (shqiptar), më shumë është qeverisur nga hunta e qeveri fashiste, se sa nga qeveri demokratike! Greqia, edhe më keq se Serbia, Maqedoninë nuk e njeh as si shtet, as si komb as si emër! Populli maqedonas në Maqedoninë e Egjeut nuk njihet as si pakicë kombëtare dhe të mos flasim për të drejta njerëzore, kulturore, gjuhësore apo kombëtare! Kushtetuta greke dhe regjimet e Greqisë e kanë proklamuar atë si shtet të pastër etnik, ku "nuk" ekzistojnë pakica tjera kombëtare jo greke! Por realiteti objektiv dhe e vërteta mund të fshehen, aq sa mund të mbulohet dielli me shoshë. Dhe është fakt i gjallë se, që nga Gjevgjelia e deri në Selanik, në të dyja anët e rrjedhës së Vardarit, shtrihet Maqedonia e Egjeut, e banuar kryesisht me popullsi maqedone, që mendojnë e flasin maqedonisht, edhe pse, si në të kaluarën, ashtu edhe tash, nuk guxojnë as të shkruajnë dhe as të flasin publikisht maqedonisht nga regjimet dhe politika në vazhdimësi fashiste e raciste e Athinës!

*****

Shqiptarët dhe maqedonët kanë qenë dhe janë aleatë natyrorë dhe strategjikë të njëri-tjetrit. Ata kurrë nuk kanë luftuar mes veti dhe nuk kanë pushtuar me vetëdije tokat e njëri-tjetrit, përveç se në raste kur kanë ra në kurthën e të huajve, si për shembëll: kur luftëtarët maqedonas janë nxitur dhe mashtruar nga shovenistët serbo-bullgarë, pas tërheqjes së Turqisë nga Ballkani, gjatë Luftërave Ballkanike, në luftë për pushtimin e tokave shqiptare! Apo rasti tjetër, kur ballistët shqiptarë, të nxitur nga fashistët italo-gjermanë, kanë luftuar kundër maqedonëve për mbrojtjen e krijesës fashiste, shtetit gjysmak e kuisling të "Shqipërisë së Madhe", e cila as si e tillë nuk ka qenë fare e madhe, sepse s'ka qenë as sa gjysma e Shqipërisë reale etnike!

Sidoqoftë, edhe ato pak përleshje të armatosura që janë zhvilluar midis shqiptarëve dhe maqedonëve, janë rezultat i intrigave dhe politikave antishqiptare dhe antimaqedone të Serbisë, Bullgarisë, Greqisë dhe regjimeve fashiste evropiane. Kurse, gjatë gjithë periudhës tjetër historike, shqiptarët dhe maqedonët kanë bashkëpunuar, kanë qenë aleatë dhe kanë luftuar së bashku kundër pushtimit turk dhe të tjerëve më vonë, për çlirim kombëtar. Nuk është këtu vetëm rasti i Kryengritjes së Ilindenit dhe Republikës maqedono-shqiptare të Krushevës më 1903, por janë me qindra beteja e ndihma solidare të shqiptarëve dhe maqedonëve në luftën e tyre për liri e pavarësi kombëtare. Ky bashkëpunim e bashkëveprim i përbashkët është pohuar e shkruar edhe nga vetë luftëtarët, historianët, shkrimtarët dhe udhëheqësit politik e ushtarakë maqedonas të asaj periudhe kohore. Kush e ka shfletuar e lexuar historinë e Maqedonisë dhe të Shqipërisë të shekujve XVIII, XIX e XX do të binden për këtë të vërtetë. Historia është për t'u lexuar, për t'u analizuar, për t'u kuptuar drejt, për të mësuar nga ajo dhe për të mos u përsëritur gabimet historike të të dy popujve tanë sot dhe në të ardhmen. Po ta lexojnë me vëmendje, seriozisht, shkencërisht, me mendje të kthjelltë, me zemër e sinqeritet të vërtetë shqiptarët dhe maqedonët historinë e tyre kombëtare dhe historinë e njëri-tjetrit, atëherë do të shohin dhe do të binden se ata kanë qenë dhe janë të vetmit aleatë natyrorë e strategjikë, të vetmit mbështetës të njëri-tjetrit për zgjidhjen e drejtë të çështjeve të tyre kombëtare në Ballkan, janë bashkëluftëtarë për krijimin e Shqipërisë Etnike dhe të Maqedonisë Etnike. Natyrisht që, përveç njëri-tjetrit, shqiptarët dhe maqedonët kanë e do të kenë edhe aleatë të tjerë në Ballkan dhe në botë.

Nuk mund të çlirohet e të bashkohet Maqedonia Etnike, duke luftuar maqedonët kundër të gjithë popujve fqinjë, e sidomos kundër shqiptarëve, sepse nuk kanë resurse njerëzore dhe ekonomike. As duke mbajtur nën sundim Iliridën shqiptare (Maqedoninë Veri-Perëndimore), por duke u afruar e pajtuar, duke bashkëvepruar e lidhur

aleancë politiko-ushtarake me shqiptarët e Iliridës e të gjithë Shqipërisë Etnike, në luftë të përbashkët kundër armiqëve e pushtuesve të përbashkët të tyre.

Le të shërbejë Marrëveshja historike e Ohrit e gushtit 2001 si një urë lidhëse, afrimi, pajtimi e besimi reciprok; si një fillim i bashkëpunimit politiko-strategjik, si një ripërtritje e aleancës shekullore shqiptaro-maqedone në luftë të përbashkët për aspirata të njëjta kombëtare. Le të shërbejë Marrëveshja e Ohrit si pikënisje, si gur themeli për ndarjen paqësore e demokratike të të dy popujve tanë dhe për forcimin e fqinjësisë dhe miqësisë midis shqiptarëve e maqedonëve dhe si fillim i bashkëpunimit ndërshtetëror në mes të Maqedonisë Etnike dhe Shqipërisë së ardhshme Etnike.

Prandaj, të mos e dëmtojmë më tej njëri-tjetrin, të mos e luftojmë dhe urrejmë më tej njëri-tjetrin, të mos e pengojmë më tej njëri-tjetrin në rrugë për çlirim dhe bashkim kombëtar, sepse në këtë mënyrë luftojmë vetëveten, pengojmë me vetëdije ribashkimin e Maqedonisë Etnike dhe të Shqipërisë Etnike.

As Shqipëria Etnike nuk mund të çlirohet e të ribashkohet duke u ngritur shqiptarët kundër gjithë Ballkanit, pavarësisht se ata janë rreth 8 milionë banorë në gjithë hapësirat e Shqipërisë Etnike. Edhe shqiptarëve u duhen aleatë natyrorë e miq për të realizuar të drejtat dhe idealet e tyre kombëtare. Dhe njëri nga ata 5-6 aleatët e mundshëm të shqiptarëve janë edhe maqedonët.

Armiqtë e shqiptarëve dhe të maqedonëve janë në bashkëpunim të fshehtë dhe në aleancë të fortë me njëri-tjetrin kundër dy popujve tanë, dhe përmes taktikës e dredhisë romake ”përçajë e sundo” e kanë penguar dhe po e pengojnë ende ribashkimin e popullit maqedonas dhe të popullit shqiptar në shtetet e tyre etnike. Edhe sa do të ketë sukses kjo taktikë e politikë kolonialiste serbo-bullgaro-greke, kjo do të varet nga mençuria, vendosmëria, guximi, afrimi, pajtimi, bashkëveprimi, marrëveshja dhe lidhja e aleancës politiko-ushtarake midis shqiptarëve dhe maqedonëve për të punuar e

luftuar së bashku kundër pushtuesve e kolonizatorëve të Shqipërisë Etnike dhe të Maqedonisë Etnike.

Ndoshta edhe të vetëm, të ndarë dhe të armiqësuar me njëri-tjetrin shqiptarët dhe maqedonët do ta realizojnë idealin, programin dhe të drejtën e tyre për shtete të bashkuara etnike, por është vështirë të besohet se, edhe po të arrihet një gjë e tillë pa aleancën shqiptaro - maqedone, atëherë kjo do të arrihet përmes ndeshjeve e përleshjeve të kota e të panevojshme midis shqiptarëve e maqedonëve, të cilat do të gjakosnin e rigjakosnin dy popujt tanë dhe do të gëzonin armiqtë tanë të përbashkët!

Një tragjedi dhe gabim i tillë historik e fatal nuk duhet të ndodhë, sepse udhëheqësve e luftëtarëve shqiptarë e maqedonas një gjë të tillë nuk do t'ua falte kurrë as historia, as ndërgjegja njerëzore e demokratike dhe as brezat e ardhshëm të të dy popujve tanë.

Uroj nga zemra që shqiptarët dhe maqedonët, si dhe politikanët e tyre të tashëm e të ardhshëm, ta shqyrtojnë me bindje e seriozitet të plotë, me zemër të ftohtë e mendje të kthjelltë realitetin historik e aktual të marrëdhënieve politiko - ushtarake shqiptaro - maqedone, duke hartuar kontrata, pakte e marrëveshje të reja strategjike bashkëpunimi e bashkëveprimi në interes të forcimit të paqes e të pajtimit, të krijimit të aleancës shqiptaro - maqedone për arritjen e objektivave legjitime kombëtare për vetëvendosje të të dy popujve tanë, si dhe për ribashkimin e Shqipërisë Etnike dhe të Maqedonisë Etnike.

Shkruar në Janar 2004,
Botuar në, PASQYRA, revistë e pavarur, Nr.78, 10 Shkurt 2004, Prishtinë, me titull: Shqiptarët dhe maqedonët duhet të punojnë bashkë

MAQEDONIA, DREJT EUROPËS PA ILIRIDËN!

Pushtetarët sllavomaqedonas gjatë gjithë historisë së tyre ”shtetërore”, që nga viti 1945 e deri më sot, janë treguar antishqiptarë! Kanë punuar e vepruar kundër popullit shqiptar nën këtë ”republikë-shtet”, duke i maltretuar e burgosur, duke ua mohuar të drejtat kombëtare e njerëzore, duke ua cunguar kulturën, arsimin dhe historinë e tyre origjinale.

Si në kohë të ”komunizmit” (1945-1991), ashtu edhe në kohë të ”demokracisë” (1991-2007), pozita shtypëse e shfrytëzuese e shqiptarëve nën këtë ”republikë-shtet” nuk ka ndryshuar aspak! Ajo vetëm ka njohur disa zbatica të vogla herë pas here, kur forcat e pushtetarëve kanë qenë të dobësuara, por në momentin kur pushtetarët sllavomaqedonas në Shkup kanë forcuar pozitat politiko-ushtarake, atëherë menjëherë ka filluar batica dhe përplasja e tyre me popullin shqiptar të Iliridës!

Duke qenë gjithmonë një dorë e zgjatur e shovenizmit serbomadh dhe ekspansionizmit bullgaromadh, pushtetarët sllavomaqedonas në Shkup kurrë nuk kanë ngurruar që të nëpërkëmbin Shqiptarët, që t’i shtypin politikisht, që t’i diskriminojnë etnikisht, që t’i shfrytëzojnë ekonomikisht, deri edhe t’i burgosin dhe vrasin fizikisht!

Kështu flet historia e djeshme e këtij ”shteti”! Kështu flasin edhe ngjarjet e sotme politike në këtë vend! Pushtetarët sllavomaqedonas në Shkup thonë e trumbetojnë çdo ditë se ata kanë ndërtuar një ”shtet” i cili është e vetmja ”oazë e paqes” në Ballkan, duke u përpjekur kështu që të fitojnë poena tek ndërkombëtarët për t’u anëtarësuar në NATO dhe në ”Bashkimin” Europian. Por me politikën e saj antishqiptare që ka ndjekur dhe që po ndjek në vazhdimësi, Maqedonia (IRJM) jo vetëm që nuk do të aderojë kurrë në këto organizma ndërkombëtarë, por ajo rrezikon edhe integritetin e vet territorial!

Me politikën antidemokratike, shoveniste e antishqiptare që ndjekin, pushtetarët e Shkupit e kanë dëshmuar se ata nuk duan që të anëtarësohen në NATO dhe në "Bashkimin" Europian, sepse nuk i lejon albanofobia e tyre, sëmundje kjo kronike e të gjitha shovenizmave sllavo-greke të Ballkanit! Ata duan të integrohen në NATO dhe Europë, por pa Shqiptarët dhe pa trojet shqiptare të Iliridës. Kësaj doktrine antishqiptare i shërben edhe akti më i fundit i Gjykatës Kushtetuese të Shkupit për ndalimin e përdorimit të Flamurit Kombëtar Shqiptar nga populli ynë në Iliridë, si dhe më heret të mohimit të të drejtës së Gjuhës Shqipe që të jetë gjuhë e dytë zyrtare shtetërore! Kush na garanton neve se nesër po kjo Gjykatë Kushtetuese nuk do të marrë një vendim tjetër për anulimin e Ligjit për Decentralizimin Territorial, ose se nuk do të anulojë Ligjin për Zyrtarizimin e Universitetit Shtetëror të Tetovës?! Ky qëndrim antishqiptar i qeveritarëve sllavomaqedonas e ka burimin te mohimi dhe shkelja e vendimeve të "Marrëveshjes së Ohrit". Kjo do të thotë se historia po përsëritet. Historia shqiptaro-maqedonase po kthehet me shpejtësi te viti i errët dhe i përgjakur i vitit 1997! Kjo do të thotë se sërish po na troket në derë viti i përleshjeve të gjakosura shqiptaro-maqedonase të pranverë-verës 2001!

Këtë herë luftën shqiptaro-maqedonase don ta shpallë Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë, një organ "i pavarur" e "apolitik", i cili duhej të ishte garant i demokracisë, ligjshmërisë, kushtetutshmërisë dhe paqes ndëretnike në IRJM! Por, jo, ajo tanimë ka marrë rolin e luftënxitësit dhe përndjeksit të një populli të tërë – Shqiptarëve të Iliridës!

Nuk duhet harruar se vendimet e kësaj Gjykate janë obligative për pushtetin ekzekutiv qendror dhe lokal. Vendimet e kësaj Gjykate nuk janë të diskutueshme, ato vetëm duhet të zbatohen. Kjo do të thotë se, në rast se Kryetarët Shqiptarë të Komunave refuzojnë zbatimin e këtij vendimi, ata do të detyrohen me ligj që ta bëjnë një gjë të tillë! Në rast se ata refuzojnë përsëri, atëherë ata do

të ndiqen penalisht! Kjo do të thotë se, Kryetarët Shqiptarë të Komunave do të pushohen nga puna, do t'u merret me dhunë mandati i populli dhe do të arrestohen, burgosen dhe gjykohen për shkelje të ligjit! Refuzimi i Kryetarëve Shqiptarë të Komunave që të zbatojnë vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe të urdhërave të Qeverisë, do të thotë përleshje dhe gjakderdhje e re shqiptaro-maqedonase! Do të thotë fillimi i shpërbërjes definitive të këtij shteti me emrin IRJM/FYROM. Dhe fajtorë për këtë do të jetë Gjykata Kushtetuese antishqiptare e Shkupit dhe nxitësja e saj – Qeveria ultranacionaliste e VMRO-DPMNE-së dhe vazalëve të tyre "shqiptarë"!

Mohimi dhe shkelja e "Marrëveshjes së Ohrit" nga pushtetarët e sotëm ultranacionalistë të VMRO-DPMNE-së është në realitet mohim i bashkëjetesës së Shqiptarëve dhe Sllavomaqedonëve në të njëjtin shtet, që sot nga ata quhet Republika e Maqedonisë, kurse nga Ndërkombëtarët dhe OKB quhet Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë – IRJM (apo FYROM në anglisht).

Mohimi, anashkalimi, shkelja dhe moszbatimi i "Marrëveshjes së Ohrit", nga kushdoqoftë, do të thotë mohim i IRJM-së, do të thotë shpërbërje dhe ndarje e Republikës aktuale të Maqedonisë ndërmjet Shqiptarëve dhe Sllavomaqedonasve. Dhe, përderisa këtë "Marrëveshje të Ohrit" deri tani e kanë mohuar dhe shkelur vetëm qeveritarët sllavomaqedonas, kjo do të thotë se ata janë iniciatorët numër një për ndarjen e Maqedonisë. Ç'është e vërteta, qeveritarët e VMRO-DPMNE-së edhe herën e kaluar kur ishin në pushtet, edhe tani që kanë rimarrë pushtetin, janë deklaruar disa herë hapur se janë për ndarjen e Maqedonisë, gjegjësisht për flakjen e Shqiptarëve nga ky shtet.

Qeveritarët sllavomaqedonas "Flakjen" e Shqiptarëve nga ky vend kanë tentuar ta bëjnë edhe gjatë konfliktit të armatosur të vitit 2001, por nuk u ka ecur. Një gjë të tillë ata tentojnë ta bëjnë edhe tani, me anë të mohimit të të drejtave njerëzore dhe kombëtare të shqiptarëve, përmes

moszbatimit të ”Marrëveshjes së Ohrit” dhe përmes provokimeve të përditshme, siç është rasti i fundit përmes ndalimit gjyqësor të përdorimit të lirë e publik të Flamurit Kombëtar nga ana e popullit shqiptar të Iliridës.

Ç’do të thotë ”Flakje” e Shqiptarëve nga Maqedonia, sipas planeve shoveniste antishqiptare të pushtetarëve VMRO-istë? FLAKJE do të thotë që Maqedonia dhe sllavomaqedonët të lirohen nga shqiptarët dhe trojet e tyre, duke u dhënë atyre aq sa duan ata dhe jo aq sa janë trojet shqiptare nën Maqedoni.

Dhe, sipas tyre, trojet shqiptare të Iliridës janë vetëm dy qytete-komuna të saj: Dibra dhe Gostivari dhe ndonjë pjesë rurale aty-këtu!!! E pra, kaq fodullë e arrogantë, kaq mendjelehtë dhe mendjemëdhenj janë shovenistët sllavomaqedonas, sa që ata luajnë rolin e ”Zotit” të ”plotëfuqishëm” dhe u ”japin” Shqiptarëve aq troje shqiptare sa duan ata! Luajnë rolin e ”Zotit” të ”gjithëdijshëm”, duke pretenduar se janë historian ”të pagabueshëm” dhe ”i dijnë” se ku shtrihen historikisht dhe faktikisht trojet shqiptare të Iliridës!

Në këtë mënyrë, pushtetarët dhe historianët sllavomaqedonas luajnë edhe rolin e ”naivit”, bëhen sikur ”nuk i njohin” kufinjtë etnikë të Iliridës në IRJM! Ata dridhen e tmerrohen kur u kujtohet se ku janë kufijtë etnikë, natyrorë e realë të trojeve shqiptare të Shqipërisë Etnike dhe në këtë kuadër edhe kufijtë e trojeve etnike të Iliridës. Ata e dinë se heret a vonë trojet etnike shqiptare të Iliridës do të ndahen nga IRJM dhe do t’i bashkohen Shqipërisë Etnike, prandaj ata, me një sjellje prej ”demokratësh” e ”xhentëlmenësh” përpiqen që ”të keqes” t’i dalin përpara, duke propozuar ”vetëvendosje” sllavomaqedonase për trojet shqiptare të Iliridës dhe shkëputjen e tyre nga Maqedonia në mënyrë ”paqësore”.

Në këtë mënyrë ata duan të marrin pjesën e ”luanit” të trojeve shqiptare, duke ofruar ”vullnetarisht” ndarjen e dy-tre qyteteve shqiptare nga Maqedonia dhe kështu të mbyllej përgjithmonë çështja shqiptare në Maqedoni. Ta duan ta ndajnë Maqedoninë (IRJM) por jo me

marrëveshjen e tyre me Shqiptarët, por përmes provokacioneve të këtilla, që faji para ndërkombëtarëve, për ndarjen e Maqedonisë, për ndryshimin e kufijve, për prishjen e ”paqes”, etj., t’u mbesë shqiptarëve! Ky është një plan dinak nga sllavomaqedonasit, por i parealizueshëm, sepse është bërë pa Shqiptarët. Pa të zotët e vendit. Ilirida nuk mund të ndahet, ajo është një trevë kompakte shqiptare. Maqedonia mund të ndahet kur të dojë nga Ilirida.

IRJM mund të hyjë në Europë e në NATO, edhe pa popullin shqiptar, pa trojet etnike shqiptare, pa Iliridën. Ilirida, trojet e saj dhe shqiptarët e saj, së pari do të bëjnë integrimin dhe bashkimin territorial të Shqipërisë Etnike dhe pastaj si shtet i bashkuar kombëtar do të integrohen edhe në organizmat euro-atlantike të NATO-s dhe të Bashkimit Europian. Shqipëria e Bashkuar në Europën e Bashkuar.

1 nëntor 2007

REPUBLIKA FEDERATIVE E VARDARIT-
ALTERNATIVA E VETME PAQËSORE

H Y R J E

Bashkimi bën fuqinë, - thotë urtësia popullore. Por, jo çdo bashkim bën fuqinë. Ka bashkim dhe „bashkim“. Ka bashkim të vullnetshëm dhe bashkim të dhunëshëm.

Pjesa e kombit shqiptar dhe trojeve të tij që sot gjenden të kolonizuara, të ndara dhe të pushtuara nga Serbia, Greqia, Maqedonia dhe Mali i Zi bëjnë pjesë në bashkimin e dhunshëm të trojeve shqiptare këtyre shteteve shoviniste fqinje.

Bashkimi i vullnetshëm i popujve dhe shteteve bëhet nga shkaqe, interesa dhe rrethana të caktuara historike, objektive dhe subjektive të popujve që bëjnë bashkimin. Dhe po nga rrethana e shkaqe të caktuara historiko-politike, ekonomike e kulturore popujt bëjnë çbashkimin dhe ndarjen e tyre. Bashkimi i dhunshëm sjellë çbashkimin e dhunshëm, kurse bashkimi i vullnetshëm sjellë ndarjen e vullnetshme. Bashkimi dhe ndarja e popujve është një e drejtë e tyre e patjetërsueshme, është një veprim i arsyeshëm dhe i nevojshëm në bazë të kohës, hapësirës dhe rrethanave konkrete politike në të cilat bëhet bashkimi apo ndarja e popujve.

Me vullnetin e tyre popujt, zakonisht, bashkohen në federata e konfederata, lidhje apo bashkësi shtetesh dhe po me vullnetin e tyre ata dalin nga federata, konfederata apo bashkësia shtetërore. Shprehja e lirë e vullnetit të popullit bën pjesë në të drejtën demokratike e të ligjshme të çdo populli për vetëvendosje: të vendosë vetë për bashkim me popujt tjerë apo për ndarje nga ata, si dhe të vendosë vetë për formën shtetërore të zhvillimit të tij shoqëror, politik, juridik, ekonomik dhe kulturor.

I. PAK HISTORI

Kombi shqiptar është njëri ndër popujt më të vjetër të Ballkanit (Ilirikut) dhe Europës. Ai është populli autokton në tokat ku jeton sot dhe është pasardhës i drejtpërdrejtë i Ilirëve.

Si gjatë sundimit romako-bizantin, pushtimeve të hershme e të vonëshme sllave, ashtu edhe gjatë sundimit osman, populli ynë nuk e pushoi kurrë qëndresën dhe luftën e tij me shpatë, penë dhe pushkë në dorë për liri, pavarësi, bashkim kombëtar dhe progres shoqëror.

Me gjithë luftërat dhe përpjekjet e parreshtura për çlirim dhe bashkim kombëtar, populli shqiptar dhe trojet e tij etnike ende janë të ndara në katër shtete shoviniste dhe kolonialiste fqinje: Serbia, Greqia, Maqedonia (IRJM) dhe Mali i zi.

Ndarja e kombit shqiptar dhe trojeve të tij etnike është si rezultat i politikave grabitqare të shteteve shoviniste fqinje dhe si rezultat i qëndrimeve antishqiptare e antidemokratike të Fuqive të Mëdha të kohës, të cilat përmes Kongresit të Berlinit (1878), Konferencës së Londrës (1913), Konferencës së Versajës (1919) dhe Konferencës së Parisit (1945), konfirmuan vazhdimisht ndarjen e kombit shqiptar dhe të atdheut të tij – Shqipërisë.

Populli shqiptar në Maqedoni dhe trojet e tij janë vazhdimësi dhe pjesë integrale e kombit shqiptar dhe trojeve të tij në Ballkan – Shqipërisë Etnike.

II. GJENDJA AKTUALE POLITIKO-EKONOMIKE E SHQIPTARËVE NË ILIRIDË

Shqiptarët në Maqedoni përbëjnë mbi 40% të numrit të përgjithshëm të popullsisë së republikës.

Edhepse në numër shumë të madh dhe autoktonë në tokat e tyre, shqiptarët kurrë nuk kanë qenë të barabartë me maqedonasit.

Shqiptarët e Iliridës kanë qenë dhe janë të shtypur e të diskriminuar politikisht, juridikisht dhe ekonomikisht nga ana e pushtetmbajtësve maqedonas.

Shqiptarët janë diskriminuar e po nëpërkëmben edhe sot në fushën e arsimit, kulturës, punësimit dhe të drejtave tjera kombëtare e njerëzore.

As në polici, ushtri dhe në administratën publike, shqiptarët nuk janë të përfshirë në përputhje me numrin e tyre real të numrit të përgjithshëm të popullsisë së republikës, sepse numrin e vërtetë të shqiptarëve e kanë fshehur të gjitha regjimet e deritashme maqedonase.

Mbi shqiptarët është ushtruar dhe po zbatohet ende një politikë denigruese, mospërfillëse, johumane dhe antishqiptare në të gjitha fushat e jetës shoqërore - politike.

Kërkesat dhe vullneti politik i shqiptarëve janë mohuar dhe shkelur me dhunë policore - ushtarake me dekada të tëra nga regjimet maqedonase.

As pas luftës gjysmëvjeçare të UÇK-së dhe aprovimit të Marrëveshjes së Ohrit, shqiptarët në Maqedoni nuk i kanë realizuar aspiratat e tyre kombëtare për drejtësi dhe barazi me maqedonasit.

Marrëveshja e Ohrit jo vetëm nuk e ka tejkaluar, por as nuk e ka arritur përmbajtjen e Kushtetutës së Republikës Socialiste të Maqedonisë së viteve 70-të dhe 80-të të shekullit të kaluar.

Aktualisht shqiptarët në Maqedoni janë të pakënaqur me pozitën e tyre politike, juridike, ekonomike e kulturore, sepse kushtetuta dhe ligjet në fuqi nuk ua

njohin të drejtën e kombit shtetformues dhe gjuhën shqipe si gjuhë zyrtare shtetërore. Shqiptarët e Iliridës ende janë pakicë kombëtare në Republikën e Maqedonisë unitariste.

III. PARIMET E PËRGJITHSHME DEMOKRATIKE TË SHQIPTARËVE NË ILIRIDË

Shqiptarët e Iliridës angazhohen për realizimin praktik të së drejtës së popujve për të shprehur vullnetin e tyre politik përmes **Referendumit Popullor**, duke vetëvendosur për shtetin në të cilin duan të jetojnë dhe për formën shtetërore që duan të formojnë, gjithmonë sipas Kartës së OKB-së**: mbi të drejtën e popujve për vetëvendosje deri në shkëputje.**

Shqiptarët e Iliridës punojnë për rrespektimin e të drejtave themelore njerëzore, të drejtën e shprehjes së lirë të mendimit, të drejtën e organizimit politik, të drejtën e protestimit paqësor, të drejtën e arsimimit, të punësimit dhe besimit sipas ligjeve demokratike të sistemit shumëpartiak dhe pluralizmit politik të sanksionuara në Konventën e Gjenevës të vitit 1951.

Shqiptarët e Iliridës kërkojnë të bëhet regjistrimi real dhe transparent i popullsisë në Maqedoni, nën kontrollin e rreptë të tyre dhe të ndërkombëtarëve dhe me theks të veçantë të dihet numri i vërtetë i shqiptarëve.

Shqiptarët e Iliridës e pranojnë dialogun politik demokratik dhe marrëveshjen për zgjidhjen e të gjitha çështjeve të hapura politike, ekonomike e sociale që i preokupojnë dy popujt tanë dhe grupet tjera etnike në Maqedoni.

Shqiptarët e Iliridës janë për integrime politiko - ekonomike dhe ushtarake rajonale dhe europiane, por pasi të jetë arritur integrimi i brendshëm ndërshqiptar.

Shqiptarët e Iliridës janë përcaktuar për ekonominë e tregut të lirë, për qarkullimin e lirë të njerëzve, të vlerave

materiale e të kapitalit, duke iu nënshtruar ligjeve të konkurencës demokratike.

Shqiptarët e Iliridës angazhohen për investimin e kapitalit të jashtëm, ngritjen e objekteve industriale, duke u përkujdesur për zhvillimin sa më të shpejtë të tokave shqiptare, për punësimin e njerëzve dhe ngritjen e standardit jetësor të qytetarëve.

Shqiptarët e Iliridës mbështesin pa rezervë punën shkencore e arsimore të Universitetit të Tetovës dhe angazhohen me të gjitha forcat që ky institucion i lartë mësimor të institucionalizohet, të regjistrohet dhe të finansohet nga shteti.

IV. QËNDRIMET DHE SYNIMET POLITIKE, DEMOKRATIKE DHE KOMBËTARE TË SHQIPTARËVE NË ILIRIDË

Shqiptarët në Maqedoni i kanë të gjitha karakteristikat dhe atributet e një kombi. Ata kanë territorin e tyre kompakt, gjuhën, historinë, lidhjet ekonomike, formimin psiqik, vetëdijen e lartë kombëtare, kulturën e traditën e lashtë, si dhe autoktoninë mijëravjeçare në këto troje.

Mbështetur në realitetin objektiv aktual dhe në të vërtetën historike, shqiptarët e Iliridës aspirojnë për barazinë e plotë politiko - juridike të tyre dhe maqedonëve, përmes ngritjes së shqiptarëve në nivelin e kombit shtetformues dhe të gjuhës shqipe në gjuhë zyrtare shtetërore – krahas kombit maqedon dhe gjuhës maqedonishte.

Shqiptarët e Iliridës angazhohen që republika e sotme e Maqedonisë të shndërrohet në një shtet federativ i përbërë nga dy republika: **republika shqiptare** dhe **republika maqedonase.**

Shqiptarët e Iliridës synojnë që shteti i ardhshëm shqiptaro - maqedonas të emërohet: **Republika Federative e Vardarit (RFV).** Republikën Federative të

Vardarit, si shtet të njohur ndërkombëtarisht, do ta përbëjnë: **Republika e Iliridës** dhe **Republika e Maqedonisë.**

Kryeqyteti i Republikës Federative të Vardarit do të jetë **Shkupi**, i cili njëkohësisht do të shpallet kanton i pavarur e neutral, kurse Republika e Iliridës dhe Republika e Maqedonisë do të kenë kryeqytetet e tyre, por jo Shkupin.

Flamuri i Republikës Federative të Vardarit do të jetë një bashkim i flamurit të Iliridës dhe flamurit të Maqedonisë: mbi fushën e kuqe të flamurit do të vendoset shqiponja e zezë dykrenare dhe dielli i verdhë me rreze.

E gjithë veprimtaria politike, ekonomike dhe juridike e brendshme dhe e jashtme e Republikës Federative të Vardarit do të rregullohet me Kushtetutën Federative, e cila do të hartohet nga ekspertët e komisionit kushtetues shqiptaro-maqedonas, sipas standardeve eropiane të federalizmit demokratik.

Federalizimi i Maqedonisë nuk është shpikur nga një grusht „ekstremistësh“ shqiptarë. Këtë idé e kanë shprehur edhe shumë intelektualë dhe veprimtarë politikë realistë maqedonas qysh nga gjysma e dytë e shekullit XIX dhe deri te gjysma e parë e shekullit XX, siç janë: Petar Manxhukov, Konstantin Kirkov, Goce Dellçev, Jane Sandanski, Dimitar Vllahov,...etj., dhe deri te Vançó Mihajllov e Mirjana Maleska në ditët tona.

Shqiptarët e Iliridës konsiderojnë se krijimi i Republikës Federative të Vardarit është zgjidhja më e drejtë dhe më reale në kushtet dhe rrethanat politike aktuale në Ballkan dhe në përputhje të plotë me politikën europiane e botërore të integrimit dhe mosndryshimit të kufinjve shtetërorë me dhunë.

Shqiptarët e Iliridës besojnë thellësisht se Republika Federative e Vardarit do të ishte një faktor i madh stabilizues për paqen në Ballkan, për zhvillimin e hovshëm ekonomik të vendit, si dhe për anëtarësimin më të shpejtë të tij në Bashkimin Europian dhe në NATO.

Shqiptarët e Iliridës konsiderojnë se Republika Federative e Vardarit nuk është iluzion, por një mundësi reale që mund të arrihet përmes vullnetit të lirë të popullit shqiptar dhe popullit maqedonas – me anë të dialogut konstruktiv demokratik.

Republika Federative e Vardarit jo vetëm që do të qetësonte Ballkanin dhe Europën, por në rradhë të parë do t'i qetësonte, do t'i pajtonte, dhe do t'i miqësonte përgjithmonë shqiptarët dhe maqedonët. Të dy popujt do të bëheshin më të fortë, më të pasur dhe më të civilizuar. Ata do të ishin shembëll frymëzimi bashkëjetese paqësore për të gjithë popujt e botës.

Shqiptarët e Iliridës shprehin bindjen se Republika Federative e Vardarit është e mundur dhe duhet të arrihet e të formohet jo përmes luftës, dhe jo pas luftës, por pikërisht para luftës, përmes paqes e dialogut demokratik dhe pas marrëveshjes konstruktive në mes të përfaqësuesve të shqiptarëve dhe të maqedonëve.

Argumentet e shqiptarëve të Iliridës për krijimin e Republikës Federative të Vardarit janë:

Vullneti i lirë për vetëvendosje i shqiptarëve dhe i maqedonëve, e vërteta historike dhe realiteti aktual objektiv, dëshira demokratike për bashkëjetesë e shqiptarëve dhe e maqedonëve në një shtet të përbashkët federativ, si dhe dëshira e tyre që të jetojnë në paqë, drejtësi dhe barazi kombëtare e njerëzore me njëri-tjetrin.

Shqiptarët e Iliridës synojnë dhe besojnë në mundësinë e krijimit të Republikës Federative të Vardarit, prandaj do të angazhohen me të gjitha forcat e tyre njerëzore, politike e shpirtërore për sensibilizimin dhe sqarimin e të dy popujve tanë se Republika Federative e Vardarit është e vetmja zgjidhje politiko-juridike që çon drejtë paqes, drejtë zhvillimit ekonomik dhe progresit demokratik të të dy popujve tanë.

Shqiptarët e Iliridës nuk do të heqin dorë kurrë nga përcaktimi i tyre politik, demokratik e kombëtar për formimin e Republikës Federative të Vardarit. Në realizimin e bindjeve të tyre politike, ata llogarisin në

përkrahjen e gjithë kombit shqiptar, në përkrahjen e popullit maqedonas, si dhe në ndihmën këshillëdhënëse e inkurajuese të qeverive demokratike të Europës, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Shqiptarët e Iliridës konsiderojnë se një popull që i mohon popullit tjetër lirinë, as vetë nuk është i lirë. Ai popull që robëron e sundon popullin tjetër edhe vetë është i robëruar dhe i sunduar. E drejta për liri, demokraci, pavarësi, barazi, drejtësi dhe mirëqenie ekonomike, është e drejtë natyrore dhe njerëzore e patjetërsueshme e çdo populli. Nga kjo e drejtë universale shqiptarët e Iliridës nuk do të heqin dorë asnjëherë, deri në realizimin e plotë të saj. Shqiptarët e Iliridës konfirmojnë se ardhmëria e vetme e Republikës së sotme të Maqedonisë (IRJM) është krijimi nga ajo e Republikës Federative të Vardarit (RFV). Të gjitha opcionet tjera politike jo vetëm që nuk e zgjidhin çështjen politiko-territoriale midis shqiptarëve dhe maqedonëve, por, përkundrazi, e ashpërsojnë më shumë situatën dhe i acarojnë më tej marrëdhëniet ndëretnike. Republika Federative e Vardarit është e vetmja alternativë paqësore që çon drejt paqes së qëndrueshme, kurse të gjitha rrugët tjera „të zgjidhjes“ së përkohëshme çojnë drejtë luftës së pashmangshme, në të ardhmen, midis shqiptarëve dhe maqedonëve.

Shqiptarët e Iliridës kanë bindjen se ata dhe maqedonët i kanë miqtë dhe armiqtë e përbashkët rajonalë e ndërkombëtarë. Shqiptarët dhe maqedonët janë aleatë natyrorë dhe strategjikë të njëri-tjetrit. Republika Federative e Vardarit do ta forconte dhe do ta përjetësonte miqësinë dhe aleancën natyrore e strategjike të shqiptarëve dhe maqedonëve dhe do të hapte horizonte të reja drejtë ardhmërisë paqësore të të dy popujve.

.....

Shkruan në Qershor 2002,
Botuar në GLOBI, revistë e pavarur,
Nr.37, 31 Tetor 2002, Shkup.

KOSOVA–SHTET, RRADHËN E KA ILIRIDA!

Historikisht, në të shumtën e rasteve, Shqiptarët kanë luftuar kundër pushtuesve të tyre ndaras: fis pas fisi, principatë pas principate, pashallëk pas pashallëku e krahinë pas krahine. Numrohen në gishta ato raste në histori kur Shqiptarët janë bashkuar dhe ngritur në luftë çlirimtare si një popull i vetëm dhe i bashkuar.

Këtu mund të numrohet Lidhja e Lezhës, Lidhja e Prizrenit dhe Kryengritja e Përgjithshme e 1912-së, të cilat nuk mund të themi se ia kanë arritur qëllimit final, sepse, pas formimit të tyre Udhëheqjet e tyre nuk kanë funksionuar në unitet të plotë, por ka pasur ndarje e mosmarrëveshje midis krerëve udhëheqës të këtyre Lidhjeve dhe mosunitet mendimi dhe veprimi brenda Udhëheqjes së Kryengritjes së Përgjithshme.

Luftërat çlirimtare pas 1912-së populli ynë i ka bërë i ndarë, veç e veç dhe secili në krahinën e vet. Edhe luftërat e fundit çlirimtare u bënë me rend dhe ndaras, prandaj u fitua aq pak liri e të drejta kombëtare.

Pavarësia e Kosovës vetëm do ta thellojë këtë ndarje, do ta përligji këtë vazhdimësi të përpjekjeve të çdo krahine shqiptare që me forcat e veta të luftojë për të hedhur qafe zgjedhën e robërisë sllavo-greke.

Kosova-Shtet, do t'i hypë "Trenit të Europës", porsi Shqipëria e Tiranës, dhe krahinave tjera shqiptare: Iliridës, Kosovës Lindore, Malësisë së Madhe, Çamërisë, Sanxhakut e Toplicës, do t'u thotë: "Zoti ua bëftë çaren, unë i hypa trenit, eca,... - mirupafshim në Bruksel"!

Kosova-Shtet nuk ishte dhe nuk është aspiratë e popullit shqiptar nën ish-Jugosllavi. Republika Shqiptare e Kosovës, nga Ulqini në Manastir dhe nga Struga në Medvegjë, ishte përpjekja dhe lufta e Shqiptarëve nën ish-RSFJ. Bashkimi i kësaj Republike me Shqipërinë ishte

dhe është vullneti politik dhe kombëtar i popullit shqiptar të Trojeve Shqiptare nën ish-Jugoasllavi, tanimë të copëtuara sërish midis Serbisë, Malit të Zi, Maqedonisë dhe një "Shteti artificial" në formim e sipër të ish-Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës! Kosova-Shtet nuk është aspiratë e shumicës së shqiptarëve të Kosovës prej 62%, të cilët nuk dolën në zgjedhje, por është vetëm e militantëve dhe antëtarëve të Partive politike që morën pjesë në votimet e 17 Nëntorit dhe 8 Dhjetorit 2007, pjesëmarrje e cila mezi i arriti 38%! Ndaj, Kosova do të jetë 38% "shtet" i kosovarëve naivë që ndoqën partitë politike kolaboracioniste shqiptaro-kosovare dhe 62% do të jetë Krahinë Jugore Serbe (Srpska Juzhna Pokrajina), apo Kosovë e Metohi!!!

Nga zgjedhjet e 17 nëntorit dhe 8 dhjetorit del qartë se 38% e shqiptarëve të Kosovës janë për Shtetin multietnik e gjysmak të Kosovës, kurse 62% të shqiptarëve të Kosovës janë për Vetëvendosje dhe për bashkim kombëtar me Shqipërinë, janë pra për bërjen e Shqipërisë Etnike.

Prandaj, lufta dhe përpjekjet e Shqiptarëve të këtyre trevave shqiptare nuk do të ndalen deri në çlirim dhe ribashkim kombëtar. Është iluzion të mendosh se e ke zgjidhur Çështjen Kombëtare të Kosovës vetëm me formimin shtet të 1/3-së së saj! Kosova e vërtetë është trualli i Dardanisë Ilire, që shtrihet nga Tivari në Preshevë dhe nga Manastiri te Molla e Kuqe në Nish.

Sidoqoftë, Kosova, pas shumë vuajtjesh, luftërash e gjakosjesh, e meriton "biletën e trenit" për në Bruksel. Ndërsa, krahinat tjera shqiptare janë ende shumë larg mundësisë për të "blerë" atë biletë të lirisë e të pavarësisë që të udhëtojnë me "Trenin e Europës" për në Bruksel.

Kosova-Shtet do t'i kthehet vetvetes, shërimit të plagëve të veta të robërisë shekullore, ashtu sikurse

Shqipëria londineze, e cila merret me vetveten qe 95 vjet rresht dhe nuk merret me çështjen kombëtare shqiptare dhe me krahinat e robëruara të Shqipërisë Etnike.

Solidariteti dhe bashkëpunimi ndërshqiptar po dobësohet vazhdimisht, sepse është në rritje egoizmi krahinor dhe xhelozia ndërkrahinore e ndërshtetërore midis Kosovës dhe Shqipërisë, se cila do të arrij e para në Bruksel. Kështu do të harrohen plotësisht nga këto dy shtete shqiptare problemet dhe aspiratat e krahinave tjera të pushtuara shqiptare dhe luftërate tyre për çlirim dhe ribashkim kombëtar!

Kosova e Pavarur do t'i ndihmojë krahinat e robëruara të Shqipërisë Etnike, aq sa i ka ndihmuar ata deri më tani Shqipëria e Pavarur e Tiranës: me fjalë, me deklarata kontradiktore, me destabilizim të vetvetes në momentet më kyçe që ka kaluar Kosova dhe trojet tjera shqiptare, me njohjen e shtetit të Maqedonisë e të Malit të Zi, me thirrjet patetike drejtuar "vëllezërve" të matanë kufinjve për të duruar robërinë, për të mos luftuar për liri, të mos prishin "paqen" e pushtuesve dhe thirrje e deklarata tjera antikombëtare!

Moskokëçarja e Shqipërisë londineze dhe e Kosovës unmikistaneze për çlirim dhe ribashkim kombëtar të Shqipërisë Etnike, do të imponojë shumë shpejt që krahinat shqiptare të mbetura edhe më tej nën pushtim të huaj të kthjellohen, të zgjohen, të binden për realitetin objektiv dhe ta marrin fatin e tyre në duart e veta dhe të mos presin ndonjë ndihmë të veçantë "vëllazërore" nga këto dy shtete shqiptare, sepse kjo ndihmë, në raste speciale, do të jetë shumë e vogël, më shumë deklarative, pak logjistike dhe aspak praktike dhe ushtarake.

Kosova do të bëhet "shtet i pavarur", me një gjysmë pavarësi, me sovranitet të kufizuar, shtet pa tapi, me një "sakat" pavarësi, e cila do të jetë shumë pak funksionale

dhe e përdorshme! Kjo pavarësi do të jetë fasadë, sikurse Autonomia e mëparshme e KSA të Kosovës nën Jugosllavinë titiste, sepse tani Kosova do të ketë të njëjtën Autonomi, kurse në realitet ajo nuk do të jetë e vetëdijshme, do të jetë në ëndërr e në iluzion dhe do të kujtojë se ka ”pavarësi e sovranitet”, do të kujtojë se është ”shtet”!!! Kosova-Shtet, do të jetë një shtet i dobët që mezi do të qëndrojë në këmbë, por megjithatë, do të jetë shtet dhe ne ia urojmë shtetësinë e pavarësinë, me dëshirën e shpresën që ky "shtet", me kohën, do të bëhet vërtetë shtet.

”Pavarësia dhe shtetësia” e Kosovës nuk duhet t’ua rrisë mendjen dhe vetëkënaqësinë kosovarëve shqiptarë. Kjo gjendje deliri mund të bëhet shumë e rrezikshme për Kosovën dhe për mbarë Çështjen Kombëtare Shqiptare. Tani mund të jetë më vështirë që t’i bindësh shqiptarët e Kosovës, ”kosovarët” e ”shtetit” të Kosovës, që ata nuk kanë fituar asgjë nga ky pseudoshtet! Mund të jetë e vështirë t’i bindësh ata se janë të barabartë me shqiptarët e Iliridës, Kosovës Lindore e të Malësisë së Madhe në aspektin e lirisë, pavarësisë e sovranitetit kombëtar. Pra, janë edhe mëtej, sikurse vëllezërit tjerë: pa liri, pa pavarësi, pa sovranitet dhe në robëri, por që kjo robëri e ky pushtim tani kanë emër tjetër në Kosovë, më të sofistikuar, më të kamufluar, më tërheqës për naivët e mendjelehtët, ka emrin e ”Shtetit” e të ”Pavarësisë”, por realisht ka përmbajtjen e Protektoratit, i cili nuk është asgjë tjetër pos Neokoloni Evropiane!

Kush është tani ai filozof e patriot, ai lider e idealist, ai luftëtar e revolucionar që mund t’i bindë shqiptarët kosovarë se ata nuk kanë pavarësi, nuk kanë liri, nuk kanë shtet e sovranitet?! Kush është ai politikan udhëheqës e gjeneral prijës që mundet t’i bindë kosovarët shqiptarë se ata janë në të njëjtën pozitë politike, juridike

dhe ekonomike me trojet tjera të Shqipërisë Etnike dhe se duhet t'u bashkohen atyre në luftë për liri, për çlirim e ribashkim kombëtar, për ribërjen e Shqipërisë Etnike?!

Vallë, kur dhe sa shpejtë do ta kuptojnë shqiptarët e Kosovës se ata jetojnë në një pseudoshtet, me një pavarësi të cunguar dhe me një liri të rrejshme dhe të ndarë nga trungu i Shqipërisë Etnike?!

As dje Shqiptarët nuk ishin aq të mirëorganizuar për një ide e një qëllim, kurse tani që Kosova do të bëhet "shtet" pa pushtet, do të bëhet "pavarësi" pa liri dhe do të ndahet nga fronti i përbashkët mbarëkombëtar për bërjen e Shqipërisë Etnike, tani e tutje do të jetë edhe më vështirë për kombin tonë që të mobilizohet, që të solidarizohet dhe të ribashkohet në një Shtet Kombëtar!

Tani e tutje Kosova e kosovarët, të moderuar e të kulturuar, sikurse Shqipëria e shqiptarët, do t'u mbajnë leksione "ex catedra" Shqiptarëve të Iliridës, Kosovës Lindore, Malësisë së Madhe e të Çamërisë se si ata duhet të jenë të "qetë", "paqësorë", të "logjikshëm", të "matur", "konstruktivë", "bashkëpunuesë", "elastikë", të "dëgjueshëm", "dialoguesë", "stabilizuesë", "jo kryengritës", "jo luftënxitës",... dhe që të rrinë urtë e të mos prishin rehatinë e pushtuesve sllavo-grekë, që të pranojnë paqen në robëri, të mos prishin paqen e pushtuesve dhe të mos prishin paqen dhe stabilitetin e Ballkanit dhe të Europës!!!

Nga qëndrimi i politikës sektariste, egoiste e oportuniste të Shqipërisë londineze ndaj Kosovës dhe trojeve tjera shqiptare jashtë saj, Kosova dhe krahinat tjera shqiptare nën ish-Jugosllavi u detyruan që t'i largojnë shpresat dhe iluzionet tek ndihma politiko-ushtarake dhe ekonomiko-logjistike e Shqipërisë, u zhdehën nga propaganda paqësore e Tiranës zyrtare, u kthjelluan nga premtimet boshe për ndihmë vëllezërve të

një gjaku,... dhe e morën fatin e tyre në duar të veta dhe u organizuan, u mobilizuan dhe ashtu siç mundën e sa dijtën, u ngritën në këmbë, rrokën armët dhe shpërthyen kryengritjen e armatosur, nisën luftën çlirimtare kundër pushtuesëve sllavomëdhenj.

Tani kësaj politike e propagande false, "përkrahëse e vëllazërore" të Tiranës zyrtare, në "mbështetje" të vëllezërve të tyre për liri e pavarësi, do t'i shtohet edhe propaganda dhe politika hipokrite e Prishtinës zyrtare! Këto dy kryeqytete shqiptare tani si në kor do të koordinojnë politikat e tyre të jashtme kundër përpjekjeve të vërteta, kundër kryengritjeve dhe luftërave për liri e pavarësi të trojeve tjera shqiptare: Iliridës, Kosovës Lindore, Malësisë së Madhe e të Çamërisë!

Do të ndodhë kështu, sepse këto dy shtete shqiptare do të shikojnë interesin e tyre e nuk do të çajnë kokën për krahinat tjera shqiptare a janë të robëruara apo të çliruara! Kështu veproi deri më sot Shqipëria e Tiranës ndaj Kosovës dhe viseve tjera shqiptare, kështu do të veprojë këtej e tutje edhe Kosova e Prishtinës, bashkë me Tiranën, ndaj krahinave tjera shqiptare që ndodhen ende nën pushtimin e huaj sllavo-grek!

Ndodhë dhe do të ndodhë kështu sepse i ngopuri nuk e beson të uriturin, i pasuri nuk e beson të varfërin, i shëndoshi nuk e beson të sëmurin, i çliruari nuk e beson të robëruarin,...!

Nga realiteti i ri i krijuar me dredhi nga Fuqitë e Mëdha, Shqipëria Etnike nuk ka shkuar në drejtim të bashkimit të saj, por në drejtim të ndarjes së mëtejshme të saj! Me "Shtetin" e Kosovës do të dobësohet edhe më tej solidariteti dhe lufta e përbashkët e kombit shqiptar për ribashkim kombëtar. Do të thyhet edhe një krah i fuqishëm i kësaj lufte. Ashtu siç bënte sehir Shqipëria londineze kur luftonte e përgjakej Kosova nga

serbomëdhenjtë, poashtu do të shikojë e bëjë sehir Kosova unmikistaneze kur do të luftojnë e gjakosen për liri e pavarësi Shqiptarët e Trojeve tjera Shqiptare që ende kanë mbetur nën robëri dhe pushtim greko-sllav!

Ky është fati i Shqiptarëve dhe Shqipërisë Etnike. Shqiptarët e pafat dhe josolidarë në mes vete, janë të detyruar edhe më tej që të luftojnë të ndarë dhe secila krahinë shqiptare të luftojë e vetmuar dhe për vete!

Por sa kanë shansë dhe mundësi që të fitojnë lirinë dhe pavarësinë nga pushtuesit e tyre krahinat shqiptare me një popullsi të vogël, siç janë: Kosova Lindore, Malësia e Madhe dhe Çamëria?! Pa ndihmën e sinqertë politike, pa ndihmën e vendosur e konkrete ushtarako-logjistike të Shqipërisë londineze dhe të Kosovës unmikistaneze këto krahina shqiptare nuk kanë gjasa reale që të çlirohen vetë nga shtetet që i kanë nën pushtim e sundim.

Vetëm Ilirida bën përjashtim nga këto krahina shqiptare dhe ka parakushte më të përshtatshme që të çlirohet me forcat e veta nga IRJM dhe të fitojë shtetësinë dhe pavarësinë e vet, duke u bërë shteti i tretë i pavarur shqiptar i Shqipërisë Etnike. Ndërsa tri krahinat tjera shqiptare, hë për hë, duhet të pajtohen me një autonomi politiko-territoriale në kuadër të Serbisë, Malit të Zi dhe të Greqisë.

Për Iliridën dhe Shqiptarët e saj, këtej e tutje, pasi Kosova të bëhet "shtet i pavarur e sovran", ka dy rrugë:

1.Republika e Iliridës, në kuadër të Republikës Federative të Vardarit, dhe

2.Ilirida - Shtet i pavarur dhe sovran.

Republika e Iliridës dhe federalizimi i Maqedonisë (IRJM-së) mund të arrihet në rrugë demokratike e paqësore, përmes rezistencës aktive popullore, përmes demonstratave masive të parreshtura shqiptare dhe përmes bojkotit të të gjitha institucioneve qendrore dhe

lokale të pushtetit zyrtar nga ana e të gjitha partive politike shqiptare të pozitës dhe të opozitës.

Dalja e Shqiptarëve nga institucionet dhe krijimi i një Këshilli Kombëtar Shqiptar me anëtarë nga të gjitha partitë politike shqiptare të Iliridës dhe me individë nga shoqëria civile, do të ishte fillimi i fillimit të veprimtarisë së bashkuar dhe aktive të Shqiptarëve për federalizimin e Maqedonisë dhe krijimin e Republikës së Iliridës.

Këshilli Kombëtar Shqiptar do të hartonte Platformën Politike dhe Planprogramin e veprimit Taktiko-Strategjik, do ta unifikonte forcën vepruese të popullit shqiptar, do të shtronte vullnetin dhe kërkesat politiko-kombëtare të Shqiptarëve të Iliridës ndaj palës sllavomaqedonase, si dhe do të udhëhiqte popullin tonë në protesta, marshime dhe demonstrata të parreshtura paqësore e demokratike, duke paralizuar e bllokuar gjithë jetën institucionale dhe funksionimin e shtetit, deri në arritjen e Marrëveshjes për Federalizimin e Maqedonisë, duke u krijuar në territorin e sotëm të saj dy Republika: Republika e Iliridës dhe Republika e Maqedonisë, të cilat do të përbënin Shtetin e pavarur e sovran të Republikës Federative të Vardarit (RFV).Formimi i Republikës Federative të Vardarit, jo vetëm që do ta ndërpriste procesin e shpërbërjes së Maqedonisë së sotme, jo vetëm që do ta forconte bashkëjetesën demokratike e paqësore të Shqiptarëve dhe Sllavomaqedonasve në një Shtet të përbashkët Federativ, demokratik e stabil, por në të njëjtën kohë, apriori, do të zgjidhej edhe çështja e emrit të sotëm të Maqedonisë të kontestuar nga Greqia. Tani në OKB dhe në arenën botërore do të ekzistonte shteti i ri me emrin Refupblika Federative e Vardarit (RFV), i cili do të zëvendësonte shtetin e sotëm me emrin Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM).

Ndërsa Shteti i pavarur e sovran i Iliridës mund të vjen në shprehje në rast se populli sllavomaqedonas në asnjë mënyrë nuk do të dëshironte që të bashkëjetonte në një Shtet Federativ me popullin shqiptar. Në një rast të këtillë, me anë të Referendumit Popullor, të Shqiptarëve dhe Sllavomaqedonasve, do të vinte deri te ndarja paqësore e Iliridës nga Maqedonia (IRJM) e Sllavomaqedonasve dhe krijimi i Shtetit të pavarur e sovran të Iliridës. Sidoqoftë, ***Kosova-Shtet, rradhën e ka Ilirida!*** Por, pse vallë ta ketë rradhën tani Ilirida?! Ç'është kjo rradhë, ky rend?! Pse duhet që Shqiptarët dhe krahinat shqiptare të luftojnë me rradhë e me rend dhe jo së bashku e së toku?! Rradhën faktikisht e ka Kombi Shqiptar i Shqipërisë Etnike që të zgjohet, të pajtohet, të mobilizohet, të organizohet dhe të ngritet në këmbë, si një trup i vetëm, si një popull unik, me një Ushtri e një Komandë të përbashkët dhe të çlirojë e të ribashkojë Trojet Shqiptare të Shqipërisë.

Por këtë imperativ të kohës, këtë detyrë e obligim, këtë mrekulli Kombi ynë nuk e bën, prandaj, pas Kosovës, tani rradha i ka ardhë Iliridës që të ngritet e të luftojë e vetmuar për lirinë dhe pavarësinë e saj, kurse pjesa tjetër e Kombit do ta shikojë nga ekranet televizive, sikurse sheh një film Hollivudian, përpjekjen dhe përgjakjen e saj për Liri! Por, ajo më e turpshmja dhe më tragjikja do të jetë se, një numër i konsiderueshëm pushtetarësh e qeveritarësh shqiptarë Iliridën do ta quajnë "vatër destabilizimi", kurse Iliridasit luftëtarë e çlirimtarë do ti emërtojnë si "ekstremistë", "radikalë", "aventuristë" e "terroristë"! Këtij kori injorantësh e antikombëtarësh, pastaj, të nesërmen do ti bashkangjitet edhe Faktori Ndërkombëtar!

Dhe ecë e fito pastaj lirinë, kur gjendesh midis tre zjarreve: 1.zjarrit bombardues të pushtuesit, 2.zjarrit

dëshprues të vëllezërve pushtetarë nga Tirana, Prishtina e Shkupi dhe, 3.zjarrit anatemues të Fuqive të Mëdha.

Pavarësisht se për paqën në robëri është çjerrë vazhdimisht Europa dhe Shqipëria, Shqiptarët e robëruar, krahinat tjera të Shqipërisë së pushtuar Etnike nuk e kanë ndalur për asnjë çast rezistencën, qëndresën, kryengritjen dhe luftën çlirimtare, sepse këtë e kanë amanet nga Abdyl Frashëri, i cili i tha Europës më 1878 se, "Pa zgjidhjen e drejtë dhe përfundimtare të çështjes kombëtare shqiptare, nuk do të ketë paqë Europa dhe Ballkani!". Dhe kështu ndodhi në vazhdimësi, që nga ajo ditë zëri dhe pushka e Shqipërisë së copëtuar Etnike ka gjëmuar nëpër dekada, duke nxjerr tym e barot kundër pushtuesve sllavo-grekë për çlirim dhe ribashkim kombëtar. Nga Ballkani u dëbua Perandoria Osmane si rezultat i luftërave të parreshtura të Shqiptarëve për liri dhe pavarësi kombëtare nga pushtuesi anadollak. Në Ballkan filloi Lufta I dhe e II Botërore. Nga Kosova shqiptare filloi shpërbërja e Jugosllavisë titiste më 11 mars 1981. Për shkak të kryengritjes së Kosovës shqiptare (1997-1999) filloi bombardimi i Serbisë millosheviçiane nga NATO më 24 mars 1999.

Për shkak të moszgjidhjes drejt dhe përfundimisht të Çështjes Shqiptare në Ballkan paqa dhe siguria në Europë do të jenë vetëm një iluzion. Tronditjet e turbullirat do ta ndjekin hap pas hapi, deri në shkatërrim, edhe perandorinë e re në formim - Bashkimin Europian, nëse nuk e zgjedh tani çështjen kombëtare shqiptare të Shqipërisë Etnike.

Shqipëria Etnike është çelsi i paqes dhe sigurisë europiane, ose dryri i saj, nëse nuk merren parasysh aspiratat legjitime dhe historike të kombit shqiptar.

12 dhjetor 2007

IV - BASHKIMI DHE LUFTA

BASHKIMI POLITIK DHE USHTARAK I SHQIPTARËVE

Bashkimi politik dhe ushtarak i shqiptarëve arrihet përmes takimeve, bisedimeve dhe përpjekjeve të gjata, serioze e të mundimshme të udhëheqjeve të të gjitha grupimeve politike dhe ushtarake të shqiptarëve në trojet e robëruara të Shqipërisë Etnike.

Bashkimi politik arrihet përmes pajtimit kombëtar të shqiptarëve dhe të udhëheqjeve të të gjitha grupeve, organizatave, partive e shoqatave shqiptare dhe bashkimin e tyre në një organizatë apo front të vetëm mbarëkombëtar.

Bashkimi politik arrihet, jo me formimin e partive të reja, por me ndërprerjen e veprimtarive politike të partive ekzistuese dhe bashkimin e tyre në një organizatë të vetme popullore e mbarëkombëtare.

Bashkimi politik arrihet përmes hartimit dhe aprovimit të një Platforme të përbashkët Kombëtare, rreth së cilës do të bashkoheshin dhe do të vepronin të gjitha grupet, organizatat, partitë e shoqatat aktuale politike të shqiptarëve të Shqipërisë së robëruar Etnike.

Bashkimi politik dhe ushtarak i shqiptarëve arrihet, jo duke formuar përditë grupe guerrile, "ushtri" të reja, apo duke aktivizuar ushtritë e vjetra (ish-UÇK-të), por duke krijuar dhe duke u rreshtuar në një Ushtri të vetme Kombëtare.

Bashkimi politik e ushtarak arrihet vetëm duke flakur mënjanë karrierizmin, bajraktarizmin, inatet dhe mëritë e vjetra e të reja dhe duke trokitur te njëri-tjetri me thirrjen për pajtim dhe bashkim politik e ushtarak, sepse vetëm të bashkuar do të trimfojmë dhe do ta bëjmë më lehtë, më shpejt dhe me më pak sakrifica njerëzore e dëme materiale Shqipërinë e Ribashkuar Etnike.

Bashkimi politik dhe ushtarak arrihet vetëm përmes sqarimit, vetëdijsimit dhe ndergjësimit të popullit dhe të

udhëheqjeve të partive politike shqiptare, se bashkimi, çlirimi dhe bërja e Shqipërisë Etnike nuk është luks e aventurë, por është një domosdoshmëri e kohës, një çështje historike që kërkon zgjidhje urgjente dhe një ideal mbarëkombëtar, pa të cilin nuk ka ardhmëri, zhvillim dhe progres nacional, shoqëror e ekonomik.

Të gjithë karrieristët, egoistët, sharlatanët "kryengritës", "komandantët" mendjemëdhenj, pseudopatriotët, demagogët e gënjeshtarët, të gjithë mercenarët e tradhëtarët duhet të demaskohen publikisht, me argumente bindëse dhe të ndalohen e të izolohen që të mos e dëmtojnë bashkimin politik e ushtarak të shqiptarëve dhe luftën e tyre çlirimtare për ribashkim kombëtar një një Shqipëri të Bashkuar Etnike.

Tani është koha që të gjithë ta tregojnë e dëshmojnë atdhedashurinë e tyre për popullin dhe Atdheun, ta demonstrojnë gatishmërinë e tyre për të kontribuar konkretisht me vepra për bashkimin politik dhe ushtarak të shqiptarëve, për t'i thënë STOP përçarjes dhe luftës për pushtet pa shtet të lirë e të bashkuar.

Patriotët, luftëtarët dhe ish-komandantët e vërtetë e popullorë nuk krijonë "ushtri" të reja, nuk e përçajnë popullin, nuk e fusin atë në një luftë të re vëllavrasëse, por e bashkojnë popullin, kurse vetë, së bashku me shokët, bashkëluftëtarët e simpatizantët e tyre bashkojnë armët dhe rreshtohen në rradhët e Ushtrisë Kombëtare, sepse vetëm në këtë mënyrë do të fitohet liria dhe bashkimi i Shqipërisë Etnike.

T'i lëmë mënjanë akuzat reciproke, inatet e meritë personale (të vjetra e të reja) dhe t'i bashkojmë idealet, zemrat dhe armët tona për të çliruar njëherë e përfundimisht këto troje të copëtuara nga bishat shoveniste sllavo-greke.

Kush ka vetëdije njerëzore dhe ndërgjegje kombëtare nuk formon grupe, parti e "ushtri" të reja, por me punë, sinqeritet, këmbëngulje e vullnet të pathyeshëm vepron dhe angazhohet për bashkimin politik e ushtarak të kombit shqiptar. Kështu, me punën dhe luftën e

ndershme e tregon vehten se është shqiptar, se është patriot, se është trim, se është luftëtarë i lirisë, por edhe se është strateg, komandant e gjeneral i zoti i artit luftarak çlirimtar.

Sot nuk është koha e ekperimenteve "ushtarake" dhe e përçarjes politike të popullit, por është koha e bashkimit politik dhe ushtarak të shqiptarëve për të bërë bashkimin kombëtar të Shqipërisë Etnike.

30 gusht 2007 (Titan Tivari)

FAKTORIZIMI I LUFTËS ÇLIRIMTARE PËR SHQIPËRINË ETNIKE

Ngjarjet po rrokullisen me një shpejtësi marramendëse në hapësirat e Shqipërisë Etnike. Si rezultat i kësaj forcat politike dhe ushtarake shqiptare duhet jo vetëm të mbajnë hapin me këto ngjarje, por në të shumtën e rasteve ato duhet t'i parashikojnë këto ngjarje, të jenë një hap përpara tyre dhe tu prijnë atyre ngjarjeve.

Ka ardhur koha që këto forca kombëtare të fillojnë të krijojnë ngjarje, të udhëheqin me ngjarjet dhe jo vetëm t'i komentojnë ngjarjet e ndodhura që më parë, me ose pa dijeninë e tyre, sepse në këtë mënyrë populli mendon se detyra kryesore e tyre është propaganda dhe komentimi i ngjarjeve që kanë ndodhur e që po ndodhin për çdo ditë.

Aktualisht lufta për ribashkimin e Shqipërisë Etnike po vazhdon të injorohet nga faktori i brendshëm politik dhe nga faktori i jashtëm politik! Ka ardhur koha që Lufta Çlirimtare për Shqipërinë Etnike të **faktorizohet.**

Të jeshë **faktor** do të thotë të jeshë **Zot** i vetvetes, Zot në shtëpinë tënde dhe Zot në atdheun tënd. Dhe askush të mos bëjë asgjë për ty, në shtëpinë tënde dhe në atdheun tënd pa marrë paraprakisht lejen dhe pëlqimin tënd. Të jeshë faktor do të thotë të pyetesh, të jeshë i fortë, të jeshë dikushi dhe të tjerët të kenë konsideratë për ty dhe për popullin tënd. Do të thotë që mos të të shpallin të vdekur për së gjalli!

Me faktorizim nuk kuptohet vetëm dijenia e popullit dhe e bashkësisë ndërkombëtare se ekziston aspirata, ideali dhe synimi i Kombit Shqiptar për çlirimin dhe ribashkimin e Shqipërisë Etnike. Nuk mjafton që ata kanë informacion e njohuri për Platformën dhe Programin Politik-Kombëtar të disa grupeve, partive, fronteve,

organizatave e shoqatave patriotike shqiptare dhe për planin strategjik ushtarako-çlirimtar të tyre për bërjen e Shqipërisë Etnike.

Faktorizim do të thotë të bëhesh **legjitim**, të fitosh legjimitetin e popullit për udhëheqjen e kombit në luftën e madhe për çlirim e bashkim kombëtar.

Faktorizim do të thotë kur Qeveritë shqiptare, Kuvendet shqiptare dhe partitë më relevante shqiptare të pozitës dhe opozitës nuk ndërmarrin asnjë hap konkret me rëndësi jetike e madhore për kombin, për Atdheun dhe për çështjen kombëtare shqiptare - pa u konsultuar me forcat politike dhe ushtarake shqiptare që veprojnë e luftojnë për bashkimin kombëtar të Shqipërisë Etnike, pra, pa marrë mendimin dhe pëlqimin edhe të tyre.

Faktorizim do të thotë kur të deleguarit special të qeverive të Bashkimit Evropian dhe të SHBA-ve, para marrjes së vendimeve për çështjen kombëtare shqiptare, trokasin rregullisht edhe në ”derë” të forcave politike kombëtare dhe të Ushtrisë Kombëtare për të marrë edhe pikëpamjet, mendimet dhe qëndrimet e tyre politiko-ushtarake për zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare, pse jo, edhe për çështjen e statusit të Kosovës.

Faktorizimi bëhet vetëm me veprime konkrete në terren. Faktorizimi i Luftës Çlirimtare për Bashkim Kombëtar bëhet përmes demonstrimit të forcës politiko-ushtarake të forcave të organizuara kombëtare si në teori ashtu edhe në praktikë. Deri tani faktori politik atdhetar ka demonstruar vendosmëri, atdhetari e pjekuri politike, përmes teorisë kombëtare dhe propagandës intenzive disa vjeçare. Kurse faktori ushtarak nuk e ka demonstruar forcën dhe pjekurinë ushtarake përmes praktikës luftarake. Këtu çalon puna: krahu politik ka ecur shumë përpara, kurse krahu ushtarak ka ngecur shumë prapa.

Që të bëhet faktorizimi politiko-ushtarak i Luftës Çlirimtare të kombit tonë për ribashkim kombëtar dhe formimin e shtetit të Shqipërisë Etnike, duhet që sa më parë që të jetë e mundur të bëhet lidhja organike ndërmjet teorisë dhe praktikës, të bëhet aktivizimi paralel i të dy krahëve: politik dhe ushtarak.

Aktivizimi i krahut ushtarak bëhet përmes demonstrimit të forcës luftarake në terren, me veprime e aksione konkrete ushtarake kundër forcave ushtarako-policore të armikut.

Gjatë veprimtarisë së saj, çdo organizatë politike apo ushtarake ka Programin Politik, i cili paracakton edhe format, metodat dhe fazat nëpër të cilat do të kalojë veprimtaria apo lufta e asaj organizate. Por, shpesh, me kalimin e kohës, gjërat ndryshojnë shpejtë dhe në mënyrë të paparashikueshme, prandaj në të këtilla raste organizata duhet të ecë me kohën, t'i përshtatet kohës dhe të dalë në ballë të kohës për të udhëhequr me ngjarjet që ka sjellë, papritmas, koha. Ky veprim ndryshe quhet kapërcim apo djegëje e etapave të luftës politike dhe të luftës së armatosur të organizatës. Kjo shtron edhe ndryshimin urgjent të disa pikave organizative dhe ekzekutive të Programit politiko-ushtarak të organizatës për t'iu përshtatur kohës dhe që tu përgjigjet kërkesave të kohës. Nëse nuk i përshtatesh kohës dhe nuk i përgjigjesh kohës në kohën e duhur, koha të shkel dhe atëherë ekzistenca e veprimtaria e asaj organizate bëhet e pavlefshme.

Si rrjedhim i rrokullisjes rapide të ngjarjeve në trojet e Shqipërisë Etnike, por edhe në arenën ndërkombëtare, konsideroj se forcat politike kombëtare duhet të koncentrohen plotësisht në forcimin e krahut ushtarak kombëtar. Pa një Ushtri Mbarëkombëtare të fortë, Fronti Çlirimtar Kombëtar do të mbetet një organizatë politike e

margjinalizuar, e papërfillshme nga populli dhe nga bashkësia ndërkombëtare, kurse Programi i tij do të jetë i parealizueshëm.

Tanimë nuk është koha e pritjes, por është koha e veprimit, është koha e luftës, e cila po na troket në derë dhe ne nuk guxojmë që të mos ia hapim derën me kohë. Ne nuk duhet që të mos jemi të përgatitur kur të vjen ajo kohë, nëse duam vërtetë që të fitojmë.

Koha e bën të vehten, ne e bëjmë tonën vetëm duke ecur me kohën në kohë.

3 tetor 2007 (Tomorr Toplica)

ZARET U HODHËN...,
AKSH EKZISTON!

Më 3 tetor 2007, në Lajmet Qendrore të Radiotelevizionit të Kosovës (RTK), u paraqitën filmime të shkurtuara nga një Reportazh shumë më i gjatë i daljes në skenën politiko-ushtarake shqiptare të Armatës Kombëtare Shqiptare (AKSH).

Lajmi shumë shpejt mori dhenë. Disa reaguan, disa heshtën. Disa u gëzuan, disa u tmerruan. Disa u befasuan, disa u shqetësuan. Disa u aktivizuan, disa u neutralizuan. Disa u trimëruan, disa u frikësuan.

Reaguan kundër, por në mënyrë konstruktive, ashtu siç ua don interesi momental dhe ashtu siç ua kërkon pozita pushtetare që mbajnë: Kryetari i Kosovës, Kryeparlamentari, Kryeministri, Ministri i Brendshëm dhe ndonjë tjetër që unë ende nuk e kam dëgjuar apo parë në televizion. Këto reaguan kundër, por reaguan me takt dhe me demagogji njëkohësisht.

Reagoi edhe një partiçkë e vogël e Kosovës, që veten e quan Lëvizja Kombëtare për "Çlirimin" e Kosovës (LKÇK), e cila reagoi me një ton sa nënçmues aq edhe mospërfillës, duke e konsideruar si diçka "të parëndësishme" daljen publike të pjesëtarëve të Armatës Kombëtare Shqiptare.

Reagoi edhe KFOR-i, duke u zotuar se do ta mbrojë "stabilitetin dhe paqën" në Kosovë dhe se nuk ka nevojë për forca tjera ushtarake në Kosovë përveç tij.

Deri tani bilanci i reagimit apo mosreagimit të pushtetarëve e politikanëve shqiptarë në Shqipërinë e Robëruar është ky: Pozita e Prishtinës u deklarua kundër. Opozita e Prishtinës heshti, ose e injoroi faktin. Pozita dhe opozita shqiptare e Shkupit heshti ose e injoroi ngjarjen. Heshtën edhe liderët shqiptarë të Kosovës Lindore dhe të Malësisë së Madhe.

Në Shqipërinë e Lirë (londineze) reagoi Kryeministri i Shqipërisë. Reagoi kundër AKSH-së, duke i quajtur ushtarët, luftëtarët e lirisë e të bashkimit kombëtarë,

çlirimtarët e Shqipërisë Etnike hiç më pak se "aventurierë"!

Ish-Kryeministri ”socialist” i Shqipërisë, reagoi kundër dhe reagoi shumë ashpër, antishqiptarisht e në mënyrë ofenduese, duke i quajtur pjesëtarët e AKSH-së, ushtarët e Shqipërisë Etnike - "njerëz me thasë në kokë"!

Për të tjera reagime në Tiranë nuk ka njohtime, por kjo nuk prish punë. Mjaftojnë këto reagime që të konkludojmë se reagimet anti-AKSH ishin më të forta në Tiranë se në Prishtinë apo gjetiu.

Reagime të ndryshme sigurisht që do të ketë edhe në të ardhmen dhe vazhdimisht. Do të ketë reagime pro et contra (për dhe kundër) nga pushtetarë e jo pushtetarë, nga plotikanë e jo politikanë, nga intelektualë e krijues të ndryshëm, nga njerëz të thjeshtë e nga njerëz të ndërlikuar, nga miq e armiq të kombit tonë, por reagimi kryesor, relevant dhe vendimtar është dhe do të jetë reagimi dhe qëndrimi i popullit shqiptar ndaj AKSH-së, qëndrimi i kombit shqiptar ndaj vetvetes dhe ndaj lirisë e bashkimit të Shqipërisë Etnike.

Kombi shqiptar do të jetë ai që do ta vulosë të ardhmen e tij, të Atdheut të tij dhe fatin e AKSH-së. Të tjerat s’kanë rëndësi. AKSH nuk duhet të merret shumë me reagimet e pushtuesve sllavo-grekë dhe lakejve të tyre shqipfolës, antikombëtarë, antishqiptarë e mercenarë. Përgjigjja më e mirë ndaj tyre është vazhdimi i luftës çlirimtare, është bashkimi i popullit, është fitorja mbi robërinë, është liria e Shqipërisë Etnike. Me qentë që lehin gardhiqeve dhe me ujqërit që ulërijnë në dritë të Hënës AKSH-ja nuk duhet të merret aspak, sepse harxhon kohë dhe energji panevojë. Në luftë e sipër ata do të dërrmohen e asgjësohen vetvetiu.

*****

Populli shqiptar i Kosovës ende nuk ka reaguar. Ai vetëm hesht dhe në heshtje e përkrah AKSH-në dhe i gëzohet jo vetëm daljes së saj publike, por edhe forcimit dhe rritjes së vazhdueshme të saj. Populli hesht, ai është si vullkani para shpërthimit. Populli do ta thotë fjalën e tij

i fundit, por këtë herë do ta thotë rrast fjalën dhe vullnetin e tij për vetëvendosje dhe bashkim kombëtar të Shqipërisë Etnike.

Të njëjtin qëndrim, të përkrahjes në heshtje të AKSH-së, ka edhe populli shqiptar në Shqipërinë londineze, në Iliridë, në Kosovën Lindore, në Malësi të Madhe e anembanë Shqipërisë Etnike dhe në Diasporë.

Jo rastësisht rapsodi popullor këndoi e këndon vazhdimisht: "...sërish vjen Marsi e sërish vjen Stina...", sepse urtësia e intuita popullore e di dhe e ndjen se liria nuk erdhi me ardhjen e KFOR-it dhe UNMIK-ut në Kosovë. Populli e di se amaneti i Adem Legjendarit dhe shokëve të tij ende nuk ka shkuar në vend, ende nuk është realizuar, sepse Kosova jo vetëm që nuk është e bashkuar me Shqipërinë, jo vetëm që nuk është shtet i pavarur, por çka është më tragjike, ajo ende është pjesë e Serbisë, e ndarë, me plagë të vjetra e të reja dhe e qeverisur në emër të saj nga UNMIK-u!

*****

Daljes së AKSH-së në skenë iu frikësuan liderët, qeveritarët, pushtetarët dhe politikanët anacionalë të të gjitha ngjyrave. Ata që folën dhe ata që heshtën. Pse vallë?

Sepse nuk e kanë ndërgjegjen e pastër. Sepse nuk kanë ndjenja dhe vetëdije kombëtare shqiptare. Sepse janë kundër bashkimit kombëtar, janë kundër vullnetit dhe vetëvendosjes së popullit, janë kundër bërjes së Shqipërisë Etnike! Dhe mbi të gjitha, ata reaguan instiktivisht, pa menduar, pa analizë, nga frika, sepse nuk e kanë popullin me vete. Se po ta kishin mbështetjen e popullit, atëherë nuk do të kishin nevojë aspak që të merren me AKSH-në, por do ta injoronin daljen e saj publike dhe do t'ia lenin policisë që të merret me atë çështje. Por jo, ata reaguan shpejtë dhe reaguan shumë ashpër e të frikësuar, duke e shndërruar paraqitjen e AKSH-së në një problem "destabilizues", "kërcënues", në një çështje politike dhe ushtarake.

*****

Zaret u hodhën..., thotë një fjalë, më në fund AKSH-ja doli nga "interneti", siç shpreheshin deri dje gojëkëqinjtë, dhe u paraqit në dritë të Hënës. Nesër do të dalë edhe në dritë të Diellit, kurse pasnesër do të shndërisë në dritë të Lirisë dhe të Shqipërisë Etnike. Zaret u hodhën..., AKSH doli nga irealiteti në realitet, ajo ekziston.

Zaret u hodhën, "loja" filloi, kthim prapa nuk ka. Pas kësaj paraqitjeje publike AKSH nuk mund të hy përsëri në "internet", por do të qëndrojë aty ku e ka vendin, aty ku ka qenë gjithmonë, që nga formimi i saj – në gjirin e popullit liridashës e atdhetar shqiptar. Do të qëndrojë në ballë të popullit për liri, vetëvendosje e bashkim kombëtar të Shqipërisë Etnike.

Zaret u hodhën, AKSH foli, AKSH u duk. Por vallë, ç'ishte kjo e folme dhe kjo e dukme? Improvizim apo Realitet?

Improvizimi është trillim, sajim, shpikje aty për aty për të dalë nga situata e papritshme. Improvizimi është gjindshmëri, aftësi, veprim i paplanifikuar që më parë, por që bëhet aty për aty për të dalë nga kriza momentale.

Improvizime, zakonisht, bëjnë aktorët në skenën e teatrit, të cilët kur harrojnë tekstin e dramës, dialogun apo monologun, ata aty për aty, pa u hetuar nga publiku, me mjeshtëri dhe pa belbëzuar, vazhdojnë aktrimin duke improvizuar, duke sajuar tekst të ri të vetin, por që i përshtatet motivit të aktit të dramës, tragjedisë apo komedisë që luhet në skenë.

Improvizimi është zotësi dhe aftësi krijuese e aktorit, politikanit, liderit, oratorit, ligjëruesit dhe të gjithë njerëzve, kur bëhet në kohën dhe në çastin e duhur, për të dalë nga situate e palakmueshme, e paparashikueshme. Improvizimi është njëfarë Plani B i të gjithë veprimtarëve artistik, politik e ushtarak.

Improvizimi është domosdoshmëri, por nuk është frytdhënës nëse shndërrohet në shprehi, sepse improvizimi nuk është art, nuk është politikë dhe nuk është plan strategjik ushtarak. Me improvizime konstante nuk bëhet art, nuk bëhet politikë, nuk bëhet luftë dhe as nuk fitohet liria.

I mbetet AKSH-së që ta vërtetojë në të ardhmen e afërt se paraqitja e saj nuk ishte improvizim por realitet. Se nuk ishte demagogji por defilim real atdhetar, luftarak e çlirimtar.

Vetëm koha dhe populli do ta vërtetojnë nëse dalja në publik e AKSH-së ishte Improvizim apo Realitet.

Megjithatë, zaret u hodhën…, këtej e tutje më nuk do të ketë gjumë mbi dafina, shpirtrat u trazuan, këmbanat ushtuan, ora filloi tik-takun e saj historik drejt Shqipërisë Etnike.

8 tetor 2007 (Tomorr Toplica)

LUFTËS I PRIN DHE LUFTËN E FITON,
AI QË E FILLON I PARI!

Shkaktar për të shkruar këtë Koment u bë Deklarata e Zëdhënësit Politik të FBKSH-së me titull: Rradhën e ka FBKSH dhe askush tjetër…, të datës: Tiranë 23 gusht 2007. Pajtohem me Deklaratën e FBKSH-së, por edhe nuk pajtohem. Pajtohem se shumë organizata e parti kanë gabuar dhe e kanë lënë luftën për bashkim kombëtar në mes të rrugës. Por nuk pajtohem me FBKSH-në se ata nuk kanë më të drejtë të vazhdojnë luftën për bashkim aty ku e kanë lënë. Pajtohem se askush nuk duhet ta pengojë e sabotojë luftën e FBKSH-së, por as FBKSH-ja nuk ka të drejtë që dikujt tjetër t'ia ndalojë organizimin dhe luftën për bashkim kombëtar.

Që në hyrje të Deklaratës Zëdhënsi Politik i FBKSH-së ankohet se këtij Fronti nuk i janë bashkangjitur ”forcat progresiste e atdhetare shqiptare”.

Së pari ne nuk e dijmë cilat janë ato forca progresiste e atdhetare shqiptare.

Së dyti ne nuk e dijmë a u ka bërë thirrje direkte për bashkëveprim, bashkëpunim, bashkim apo shkrirje FBKSH-ja me gojë, me shkrim apo me letra të hapura nga interneti.

Së treti ne nuk e dijmë cilat kanë qenë kushtet që ka shtruar para këtyre forcave FBKSH-ja për bashkim-shkrirje në FBKSH, sepse bashkim pa kushte dhe pa interes reciprok nuk ka.

Së katërti ne nuk e dijmë se FBKSH-ja me veprimtarinë e saj kombëtare a ka mundur që të fitojë besimin e këtyre ”forcave progresiste” që t’i bashkohen Frontit, qoftë me kushte, qoftë pa kushte.

Sidoqoftë e vërteta, edhe nëse këto ”forca progresiste e atdhetare shqiptare” nuk shprehin vullnetin e

gatishmërinë që t'i bashkohen FBKSH-së, për shkaqet dhe arsyet që vetëm ata i dinë, atëherë kjo nuk i jep të drejtë FBKSH-së që t'i etiketojë ato, apo t'ua marrë të drejtën e veprimtarisë kombëtare sot, apo të luftës së armatosur nesër. Bashkimi luftarak bëhet me vullnet, me besim reciprok e bindje të plotë dhe jo me detyrim, me dhunë, me kërcënime e shantazhe. FBKSH-ja nuk ka nevojë që t'i lusë dhe as t'i presë forcat tjera të organizuara politiko-ushtarake që këto t'i bashkohen FBKSH-së, sepse ndoshta do të duhet të presë me dekada apo tërë jetën. FBKSH-ja, nëse është ajo që thotë se është, atëherë ajo duhet të veprojë e vetme e konkretisht dhe ta marrë situatën në duartë e veta, pa pritur që dikush apo disa t'i bashkohen këtij Fronti dhe AKSH-së.

E kaluara e ka vërtetuar se forcat e organizuara patriotike e luftarake shqiptare jo vetëm që nuk i bashkon paqa, por nuk i bashkon as lufta. Kush ka kujtesë të freskët nga luftërat e viteve 1997-2001 e di mirë këtë mosbashkim tragjik të shqiptarëve!

Lufta çlirimtare nuk pyet për rradhë, siç shkruan në fund të Deklaratës Zëdhënësi Politik i FBKSH-së, kur shprehet se: *"Rradhën e ka Fronti për Bashkim Kombëtar Shqiptar (FBKSH) dhe askush tjetër. Të gjithë ata që kanë qenë në skenën politike para tri luftërave të fundit, si dhe të gjithë ata që kanë qenë në skenën politiko-ushtarake gjatë tri luftërave të fundit dhe në skenën politike pas tri luftërave dhe që jo vetëm kanë dështuar por edhe kanë penguar, sabotuar dhe dëmtuar çështjen madhore kombëtare të rrinë urtë e të mos pengojnë dhe sabotojnë FBKSH-në dhe strukturat e tij. Nëse nuk mund të na ndihmojnë, duke na ndenjur në krah, le të rrinë prapa krahëve tona dhe le të mos gabojnë të na dalin përpara që të na pengojnë e sabotojnë, sepse ndëshkimi dhe gjaku i*

dëshmorëve të kombit shqiptar ka me ndëshku shumë, shumë rëndë."

Rradhën për luftë çlirimtare dhe për Shqipëri Etnike e ka Populli. Rradhën e kanë të gjithë ata shqiptarë, grupe, parti e "ushtri" që kanë ndërgjegje të zhvilluar kombëtare dhe që nuk e durojnë më tej copëtimin e Shqipërisë Etnike. Rradha dhe e drejta për të luftuar për Atdhe nuk humb kurrë, pavarësisht se mund të kesh dështuar njëherë apo disa herë. Gabimet dhe dështimet janë për njerëz. Vetëm Zoti është i pagabueshëm. Vetëm tradhëtarët dhe spiunët nuk kanë të drejtë morale për të luftuar për Atdhe. Por vetëm morale, sepse të drejtë njerëzore e ligjore kanë të gjithë, pa përjashtim, të luftojnë për Atdhe me qëllim që Atdheut e popullit t'ia paguajnë dëmet që i kanë shkaktuar në një kohë tjetër.

Ka plot raste në historinë tonë dhe atë botëroere që njerëz të caktuar kanë jetuar si agjentë, kanë luftuar si luanë dhe kanë rënë si heronj në luftë për çlirimin e atdheut të vet. Të kujtojmë këtu vetëm Mojsi Golemin e Dibrës, të cilit Skënderbeu ia fali tradhtinë, kurse Mojsiu si shpërblim për këtë falje mbinjerëzore të Gjergjit, luftoi pastaj me forca edhe më të shumëfishuara kundër armikut derisa u zu rob nga osmanllinjtë dhe vdiq si hero. Shembuj të këtillë ka sa të duash, por unë nuk do ta lodhë më tej lexuesin e nderuar me histori, sepse histori kemi lexuar të gjithë, por shumë pak janë ata liderë që kanë mësuar diçka nga historia jonë e bujshme, sepse jemi dëshmitarë okular se historia e dështimeve po na përsëritet përditë para hundëve tona dhe ne nuk po përmirësohemi e nuk ndërmarrim asgjë konkrete, por vetëm grindemi e sulmojmë njëri-tjetrin me një egërsi që do të na e kishte zili edhe armiku sllavo-grek!

Lufta për liri është një lloj gare në mes organizatave, grupeve, partive apo "ushtrive" shqiptare, sepse ajo

njëherit është edhe luftë për pushtet pas luftës. Bajrakun, udhëheqjen e luftës e merr ai grup apo ajo "ushtri" që ia fillon e para luftës së armatosur konkretisht, në terren. Të tjerët pastaj munden vetëm t'i bashkangjiten kësaj lufte, por nuk munden t'i prijnë. Vetëm kujtoni fatin e FARK-ut të LDK-së. UÇK-ja u ngritë e para në luftë dhe i takoi asaj që t'i prijë luftës, kurse FARK-u mbeti në bisht të luftës, sepse i kapi armët shumë vonë. Dhe t'ju kujtoj edhe atë se kur nisi lufta në Iliridë, UÇK(Kombëtare) ishte dy-tre hapa para AKSH-së, e nisi e para luftën dhe i priu asaj deri në fund, pavarësisht humbi apo fitoi. Kurse AKSH-ja filloi aksionet luftarake me një vonesë të madhe, kur veç u ndërpre lufta dhe u nënshkrua Marrëveshja e Ohrit.

Të kthehemi edhe më prapa në histori dhe të kujtojmë Luftën Nacionalçlirimtare në Shqipëri. Luftën e fituan partizanët sepse u treguan më të aftë në organizim, më guximtarë dhe nisën luftën të parët kundër nazifashizmit. Kurse ballistët jo vetëm që ia nisën më vonë, por nuk ia nisën fare luftës, ata vetëm bënin plane për pushtet pasi të kryhet lufta dhe e dijmë ku përfunduan. Të vijmë pak më afër, në fillim të viteve ’90. Popullin e bëri për vete partia e parë e themeluar pas rënies së komunizmit në ish-Jugosllavi, Lidhja Demokratike e Kosovës, e themeluar në Dhjetor 1989. Sepse ishte e para parti legale demokratike. Popullin e bëri për vete dhe e udhëhoqi I.Rugova, sepse ishte i pari lider partie që pati guximin dhe vullnetin t’i prij asaj partie, kurse Rexhep Qosja nuk pati vullnetin t’i prij LDK-së dhe humbi, sepse kur atij iu kujtua se populli ka lider jo të aftë ishte shumë vonë dhe partia e tij LDB nuk fitoi asnjë mandat në zgjedhjet e lira parlamentare. As edhe një Adem Demaç nuk mundi ta eliminojë nga skena politike Ibrahim Rugovën, sepse ishte i vonuar. Pra, **vonesa është nëna e dështimit dhe e humbjes**. Lideri i

zgjuar duhet të kapë flamurin udhëheqës i pari, në kohën e duhur dhe në vendin e duhur.

E njëjta gjë do të ndodhë edhe në luftën e nesërme për bashkim kombëtar. Ajo "Ushtri", ai Front apo ajo Parti që do t'ia kërcasë e para luftës së armatosur për Liri e për Shqipëri Enike, ajo ushtri e parti do ta udhëheqë deri në fund këtë luftë, sepse do të jetë disa hapa përpara se ushtritë e partitë tjera që do të tentojnë të futen në luftë vetëm për të udhëhequr e për të marrë komandën e luftës.

Kjo ka të bëjë me çështjen e organizimit. Organizatori më aktiv dhe më i zhdërvjelltë fiton. Por njëherit çështja e udhëheqjes së politikës dhe luftës ka të bëjë shumë edhe me psikologjinë e popullit. Populli shkon vetëm pas atij që ia nis i pari luftës çlirimtare, sepse kështu i del nami (fama), bëhet idol, idhull, legjendar,...*Populli përkrah ata më guximtarët që ia fillojnë të parët.*

Këtu nuk kemi të bëjmë me karrierizëm, këtu kemi të bëjmë me aftësi organizative, mobilizuese dhe guxim. Cila "ushtri", front apo parti që i ka dhe do t'i ketë këto tri cilësi, ajo do të prij dhe do të fitojë përkrahjen e popullit. Mbaheni mend mirë këtë gjë. Vonesat paguhen me dështim dhe me mos përkrahje të popullit. E njëjta gjë do të ndodhë edhe në të ardhmen: Ai që do ta fillojë i pari luftën, ai do ta udhëheqë atë, pavarësisht a do të jetë fillimisht më pak në numër dhe më dobët finansiarisht apo në armatim se "ushtria" apo partia tjetër që nis luftën më vonë, sepse do të ketë përkrahjen e fortë të popullit. Këtë të vërtetë historike të mos e harrojë askush, as FBKSH-ja dhe AKSH-ja.

E vetmja TAPI për udhëheqje të luftës e të popullit, është vetë LUFTA e armatosur që një popull dhe një ushtri i bënë armikut pushtues.

24 gusht 2007 (Tomorr Toplica)

V - SHQIPËRIA ETNIKE

SHQIPËRIA ETNIKE DHE PROMETHEU

Linde në kohë të lashta, të tejlashta Shqipëri. Askush nuk e di kur linde Ti. Linde sëbashku me Dheun, atëherë kur u krijua planeti Tokë. Linde e para, Shqipëri, dhe u quajte Pellazgji. Zoti kështu të emëroi dhe fat e mbarësi të uroi. U fundose Atlantidë, dole sërish në dritë, linde Pellazgji, u rilinde Iliri, jetove Arbëri, u përjetësove Shqipëri.

Prometheun e lindi Pellazgjia, e rriti Iliria, e burrëroi Arbëria dhe e përjetësoi Shqipëria. Nënë e bir, dorë për dorë e krah për krah ecën nëpër histori, nëpër lashtësi, nëpër tokë e nëpër qiell... Herë në këmbë e herë shaluar, herë duke vrapuar e herë duke fluturuar. Gjithmon bashkë, gjithmon tok e të pandarë. Nga parahistoria në histori dhe nga historia në ardhmëri ato bashkërisht çajnë përpara krenarë e të pamposhtur në rrugën e tyre të jetës e të luftës, në tokën e vet, në të drejtën e vet, duke sfiduar ballëlartë të gjithë armiqtë e tyre nëpër shekuj e mijëvjeçarë.

Legjendat thonë se Prometheu ua rrëmbeu "zjarrin" - lirinë "Perëndive" të Olimpit - sundimtarëve të Pellazgjisë, dhe ua dha njerëzve - popullit, prandaj ata e zunë, e prangosën dhe e mbërthyen, e gozhduan për një shkëmbi, sikurse Krishtin në kryq. E dënuan me vdekje dhe interrnim, duke e dërguar në cepin më të largët verior të Pellazgjisë, në malet shkëmbore të Kaukazit, sepse "Perënditë¨ e Olimpit i frikësoheshin për së gjalli dhe i tmerroheshin për së vdekuri Prometheut.

Kujtuan se e vranë, kujtuan se e mposhtën sundimtarët Prometheun, por gabuan, sepse nuk mund të vritej liria dhe populli, nuk mund të mposhtej Pellazgjia, sepse ajo pati edhe Promethe tjerë si Herkuli e Anteu. Ajo lindi e rriti Promethe në vazhdimësi që nga Leka i Madh e Pirro Epiroti, deri te Bardhyli e Gjergj Kastrioti. Që nga

Muji e Halili deri te Mic Sokoli e Abdyli. Që nga Gjergj Elez Alia e Hasan Prishtina deri te Ismail Qemali e Adem Jashari.

Pellazgjia kishte Promethetë e vet. Iliria kishte Promethetë e vet. Arbëria pat Promethetë e vet. Shqipëria Etnike pati dhe ka Promethetë e vet. Vargu i Prometheve shqiptarë është i pambarim, i pafund, sepse i pafund e i pavdekshëm është populli që i lindi, e pamposhtur dhe e përjetshme është toka pellazgo-iliro-shqiptare që i rriti e i burrëroi.

*****

E stërlashtë sa vetë Dheu. E urtë, guximtare, stoike dhe e fortë si Prometheu, Shqipëria Etnike rrugëton nga tejlashtësia përmes udhëve të paudhë, marshon shtigjeve të pashtigje, përmes historisë së përflakur, përmes njerëzimit të përgjakur, përmes dritës dhe errësirës, udhëton e vrapon me shpejtësi e krenari drejtë lirisë, drejtë ardhmërisë, drejt përjetësisë.

Shqipëria Etnike është sfidë e pushtuesve, e tiranëve dhe e kolonizatorëve të Ballkanit e të botës. Ashtu siç ua rrëmbeu Prometheu zjarrin e diturinë "Perëndive" të Olimpit, ashtu Shqipëria Etnike po ua rrëmben përditë e më shumë lirinë dhe trojet e veta të grabitura e të rrëbyera nga shovenistët e barbarët ballkanas dhe evropianë.

Për këtë shkak Shqipëria Etnike ndër shekuj e mijëvjeçarë u bë rrufepritësja e ”perëndive” shoveniste të Ballkanit, të Europës e të Azisë. Ashtu siç e gjuajtën Prometheun me rrufe "Perënditë" e Olimpit, ashtu e gjuajtën me zjarr e hekur, me plumba e topa armiqtë e shumtë Shqipërinë tonë etnike.

Kur "Perënditë" e gjuajtën me rrufe Prometheun dhe i thanë që të dorëzohet se do t’ia falin jetën, ai ua ktheu me vendosmëri atyre: **”Nuk i ndërroj vuajtjet me një shërbim prej skllavi”**. Kurse Shqipëria Etnike u tha dhe u thotë armiqve të saj, sa herë ata e goditën dhe e godasin për ta asgjësuar, se: **”Nuk do të ketë paqë në Ballkan**

dhe në Evropë, pa u çliruar dhe bashkuar trojet shqiptare”.

Shqipëria Etnike është antipod i errësirës, është vetë drita. Është antipod i robërisë, është vetë liria. Është antipod i dorëzimit, frikës dhe dobësisë. Është vetë qëndresa, trimëria, guximi dhe forca stoike. Shqipëria Etnike është vetë Prometheu. Ashtu si u ngritë mbi "Perënditë" e Olimpit Prometheu me guximin, bamirësinë, virtytin dhe vendosmërinë e tij, ashtu u ngritë e po ngritet vazhdimisht Shqipëria Etnike mbi padrejtësitë, sulmet dhe egërsinë antishqiptare të armiqve të saj sllavo-grekë dhe evro-aziatikë.

Ndërmjet Prometheut dhe "Perëndive" të Olimpit qëndron një hapësirë e madhe e mbushur me bubullima e vetëtima rrufeshë, me shkarkime përcëlluese zjarri mbi trup të tij, por Ai qëndroi i pamposhtur, duke qëndruar titanik në idetë e tij liridashëse e njerëzore. Mateshin kështu rrufetë e "Perëndive" të Olimpit me forcën e ideve përparimtare dhe me zemrën bujare të Prometheut. Rrufetë që hidheshin kundër Prometheut, u ktheheshin, si bumerang, me forca të shumëfishuara "Perëndive" të Olimpit, duke i dobësuar e cfilitur gjithnjë e më shumë ata, duke ua shkundur e lëkundur gjithnjë e më tepër fronin tiranik "Perëndive", pushtetarëve e diktatorëve të kohës.

Edhe midis Shqipërisë etnike dhe barbarëve të panumërt pushtuesë të të gjitha kohërave ekziston një mal i tërë me kufoma dhe një det i gjerë me gjak. Dhe ata që thyen kokën mbi këtë mal kufomash, heronjsh e heroinash pellazgo-iliro-shqiptare ishin vetë armiqtë pushtuesë. Ata që u mbytën në detin e gjakut të Shqipërisë Etnike ishin vetë ushtarët bisha të legjioneve të huaja barbare, të cilët sulmonin pandërprerje atdheun e shqiponjave dhe feniksve – Shqipërinë Etnike.

Prometheu dhe Shqipëria qëlluan dhe qëllojnë së bashku, vazhdimisht dhe pandërpreje ”perënditë” e djeshme dhe të sotme të botës. Qëllojnë për vdekje të gjithë tiranët e diktatorët e të gjitha kohërave, që janë

ngritur e ngriten kundër njerëzimit, kundër lirisë dhe pavarësisë së popujve. Zjarri që rrëmbeu Prometheu nga ”perënditë” ende flakëron në duartë, në zemrat dhe në mendjet e njerëzve të lirë e të robëruar të botës. Ai zjarr përcëllon e shkrumbon në vazhdimësi tiranët, diktatorët, sundimtarët, pushtetarët dhe pushtuesit e mbarë njerëzimit.

Prometheu i sotëm modern pandërpreje, me pishtarin flakërues e të zjarrtë në dorë, ngjitet e zbret monopateve të Olimpit, duke sulmuar e goditur vazhdimisht ata të cilët qëndrojnë ulur në fronet e pushtetit me duar të përgjakura në popull. Liria dhe robëria janë ende në ndeshje e përleshje të ashpër për jetë a vdekje. Ata janë antipodi i njëra-tjerës. Nuk ka bashkëjetesë dhe pajtim ndërmjet tyre. Lufta midis tyre është e përjetshme.

Zjarri i Prometheut nuk është thjeshtë zjarr, ai është mbi të gjitha liri, është drejtësi, barazi, paqë, harmoni, teknikë e teknologji e zhvillimit të njerëzimit. Zjarri i Prometheut është mbijetesë e njeriut në luftë me forcat dhe ligjet e ashpra të natyrës, është luftë për ekzistencë. Prometheu është simboli i luftës së njerëzimit kundër forcave jo humane të natyrës që në muzgun dhe agun e parë të shoqërisë njerëzore. Prometheu është lufta midis së mirës dhe së keqes, progresit dhe regresit, dritës dhe errësirës, lirisë dhe robërisë.

Prometheu u përballoi shekujve dhe mijëvjeçarëve, ai i mbijetoi të gjitha kohërat dhe sistemet shoqërore politike të njerëzimit, sepse ai u bë njësh me popullin e vet, me atdheun e vet.

Mbijetoi dhe triumfoi Shqipëria Etnike, trashëgimtarja e vetme e Pellazgjisë, ndaj fitoi e mbijetoi edhe Prometheu, biri i saj trim e besnik. Shqipëri e Promethe u bën një trup i vetëm dhe marshuan sëbashku përmes stuhive të kohërave, përmes rrebesheve të historisë dhe përmes tiranisë së sundimtarëve, shfrytëzuesve të popujve dhe mohuesve të lirisë.

Prometheu është Krishti i Parahistorisë, Krishti i Pellazgjisë që luftoi për liri, që përhapi me forcë, me veprim konkret, me shpatë e shtizë në dorë dritën, diturinë dhe lirinë. Ua rrëmbeu me dhunë "zjarrin" "perëndive" të rrejshme të kohës, sundimtarëve të egër dhe ia dha popullit, duke e vetëdijësoi atë që të mos gjunjëzohet përballë tiranisë së sundimtarëve gjakpirës dhe "perëndive" të Olimpit.

Prandaj, për këtë veprim njerëzor, për këtë luftë çlirimtare Prometheu u gozhdua, u kryqëzua sikurse Krishti më vonë, për shkëmbit gjigant të malit. Dallimi i vetëm në mes Prometheut e Krishtit është mënyra e përhapjes së lirisë dhe drejtësisë në popull. Prometheu është luftëtari i forcës dhe i shpatës, kurse Krishti është luftëtari i paqës dhe i fjalës së urtë. Dhe të dy arritën që në popull dhe në gjithë botën njerëzore të asaj kohe e të kësaj kohe të përhapin mesazhin e njëjtë të lirisë, të dashurisë, të drejtësisë e të barazisë midis njerëzve dhe popujve.

****

Shqipëria dhe Shqiptarët krenohen e mburren me bijtë e tyre si Prometheu dhe të tjerët, para e pas tij. Shqipëria i ka përjetësuar në kujtesën e saj, i mban të paprekshëm në gjirin e saj, kurse kombi shqiptar i ka ngulitur në zemër e në mendje bijat e bijtë e tij luftëtarë si Prometheu dhe herë pas here po lind Promethe të Rinj, duke i edukuar e brumosur me idealin Promethean të lirisë, me guximin dhe forcën e tij prej vigani të pamposhtur përballë armiqve e "perëndive" moderne të kohës sonë.

Sa herë që Shqipëria jonë është në rrezik për shfarosje nga "perënditë" e kohës, ajo lind Promethe të rinj dhe i rreshton përballë legjioneve vandale të armiqve të saj, duke ua ndalur turrin e duke i kthyer prapa hordhitë barbara pushtuese.

Është lidhur një Besë e fortë, e shenjtë dhe e përjetshme midis Shqipërisë dhe Prometheve të saj: që sa herë të jetë në rrezik atdheu ata rilindin përsëri, ngriten

nga shtrati i lëngatës e nga varri, rinohen, ringjallen dhe dalin në log të burrave, në fushëbeteja për të luftuar me ”perëndi” e ”bajlozë deti” që sulmojnë Shqipërinë, për të mbrojtur popullin dhe atdheun.

Kështu vepruan sa e sa herë Kreshnikët e Jutbinës, Gjergj Elez Alia, Konstandini e Ago Ymeri. Besën që kishin lidhur me popullin dhe atdheun e tyre nuk e shkelën e nuk e harruan kurrë, por e çuan në vend sa herë i thërriste atdheu për ndihmë.

Aq e fortë ishte dhe është Besa e lidhur midis Nënës Shqipëri dhe bijve të saj Promethea, sa që ata as vdekja nuk mundi e nuk mundet t'i ndajë, ata komunikojnë vazhdimisht midis tyre dhe e ndihmojnë njëri-tjerin në kohë të vështira.

Besa Shqiptare dhe Dashuria midis Shqipërisë dhe Bijve të saj është ajo Fryma Hyjnore që bën lidhjen e përjetshme midis tyre dhe i bën të pandarë, të pamposhtur dhe të pavdekshëm në jetë të jetëve.

25 dhjetor 2007

SHQIPËRIA ETNIKE DUHET TË BËHET NGA SHQIPTARËT

Shtetet etnike nuk janë shtete të pastra etnike. Ato janë shtete kombëtare, të dominuara me shumicë nga kombi shtetformues dhe të banuara me pakica të ndryshme kombëtare. Asnjë shtet kombëtar i Evropës nuk është shtet i pastër etnikisht, por ata janë shtete kombëtare. Shqipëria etnike, pas krijimit dhe bashkimit të saj, kurrsesi nuk do të jetë shtet i pastër etnikisht, siç po përpiqen ta arsyetojnë disa politikanë shqiptarë në Tiranë e Prishtinë, mosangazhimin e tyre për formimin e Shqipërisë Etnike, sepse në kuadër të saj do të ketë pakica të ndryshme etnike, si ato sllave, greke, boshnjake, turke, rome,...etj. Shteti i bashkuar dhe etnik i Shqiptarëve zyrtarisht nuk do të quhet Shqipëria Etnike, por do të quhet si edhe sot Republika e Shqipërisë. Dhe dallimi do të jetë se atëherë do të jetë shtet kombëtar i të gjithë shqiptarëve dhe nuk do të jetë i ndarë e gjysmak siç është sot. I vetmi shtet kombëtar i Evropës, i cili nuk pranon dhe nuk njeh pakicat etnike në territorin e vet është Greqia. Por, ky qëndrim racist e shovenist i pushtetarëve grekë nuk e bën aspak atë shtet të pastër etnik, por e bënë atë vetëm shtet jodemokratik, sepse realiteti nuk mund të fshihet e as të futet në xhep.

Në këtë drejtim nuk mbetet shumë prapa edhe Turqia, e cila, përpos tjerëve, nuk pranon ekzistencën e popullit kurd dhe gjuhës së tyre në formë zyrtare e ligjore.

Edhe regjimi kommunist i shtetit bullgar dikur nuk pranonte ekzistencën e pakicës turke në territorin e tij. Askund në botë nuk ka dhe nuk mundet të ketë shtet të pastër % monoetnik. Kjo është propagandë e atyre që janë kundër bashkimit të popujve e të kombeve, janë ata që duan të coptojnë tokat e të tjerëve dhe t'i mbajnë kombet

të përçarë e të sunduar nga kombet më të mëdhenj e më të fuqishëm ekonomikisht dhe ushtarakisht.

Bashkimi Evropian është për ndarjen e Kosovës dhe sëbashku me Rusinë dhe Serbinë do të provokojnë një shpërthim mbarëpopullor në Kosovë dhe në këtë mënyrë do të hiqet nga agjenda ditore Pavarësia e Kosovës dhe do të kalohet në bisedime direkte për ndarjen e Kosovës dhe krijimin e Serbisë së Madhe, duke spostuar Marrëveshjen e Dejtonit (1995) dhe duke hapur çështjen e ndryshimit të kufijve të Ballkanit dhe krijimin e shteteve etnike. Evropa është e vetëdijshme se Marrëveshja e Dejtonit ishte një ndërprerje e përkohshme e luftës, por jo një paqtim i atij regjioni. Të gjithë tanimë e kanë parë se kjo Marrëveshje ka dështuar dhe është e pazbatueshme. Edhe 12 vjet pas arritjes së asaj Marrveshjeje paqa dhe bashkëjetesa midis tre popujve të ndryshëm etnikë nuk është arritur dhe nuk do të arrihet kurrë. Në Bosnjë dhe Hercegovinë janë të pranishëm forcat ushtarake të Evropës dhe misioni civil ndërkombëtar. Në momentin që ata do të tërhiqen nga atje do të bëhet ndarja e atij shteti, qoftë me paqë, qoftë me luftë. Pra, Evropës i duhet që atje të qëndrojë me dekada e dekada të tëra që të ruaj paqen artificiale dhe bashkimin e dhunshëm të këtij shteti. Por kjo i kushton shumë shtrenjtë ekonomikisht Evropës dhe botës.

Të njëjtën kopje të Dejtonit paraqet edhe Pakoja e Ahtisarit. Kosova sipas kësaj pakoje do të jetë një shtet gjysmak e jofunksional dhe paqa aty do të ruhet nga NATO, kurse pushtetin suprem do ta ketë i ashtuquajturi Misioni Civil i Bashkimit Evropian. Dhe kjo prani ushtarake e civile në Kosovë do të detyrohet që të qëndrojë atje përgjithmonë, sepse në momentin që ato do të tërhiqen prej aty, të nesërmen do të shpërthejë përleshja shqiptaro-serbe.

Në këtë mënyrë bashkësia ndërkombëtare po investon kot në një projekt jetëshkurtër e të paqëndrueshëm, të destinuar për dështim që në fillim të tij, ashtu siç ka dështuar Marrëveshja e Dejtonit. Prandaj, OKB-ja, SHBA-të Bashkimi Evropian dhe Rusia nuk duan që të investojnë edhe në një Dejton II në Kosovë, duke shpenzuar miliarda dollarë dhe duke e lënë edhe më tej Ballkanin një "fuçi baroti", një bombë të kurdisur te porta e Evropës. Këtë më së paku do ta tolerojë Evropa, e cila pretendon të bashkohet dhe të shndërrohet në një Superfuqi të re ekonomiko-ushtarake. Evropa dhe bota kanë vendosur që Ballkanin nga "fuçi baroti" ta kthejnë në një oazë të paqes dhe ta bëjnë vërtetë Evropë. Dhe kjo gjë arrihet vetëm përmes organizimit të një Konference Ndërkombëtare për Ballkanin, ku do të ndryshoheshin, me konsensus, kufijtë aktual të Ballkanit dhe do të krijoheshin shtetet etnike kombëtare, ndër ta edhe Shqipëria e Bashkuar, etnike dhe natyrale. Bashkimi Evropian është i vetëdijshëm se pa bërjen e Shqipërisë Etnike dhe konsolidimin etnik edhe të disa shteteve tjera të Ballkanit, nuk do të ketë paqe në Evropë dhe rrjedhimisht as bashkim të Evropës dhe as zhvillim ekonomik të saj. Evropa e Bashkuar nuk do të jetë kurrë e bashkuar me një Ballkan të ndarë e të copëtuar dhe as me Shqipërinë Etnike të pabashkuar. Evropa e Bashkuar nuk do që të mbesë prapa SHBA-ve, Rusisë dhe Kinës në ambicjet e saja për t'u bërë superfuqi ekonomike dhe më vonë edhe superfuqi ushtarake. Bashkimi Evropian duke plotësuar ambiciet serbomëdha të Serbisë, ajo indirekt edhe do të bëjë të mundur edhe hapjen dhe zgjidhjen e çështjes shqiptare dhe formimin edhe të Shqipërisë Etnike dhe të disa shteteve tjera etnike në Ballkan.

Edhe pa pëlqimin e pushtetarëve shqiptarë Evropa dhe bashkësia ndërkombëtare do ta bëjë ndryshimin e

kufijve të Ballkanit, por është në të mirën tonë që Shqiptarët të kyçen në ketë proces që në fillim, se kështu do të kenë favore më të mira. Vetë humbja e durimit tonë, shpërthimi i shqiptarëve të Kosovës në revolta masive kundër status-kuosë së tanishme do të çonte në heqjen nga rendi i ditës të Kosovës-Shtet dhe fillimin e bisedimeve për ndryshimin e kufijve të Ballkanit. Por, ka një ndryshim të madh këtu, sepse në këtë rast shqiptarët do të cilësohen si rrebelë, paqeprishës e ektremistë dhe kështu do ta kenë një barrë mbi shpinë në Konferencën Ndërkombëtare për Ballkanin. Prandaj që t'i ikin revoltës së pakontrolluar të shqiptarëve, udhëheqësit shqiptarë duhet që t'i dalin së keqes përpara duke e shtruar në mënyrë të organizuar dhe paqësore zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare në Ballkan dhe formimin e shteteve etnike në këtë Siujdhesë të trazuar me shekuj e mijëvjeçarë. Pikërisht tani është rasti i përshtatshëm që Shqipëria dhe shqiptarët të mos mbeten si gjer më tani vetëm spektatorë të ngjarjeve në Ballkan, por duhet të zgjohen nga gjumi dhe të shndërrohen në aktorë të ngjarjeve të sotme dhe të nesërme që do të ndodhin patjetër në Ballkan.

Të mos i përsërisim gabimet e shkuara të fillimit të shekullit që shkoi, kur e gjithë Evropa dëshironte prishjen e Turqisë, largimin e saj nga Ballkani dhe ndryshimin e kufijve etnikë të Ballkanit, kurse pikërisht udhëheqësit e shqiptarëve kërkonin ruajtjen e Turqisë, duke u kënaqur vetëm me një Autonomi brenda Turqisë. Dhe ndodhi ajo që deshën Fuqitë e Mëdha, Turqia u dëbua nga Ballkani, por shqiptarët mbetën me gisht në gojë, sepse ishin të papërgatitur për ndryshimin e kufijve, ishin të papërgatitur për formimin e shtetit kombëtar shqiptar. Kështu shqiptarët morën aq sa u dha Evropa, një gjysmë Shqipëri. Edhe nesër kur Evropa e bota do ta ndajnë edhe

njëherë e përfundimisht Ballkanin, shqiptarët do të marrin një gjysmë Shqipëri Etnike, nëse nuk kyçen me kohë në rrjedhat e ngjarjeve të ardhshme dhe të bëhen aktorë të këtyre ndryshimeve.

Pushtetarët shqiptarë nuk duhet të deklarojnë orë e çast, me paturpësi, se "ne nuk kemi tjetër platformë, pos asaj për shtetin e Kosovës"(!), se "ne nuk jemi për ndryshimin e kufijve të Ballkanit"(!), se "ne nuk jemi për krijimin e shteteve etnike"(!),... dhe përralla të tjera me mbret. Ai pushtetar që do t'i përsërisë edhe në të ardhmen, si papagall, këto fraza antikombëtare, do ta dëshmojë para gjithë kombit shqiptar se është kundër lirisë, kundër bashkimit kombëtar dhe kundër formimit të Shqipërisë së Bashkuar, etnike e natyrale! Ai apo Ata pushtetarë do ta thonë e dëshmojnë me gojën e vet se janë tradhëtarë dhe meritojnë ndëshkimin kapital nga ana e gjyqit popullor.

Në anën tjetër, Serbia i ka disa platforma për veprim: 1.Platformën për autonominë e Kosovës brenda Serbisë, 2.Platformën për copëtimin e brendshëm të Kosovës, 3.Platformën për ndarjen e Kosovës dhe 4.Platformën për formimin e Serbisë së madhe apo etnike. Serbia është e vetëdijshme se po të bëhet Kosova-Shtet do të fillojë zinxhirë edhe copëtimi i mëtejshëm i saj, sepse me këtë rast, heret a vonë, bile shumë shpejtë, do të kërkojë Sanxhaku që të shkëputet nga Serbia dhe një pjesë e Vojvodinës e banuar me shumicë hungareze. Që t'i iki kësaj Serbia, në momentin e fundit (e përkrahur haptas nga Rusia dhe disa shtete të Evropës), do të kërkojë hapur ndryshimin e kufijve të Ballkanit dhe krijimin e shteteve etnike. Vetëm në këtë mënyrë ajo do të qetësohet, duke dhënë disa territore, por duke marrë dyfishin e tyre me bashkimin e Republikës Serbe me Serbinë. Në këtë mënyrë do të qetësohej Serbia, por do të qetësoheshin

edhe Shqiptarët, Kroatët e Bullgarët, do të qetësoheshin kombet relevante të Ballkanit dhe në këtë mënyrë do të qetësohej mbarë Ballkani dhe Evropa.

Siç po duket, të gjithë në Ballkan dhe në Evropë janë të vetëdijshëm se pa formimin e shteteve etnike, pa ndryshimin e kufijve aktual të Ballkanit nuk mund të vendoset paqa e vërtetë dhe e qëndrueshm në këtë pjesë të Evropës, përveç shqiptarëve dhe pushtetarëve të tyre! A nuk e ka thënë kryepatrioti i Lëvizjes sonë Kombëtare, Abdyl Frashëri se: ”Pa bashkimin e trojeve shqiptare dhe formimin e Shqipërisë Etnike, nuk do të ketë kurrë paqe Evropa dhe Ballkani”? Ai e ka thënë përafërsisht kështu, por pushtetarët tanë antikombëtar, që janë kundër Platformës kombëtare të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e kanë harruar këtë, apo bëhen sikur e kanë harruar, vetëm e vetëm që të ruajnë pushtetin, postet, karriket dhe privilegjet e tyre aktuale!

Edhe po të bëhet Kosova shtet, kjo nuk do të thotë se do të qetsohej Ballkani, sepse pikë së pari Serbia nuk do ta pranonte kurrë një gjë të tillë, nuk do ta hiqte nga Preambula e Kushtetutës së saj Kosovën si pjesë integrale të shtetit serb dhe kështu do të nxiste trazira të vazhdueshme në Kosovë, përmes pakicave serbe atje, me qëllim që Kosovën ta rikthente nën sovranitetin dhe sundimin e saj.

Por, çka është edhe më me rëndësi, Kosova-Shtet nuk do t’i kënaqë dhe nuk do t’i qetësojë fare as edhe Shqiptarët, përkundrazi, shteti i Kosovës do t’i trimërojë edhe më tepër Shqiptarët për t’u riorganizuar dhe për të vazhduar veprimtarinë dhe luftën e tyre për bashkim kombëtar dhe për Shqipërinë Etnike. Kosova-Shtet nuk është fundi, por është fillimi i një lufte të re serbo-shqiptare, e cila domosdoshmërisht do të çonte në mbajtjen e një Konference Ndërkombëtare për Ballkanin

dhe në ndryshimin e kufijve të këtij Gadishulli dhe në formimin e shteteve etnike në Ballkan.

Por, pse të imponohet me luftë të re serbo-shqiptare mbajtja e Konferencës për Ballkanin, kur kjo gjë mund të bëhet tani në rrugë paqësore?! Përse duhet edhe një gjakderdhje e re e shqiptarëve që të binden pushtetarët tanë se heshtja dhe mosveprimi i tyre është një kasaphanë e re për popullin tonë?! Se mosshtruarja për zgjidhje nga ana e pushtetarëve tanë e Shqipërisë Etnike është edhe një robëri e re për më se gjysmën e shqiptarëve dhe trojeve të tyre etnike!

Një gjë të këtillë Evropa e di, Serbia e di, Rusia e di, bota e di, por mjerisht vetëm pushtetarët shqiptarë të Tiranës, të Prishtinës dhe të Shkupit nuk e dijnë dhe nuk duan ta dijnë. Ata do ta dijnë kur të mbështeten për muri, kur të tjerët t'i vënë para aktit të kryer, por atëherë do të jetë shumë vonë, sepse do ta paguajnë me territore haraçin e pavetëdijsimit e të mosveprimit me kohë.

Nga Konferenca Ndërkombëtare do të dalim me cungimin edhe të Shqipërisë Etnike, ashtu siç dolëm me një gjysmë Shqipëri nga Konferencat e Kongreset e Evropës në shekullin e kaluar! Mbajtja e Konferencës Ndërkombëtare për Ballkanin nuk do të thotë automatikisht se kufijtë e Shqipërisë Etnike janë të siguruar, por për ta duhet të argumentohet me urtësi, me fakte dhe me këmbëngulje të madhe edhe atje në tryezën e kësaj Konference.

Pushtetarët shqiptarë të "principatave" aktuale mesjetare shqiptare dhe të "vilajeteve" aktuale otomane duhet të heqin dorë një orë e më parë nga teoria e tyre antikombëtare: "Më mirë i pari në fshat, se i dyti në qytet", të heqin dorë nga karrierizmi, egoizmi dhe bajraktarizmi i tyre personal dhe t'i bashkojnë forcat e idetë, të krijojnë një Platformë Kombëtare të Shqipërisë

Etnike dhe në këtë mënyrë t'i bashkojnë edhe "principatat" dhe "vilajetet" e tyre aktuale. Në të kundërtën mallkimi dhe dënimi i kombit do të bjerë mbi ta. Në të kundërtën ata do të jenë shkaktarë të një gjakderdhjeje dhe vëllavrasjeje të re brendashqiptare.

Shqipëria Etnike mund edhe të mbesë e pabashkuar dhe e copëtuar, për shkak të politikës antikombëtare të pushtetarëve të saj, por as pushtetarët nuk do t'i gëzojnë privilegjet dhe pasurinë e tyre, ata jo vetëm që do t'i humbin ato, por do ta humbin edhe jetën e tyre nga revolta popullore dhe luftëtarët kombëtarë, të cilët kurrë nuk do të rrijnë duarkryq, kurrë nuk do t'i dorëzojnë armët pa u bërë Shqipëria Etnike. Nëse sot në Kosovë janë 400 000 armë në duar të popullit, nesër do të jenë me siguri 4000 000 armë në duar të Shqiptarëve e të Shqipërisë Etnike, sepse kjo do të jetë rruga e vetme për ribashkimin kombëtar, për dëbimin e pushtuesve sllavo-grekë nga trojet tona dhe për dënimin e tradhëtisë dhe të tradhëtarve të sotëm e të nesërm. Moti kohë nuk është dënuar me plumb tradhëtia dhe tradhëtarët, prandaj po bëjnë të qetë gjumin e ariut pushtetarët shqiptarë dhe po shtojnë përditë pasuritë e tyre të paligjshme, duke grabitur popullin dhe atdheun. Por, "kungulli nuk shkon gjithmon mbi ujë", thotë populli. Këtë herë askush nuk do t'i shpëtojë dënimit kapital për tradhëti kombëtare. Shqiptarë e pushtetarë, ruajuni tradhëtisë kombëtare, sepse këtë herë populli nuk do t'ua falë tradhtinë. Hakmarrja e popullit do t'ju ndjekë deri në varr e përtej varrit, djalë pas djali e nip pas nipi.

Kosova shtet është rruga e shkurtër dhe gjysmake e zgjidhjes së çështjes shqiptare, kurse ndryshimi i kufijve të Ballkanit, formimi i Shqipërisë Etnike është rruga më e gjatë, por zgjidhje e plotë e përfundimtare e çështjes shqiptare. Është paradoksale sjellja e papërgjegjshme dhe

antikombëtare e pushtetarëve shqiptarë në Tiranë, Prishtinë e Shkup, kur ata deklarojnë se janë vetëm për Kosovën-Shtet, se nuk janë për ndryshimin e kufijve të Ballkanit dhe për formimin e shteteve etnike në këtë Gadishull. Ata ose nuk janë të vetëdijshëm se çka thonë, ose janë antikombëtarë dhe kundër bashkimit kombëtar të trojeve etnike shqiptare në Ballkan! E si mund të formohet Shqipëria Etnike pa ndërrimin e kufijve të Ballkanit?! Status-quoja e djeshme dhe e sotshme është pushtim e robëri, është copëtim i trojeve shqiptare. Vetëm ndryshimi i kësaj status-kuoje bën të mundur bashkimin kombëtar të shqiptarëve në një shtet të vetëm - në Shqipërinë e Bashkuar, etnike e natyrale. Shqiptarët dhe politikanët e tyre në pozitë dhe në opozitë duhet të jenë të parët që duhet të ngrejnë zërin dhe të kërkojnë ndërrimin paqësor të kufijve të Ballkanit, të kërkojnë formimin e shteteve etnike në këtë rajon dhe bërjen e Shqipërisë së vërtetë. Askush më shumë se kombi shqiptar dhe trojet e tij në Ballkan nuk janë më të copëtuar e më të ndarë, prandaj askujt më tepër se shqiptarëve nuk u takon dhe nuk u konvenon ndryshimi i kufijve dhe formimi i shteteve etnike. Kombi shqiptar nuk ka çka të humbasë nga ripërcaktimi i kufijve të Ballkanit, përveç copëtimit dhe robërisë aktuale. Nga ndryshimi i kufijve të Ballkanit ne do të fitojmë lirinë kombëtare dhe do të humbasim pushtimin e sotëm sllavo-grek. Deri tani as me luftë e gjakderdhje nuk kemi mundur që ta bashkojmë Shqipërinë. Tani është momenti historik që këtë ta bëjmë në mënyrë paqësore. Nëse edhe këtë çast historik kombi ynë nuk e shfrytëzon, atëherë shqiptarët do ta dëshmojnë tezën antishqiptare serbe se "nuk janë popull i civilizuar dhe shtetformues"(!). Atëherë edhe unë do të thosha se shqiptarët nuk e meritojnë as edhe këtë gjysmë Shqipërie (londineze) që e kanë! Deri tani pushtetarët shqiptarë,

andej e këtej kufinjve shqiptaro-shqiptarë, janë në një gjumë të thellë dimëror, janë në kllapi, janë pasivë, janë të pavetëdijshëm e të pandërgjegjshëm dhe nuk e kanë opcion e vizion politiko-kombëtar formimin e Shqipërisë Etnike! Ata, në këtë mënyrë, rrezikojnë edhe tërësinë territoriale të Kosovës unmikistaneze! Nëse pushtetarët shqiptarë nuk do të jenë edhe në të ardhmen për ndryshimin e kufijve dhe formimin e shteteve etnike në Ballkan, atëherë Evropa dhe bota do t'i detyrojnë ata në ndarjen e Kosovës dhe në këtë rast do të fitojë vetëm Serbia, sepse nuk do të bashkohen shqiptarët dhe trojet e tyre, nuk do të bëhet Shqipëria e bashkuar etnike, por vetëm do t'i hiqet edhe një pjesë (Kosova veriore) integritetit territorial të Shqipërisë Etnike! Prandaj, Organizatat patriotike dhe formacionet paraushtarake kombëtare, legale e ilegale, duhet t'u japin një Ultimatum të afatizuar pushtetarëve tanë që ata të zgjohen nga gjumi dhe një orë e më parë të shtrojnë para opinionit ndërkombëtar zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare - formimin e Shqipërisë Etnike. Kurse përtej këtij afati, në rast se pushtetarët shqiptarë nuk zgjohen, atëherë forcat kombëtare politiko-ushtarake, legale e ilegale, duhet të bashkohen, pa kushte, ndërmjet veti dhe të marrin në dorë zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare, duke i eliminuar nga skena politike pushtetarët antikombëtar, përmes një Kryengritjeje të Përgjithshme Mbarëkombëtare për çlirimin dhe bashkimin e Shqipërisë Etnike.

Koha e fjalëve ka perënduar, tani është koha e veprimit. O sot, o kurrë, nesër do të jetë tepër vonë! Shqipëria Etnike duhet të bëhet nga Shqiptarët, për Shqiptarët dhe jo për inat të Shqiptarëve dhe në dëm të Shqiptarëve.

24 gusht 2007 (Titan Tivari)

SHQIPËRIA ETNIKE DUHET TË BËHET SOT, NESËR DO TË JETË VONË!

Shqiptarët, apo më saktë: udhëheqësit, kapedanët, princërit, bajraktarët, komandantët, liderët, mbretërit apo presidentët e tyre, gjatë gjithë historisë mijëravjeçare të kombit tonë dhe të Shqipërisë Etnike, në luftërat e tyre për çlirim dhe bashkim kombëtar, gjithmonë janë vonuar. Shqiptarët ose i kanë filluar luftërat dhe kryengritjet e tyre antipushtuese shumë heret, ose shumë vonë. Edhe atëherë, në raste shumë të rralla, kur kanë bërë rezistencë në kohë të duhur, ata kanë qenë të pabashkuar, pa unitet dhe të përçarë ideologjikisht dhe politikisht! Prandaj, edhe kurrë nuk arritëm që ta çlirojmë dhe ta bashkojmë tërësisht Atdheun tonë – Shqipërinë Etnike.

Shqiptarët, më saktë, udhëheqësit e tyre politik e ushtarak, asnjëherë nuk kanë marrë mësime të mjaftueshme nga pësimet dhe dështimet e tyre gjatë historisë. Prandaj, edhe u është përsëritur historia, u është ricikluar robëria! Udhëheqësit shqiptarë, gjatë pjesës më të madhe të historisë sonë kombëtare, kanë qenë egoistë e karrieristë të pasionuar. Ata më tepër kanë luftuar për vehte, për privilegje, për pasuri dhe për famë personale, se sa kanë luftuar për liri, për çlirim dhe bashkim të Atdheut të tyre. Dhe mjerisht, të njëjtën gjë po bëjnë edhe liderët aktualë të shqiptarëve, apo më saktë: Presidentët, kryeministrat, qeveritë, kuvendet popullore dhe kryetarët e partive të shumta politike në pozitë dhe në opozitë!

Pra, historia, vonesa dhe dështimet po na përsëriten para syve, veshve dhe hundëve tona dhe ne, populli, shtiremi si kur as nuk i shohim, as nuk i dëgjojmë dhe as nuk i nuhasim mbrapshtitë dhe tradhtitë e liderëve dhe udhëheqësve tanë këtej e andej kufinjve shqiptaro-shqiptarë! Kështu, sa kanë faj udhëheqësit e pushtetarët tanë, aq kanë faj shqiptarët, populli, që në të shumtën e rasteve, vetë i ka zgjedhur me votën e tij të lirë apo gjysmë

të lirë. Në këtë mënyrë, bashkëfajtorë për prapambetjen ekonomike, për anarkinë politike dhe për robërinë e pushtimin e më se gjysmës së Shqipërisë Etnike janë edhe vetë Shqiptarët, vetë kombi ynë, i cili jo vetëm i voton antikombëtarët, por edhe i duron ata edhe atëherë kur ata shkelin me të dyja këmbët mbi shpinë të popullit dhe mbi interesat vitale të lirisë, të çlirimit e të bashkimit të Shqipërisë Etnike!

*****

Dihet historikisht se, popujt çlirohen dhe shtetet formohen gjatë kthesave të mëdha dhe rrënjësore të historisë së një populli, të një vendi të një regjioni apo të një kontinenti. Dhe ne sot gjendemi pikërisht në fund të kësaj kthese të madhe historike për kombin tonë, për Shqipërinë Etnike dhe për mbarë Ballkanin. Kjo kthesë historike ka filluar më 1990 dhe duket se do të përfundojë më 2010. Gjatë kësaj periudhe do të mbyllet procesi i riformulimit të kufijve të shteteve të Ballkanit, prandaj kombi ynë dhe liderët e tij duhet ta marrin seriozisht këtë mundësi, ta shfrytëzojnë me zgjuarësi fundin e këtij procesi, nëse nuk duan që popullin dhe Atdheun e vet ta lënë në robërinë e vjetër të shteteve fqinje. Udhëheqësit e shqiptarëve në Shqipëri, Kosovë, Iliridë, Kosovë Lindore, Malësi të Madhe, Çamëri, Sanxhak e Diasporë duhet të mblidhen sa më parë kokë më kokë dhe të marrin një vendim për bërjen e Shqipërisë Etnike. Të kërkojnë bashkimin e trojeve etnike shqiptare në Ballkan, pra, të kërkojnë para opinionit publik botëror dhe para faktorëve politik ndërkombëtar ndryshimin e kufijve shtetëror të Ballkanit dhe formimin e shteteve etnike në Ballkan. Të kërkojnë mbajtjen e një Konference Ndërkombëtare për Ballkanin, ku, në prani të përfaqësuesve të shteteve ballkanike dhe me pjesëmarrjen e fuqive të mëdha dhe të organeve vendimmarrëse të OKB-së të vendosej paqja e qëndrueshme në Ballkan me ndryshimin e kufijve aktualë dhe formimin e shteteve kombëtare të popujve të Ballkanit. Vetëm në këtë mënyrë do të qetësohej Ballkani dhe do të bashkohej edhe Evropa. Në të kundërtën,

grindjet dhe përleshjet ndëretnike dhe ndërshtetërore në Ballkan do të jenë të pashmangshme, të pandërprera dhe të përgjakshme.

*****

Deri më sot koha e ka vërtetuar se liderët shqiptarë nuk kanë qenë në nivel të përgjegjësive të tyre politike e kombëtare, sepse nuk i kanë shfrytëzuar maksimalisht dhe në momentin e caktuar situatat e favorshme që janë paraqitur nga viti 1990 e këtej për zgjidhjen e drejtë dhe përfundimtare të çështjes kombëtare shqiptare. Udhëheqësit shqiptarë dhe mbarë populli ynë janë vonuar gjithmonë në reagimin e tyre politik apo ushtarak, sepse asnjëherë nuk kanë qenë të bashkuar dhe asnjëherë nuk kanë pasur një plan strategjik, një platformë kombëtare për veprim. Prandaj, kur gjithë popujt e ish-Jugosllavisë luftonin me armë në dorë për shkëputje nga Serbia e Madhe, populli ynë dhe udhëheqësit e tij rrinin duarkryq dhe pritnin. Pritnin Godonë! S'dinin as çka prisnin, sepse nuk kishin asnjë plan strategjik të veprimit. Kishin vetëm planin kobzi të luftës klanore, grupore apo partiake midis tyre! Dhe shqiptarët u ngritën në kryengritje kur u mbaruan luftërat në hapsirën tjetër ish-jugosllave. Pra, filluan luftën me vonësë dhe për fatin tonë të keq, të përçarë dhe me disa "ushtri" provinciale! Prandaj edhe nuk fituan lirinë krahinore e të mos bëjmë fjalë për lirinë kombëtare dhe bashkimin e Atdheut, që as nuk u dukën në horizont.

Të njëjtin rol regresiv e pasiv luajnë liderët shqiptarë edhe sot, edhe tani, kur është momenti final i bërjes apo mosbërjes së Shqipërisë Etnike! Ata nuk bëjnë asnjë veprim konkret për bashkimin e politikës shqiptare, ata nuk bashkohen rreth një platforme kombëtare për formimin e Shqipërisë Etnike, ata nuk janë të përgjegjshëm kombëtarisht, por nuk janë as të vetëdijshëm politikisht se sot është momenti i përshtatshëm për ndërrimin e kufijve të shteteve të Ballkanit në mënyrë paqësore, se pikërisht sot është çasti historik për formimin e shteteve etnike në Ballkan dhe me

këtë rast edhe për bashkimin e Shqipërisë Etnike. Nesër, kur të mbyllet çështja e Kosovës, do të jetë vonë, sepse do të mbyllet edhe për 100 vjet të tjera, apo më shumë, çështja e ndërrimit të kufijve në Ballkan dhe Evropë. Evropa dhe bota nuk ka kohë as vullnet që të merret me shtetet e Ballkani çdo ditë, çdo vjet, çdo dekadë, apo kur tu dalë gjumi shekullor shqiptarëve e tu kujtohet se janë të robëruar e të copëtuar nga shtetet fqinje!

Historikisht, shqiptarë kanë zhvilluar luftërat e tyre çlirimtare ose me vonesë, ose të përçarë, prandaj edhe kurrë nuk kanë fituar deri më sot, kurrë nuk kanë mundur që ta çlirojnë dhe bashkojnë përfundimisht Shqipërinë Etnike. Tani është momenti i fundit për këtë shekull që të bëhet Shqipëria Etnike, por që të bëhet ajo Shqiptarët dhe udhëheqësit e tyre duhet ta kërkojnë atë me qartësi politike, me vendosmëri dhe me vetëdije e ndërgjegje të lartë kombëtare.

Shqiptarët dhe politikanët e tyre, ose e dinë ose nuk duan ta dinë se, duke kërkuar shtetin e pavarur të Kosovës dhe mosndryshimin e kufijve të Ballkanit, ata janë kundër bashkimit kombëtar të kombit tonë, ata janë kundër formimit të Shqipërisë Etnike! Mosndryshimi i kufijve të shteteve të Ballkanit do të thotë vazhdim i robërisë dhe pushtimit shovenist mbi Çamëri, mbi Iliridë, mbi Kosovë Lindore, mbi Sanxhak e mbi Malësi të Madhe! Dhe pikërisht këtë po bëjnë sot liderët e pushtetarët shqiptarë në Tiranë, në Prishtinë, në Shkup e në Preshevë. Ata me duartë e tyre po ia farkojnë më tej zinxhirët e robërisë, vuajtjes e asimilimit popullit shqiptarë jashtë Shqipërisë londineze dhe Kosovës unmikistaneze! Për të bërë Kosovën "shtet", kosovarët e Prishtinës dhe shqiptarët e Tiranës po flijojnë në skëterrën e robërisë vëllezërit e tyre në trojet tjera etnike të Shqipërisë! Kosova edhe mund të bëhet njëfarë shteti i tredhur, i cunguar e gjysmak, por me këtë rast kombi shqiptarë duhet të përshëndetet me Shqipërinë Etnike të paktën edhe për 100 vjet të tjera.

Që të bëhet Shqipëria Etnike kombi ynë duhet të presë që të shpërbëhet perandoria e re në formim e sipër - Bashkimi Europian. Por edhe kur do të shembet kjo perandori, qoftë pas 100 apo 1000 vjetësh, shqiptarët përsëri do t'i zërë përfundi, ashtu siç i zuri përfundi gërmadhave të saj shembja e Jugosllavisë Federative, sepse nëse Shqiptarët do të hyjnë në Evropë të ndarë, ata të ndarë e me robëri të re do të dalin nga kjo Evropë e Bashkuar.

*****

Liderët shqiptarë në pushtet e në opozitë nuk janë të vetëdijshëm se shpesh fati gjendet në fatkeqësi. Është fatëkeqësi që Serbia nuk e pranon pavarësinë e Kosovës. Është fatkeqësi që Rusia vendos veton në Këshillin e Sigurimit kundër pavarësisë së Kosovës. Por askush nga pushtetarët trutharë shqiptarë nuk është i vetëdijshëm se mospranimi i Serbisë dhe vetoja e Rusisë (por edhe hezitimi i heshtur kundër shtetit të Kosovës i Bashkimit Europian), i hap rrugë ndërrimit të kufijve në Ballkan, i hap rrugë formimit të Shqipërisë Etnike. A nuk i hapi rrugë intervenimit të NATO-s kundër Serbisë egërsia, gabimi dhe kokëfortësia e Millosheviçit kundër Kosovës dhe kundër botës? Ky pra, është fati në fatkeqësi. Dhe këtë fat Shqiptarët dhe udhëheqësit e tyre duhet ta kapin me mençuri edhe tani, duhet ta shfrytëzojnë me shpejtësi dhe të bëhen pjesë e idesë për ndryshimin paqësor të kufijve të Ballkanit dhe formimin e shteteve kombëtare në këtë siujdhesë të trazuar me shekuj e mijëvjeçarë.

Shqiptarët dhe liderët e tyre duhet ta dijnë njëherë e mirë se ne as nuk kemi qenë, as nuk jemi dhe as nuk do të jemi ndonjëherë aq të fortë për të ndryshuar kufinjtë e shteteve të Ballkanit. Këtë gjë e bëjnë shtetet e forta, kombet e mëdha dhe fuqitë e mëdha. Mos ta gënjejë kend mendja se Jugosllavinë e prishën një grusht shqiptarësh me ca pushkë të vjetra ruso-kineze. Jugosllavinë e shkatërruan republikat e mëdha e të forta të saj siç ishin Serbia dhe Kroacia. Edhe kufinjtë e Ballkanit ka gjasa që t'i ndërrojë vetëm Serbia me ndihmën e Rusisë dhe

aprovimin e heshtur të Bashkimit Europian.. Dhe për ndërrimin e këtyre kufinjve askush më tepër se kombi ynë nuk është i interesuar që të ndërrohen, sepse vetëm me këtë rast do të bëhej bashkimi ynë kombëtar në një Shqipëri të Bashkuar Etnike. Ky pra, është fati në fatkeqësi.

Të vetmit shtete sot në Ballkan që u konvenon ndërrimi i kufijve të Ballkanit janë Serbia, Shqipëria, Bullgaria dhe Kroacia. Në rast të ndërrimit të kufijve të Ballkanit Serbia do të merrte Republikën Serbe, Kroacia do të merrte Hercegovinën, Bullgaria do të merrte Maqedoninë Lindore, kurse Shqipëria Etnike do të bashkohej duke iu bashkangjitur Shqipërisë aktuale të gjitha trojet shqiptare që sot janë jashtë saj në Mal të Zi, në Serbi, në Maqedoni dhe në Greqi.

Por, fatkeqësisht, vetëm Serbia është aktualisht ajo që bën përpjekje hapur e fshehur për ndërrimin e këtyre kufijve. Të tjerët po presin që t'i njxerrin gështenjat nga zjarri me duartë e Serbisë. Por kjo nuk është politikë e zgjuar dhe e sigurt, sepse dihet që askush nuk punon për ne, nëse ne nuk punojmë për vete. Po u kyçëm me vonesë në këtë process do ta kemi më të vështirë edhe daljen me sukses e të kënaqur nga ky proces, nga procesi i rindarjes së "kulaçit të Ballkanit".

Ndaj, udhëheqësit shqiptarë në pushtet e në opozitë, një orë e më parë duhet ta shtrojnë me miqtë dhe aleatët politiko-ushtarakë të shqiptarëve çështjen e ndërrimit të kufinjve të Ballkanit, zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare dhe çështjen e formimit të shtetit kombëtar shqiptar – Shqipërisë Etnike. Nuk është politikë e zgjuar, nuk është politikë kombëtare dhe as largpamësi vizionare kokëfortësia dhe këmbëngulja e politikanëve tanë vetëm në një opcion politik, në atë të shtetit të Kosovës. Ne duhet të jemi flexibilë, të zhdërvjelltë dhe të hapur për të gjitha opcionet politike që ofron çasti historik dhe, mbi të gjitha, ne duhet të jemi të gatshëm dhe të shpejtë në kapjen e fatit që na ka ardhë te dera dhe na buzqesh, në

ndryshimin e kufijve të Ballkanit dhe të bërjes së Shqipërisë Etnike.

Shumë liderë shqiptarë në pozitë, por më shumë ata në opozitë dhe sidomos liderët e disa grupeve e organizatave patriotiko-revolucionare, që janë opozitë edhe e pozitës, edhe e opozitës, janë duke menduar shumë gabimisht se për të luftuar për bashkim kombëtar dhe për Shqipërinë Etnike nuk është vonë kurrë. Por kjo nuk qëndron, sepse historia shqiptare shumë shpesh e ka vërtetuar se ne sa herë kemi luftuar me vonesë nuk kemi fituar. Ne kemi derdhur gjak, kemi dhënë dëshmorë, por lirinë nuk e kemi fituar, sepse kemi qenë të vonuar. Kemi luftuar kur luftërat kanë përfunduar dhe kur Fuqitë e Mëdha e kanë mbyllë çështjen dhe kanë marrë vendimet e tyre fuqiplote. Populli thotë: "pas dasmës nuk bien tupanat!". Ndaj, t'u biem "tupanave" të lirisë, të bashkimit kombëtar dhe të Shqipërisë Etnike sot, tani, se nesër do të jetë shumë vonë. Ata të cilët do të ngriten nesër në luftë të armatosur, gjoja për të kundërshtuar vendimet e OKB-së apo të Fuqive të Mëdha, në emër të lirisë, të bashkimit kombëtar dhe të Shqipërisë Etnike, ata s'do të jenë gjë tjetër pos demagogë, pseudopatriotë dhe xhelatë të gjakderdhjes së kotë të shqiptarëve, sepse disfata do të jetë e garantuar. Nëse duhet të luftohet me armë në dorë, kjo poashtu duhet të bëhet sot, tani, këtë vit apo më së largu në fillim të vitit që vjen, se pastaj poashtu do të jetë shumë vonë.

Organizatat dhe formacionet paraushtarake legale e ilegale, të cilat janë vendosmërisht për Shqipërinë Etnike, duhet që liderëve dhe pushtetarëve shqiptarë që janë në pushtet në Tiranë, Prishtinë dhe Shkup, si dhe Qeverive e Kuvendeve në Prishtinë e Tiranë, tu drejtojnë një Ultimatum dhe t'ua caktojnë datën deri kur ata kanë kohë që ta shtrojnë për zgjidhje çështjen kombëtare të Shqipërisë Etnike para opinionit ndërkombëtar dhe OKB-së. Përtej datës së këtij Ultimatumi këto organizata dhe formacione paraushtarake duhet urgjentisht, brenda javës, të bashkohen dhe të nisin Kryengritjen e

Përgjithshme të Armatosur për çlirimin dhe bashkimin e Shqipërisë Etnike. Në këtë mënyrë, të gjithë faktorët relevantë ndërkombëtarë do të detyroheshin që ta vënë në rend të ditës çështjen shqiptare dhe zgjidhjen e saj. Kjo është teoria e imponimit.

Ne nuk jemi aq të fortë sa të luftojmë kundër gjithë botës dhe vendimeve të tyre, qofshin ato edhe vendime të padrejta, antishqiptare dhe plotësisht në kundërshtim me vullnetin e kombit tonë. Për këtë arsye ne nuk duhet të presim më shumë se disa muaj, sepse është rrezik që bashkësia ndërkombëtare të marrë vendime antishqiptare dhe atëherë do të jetë e pamundur që t'i ndryshojmë këto vendime superiore. Prandaj, zgjoheni shqiptarë sot! Ngritu në këmbë o komb shqiptar sot! Bashkohuni liderë e pushtetarë sot! Bëheni Shqipërinë Etnike në rrugë paqësore sot, se nesër do të jetë shumë vonë.

Populli thotë: "njëherë të vjen e mira kah dera". Ndaj, o Shqiptarë, hapeni "derën" dhe futeni brenda në zemrat dhe mendjet tuaja nusen e stolisur, shtojzovallen e bukur dhe zanën e bjeshkëve tona legjendare – Shqipërinë Etnike.

Mos thoni nesër se nuk ditëm dje, por diheni se padituria, mosguximi dhe tradhëtia paguhen shtrenjtë, paguhen me kokë dhe me robërinë e re shekullore të Shqipërisë Etnike. Ndaj, të gjithë shqiptarët dhe pushtetarët, sot o kurrë, duhet të kërkojnë para gjithë opinionit botëtror, para miqve dhe armiqve tanë: Vetëvendosje, Referendum Popullor, ndërrimin e kufijve të Ballkanit dhe formimin e Shqipërisë Etnike.

14 gusht 2007 (Titan Tivari)

SHQIPËRIA ETNIKE – PROCES DIALEKTIK

Aktualisht, të gjithë janë kundër çlirimit kombëtar shqiptar, kundër dekolonizimit të trojeve të robëruara shqiptare dhe kundër ribashkimit të Shqipërisë Etnike.

Kundër është politika zyrtare e Tiranës, e Prishtinës, e Shkupit (pjesa shqiptare) dhe e Podgoricës (pjesa shqiptare)! Për politikën zyrtare antishqiptare sllave të Shkupit e të Podgoricës s'kemi çka flasim, ajo është e njëjtë me atë të Beogradit. Përveç pushtetarëve e zyrtarëve shqiptarë, kundër ribashkimit kombëtar të Shqipërisë Etnike janë pastaj të gjithë të tjerët. Gjithë Europa e bota është kundër çlirimit dhe bashkimit të kombit shqiptar në një shtet të vetëm kombëtar. Dhe kjo nuk është aspak e çuditshme, sepse kur ti je kundër vetvetes, të tjerët nuk kanë se si të jenë pro teje. Por, të mos keqkuptohemi, në gjithë këtë politikë antikombëtare të zyrtarëve shqipfolës nuk bën pjesë kombi shqiptar, pra populli ynë. Poashtu, në të gjithë këtë politikë antishqiptare të Europës dhe të Botës, nuk bëjnë pjesë popujt dhe kombet e botës, sepse popujt në thelbin e tyre janë liridashës dhe solidarë me njëri-tjetrin. Kundër bashkimit kombëtar të Shqipërisë Etnike, pra, janë qeveritë dhe pushtetarët shqiptarë, si dhe qeveritë dhe pushtetarët botërorë. Të gjitha qeveritë dhe pushtetarët janë njësoj: ruajnë pushtetin dhe privilegjet e tyre në dëm të barazisë, drejtësisë, lirisë dhe mirëqenies së popujve. Për bashkimin kombëtar dhe bërjen e Shqipërisë Etnike është kombi shqiptar dhe të gjithë popujt e tjerë të botës. Nga kjo del se për Shqipërinë Etnike është forca numerike e sasiore (kuantitative) – popujt, kombet e grupimet e ndryshme joqeveritare botërore. Kundër Shqipërisë Etnike është forca cilësore (kualitative) – qeveritë, ushtritë dhe organizmat pushtetmbajtëse botërore.

Dy taborret e kundërta, që ndeshen e luftojnë vazhdimisht me njëri-tjetrin, hapur e fshehur, në gjithë botën, janë: **1.forcat popullore dhe 2. forcat qeveritare**

Janë pikërisht forcat qeveritare, shqiptare e ndërkombëtare, ato të cilat ia mohojnë kombit tonë lirinë, të drejtën e vetëvendosjes, referendumin popullor dhe ribashkimin kombëtar në Shqipërinë etnike.

Dhe mohimi sjellë revoltën, aksioni qeveritar sjellë reaksionin popullor, robëria imponon lirinë, kurse sundimi i huaj sjellë rezistencën kombëtare në të gjitha format e mundshme të tij. Përderisa kombi ynë është i ndarë, ai medoemos që kërkon dhe do të kërkojë bashkim. Përderisa trojet shqiptare të më tepër se gjysmës së Shqipërisë Etnike janë të pushtuara, medoemos që populli ynë kërkon e do të kërkojë çlirimin e tyre. Përderisa kombit tonë i mohohet e drejta e lirisë dhe e vetëvendosjes, sigurisht që ai kërkon dhe do të kërkojë me këmbëngulje realizimin e kësaj të drejte njerëzore e kombëtare univerzale. Përderisa aspratat dhe kërkesat e ligjshme kombëtare të Shqiptarëve ndeshin në vesh të shurdhër e mospërfillës të pushtetarëve shqiptarë e ndërkombëtarë, medoemos që populli ynë do të detyrohet që të bëhet më i zëshëm dhe më radikal, me qëllim që zëri i tij të bëhet i dëgjueshëm edhe për shurdhëmemecët. Që kërkesat tona kombëtare të merren seriozisht, ne do të detyrohemi që të imponojmë zgjidhjen e çështjes sonë kombëtare përmes Kryengritjes së Përgjithshme Popullore. Gjithmonë kur nuk është dëgjuar zëri, është dëgjuar pushka e Shqiptarit. Ashtu si e vërteta vonon, por nuk harron, poashtu edhe liria dhe lufta e popullit vonon, sakrifikon dhe në fund fiton. Përpjekja, aspirata dhe lufta e kombit tonë për Shqipërinë Etnike është një proces i pandalshëm, që ka kaluar nëpër shumë faza dhe situata historike, duke iu afruar për çdo ditë e më shumë aktit final të ribashkimit tonë kombëtar.

As dje, as sot, por as nesër nuk do të ketë forcë politiko-ushtarake kombëtare e ndërkombëtare që do të mund ta shuaj e frenojë luftën e kombit shqiptar për bashkim kombëtar dhe bërjen e Shqipërisë Etnike. Shqipëria Etnike është një proces dialektik e natyror, që është e pamundur të mohohet në vazhdimësi. Të gjitha

”marrëveshjet”, ”kontratat”, ”traktatet” e ”zgjidhjet” e qeverive dhe pushtetarëve tanë e ndërkombëtarë, në kundërshtim me vullnetin e kombit shqiptar, janë e do të jenë të përkohshme dhe të pavlefshme.

Edhe ”paqa” aktuale, që duket si paqë, nuk është paqë dhe nuk do të bëhet e tillë derisa të formohet Shqipëria Etnike. As shteti i ”pavarur” i Kosovës nuk do ta qetësojë popullin tonë, që ai të heqë dorë nga bashkimi i Shqipërisë, përkundrazi, Kosova-”Shtet” do të jetë fillimi i fillimit të vërtetë të bërjes së Shqipërisë Etnike. Janë iluzionistë e demagogë ata pushtetarë e politikanë shqiptarë dhe ndërkombëtarë që trumbetojnë se paqa dhe stabiliteti i Ballkanit varet nga bërja e Kosovës-”Shtet”.

Paqa dhe stabiliteti i Ballkanit varet nga zgjidhja apo moszgjidhja e çështjeve kombëtare të popujve të Ballkanit dhe sidomos ajo varet nga bërja apo mosbërja e Shqipërisë Etnike. Pa zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare në Ballkan, jo vetëm që s’do të ketë paqë në këtë Gadishull, por as në Europë. Europa kurrë nuk do të jetë e qetë dhe e bashkuar pa bashkimin e trojeve të copëtuara e të pushtuara të Shqipërisë Etnike. Këtë qeveritë e Europës e dijnë, por ata, megjithatë, shpresojnë se populli ynë një ditë do të heqë dorë nga ëndrra e tij kombëtare për çlirim, liri e bashkim. Këtë shpresë të kotë Europës ia ushqejnë qeveritë dhe pushtetarët shqiptarë, të cilët orë e çast, edhe kur nuk i pyet askush, ulërijnë si çakallë se nuk janë për bashkim kombëtar!

Dhe Europa e bota bien në grackën e këtyre trutharëve shqipfolës, nuk dëgjon zërin e kombit shqiptar dhe nuk merr parasysh vullnetin e tij për vetëvendosje dhe bashkim kombëtar. Prandaj edhe ka pasur aq shumë përleshje e luftëra ndëretnike në Ballkan! Prandaj edhe pati e do të ketë edhe luftëra e përgjakje të tjera ndëretnike në Ballkan, sepse Europa dhe Bota nuk kanë vullnetin që t’i zgjidhin çështjet kombëtare në Ballkan, nuk kanë gatishmërinë dhe pjekurinë politike e njerëzore që të bëjnë të mundshme bashkimin e Shqipërisë Etnike në rrugë paqësore.

Dikush në hapsirën shqiptare, në Europë e në botë harron me qëllim se kur dështon rruga paqësore për çlirim, liri, vetëvendosje e bashkim, atëherë rradha i vjen rrugës së luftës së armatosur popullore. Dhe për këtë luftë ata fajsojnë pastaj popujt e robëruar, por e kanë kot, atëherë është tepër vonë, lufta e bën të veten, sjellë vrasje e shkatërrim, por sjellë edhe lirinë dhe pavarësinë për popujt e robëruar dhe të pushtuar.

Qëndrimet antikombëtare të zyrtarëve shqiptarë dhe politikat antishqiptare të qarqeve të caktuara euro-aziatike imponojnë luftën e armatosur çlirimtare të kombit shqiptar, kurse lufta çlirimtare e popullit tonë imponon pastaj zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare dhe ribashkimin e Shqipërisë Etnike. Imponimi imponon imponimin. Kjo është rregulla e pashkruar, por frytdhënëse, në luftë dhe në politikë, e cila shpërthen prangat e robërisë dhe cila ndryshon status quonë e padurueshme të një populli, i cili aspiron për liri dhe pavarësi. Lufta çlirimtare për asnjë popull të botës nuk është dëshirë, luks apo aventurë, ajo është domosdoshmëri e gjendjes së robërisë dhe imponim nga ana e pushtuesve. Lufta çlirimtare është negacion i robërisë dhe paralajmëruese e lirisë.

Po kjo luftë çlirimtare dhe imponuse njëkohësisht, siç duket, do ta sjellë edhe lirinë, pavarësinë dhe ribashkimin kombëtar të Shqipërisë Etnike. Rrugë tjetër nuk ka: ose në robëri, ose luftë për liri. Nëse dikush e din ndonjë rrugë të mesme për të fituar lirinë, le të na e tregojë. Por rruga e mesme nuk e sjellë lirinë, ajo e sjellë demagogjinë, iluzionin dhe lirinë e rrejshme, siç është "liria" aktuale e Kosovës unmikistaneze, apo siç do të jetë nesër "pavarësia" e kufizuar (e mbikqyrur) e "shtetit" të Kosovës, nën protektoratin (neokolonializmin) e Europës së "Bashkuar"! Nesër Kosova vetëm do të ndërrojë padronin (Bossin) e vet. Nga neokolonializmi i UNMIK-ut do të kalojë në neokolonializmin e EUMIK-ut! Nga protektorati në protektorat, nga pushtimi në pushtim! Pa çka se ky pushtim është më "i butë" dhe me i sofistikuar

se pushtimi i djeshëm serbomadh! Robëria është robëri, pushtimi është pushtim. Ata kanë një fytyrë të njëjtë çnjerëzore e antipopullore. Ata kanë një përmbajtje të njëjtë antishqiptare! Kur i huaji të bëhet zot në shtëpinë tënde, në atdheun tënd, aty më nuk ka vend që të flitet për liri, pavarësi apo për demokraci. Këto termine tani bëhen vetëm mashtrim e demagogji dhe fasadë për robëri kombëtare e shfrytëzim ekonomik.

Kombi shqiptar është kombi më i vjetër i Europës, me një kulturë e civilizim parahistorik dhe antik, prandaj nuk ka nevojë për tutorë e regjentë të huaj që ta qeverisin e sundojnë në emër të "lirisë" dhe të "demokracisë" europiane! Kombi ynë ka nevojë për miq e aleatë të vërtetë, të sinqertë e natyrorë, që ta ndihmojnë për të ribashkuar trojet e copëtuara, për të fituar lirinë e pavarësinë kombëtare dhe për të zhvilluar e ndërtuar vendin. Lufta çlirimtare për bashkim kombëtar është e pashmangshme dhe e imponuar për popullin tonë. Sa më parë që ta kuptojnë këtë qeveritarët, pushtetarët dhe politikanët shqiptarë, aq më mirë do të jetë për popullin dhe për ta. Sa më parë që ta kuptojnë dhe ta pranojnë qeveritarët dhe politikanët shqiptarë se Shqipëria Etnike është e vetmja alternativë e kombit tonë, aq më herët do të përgatitemi dhe do të fitojmë lirinë dhe bashkimin kombëtar. Sa më herët që ne të gjithë të bindemi se lufta na troket te dera, aq më shpejt do të mobilizohemi dhe aq më pak pasoja do të kemi nga ajo luftë e re që po na imponohet nga qarqet qeveritare antishqiptare euro-aziatike.

Të flasim për paqën dhe të përgatitemi për luftën.
Kombi shqiptar është i mbështetur për muri.
Kush ka sy e shikon, kush ka ndjenja e përjeton.
Shqipëria Etnike është proces dialektik.
Kësaj askush s'mundet t'i ikë.

10 tetor 2007 (Titan Tivari)

RIBËRJA E SHQIPËRISË ETNIKE VARET NGA SHQIPTARËT

Aktualisht, Shqipëria Etnike përkundet ndërmjet ëndrrës dhe realitetit, me synimin, shpresën dhe besimin që Ëndrrën ta bëjë Realitet. Por, si do të bëhet ëndrra realitet? Disa thonë përmes rrugës paqësore, me mjete demokratike, siç është Referendumi dhe Vetëvendosja, si dhe përmes së drejtës natyrale që kanë popujt për të qenë të lirë dhe të bashkuar në atdheun e vet. Deri më sot në Ballkan, për zgjidhjen e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve ndëretnike dhe ndërshtetërore, mjetet paqësore dhe demokratike nuk kanë gjetur zbatim dhe përdorim. Kanë qenë luftërat e armatosura dhe përleshjet e përgjakura ndërmjet pushtuesve dhe çlirimtarëve ato që u kanë prirë zgjidhjeve të problemeve ndërshtetërore, kurse mjetet demokratike e bisedimet politike kanë ardhur pas ndërprerjes së luftës. Se si do të jetë në të ardhmen, këtë askush nuk e di, këtë vetëm e nesërmja do ta vërtetojë. Një gjë dihet me saktësi - në rrugën tonë për bërjen e Shqipërisë Etnike, Ne, shqiptarët, duhet t'i kemi parasysh e në dispozicion që të dy opcionet: edhe opcionin e luftës së armatosur çlirimtare, edhe opcionin paqësor të mjeteve demokratike.

Ne shpeshherë në analizat dhe debatet tona për gjendjen e ndarë e të pushtuar të Shqipërisë Etnike e fajsojmë faktorin e jashtëm ndërkombëtar dhe shumë pak e rrallë i analizojmë e i zbulojmë gabimet, të metat dhe mosunitetin tonë të brendshëm. Prandaj edhe na përsëriten humbjet, dështimet dhe mosrealizimi i aspiratës sonë shekullore për krijimin dhe ribashkimin e Shqipërisë Etnike.

Liria jonë fillon tek ne, te organizimi, bashkimi dhe lufta jonë e vendosur për çlirimin dhe ribashkimin kombëtar, kurse përfundon me njohjen ndërkombëtare të kësaj lufte. Por nëse kjo liri e kjo luftë fillon me defekte e të çara në rradhët tona, atëherë s'do mend se do të

përfundojë pa sukses dhe për fajin e shqiptarëve e jo të ndërkombëtarëve. Ne duhet të punojmë më shumë me vetveten tonë, ne duhet ta edukojmë veten dhe popullin tonë, ta armatosim atë me dituri e arsim, me informacion politik e kombëtar, ta armatosim me idealin kombëtar të luftës për liri e ribashkim kombëtar, ta brumosim me dashurinë për atdheun tonë, për Shqipërinë Etnike.

Atdhedashuria e zjarrtë dhe nacionalizmi i pastër janë baza e fitores sonë. Shqiptarët së pari duhet ta integrojnë - bashkojnë atdheun e vet dhe pastaj të integrohen në Europë. Nuk hyhet në Europën e bashkuar me shqiptarë të ndarë. Në Europë duhet të shkojmë si komb i bashkuar, jo si fise mesjetare. Në Europë duhet të shkohet me dinjitet, si shtet i bashkuar, si Shqipëri Etnike.

Duhet ta theksojmë me përgjegjësi dhe sinqeritet të plotë se ëndrra është teoria e çështjes sonë kombëtare, kurse realiteti është praktika, zbatimi, vënia në jetë e kësaj ëndrre, e kësaj teorie. Dhe ne, gjithashtu, duhet ta pranojmë me arsye shkencore se gjithmonë ekziston një shpërputhje midis teorisë dhe praktikës. Në rastin tonë konkret ekziston një disharmoni ndërmjet ëndrrës dhe realitetit, ndërmjet ëndrrës për Shqipërinë Etnike dhe realitetit të Shqipërisë Etnike.

Mijëvjeçari i tretë dhe fillimi i shekullit XXI nuk janë e nuk do të jenë si mijëvjeçari e shekulli i kaluar, prandaj edhe gjendja e Shqipërisë Etnike do të jetë shumë më e ndryshme se ajo e së kaluarës. Para Shqiptarëve në këtë shekull të ri shtrohen edhe forma e rrugë të reja të veprimtarisë dhe luftës së tyre për bërjen e Shqipërisë Etnike.

Shqipëria Etnike është reale, realiste, realitet dhe e realizueshme.

Shqipëria Etnike është edhe ëndërr, edhe zhgëndërr, edhe realitet.

Shqipëria Etnike është rrugëtimi i pandalshëm dhe titanik mijëvjeçar i ëndrrës drejt realitetit.

Ëndrra për Shqipërinë Etnike është fillimi, kurse realiteti është përfundimi i këtij rrugëtimi të gjatë e maratonik për bërjen e Shqipërisë Etnike e të Ribashkuar.

Është fatkeq vendi që nuk ka heronj. Një komb nuk mund të vdesë, vetëm nëqoftëse bën vetëvrasje. E ardhmja e kombit tonë duhet të mbillet në të tashmen, sot, tani. Ardhmëria jonë është në të tashmen, varet nga ajo, por është edhe në të kaluarën. Jemi ne ata që e krijojmë atë. Po të jetë ardhmëria jonë e keqe, atëherë jemi ne fajtorë për këtë.

*****

Shqipëria Etnike është plagë e hapur që kullon gjak pellazgjik, ilirik e shqiptar. Është lapidar i ngritur ndër mijëvjeçarë nga eshtrat e mijëra e miliona luftëtarëve, dëshmorëve dhe heronjve të saj.

Shqipëria Etnike është Pellazgjia, është vatra dhe froni i Perëndive Pellazgjike të Olimpit, është atdheu i Zeusit, Herës, Herkulit, Afërditës, Dionisit, Apollonit, Poseidonit, Marsit,... është Pellazgjia e Homerit, Dodonës, Orfeut, Anteut e Prometheut.

Shqipëria Etnike është Iliria, është shtiza, mburoja, shpata dhe përkrenarja e Akilit, Hektorit, Priamit, Agamemnonit, Odiseut, Pirros, Lekës së Madh, Bardhylit, Teutës, Agronit, Gentit...

Shqipëria Etnike është Arbëria e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, Gjergj Arianitit, Moisi Dibrës, Pal e Lekë Dukagjinit, Karl e Tanush Topisë, Kont Uranit, Lekë Zaharisë, Gjin Bua Shpatës, Gjon Zenebishit, është Arbëria e Muzakajve, Balshajve, Spanëve, Skurrajve, Gropajve,...

Shqipëria Etnike është Shqipëria e Rilindjes sonë Kombëtare, është Shqipëria e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, është Shqipëria e Pavarur e Kuvendit të Vlorës, është Shqipëria e Flamurit Kombëtar të 28 nëntorit 1912,...

Shqipëria Etnike është kandili, qiriri, pishtari, pena dhe pushka e Luftëtarëve të Lirisë, që nuk kursyen as djersën, as gjakun, as jetën dhe as pasurinë e tyre për ta bërë Shqipërinë që nga parahistoria dhe deri më sot.

Shqipëria Etnike është katakomb, varr gjigant, terr, ferr e skëterrë për barbarët, pushtuesit, sundimtarët, kolonizatorët dhe armiqtë e saj të të gjitha kohërave.

Shqipëria Etnike është e pavdekshme, është Feniks që përgjaket, plagoset, rrëzohet dhe për liri bëhet pluhur e hi, dhe nga hiri i vet ngritet, ringjallet dhe bëhet sërish Shqipëri.

Shqipëria Etnike është e pavdekshme, sepse i pavdekshëm është kombi shqiptar me rrënjë pellazgo-ilire.

Ëndrra për Shqipërinë Etnike është një ëndërr njerëzore e mbarëkombëtare, që do të shndërrohet në një realitet tokësor, me një bukuri engjëllore dhe madhështi hyjnore.

Të gjitha rrugët çojnë drejt Shqipërisë Etnike.

14 shtator 2007 (Titan Tivari)

Në vend të Pasthënies:

ZGJOHU, NGRITU SHQIPËRI!

Re të zeza të kanë mbuluar,
Diell e Hënë të kanë errësuar,
s'je në ëndërr,
por je zhgëndërr,
në terr të zi e në robëri,
zgjohu, ngritu Shqipëri!

Laku n'fyt po t'shtrëngon,
pranga trupin ta mundon,
okupimi po t'shkatërron,
armiqt sulen me egërsi,
me ushtri e me djallëzi,
zgjohu, ngritu Shqipëri!

Mjaft Ti fjete e u përgjume,
mjaft Ti ndejte e ngujume,
mjaft Ti prite ditë përditë,
flake terrin bëhe dritë,
ndize zjarrin nga një shkëndi,
zgjohu, ngritu Shqipëri!

Më dhemb zemra kur rënkon,
kur nga dhembjet Ti gjëmon
m'hapet goja e s'mund të flas,
jap kushtrim e po bërtas,
por askush nuk më dëgjon,
po askush nuk më beson
i gjithë trupi të është shkri,
zgjohu, ngritu Shqipëri!

Kam shumë zjarr e shumë dhimbje,
kam shumë mall e shumë dridhje,
kam shumë vuajtje e dashuri,
kam shumë dhembje e krenari,
kam shumë ankth e burrëri,
zgjohu, ngritu Shqipëri!

Shpatë e Damokleut të rrin mbi kokë,
”Pako” e ”Traktate” hartojnë me okë,
Rezoluta (1244) e 14 Pika,
gjithësecila më e mprehtë se thika,
trupin copa ta copëtojnë,
shpirt e zemër të dërrmojnë,
trojet Tua t’i pushtojnë,
marimangat thurrin robëri,
kameleonët endin tradhti,
zgjohu, ngritu Shqipëri!

Serbia jepë autonomi,
bota jepë gjysmëpavarësi,
ç’janë këto hile një dreq e di,
gjithçka janë veç jo liri,
të ka hy n’Kullë bajlozi i zi,
zgjohu, ngritu Shqipëri!

Janë ndryshkë armët mbi tavan,
pastro shpatë e jatagan,
dil në shesh dhe n’mejdan,
shpërthe vrullshëm si vullkan,
Ja vdekje – Ja liri,
zgjohu, ngritu Shqipëri!

Mos i le armët të ndryshken,
mos i le teshat të myken,
mos e le luftën në mes,
mos e le idealin t'vdesë,
mos harro - je Iliri,
zgjohu, ngritu Shqipëri!

Gjithë Kosova n're të zeza,
nënat, motrat shamizeza,
frynë stuhia e shfrynë era,
lufta të troket te dera,
s'ka liri, s'ka pavarësi,
s'ka bashkim, as drejtësi,
rroki armët përsëri,
zgjohu, ngritu Shqipëri!

Zgjohu, ngritu del te dera,
se sërish po vjen pranvera,
se liria s'vjen çdo ditë,
flake terrin del në dritë,
del në dritë e në liri,
mos duro më tirani,
sllavo-grekë, as dredhi,
zgjohu, ngritu Shqipëri!

Nëntor 2007

VI - SHTOJCË

Për shkak të aktualitetit dhe të rolit përforcues e sqarues të Çështjes Kombëtare Shqiptare, në përfundim të Librit, në formë të Shtojcës, po vendos disa artikuj dhe shkrime të plota e origjinale, marrë nga Libri:Shefki Ollomani - NË RRUGË DREJT LIRISË, "Shkupi", Shkup 2004.

AUTORI

SHQIPTARËT
DHE MALLKIMI I HISTORISË

I

Ne, shqiptarët, ende jemi shumë romantikë dhe ëndërrues të mëdhenj. Ende ushqehemi dhe jetojmë me mite, legjenda e balada, duke i stolisur dhe zbukuruar aq shumë ngjarjet reale historike, sa që i shndërrojmë ato në përralla, në ngjarje ireale!

Ne jemi mësuar vetëm që të lëvdohemi e të mburremi me historinë tonë të lashtë, duke e veshur atë me vello hyjnore! Ne nuk jemi mësuar që të kritikojmë historinë tonë. Autokritika për shqiptarin është diçka e pakapshme, e huaj!

Ne jemi mësuar që t'i zmadhojmë ngjarjet, veprimet dhe punët tona e të paraardhësve tanë deri në përmasa jashtëtokësore, jashtëlogjike. Ne jemi mësuar që të zezës t'i themi e bardhë dhe të bardhës e zezë!

Ne jemi mësuar që të vetëlëvdohemi. Ne s'jemi të sinqertë ndaj vetvetes, ndaj njëri-tjetrit dhe ndaj historisë sonë. Ne nuk jemi realistë në shpalimin e historisë sonë kombëtare. Ne jemi vetëmashtrues! Ne nuk ecim për toke, por për qielli!

Ne, shqiptarët, nuk kemi mësuar asgjë nga pësimet tona historike, sepse nuk jemi vetëkritikë, nuk i pranojmë të metat dhe gabimet tona! Ne jemi kokëfortë! Ne jemi idealistë të mëdhenj edhe në shekullin e shkencës dhe të

atomit, edhe atëherë kur duhet të jemi jo vetëm realistë, por superrealistë!

Ne na ka shkelur gjithmonë historia, sepse nuk kemi mësuar asgjë nga ajo, sepse nuk e kemi përfillur atë, sepse e kemi keqinterpretuar historinë! Ne nuk e çmojmë sa duhet njëri-tjetrin, prandaj, shpeshherë, na ka nënçmuar historia! Prandaj, **na ka mallkuar historia!**

II

Thonë se historia është gjykatësja më precize e ngjarjeve, e veprimtarisë së individëve dhe e luftës së popujve. Thonë se historia është e pamëshirshme, rigoroze, shumë e rreptë, por edhe parimore dhe e drejtë.

Thonë, gjithashtu, se historia nuk të fal, ajo të dënon ashpër. Por, siç duket, ne shqiptarëve historia jo vetëm që na ka dënuar rëndë, por edhe na ka mallkuar! Dhe, përderisa çdo lloj dënimi e ka njëfarë afati, mallkimi i historisë qenka më i rëndi, më i tmerrshmi, më afatgjati dhe më katastrofali!

Mallkimi i historisë nuk paska afat as shekujt, as mijëvjeçarët! Kaluan shekuj, kaluan më se dymijë vjet që kur kombin dhe atdheun tonë e ndjek pas mallkimi i historisë! Kaluan dymijë vjet që kur atdheu ynë është i robëruar dhe i copëtuar!

Dhe, s'dihet cili është më jetëgjatë, mallkimi i historisë apo kombi ynë? Të dy kanë moshën e mijëvjeçarëve. S'dihet cili është i përjetshëm: mallkimi i historisë apo kombi ynë? Apo janë të dy të pavdekshëm?! Apo, megjithatë, mallkimi i historisë është i vdekshëm? Vdekja e mallkimit të historisë varet nga uniteti dhe lufta e kombit tonë.

III

Që jemi popull i mallkuar, kjo po shihet nga gjendja jonë politike dhe ekonomike, nga gjendja jonë e pushtuar, e robëruar, e copëtuar dhe e varfër. Kjo po shihet nga lufta jonë politike e brendshme që po zhvillojmë njëri me tjetrin: individi me individ, grupi me

grup, organizata me organizatë, partia me parti dhe krahina me krahinë!

Që jemi popull i mallkuar, kjo po shihet, por vallë, kush na mallkoi dhe pëse na mallkoi?! Na mallkuan të huajtë apo mallkuam vetëveten?! Na mallkuan "perënditë" e tokës apo të qiellit?! Na mallkuan "perënditë" e huaja judo-romake, ortodokso-bizantine e turko-arabe, apo na mallkuan perënditë pellazgo-ilire që i braktisëm?! Mos na mallkoi Nëna e Kombit: nëna iliriane, nëna arbëreshe apo nëna shqiptare, të cilës nuk ia çuam në vend amanetin?! Apo na mallkoi historia?

IV

Pse na mallkoi historia?

Sepse Ilirët s'u bënë kurrë popull, por mbetën fise! Sepse Ilirët s'formuan një shtet, një perandori të vetme, por formuan disa shtete! Sepse Ilirët dhe shtetet e tyre s'qenë në unitet luftarak përballë pushtuesëve të Perëndimit dhe të Lindjes! Sepse Dhmitër Fari tradhëtoi Teutën! Sepse Batoja tradhëtonte Baton! Sepse shteti ilir lidhte aleancë ushtarake me shtetin armik për të luftuar shtetin tjetër ilir! Sepse ilirët s'deshnin të bëhen gjeneralë e perandorë të Ilirisë, por bëheshin gjeneralë gjakatarë dhe perandorë katilë të Romës dhe Bizantit!

Pse na mallkoi historia?

Sepse Ilirët kurrë nuk u ngritën të tërë në kryengritje antiromake, por fis pas fisi! Sepse kur Ilirët e veriut u ngritën në kryengritje në vitin 156 p.e.s., fiset tjera ilire bënin sehir! Sepse fiset ilire zgjoheshin vonë, ngriteshin njëri pas tjetrit në kryengritje antiromake dhe asnjëherë përnjëherësh dhe të bashkuar!

Pse na mallkoi historia?

Sepse ardianëve dhe pleuratëve u dilte gjumi i robërisë romake në vitin 135 p.e.s. dhe ashtu të përgjumur shpërthenin në kryengritje! Sepse dalmatëve u

dilte gjumi në vitin 78 p.e.s.! Sepse pirustët zgjoheshin nga gjumi i robërisë në vitin 54 p.e.s.! Sepse panonët zgjoheshin në vitin 16 p.e.s. dhe në vitin 12 p.e.s.! Sepse dalmatët zgjoheshin përsëri në vitin 12 p.e.s., por pasi ishin kënaqur duke fjetur plot 66 vjet dhe pasi ishin kënaqur duke soditur se si gjakosen fiset tjera ilire, vëllezërit e tyre të nënës, të gjakut e të gjuhës! Sepse disa fise ilire nuk u zgjuan kurrë nga gjumi i robërisë romake, bizantine e sllave derisa u asimiluan! Sepse edhe atëherë kur u doli gjumi përnjëherësh shumicës së fiseve ilire dhe shpërthyen kryengritjen e viteve 6-9 të erës sonë, ngriti krye tradhëtia, iliri tradhëtoi ilirin, kurse luftën e fitoi ushtria romake!

V

Pse na mallkoi historia?

Sepse Arbëreshët ishin pasardhësit e Ilirëve! Sepse Arbëreshët, porsi Ilirët, nuk donin të kenë vetëm një Arbëri të përbashkët, të bashkuar, por donin shumë principata arbërore! Sepse Arbëreshët mezi pritën që të tërhiqet perandoria romake nga Iliriku, që të jenë të lirë për të luftuar në mes veti për principatat e tyre: për ara e livadhe, për male e kodrina, për burime e bashtina,...! Sepse kapedanët arbëreshë nuk luftonin për liri, por për pasuri! Sepse në çdo majë mali e kodre, në çdo qytet e fshat delte nga një kapedan dhe pasi rrethonte me gardh prej thuprave të shelgut një copë toke të plaçkitur e të tharë nga armiqtë pushtues, duke rrahur gjoks, bërtiste: "Unë jam prijësi, kjo është Arbëria"!

Dhe kështu, kapedan pas kapedani e princ pas princi shtoheshin principatat arbërore, shtoheshin "Arbëritë", kurse Arbëria s'formohej kurrë, Arbëria nuk çlirohej kurrë!

Ngritej pastaj mbi gërmadhat e perandorisë romake perandoria bizantine dhe i shembëte përtokë, me një goditje shkelmi, gardhiqet e shelgut që rrethonin principatat familjare të princërve të vetëshpallur arbërorë!

Binin princërit nga froni, por nuk shuhej ambicia e tyre për ringjalljen, jo të Arbërisë, por të principatave të tyre familjare! Disa princër vriteshin me shpatë në dorë, disa merrnin në sy botën, disa arratiseshin maleve, disa të tjerë shndërroheshin në vazalë, në mercenarë e shërbëtorë të pushtuesëve për një gradë!

Pse na mallkoi historia?

Sepse pa u tharë ende në letër vula e Besëlidhjes së Lezhës, Nikollë e Pal Dukagjini ia kthyen shpinën Gjergj Kastriotit - Skënderbeut! Sepse Mojsi Golemi, nga lakmia e zilia, tradhëtonte Skënderbeun dhe në krye të ushtrisë osmane sulmonte Arbërinë, popullin e vet dhe ushtrinë arbërore të Gjergj Kastriotit! Sepse Hamza Kastrioti, nga lakmia e xhelozia, tradhëtonte xhaxhain e vet dhe arratisej e kthehej në ballë të ushtrisë armike për të nënshtruar Arbërinë, për të mposhtur Gjergjin!

Pse na mallkoi historia?

Sepse princërit arbëreshë s'ishin fare në unitet politik e as luftarak në luftë të përbashkët kundër robërisë osmane! Ata luftonin, hapur e prapa shpine, njëri-tjetrin! Ata luftonin për zgjerimin e principatave të tyre, jo për çlirimin e Arbërisë!

Principata arbëreshe luftonte kundër principatës tjetër arbëreshe, duke lidhur aleancë herë me Venedik e herë me Turqi, herë me mikun e herë me armikun, për interesa të ngushta të princërve feudalë! Aleancë e vazalitet me armikun për të luftuar vëllaun, për të nënshtruar principatën tjetër arbërore!

Skënderbeu luftoi për një çerek shekulli rresht për të çliruar Arbërinë, por s'e çliroi dot! Ai mundi vetëm të çlirojë dhe të zgjerojë pak principatën e Kastriotëve, përafërsisht Shqipërinë e sotme të Mesme! Skënderbeu nuk mundi ta çlironte e ta bashkonte Arbërinë, sepse Arbëria ishte dy herë e pushtuar dhe dy herë e copëtuar: prej perandorisë osmane dhe prej kapedanëve e princërve arbërorë! Ushtritë osmane Skënderbeu i theu dhe i

shpartalloi me dhjetëra herë, por princërit dhe principatat arbërore nuk mundi t'i bashkojë dot! Ata nuk e donin unitetin, nuk e donin bashkimin, nuk e donin çlirimin! Ata nuk e donin Arbërinë e bashkuar, të lirë e sovrane! Ata e donin Arbërinë e copëtuar në disa principata të robëruara e vazale të Turqisë, me të vetmin kusht, që ata të ishin princër të atyre principatave! "Princër" nën bajrakun e Turqisë!

Dhe kështu, luhej vallja e moçme iliriane në truallin e Arbërisë: princër e principata në dyluftim dhe në armiqësi të përhershme me njëra-tjetrën!

VI

Pse na mallkoi historia?

Sepse princërit egoistë e ziliqarë arbëreshë nuk e përkrahën ushtarakisht Skënderbeun! Sepse Lekë Dukagjinit vonë i ra ndër mend që të shkulë leshrat e tij për vdekjen e Gjergj Kastriotit! Sepse edhe pas vdekjes së Skënderbeut princërit dhe principatat arbërore nuk u bashkuan kurrë në luftë të përbashkët kundër pushtuesëve osmanllinj!

Sepse princërit dhe kapedanët arbëreshë i trashëguan bajraktarët dhe pashallarët shqiptarë! Sepse principatat arbërore i trashëguan pashallëqet shqiptare! Dhe lufta e brendshme për pushtet, dominim e pasuri në mes të bajraktarëve, pashallarëve dhe pashallëqeve shqiptare vazhdoi! Vazhdoi copëtimi i Shqipërisë! Vazhdoi avazi i vjetër i shqiptarëve, vazhdoi edhe robëria e Shqipërisë!

Pse na mallkoi historia?

Sepse Pashallëku i Shkodrës nuk i ndihmonte Pashallëkut të Janinës! Sepse Ali Pashë Tepelena luftonte kundër Sulit! Sepse Pashallëku i Janinës luftonte kundër Pashallëkut të Shkodrës, të Vlorës, të Beratit, të Delvinës, të Elbasanit, të Kavajës,...! Sepse pashallëqet e pashallarët shqiptarë luftonin kundër njëri-tjetrit! Sepse nuk bashkoheshin pashallarët dhe pashallëqet shqiptare!

Sepse së pari luftonin për vete, pastaj, shumë pak, për Shqipëri! Dhe s'fitonin as pashallarët, as Shqipëria! Dhe fitonte armiku, vazhdonte robëria!

VII
Pse na mallkoi historia?

Sepse Shqiptarët kurrë nuk u ngritën në luftë çlirimtare si një popull i bashkuar dhe nën një komandë të vetme ushtarake! Sepse shqiptarët luftonin me rend: posa shuhej në gjak një kryengritje në Veri të Shqipërisë, shpërthente tjetra pas disa muajsh apo vitesh në Jug! Sa shuhej një kryengritje në Kosovë, kërciste tjetra në Shqipërinë e Mesme! Shuhej një kryengritje shqiptare në Karadak, shpërthente pas një kohe tjetra në Pollog! Sa shuhej një kryengritje antiturke në pranverë, shpërthente tjetra në vjeshtë, por në krahina të ndryshme të Shqipërisë!

Sikur bënin gara bajraku me bajrak e krahina me krahinë se cila po ngritet më shpesh në kryengritje, se cila po e mban më gjatë frontin e luftës! Sikur po bënin luftë se cili është më shqiptar se shqiptari, por shumë pak e shumë rrallë u shkonte ndërmend se si t'i bashkojnë armët dhe forcat luftarake për çlirimin jo të një fshati apo krahine, por për çlirimin dhe bashkimin e gjithë Shqipërisë!

Kur luftonte një pjesë e Shqipërisë, tjetra bënte sehir! Gjakosej e digjej një krahinë shqiptare, tjetra shikonte nga maja e malit tymin dhe flakën mbi shtëpitë e kasollet e krahinës fqinje dhe s'lëvizte dot nga vendi! Kur më vonë digjej krahina fqinje që kishte bërë sehir, krahina e djegur kohë më parë, jo vetëm që nuk i ndihmonte, por s'kish kohë e forcë nga plagët e marra armike, as që të bëjë sehir se si po digjet krahina fqinje!

Dhe kështu rradhiteshin shekujt e robërisë shqiptare: kryengritje pas kryengritjeje krahinore, djegëje pas djegëjeje, gjakosje pas gjakosjeje, sehir pas sehiri..., por kurrë bashkim, kurrë çlirim, kurrë liri!

VIII

Pse na mallkoi historia?

Sepse shqiptari mbeti shqiptar kapedan e princ, shqiptar bajraktar e pashá, shqiptar egoist e karrierist, shqiptar mendjemadh e lokalist, shqiptar mercenar e tradhëtar!

Sepse Abdullah Pashë Dreni tradhtoi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit! Sepse kryengritësit shqiptarë të Kosovës nuk e dëgjonin Hasan Prishtinën! Sepse shqiptarët nuk e donin sulltan Reshatin, por e donin sulltan Hamitin (Nuk zgjedhnin Pavarësinë, por në mes dy sulltan¨ve)! Sepse shqiptarët nuk luftonin për pavarësi, por për autonomi! Sepse Ismail Qemali zbriti në Durrës kur ¾ e Shqipërisë ishte e pushtuar nga greko-sllavët! Sepse pavarësia e Shqipërisë u shpallë në Vlorën e lirë, por në Shqipërinë e pushtuar! Sepse Esat Pashë Toptani ishte kundër Ismail Qemalit! Sepse Shqipëria e copëtuar i kishte dy qeveri: njërën në Vlorë e tjetrën në Durrës! Sepse Shqipërisë nuk i pëlqenin dy qeveritë dhe qeveritarët e saj dhe thërriste gjermanin princ Wid! Sepse shqiptari, ndër shekuj, nuk ishte mësuar që ta qeverisë dhe komandojë shqiptari, por i huaji!

IX

Pse na mallkoi historia?

Sepse shqiptarët toleruan që armiqtë turko-sllavë t'a dëbojnë Ymer Prizrenin, që ta burgosin Abdyl Frashërin, që ta varin Sulejman Vokshin, që ta vrasin në pabesi Dedë Gjon Lulin e Mehmet Shpendin, që ta vrasin me tradhti Ramadan Zaskocin e Haxhi Zekën, Çerçiz Topullin e Isa Boletinin!

Sepse shqiptarët lejuan që të bëhet mbret një analfabet, një rezil e katil si Ahmet Zogolli! Sepse shqiptarët toleruan që i vetëshpalluri "mbreti" Zog të vrasë Luigj Gurakuqin, Bajram Currin, Avni Rrustemin e Hasan Prishtinën!

Sepse shqiptarët e bënë revolucionin demokratik të Qershorit'24 dhe po "shqiptarët" e prishën atë! Sepse

reaksionarët zogistë luftonin kundër demokratëve fanolistë! Sepse Ahmet Zogu bashkëpunoi me serbomëdhenjtë! Sepse Fan Noli nuk e dëgjoi Bajram Currin!

X

Pse na mallkoi historia?

Sepse mbreti Zog u "bë zog e fluturoi", plaçkiti Shqipërinë dhe ia la të çarmatosur ushtrisë fashiste musoliniane! Sepse Balli Kombëtar nuk luftoi kundër fashizmit! Sepse Balli Kombëtar dhe Fronti Nacionalçlirimtar nuk u pajtuan e nuk u bashkuan në luftë të përbashkët antifashiste! Sepse shqiptarët partizanë dhe shqiptarët ballisto-zogistë luftuan kundër njëri-tjetrit! Sepse shqiptarët e Shqipërisë nuk u bashkuan me partizanët e Kosovës! Sepse Shqipëria dhe Kosova e bënë luftën antifashiste ndaras! Sepse partizanët shqiptarë iu besuan tepër partizanëve jugosllavë! Sepse komunistët shqiptarë më shumë ishin internacionalistë se sa nacionalistë! Sepse ideologjia internacionaliste në Shqipëri dominoi mbi ideologjinë kombëtare! Sepse ideologjia komuniste e hodhi Shqipërinë në prehrin dhe kthetrat e armiqve shekullorë të saj!

XI

Pse na mallkoi historia?

Sepse bijtë e Shqipërisë u bënë perandorë e gjeneralë të Perandorisë Romake e Bizantine, por asgjë të mirë nuk i dërguan nënës së tyre – Ilirisë, përveç ekspeditave gjakatare të legjioneve ushtarake romako-bizantine!

Sepse bijtë e Shqipërisë u bënë pashallarë, sadrazemë e vezirë të Perandorisë Osmane, por përveç ekspeditave ndëshkuese ushtarake, asgjë tjetër nuk i dërguan nënës së tyre të robëruar – Shqipërisë!

Sepse bijtë e shquar të Shqipërisë nuk ishin të gjithë patriotë, por shumë prej tyre ishin plangprishës e

egoistë, të cilët punuan për armiqtë dhe pushtuesit e Shqipërisë!

Pse na mallkoi historia?

Sepse Shqipëria lufton për ekonomi, Kosova për pavarësi, Maqedonia shqiptare – Ilirida për autonomi, kurse shqiptarët nën Serbi – Kosova Lindore dhe ato në Mal të Zi – Malësia e Madhe luftojnë për ekzistencë kombëtare! Sepse shqiptarët ende i kanë shumë princër e principata, shumë bajraktarë e bajraqe, shumë pashallarë e pashallëqe!

Pse na mallkoi historia?

Sepse shqiptarët e humbën Shqipërinë ilirike! Sepse shqiptarët s'e bashkojnë Shqipërinë etnike! Sepse shqiptarët mohojnë Çamërinë! Sepse shqiptarët po e humbin Iliridën! Sepse shqiptarët po e mohojnë Kosovën Lindore! Sepse shqiptarët nuk e kujtojnë Malsinë e Madhe! Sepse është e përçarë Shqipëria londineze! Sepse kur greko-sllavët hartojnë hapur plane për copëtimin e Shqipërisë, shqiptarët kryqëzojnë duartë e thonë: "bëhe zot ëndërr"!

Pse na mallkoi historia?

Sepse shqiptarët kanë shumë armiq dhe tepër pak miq! Sepse shqiptarët ishin tepër internacionalistë dhe luftonin e vriteshin për lirinë e shteteve fqinjë! Sepse shqiptarët janë përsëritës të pakorrigjueshëm të gabimeve të mëdha historike të paraardhësve të tyre!

XII

Pse na mallkoi historia?

Sepse shqiptari që në kohë të moçme e kish dhe i mbeti në gjak tradhëtia, zilia, lakmia, egoizmi, karrierizmi, mendjemadhësia, bajraktarizmi, lokalizmi,...! Sepse shqiptari edhe sot lufton i ndarë, i copëtuar dhe i përçarë! Sepse shqiptari ende e tradhton shqiptarin! Sepse

shqiptari ende e lufton shqiptarin! Sepse ndër shqiptarë ende është më e fortë ndjenja e karrierizmit se ndjenja e atdhetarizmit! Sepse shqiptarët ende nuk luftojnë për Shqipëri, por për kolltuqe e principata moderrne!

Pse na mallkoi historia!

Sepse ende s'janë zhdukur esatë toptanët e zogollianët! Sepse ende s'janë ngritur në këmbë avni rrustemët! Sepse bota ka arritur deri në Hënë, kurse shqiptarët ende falin e s'falin gjaqet! Sepse shqiptarëve u mungon urtësia, guximi, dhe forca! Sepse shqiptarët ende nuk e meritojnë bashkimin kombëtar, sovranitetin dhe lirinë!

Pse na mallkoi historia?

Sepse shqiptari nuk ka fé shqiptarinë! Sepse shqiptarët as nuk kanë qenë as nuk janë në unitet e pajtim kombëtar! Sepse shqiptari është gjumash i madh dhe i del gjumi kur bëhet tepër vonë! Sepse shqiptari është mburravec, është i fjalëve të mëdha e i punëve të vogla! Sepse patrioti nuk është patriot, demokrati nuk është demokrat dhe revolucionari nuk është revolucionar! Sepse shqiptari së pari duhet të luftojë me "shqiptarin", pastaj me armiqtë pushtuesë! Sepse shqiptari është romantik e jo realistë! Sepse shqiptari është anarkist e nihilist! Sepse shqiptari është besnik ndaj të huajve dhe i pabesë ndak shqiptarit! Sepse shqiptari e ka braktisur Besën Shqiptare! Sepse Besa e Burrëria për shqiptarin sot nuk kanë vlerë, ai ato i ka shndërruar në relike muzeale dhe jo në frymëzim për veprim!

Pse na mallkoi historia?

Sepse shqiptari mbeti "shqiptar", prandaj edhe Shqipëria mbeti "Shqipëri"! Sepse Shqipëria ndahej e copëtohej pandërprerje, epokë pas epoke: nga shtetet ilire në principatat arbërore, nga pashallëqet shqiptare në vilajetet turke dhe nga vilajetet turke në banovinat, obllastet dhe pokrajinat sllave!

Ndarje zinxhirë, por kurrë bashkim! Mallkim, mallkim dhe prapë mallkim! Përçarje, përçarje dhe vetëm përçarje! Robëri, robëri dhe përsëri robëri!

Pse na mallkoi historia?

Pse? Pse? Pse?… Sepse! Sepse! Sepse!…
Pse, pse na ndoqi fati i zi në vazhdimësi, nëpër histori, në pafundësi?!
O Zot! O djall! O shqiptar! A ka fund?!

Mallkim, mallkim dhe prapë mallkim!
Përçarje, përçarje dhe vetëm përçarje!
Robëri, robëri dhe përsëri robëri!

Mallkim, përçarje dhe robëri deri në përjetësi, apo derisa shqiptarët të mbushen mend dhe mallkimin ta kthejnë në bekim, përçarjen në pajtim e bashkim dhe robërinë në çlirim?

Shkruar në Janar 1992,
Botuar në:
-KUSHTRIMI I LIRISË,
organ i Organizatës Revolucionare Shqiptare (ORSH),
Viti II i botimit, Nr.1, Janar 1992, Mërgim.
-KOSOVA SOT, gazetë ditore e Prishtinës, Gusht 2002.
-GLOBI, revistë e pavarur, Nr.36, Shtator 2002, Shkup.
-RIBASHKIMI I SHQIPËRISË, organ i Frontit për Bashkim Kombëtar Shqiptar (FBKSH), Nr.1, Nëntor 2002, Tiranë.

ÇKA I NDAN DHE ÇKA I BASHKON SHQIPTARËT?

HYRJE

Shqiptarët, si çdo popull tjetër i botës, i kanë të mirat dhe të këqiat e tyre. Ata posedojnë vese pozitive dhe negative. Kanë baticat dhe zbaticat e tyre historike dhe të përditëshme. Kanë plotë vyrtyte njerëzore dhe përplotë të meta e veprime çnjerëzore.

Shqiptarët janë edhe në unitet edhe në luftë me njëri-tjetrin. Ata janë edhe të ndarë edhe të bashkuar. Edhe te shqiptarët e mbi ta vepron pandërprerje ligji dialektik natyror me emrin – **ligji i luftës dhe i unitetit të të kundërtave.** Ky ligj nënkupton se shqiptarët, si komb, nuk janë vetëm të ndarë, të përçarë dhe të armiqësuar mesveti, por ata, në të njëjtën kohë, janë edhe të bashkuar, të miqësuar e të solidarizuar mesveti. Kjo do të thotë se nuk ka ndarje absolute, por as bashkim absolut.

Fenomenet dhe marrëdhëniet ndërnjerëzore e ndërshqiptare nuk zhvillohen në rrafshin dyngjyrësh: bardhë e zi, por ato zhvillohen në një rrafsh kolorit shumëngjyrësh dhe shumëdimensional. Ngjarjet dhe veprimet nuk zhvillohen në hava, por në kohë dhe hapësirë të caktuar e konkrete. Kjo do të thotë se çka është sot e bardhë, nesër bëhet e zezë; çka është sot e drejtë, nesër shndërrohet në të padrejtë; nëse para 20 apo 30 vitesh një veprim ka qenë i arsyeshëm, sot del se ai veprim ka qenë i gabueshëm, ose anasjelltas: qëndrimi dhe vendimi që është vlerësuar gabim para disa vitesh apo dekadash, sot koha dhe rrokullisja e ngjarjeve tregojnë se ai qëndrim apo vendim (qoftë individual apo kolektiv) ka qenë i drejtë. Kjo do të thotë se gjithçka është relative. E drejta dhe e padrejta, e mira dhe e keqja, e vërteta dhe gënjeshtra,..., ecin paralel, janë të pandashme dhe bashkudhëtare të përjetëshme – por gjithmonë në kohë dhe hapsirë të caktuar, konkrete dhe objektive.

Nga ligji natyror dhe shoqëror i **luftës dhe i unitetit të të kundërtave,** ne shumë lehtë dhe qartë mund të nxjerrim përfundimin se: kombi shqiptar nuk është dhe aq i ndarë e i përçarë mesveti, sa që duket apo shkruhet disa herë (përjashtuar këtu ndarjen e tij me kufinj). Dhe në të njëjtën kohë ai nuk është dhe aq i bashkuar, siç mund të flitet e të shkruhet disa herë.

Shqiptarët nuk bëjnë pjesë në asnjërin ekstremitet. Ata qëndrojnë diku në mes të të dy ekstremiteteve. Shqiptarët janë të ndarë, por në të njëjtën kohë ata janë edhe të bashkuar. Shqiptarët janë popull dhe njerëz, si të gjithë popujt e tjerë të botës, ata nuk bëjnë përjashtim e dallim nga asgjë që është natyrore, normale dhe njerëzore.

I - ÇKA I NDAN SHQIPTARËT?

1. Ideologjitë

Në çdo popull ekzistojnë dhe veprojnë ideologjitë. Këtu nuk bën përjashtim as populli ynë. Njeriu, si qenie inteligjente: me logjikë, vetëdije dhe ndërgjegje, gjatë gjithë historisë së tij të lashtë, ka krijuar dhe zhvilluar lloj-lloj ideologjishë. Prandaj, nuk ka individ pa ideologji. Nga gjithë krijesat e gjalla të kësaj planete, vetëm njerëzit posedojnë ideologji.

Ideologjitë janë të shumëllojshme. Meqenëse njerëzit nuk janë identikë, por çdo individ është qenie unike, atëherë kuptohet që të gjithë njerëzit nuk mund të kenë një ideologji. As edhe një popull nuk mund të ketë vetëm një ideologji. Ekziston pluralizmi i ideve, i mendimeve, i pikëpamjeve, i qëndrimeve dhe pluralizmi i ideologjive. Shqiptarët nuk munden dhe nuk bëjnë përjashtim nga ekzistimi i pluralizmit të ideve dhe ideologjive. Rreshtimi i shqiptarëve në disa ideologji nuk është tragjedi, por një fenomen i natyrshëm, nga i cili nuk mund të shmanget. Pretendimi dhe tendenca për dominim vetëm të një ideologjie mbi të tjerat do të na çonte në një luftë civile, në vëllavrasje dhe në diktaturë. "Dëmet" që shkaktojnë ideologjitë (por jo vetëm ato) janë: fërkimet

politike, polemikat e ashpëra, ofendimet reciproke, gara e egër për pushtet, lufta klasore (të pasur-të varfër),...etj., por këto veprime brenda shoqërisë shqiptare duhet të zhvillohen në kohë paqeje, në një shtet të bashkuar shqiptar, ku dominon ligji dhe ku është vendosur sistemi i pluralizmit politik dhe demokracia e vërtetë. Lufta ideologjike ndërmjet shqiptarëve (individi me individ, grupi me grup apo partia me parti) në kohë lufte e pushtimi, në kohë kolonizimi e copëtimi të trojeve të tyre etnike – është një tragjedi, një katastrofë dhe një vetëvrasje kombëtare! Shqiptarëve të Shqipërisë Etnike, aktualisht, nuk u duhen ideologjitë politike. E vetmja ideologji e tyre është dhe duhet të jetë ideologjia kombëtare e çlirimit dhe e ribashkimit të Shqipërisë Etnike. Ideologjia mbi ideologjitë, që sot duhet të dominojë e të rrënjoset thellë në mendjet dhe në zemrat e shqiptarëve është: **Një komb – Një shtet = Shqipëria e Ribashkuar Etnike.** Vetëm pas ribashkimit kombëtar dhe ndërtimit të Shqipërisë Etnike, shqiptarët do të kenë të drejtë të thirren në ideologji individuale, grupore apo partiake, duke rrespektuar rregullat e lojës politike, të konkurencës së lirë dhe ligjet demokratike në fuqi.

2. Karrierizmi

Shqiptarët i ndan edhe karrierizmi. Persona e politikanë të caktuar janë aq egoistë e të pangopur me pushtet, sa që ata janë në gjendje që ta dëmtojnë shoqërinë dhe çështjen kombëtare shqiptare, për hirë të ruajtjes së privilegjeve të tyre dhe pozitës politike apo shtetërore. Karrierizmi dhe egoizmi i tepruar çon shpesh në kriminalitet, korrupsion dhe tradhëti ndaj interesave të përgjithshme shoqërore dhe kombëtare. Prandaj, karrierizmi dhe karrieristët egoistë duhet të largohen sa më shpesh dhe sa më shpejtë nga pozitat e tyre udhëheqëse, para se ata të shkaktojnë dëme të paripareshme për shoqërinë dhe çështjen tonë kombëtare.

3. Mostoleranca, inati, urrejtja,...

Ne, shqiptarëve, na ndan edhe mostoleranca, inati, kokëfortësia, sedra e sëmurë, urrejtja ndaj njëri-tjetrit, etj. Ne, nga natyra, jemi pak si shumë temperamentë dhe nervozë. Nxehemi e hidhërohemi shpejtë, por ftohemi dhe pajtohemi shumë ngadalë. Jemi inatçorë të mëdhenj. S'jemi tolerantë ndaj njëri-tjetrit dhe ngulim këmbë si mushkë xinxare edhe atëherë kur nuk e kemi drejt, edhe atëherë kur argumentet dhe faktet e gjalla jo vetëm që flasin, por edhe çirren e bërtasin. Por, si inatçorë që jemi, as shohim dhe as dëgjojmë! S'jemi sa duhet zemërgjerë që të falim gabimet e të tjerëve. Edhe faljen disa herë e bëjmë të përkohëshme, të pjesëshme dhe me gjysëmzemre. Duam të ecim përpara me botën e civilizuar perëndimore, por kokën gjithmonë e kthejmë prapa, duke u marrë me të kaluarën, qofshin ato edhe gjëra të tejkaluara e të vdekura. Nuk jemi të sinqertë me njëri-tjetrin dhe nuk mësojmë sa duhet nga gabimet tona. Mbi të gjitha jemi naivë e mendjelehtë, sa që për gjëra shumë të vogla jemi në gjendje që ta luftojmë me tërbim dhe me një urrejtje organike njëri-tjetrin, apo partia-partinë! Urrejtja organike politike dhe personale është sot një realitet i hidhur dhe i prekshëm që dominon skenën politike mbi dhjetëvjeçare në Shqipëri, Kosovë dhe Iliridë. Lufta dhe urrejtja organike midis partive politike dhe liderëve partiakë shqiptarë, janë shkaku kryesor pse sot shqiptarët si komb janë aq të përçarë, aq të varfër dhe aq të ndarë! Deviza: **Opozitarë, por vëllezër!,** duhet të jetë e shenjtë për çdo politikan shqiptar.

4. Lokalizmi dhe krahinarizmi

Kjo është plaga më e madhe, më e përgjakur dhe më vdekjeprurëse e kombit shqiptar! Pra, ndarja lokaliste, bajraktariste, fisnore, klanore dhe krahinore e shqiptarëve ndër shekuj dhe mijëvjeçarë. Këtë plagë e kemi trashëgim (mjerisht) që nga paraardhësit tanë antikë pellazgo-ilirët.

Kjo ndarje dhe përçarje, kjo plagë mijëravjerçare, ende kullon gjak, ende s'është mbyllur, ende s'është

shëruar! Fatkeqësisht, përkundrazi, ende po gangrenoset edhe në fillim të shekullit të ri të mileniumit të tretë të erës sonë! Dhe nga kush se? Nga vetë shqiptarët lokalistë, karrieristë, bajraktarë e fisnorë! Nga ata që vetes i thonë liderë, kryetarë partishë dhe kryetarë shtetesh të pashpallura e të leckosura! Dhe kjo ndodhë gjithmonë nën sllloganin: "Më mirë i pari në fshat, se i dyti apo i treti në qytet"!

Lokalizmi krahinor dhe bajraktarizmi fisnor kanë bërë që të parcializohet çështja kombëtare shqiptare. Kanë bërë që ajo, nga një çështje kardinale e jetësore e shtruar për zgjidhje para kombit tonë dhe faktorëve relevantë ndërkombëtarë, të shndërrohet në një çështje autonomiste dhe e të drejtave të njeriut. Lokalizmi krahinor dhe bajraktarizmi fisnor i liderëve shqiptarë dhe partive të tyre politike, e kanë transformuar çështjen kombëtare shqiptare – Shqipërinë Etnike, nga një çështje madhore për dekolonizim, çlirim dhe ribashkim kombëtar, në një neokolonizim dhe ricopëtim të Shqipërisë Etnike!

Po të pranojmë, kushtimisht (qoftë edhe për një moment), se ja: u krijua shteti i pavarur i Kosovës, u krijua edhe shteti i Iliridës, u krijua dhe shteti i Çamërisë, bile u krijua edhe shteti i Malësisë së Madhe. Ç'do të ndodhë atëherë? Me siguri do të ndodhë ajo që ka ndodhur dhe ndodhë me shtetet sllave, të cilat janë në luftë dhe armiqësi të përhershme me njëri-tjetrin.

Shembëll i freskët është lufta e fundit serbo-kroate, kroato-boshnjake dhe serbo-boshnjake. Të gjithë këto popuj e shtete janë me etnogjenezë të përbashkët sllave, me gjak e gjuhë të përbashkët, por me religjione, me emra dhe me flamuj të ndryshëm dhe të ndarë nga kufinj shtetërorë. Edhe shqiptarët janë me tre religjione dhe po tu ndryshohet flamuri dhe emri kombëtar, dhe po të ndahen në shtete me kufinj ndërshqiptar, atëherë e përbashkët do tu mbetet vetëm gjuha, por edhe ajo do të largohet dita-ditës në disa dialekte zyrtare. Kështu, nga 7 milionë shqiptarët do të formoheshin kombe dhe shtete të reja, të cilat përveç gjuhës, të përbashkët do të kishin

edhe grindjet e vazhdueshme ndërshtetrore dhe përpjekjet reciproke për dominim. Ne nuk jemi komb i madh si sllavët apo arabët, që të ndahemi e të krijojmë disa shtete "shqiptare". Çfarë shanse për bashkim do të kishin shtetet dhe popujt që veten nuk do ta quanin më **Shqipëri** dhe **shqiptarë,** por do ta quanin Kosovë e kosovarë (veç kanë filluar me të madhe liderët e disa partive politike të Kosovës që veten dhe popullin ta quajnë jo shqiptarë, por kosovarë!), Iliridë e iliridas, Çamëri e çamë, Malësi e Madhe e malësorë? Dhe, pastaj, do të kishin flamujt e ndryshëm shtetërorë nga njëri-tjetri (LDK-ja veç e ka qepur flamurin e shtetit të ardhshëm të Kosovës, i cili dallon nga Flamuri Kombëtar Shqiptar!), do të kishin religjione të ndryshme zyrtare, nivele të ndryshme të zhvillimit demokratik dhe ekonomik, kulturor dhe arsimor!

Një bashkim shtetesh shqiptare do të ishte i pamundur. Ndryshe është kur të ndajnë me dhunë të huajtë dhe ndryshe është kur ndahesh vetë vullnetarisht. Prandaj, shqiptarët duhet ta luftojnë lokalizmin krahinor dhe bajraktarizmin fisnor. Duhet ta kundërshtojnë politikën parcialiste që zhvillojnë disa parti në Shqipëri, në Kosovë, në Iliridë dhe në Malësinë e Madhe. Sepse politika parcialiste është politikë ndarëse, përçarëse dhe thellësisht antikombëtare e antishqiptare. Shqiptarët duhet të bashkohen dhe të luftojnë për çlirimin dhe ribashkimin e Shqipërisë Etnike. Të gjitha politikat dhe teoritë tjera çojnë në ripushtim, rikolonizim, ricopëtim dhe rindarje të trojeve etnike shqiptare.

II - ÇKA I BASHKON SHQIPTARËT?

1. Gjaku dhe gjuha

Shqiptarët i ndajnë shumë gjëra, por mbi të gjitha ata i bashkon gjaku dhe gjuha e tyre. I bashkon etnogjeneza e tyre e përbashkët. I bashkon trungu i fortë antik pellazgo-ilir. I bashkojnë gjenet e njëjta dhe formimi i tyre psiqik e shpirtëror, që e ka burimin nga parahistoria

njerëzore. I bashkon besa dhe burrëria shqiptare. I bashkon arti dhe kultura e njëjtë. I bashkon gjuha e unifikuar letrare shqipe dhe alfabeti i përbashkët latin. I bashkon Flamuri Kombëtar Shqiptar i Gjergj Kastriotit – Skënderbeut. I bashkon Hymni Kombëtar i Rilindjes sonë Kombëtare. I bashkon emri Shqipëri dhe Shqiptar. I bashkon kombi shqiptar. I bashkon atdheu i përbashkët – Shqipëria Etnike.

2. Besa dhe burrëria

Shqiptarët, përveç tjerash, i bashkon edhe Besa dhe Burrëria e tyre e fortë, unike dhe legjendare. Besa dhe burrëria e shquajnë kombin tonë nga kombet tjera. Ato janë karakteristikat dalluese të karakterit të shqiptarit, nga të cilat ndër shekuj e mijëvjeçarë ka rrezatuar vetëm besnikëri, çiltërsi, ardhedashuri, qëndresë dhe liri. Besa dhe burrëria shqiptare ende jetojnë në zemrat dhe në shpirtin e shqiptarëve, duke i fisnikëruar dhe bashkuar ata vazhdimisht, përballë çdo armiku e furtune.

3. Arti dhe kultura

Shqiptarët i bashkon edhe arti e kultura e tyre e lashtë dhe e re. Arti dhe kultura e tyre e zhvilluar, autentike dhe origjinale. Një art dhe kulturë e pastër, e qytetëruar e humaniste. E zhveshur nga çdo nacionalizëm, shovenizëm dhe racizëm. Një art dhe kulturë e fortë që çau mes për mes mijëvjeçarëve të pushtimeve të huaja dhe errësirës dekadente të mesjetës. Një art dhe kulturë që synon ardhmërinë më humane e paqësore të njerëzimit.

4. Atdheu – Shqipëria Etnike

Përveç gjakut e gjuhës, besës e burrërisë, artit e kulturës,..., shqiptarët mbi të gjitha i bashkon atdheu i tyre i shenjtë – **Shqipëria Etnike.** Shqiptari, që kur s'mbahet mend, ka pasur një nderim dhe dashuri hyjnore për tokën e tij, për atdheun e tij: Ilirinë – Arbërinë –

Shqipërinë. Iliro-shqiptari e ka dashur dhe e don perëndinë, jetën, kombin, lirinë, familjen, popujt tjerë, mirëqenien, gjuhën, artin, kulturën, arsimin,..., por, mbi të gjitha ai e ka dashur dhe e don tokën e tij - Atdheun, sepse pa tokë e atdhe, nuk ka as jetë, as komb, as liri,...Kur ka qenë në rrezik jeta e Atdheut, iliro-shqiptari kurrë nuk e ka kursyer jetën e tij, e ka dhënë atë në altarin e lirisë – në fushëbetejë, me këngë në gojë e armë në dorë, që të jetojë Atdheu. Deviza e tij luftarake dhe jetësore qe dhe mbeti: **Atdheu mbi të gjitha!** Prandaj, edhe dje, edhe sot, edhe nesër, brohoritja e shqiptarit ishte, është dhe do të jetë: **Shqipëria Etnike mbi të gjitha!**

.....

Shkruar në Gusht 2002,
Botuar në: -PASQYRA, revistë e pavarur,
Nr.66, 15 Shtator 2002, Prishtinë.
-GLOBI, revistë e pavarur, Nr.38, Dhjetor 2002, Shkup.
-RIBASHKIMI I SHQIPËRISË, organ i Frontit për Bashkim Kombëtar Shqiptar (FBKSH), Nr.2, Dhjetor 2002, Tiranë.

SHQIPTARËT – NGA ROBËRIA NË LIRI
DHE NGA ROBËRIA NË ROBËRI!
(KOMENT HISTORISË SONË POLITIKE)

I

Thonë e thuhet se ne, shqiptarët, jemi populli më i vjetër jo vetëm i Ballkanit dhe i Evropës, por edhe i botës. Thonë e shkruhet se Zanafillën e kemi nga Parahistoria njerëzore, kurse me origjinë jemi nga **Atlashtët** (Etërit e Lashtë) të Atlantidës, nga **Pellazgët** e Pellazgjisë, nga **Ilirët** e Ilirisë, nga **Arëbërit** e Arbërisë dhe deri te **Shqiptarët** e Shqipërisë. Kështu, populli ynë si zinxhirë i drejtë e i çelikt, ka çarë muzgjet e historisë njerëzore, duke ndërruar, kohë pas kohe, emrin e tij e të atdheut të tij, por kurrë nuk e ndryshoi gjakun, gjuhën, kulturën dhe identitetin e tij kombëtar.

Thonë e thuhet, por edhe dihet, nga studjuesë shqiptarë dhe të huaj, se të Parët e Shqiptarëve "u lindën" nga dheu, duke i dhënë emrin Tokës – Dheut dhe "Perëndive" të para njerëzore. Ata krijuan dhe zhvilluan kulturën e parë njerëzore, atë të Atlantidës dhe kulturën e dytë njerëzore, atë të Piramidave të Faraonëve (Faraon - Fara jonë). Pas fundosjes dhe zhdukjes së kontinentit të Atlantidës, pas Përmbytjes së Madhe biblike (rreth 15.000 vite p.e.s.), me "Barkën e Noes" Atlashtët u shpërndanë dhe u vendosën rreth brigjeve të detit Mesdhe, pjesa më e madhe e tyre në Egjiptin e sotëm, ku themeluan dhe zhvilluan njërën nga kulturat dhe qytetërimet më të vjetra e më mahnitëse të botës njerëzore, e cila ishte dhe është vazhdimësi e kulturës dhe e civilizimit të Atlantidës.

Thuhet e shkruhet nga historianë, arkeologë, filologë dhe etnologë anglezë, amerikanë, gjermanë, italianë, turq, etj. se, **Hieroglifet** e famëshme të Piramidave egjiptiane kanë domethënie shqipe, flasin shqip, deshifrohen më lehtë e më saktë përmes gjuhës shqipe dhe janë të përpiluara nga Thoti pellazgo-ilir, i cili ishte "perëndia" e shkencës dhe diturisë së Egjiptit të lashtë 6.000 vjet p.e.s. Sipas këtyre shkencëtarëve

shqiptarët, hebrenjtë dhe arabët kanë origjinë të njëjtë: nga Atlashtët e Atlantidës, kurse gjuha dhe alfabeti pellazgo-ilir i Hieroglifeve është baza edhe e alfabeteve të mëvonëshme, si atij hebrait, samarit, asirik, arabik, grek, etj. Ata pohojnë gjithashtu se, shtrirja gjeografike e pellazgo-ilirëve në kohë tepër të lashta, përfshinte gjithë hapësirën tokësore rreth detit Mesdhe, duke filluar nga Irani (Persia) në lindje, deri në Atlantik në perëndim dhe nga siujdhesa Ilirike, Apenine dhe e Azisë së Vogël në veri, deri në brigjet mesdhetare të Afrikës veriore në jug.

*****

Jemi popull i vjetër, i stërlashtë, parahistorik nga origjina, nga zanafilla dhe sot jemi popull i ri, shumë i ri, gati i papjekur për nga zhvillimi shtetëror, kombëtar, politik dhe ekonomik. Jemi popull pa shtet të mirëfilltë, pa komb e bashkim kombëtar, pa liri, pa pavarësi politike dhe ekonomike! Jemi popull i pushtuar, i robëruar, i kolonizuar nga të huajt, por edhe i përçarë skajshmërisht ndërmjet veti!

Pse ndodhë kështu?!

Sepse iliro-shqiptarët kanë bërë dhe ende po bëjnë gabime të mëdha në të gjitha fushat e jetës! Sepse ata janë përsëritësit më të pandreqshëm të gabimeve historike të stërgjyshërve të tyre! Prandaj, atyre u përsëriten humbjet dhe tragjeditë kombëtare në mënyrë ritmike, ciklike e kronike!

Sepse iliro-shqiptarët fise qenë dhe fise mbetën! Ilirët nuk arritën të bëhen popull, kurse Shqiptarët ende nuk janë bërë komb! Sepse, po të ishin bërë Ilirët popull, atëherë do ta kishin formuar një Perandori të vetme Ilire dhe s'do t'i formonin disa principata ose miniperandori gjatë gjithë historisë së tyre disa mijëvjeçare. Kurse, po të ishin sot Shqiptarët komb, atëherë do ta kishin shtetin etnik kombëtar dhe nuk do të ishin të kolonizuar nga disa shtete të huaja. Ilirët nuk u bashkuan, se ishin të armiqësuar ndërmjet veti! E njëjta gjë ndodhë edhe me ne, Shqiptarët! Kombi i mirëfilltë pajtohet, bashkohet dhe

formon shtetin kombëtar dhe nuk kërkon lëmoshë nga kolonizatorët dhe Europa që t'i "dhurojnë" ca të drejta autonomiste, kulturore, arsimore e ca të drejta njërëzore (sa për të mbijetuar) nën sundimin dhe qeverisjen e huaj!

Ndodhë kështu, sepse iliro-shqiptarët kurrë gjatë historisë së tyre mijëravjeçare nuk kanë zhvilluar luftë të përgjithshme popullore për çlirim dhe bashkim kombëtar, por kanë zhvilluar luftëra lokale, fisnore e krahinore! Prandaj, robëria e iliro-shqiptarëve dhe trojeve të tyre pellazgjike e kalon moshën e 2.000 vjeçarëve!

Ndodhë kështu, sepse iliro-shqiptarët ishin dhe mbetën fise, robër të të huajve, bijat dhe bijtë më të mëdhenj të të cilëve i dhanë botës gjithëçka nga mençuria, giximi dhe aftësia e vet, kurse fisit e popullit të vet s'i dhanë asgjë, apo fare pak! Që nga perandorët ilirë të Romës e Bizantit dhe deri te kryeministrat e kryekomandantët e Perandorisë Osmane dhe të Greqisë, gati të gjithë këta iliro-shqiptarë punuan për vete dhe për të tjerët, por shumë pak ose aspak për vendin e tyre që i lindi dhe i rriti! Ndër ata bij të mëdhenj të iliro-shqiptarëve, që la grada e ofiqe të huaja perandorake dhe u kthye në atdhe për ta çliruar e bashkuar atë ishte Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, por nuk ia arriti, nuk mundi të krijojë shtet të vërtetë arbëror, sepse "stan me lepuj" e "shtet me fise nuk bëhet"! As Skënderbeu i Madh nuk mundi t'i bashkojë fiset dhe principatat e përçara arbërore, nuk mundi nga ata të formojë një popull arbëror dhe një shtet të bashkuar etnik!

Pse ndodhë kështu?!

Sepse mosmarrëveshjet, përçarjet, xhelozia, urrejtja, karrierizmi, bajraktarizmi, egoizmi, kokëfortësia, hakmarrja, konfrontimet dhe egërsia e iliro-shqiptarëve ndaj njëri-tjetrit është trashëgim nga "perënditë" pellazgo-ilire të Olimpit, si dhe dënim nga Zoti i vërtetë, krijuesi i Universumit! Trashëgim dhe dënim që nga momenti i mosbindjes ndaj këshillës së Tij, nga atlashtët e parë të Atlantidës e të Tokës – Adamit dhe Evës për mosngrënjen

e frutave nga pema e ndaluar, të cilët nuk e përfillën këshillën e Zotit, sepse donin të bëhen më zot se Zoti! Që atëherë atlashto-pellazgo-iliro-shqiptarët i ndjek pas trashëgimia e së keqes që buron nga mosbindja, gabimet e prapësitë e të Parëve tanë dhe nga dënimi i Zotit!

Sepse, gjatë gjithë historisë së tyre mesjetare dhe më të re, nga Principatat arbërore e deri te Pashallëqet shqiptare, nga Lidhja Arbërore e Lezhës e deri te Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe e Pejës, nga Kryengritjet e Mëdha të viteve 1908-1912 dhe deri te Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare gjatë Luftës së Dytë Botërore, shqiptarët nuk i bashkuan mendjet, zemrat dhe armët për liri dhe pavarësi kombëtare! Prandaj edhe nuk e çliruan, nuk e bashkuan dhe nuk e bënë Shqipërinë etnike!

Sepse, as në betejat e fundit të armatosura të shqiptarëve kundër kolonizatorëve sllavë të viteve 1998-2001, shqiptarët nuk u bashkuan politikisht, organizativisht e ushtarakisht dhe nuk luftuan sëbashku për çlirim e bashkim kombëtar, por luftuan të përçarë, të ndarë, si fise e jo si popull, çdokush në krahinën e tij dhe secili për kërkesa e të drejta të ndryshme politiko-kombëtare, prandaj fituam shumë pak! Sepse, shqiptarët në Shqipërinë e cunguar londineze e kanë një shtet dhe mund të konsiderohen popull, por jo komb, sepse kombi ka unitet të brendshëm dhe kërkon bashkim kombëtar! Në Shqipëri, mjerisht, ende reflektohen mentalitetet fisnore e krahinore Veri-Jug, Gegë-Toskë gjatë gjithë ndeshjeve e përleshjeve politike për pushtet midis partive politike, që nga vendosja i sistemit ”demokratik” shumëpartiak! Fatkeqësisht, Shqipëria qe dhe mbeti një shtet pa dinjitet! Pa pavarësi politike dhe ekonomike! Një shtet i hurit e i litarit, i burgjeve e kampeve të përqëndrimit, i vëllavrasjes e hakmarrjes, i kriminalitetit e pasigurisë, i korrupsionit e mafisë, i varfërisë së skajshme të masave të gjera popullore! Është një ”shtet shqiptar” që dëbon, arreston e burgos patriotët dhe luftëtarët shqiptarë që veprojnë e luftojnë për çlirim dhe bashkim kombëtar, për Shqipërinë etnike!!!

Shqiptarët nuk ishin dje dhe nuk janë as sot në unitet politik dhe ushtarak për të çliruar dhe bashkuar Shqipërinë etnike! Të shpresojmë dhe të punojmë që, të paktën nesër të bashkohemi politikisht e ushtarakisht për të bërë Shqipërinë.

Të gjitha shtetet dhe perandoritë e huaja pushtuese të trojeve iliro-shqiptare, si: Perandoria Romake, Bizantine, Serbe e Car Dushanit, Bullgare e Samuilit, Osmane e Sulltanëve dhe dy miniperandoritë e Jugosllavisë së Kralëve serbë dhe e Tito-Rankoviçit, të krijuara mbi trojet tona, me shkatërrimin e tyre e kanë zënë gjithmonë përfundi popullin tonë! Sepse, kthesat historike e kanë gjetur popullin tonë përherë në gjum, të pa organizuar e të përçarë mes veti! Prandaj, edhe e kanë zënë përfundi gërmadhat e huaja dhe ka mbetur edhe më tej nën shtetet e reja pushtuese që janë ngritur mbi këto gërmadha!

Dhe kështu vazhdon të shkruhet historia jonë e lashtë dhe re: pushtim pas pushtimi, gjum pas gjumi, gërmadhë pas gërmadhe, përçarje pas përçarjeje, gabim pas gabimi, robëri pas robërie..., deri në këto ditë kolonizimi, varfërie e trishtimi!!!

II

Për ata që nuk i besojnë kësaj të vërtete të llahtarshme, po ua kujtoj shumë shkurt bëmat e gjëmat makabre e antipopullore të të parëve tanë, të prijësve politiko-ushtarakë të pellazgo-iliro-shqiptarëve, që ta kuptojnë edhe ata që nuk kanë mend në kokë, që ta shohin edhe ata që nuk kanë sy në ballë dhe që të binden edhe ata që nuk kanë ndërgjegje njerëzore e shqiptare se, nga vijmë, kush kemi qenë, kush jemi, kah shkojmë dhe kah duhet të shkojmë ne, Shqiptarët, pasardhësit e drejtpërdrejtë të atlashtëve të Atlantidës, të pellazgëve të Pellazgjisë, të ilirëve të Ilirisë, të arbëreshëve të Arbërisë, ne shqiptarët e Shqipërisë etnike, për të fituar lirinë dhe bashkimin kombëtar:

Zeusi, ”kryeperëndia” pellazgo-ilire, për të marrë fronin e ”perëndive” të Olimpit, vrau babanë e vet me anë të komplotit!!! Dhe nga xhelozia u përpoq që të kompromitojë e më pas të eliminojë edhe Prometheun, luftëtarin më bëmirës e zemërgjerë të botës antike, që ua dhuroi njerëzve zjarrin, por komploti i Zeusit dështoi falë zgjuarsisë së Prometheut!

Stërgjyshërit tanë, si ngatrrestarë e intrigantë me namë që ishin, kishin emërtuar edhe ”perëndinë” e tyre të grindjeve, Aresin, por jo që të shuaj mosmarrëveshjet dhe konfrontimet e tyre, por përkundrazi, për t'i përhapur ato më tej, si dhe për të krijuar ngatërresa, grindje e përçarje në mes njerëzve atje ku nuk kishte, me qëllim që të mund ta sundonin më lehtë popullin e vet!

Euridika, gjyshja e Lekës së Madh të Maqedonisë antike ilire, e etur për pushtet, e vrau burrin e vet mbret, dy djemtë dhe vajzën e vet për t'u bërë mbretëreshë!!!

Olimpia, nëna e Lekës së Madh, nga xhelozia, sepse burri i saj Filipi II, mbreti i Maqedonisë, martohet me Kleopatrën e re, e vret atë në gjumë, kurse poashtu e vret edhe Kleopatrën, kurse fëmijën e saj të posalindur e hedhë në zjarr!!! Por më vonë vritet edhe Olimpia nga ithtarët e mbretit të vrarë Filipit II!

Leka i Madh, pasi u bë mbret, nuk i pranonte meritat e të atit – Filipit II, dhe kështu ra në konflikt me Klitin, djalin e Bardhylit, të cilin gjatë një ahengu e vret!

Komandanti i garnizonit ilir, Dhimitër Fari, tradhëtoi mbretëreshën ilire Teutën dhe kaloi në anën e pushtuesëve romakë, duke i shkaktuar dëme të pariparueshme ushtrisë ilire!!!

Tradhëtia nxorri krye përsëri në ushtrinë ilire, me rastin e Kryengritjes së Madhe ilire të viteve 6-9 p.e.s. Komandanti i fisit të Breukëve – Bato, u tremb nga ushtria romake, tradhëtoi mbretin e vet Pines dhe bashkë me një pjesë të ushtrisë ilire dorëzohet te romakët! Me të dëgjuar për tradhëtinë e Batos së breukëve, komandanti tjetër ilir – Bato, i fisit të Desiatëve, që ishte për vazhdimin e kryengritjes antiromake, marshon me ushtrinë e tij drejt

Panonisë, robëron Bato tradhëtarin dhe e dënon me vdekje para gjyqit fisnor.

*****

Edhe në shekujt e mëvonshëm të epokës mesjetare arbërore, grindjet dhe përçarjet ndërfisnore vazhduan me të njëjtin intenzitet, si në kohën antike pellazgo-ilire! Në këtë kohë Principata e Balshajve të Shkodrës, më 1369, nga ortodoksë u konvertuan në katolikë, me qëllim që të kenë përkrahjen e Papës së Vatikanit dhe të Republikës së Venedikut në luftë kundër Principatës tjetër arbërore të Karl Thopisë, i cili sundonte në territorin e sotëm të Maqedonisë me qendër në Ohër! Pra, kemi të bëjmë këtu me një luftë vëllavrasëse ndërmjet dy principatave arbërore!

E njëjta gjë do të ndodhë disa vjet më vonë, në kohën e Gjergj Topisë, sundimtarit të Principatës së Durrësit. Feudalët vasalë arbëreshë përfituan nga papërvoja dhe mosha e re e Gjergj Topisë, si dhe nga sulmet e njëpasnjëshme të ushtrisë osmane dhe e tradhëtuan princin e tyre, duke u shkëputur njëri pas tjetrit nga Principata e Durrësit!

Konflikte të këtilla u paraqitën edhe në jug të Arbërisë, në Principatën e Artës, midis Gjin Bue Shpatës dhe Thoma Preluboviçit! Me grindje e përleshje të vazhdueshme brenda fiseve dhe principatave arbërore, nuk kishte mundësi që t'i bëhej një rezistencë e suksesshme invadimit osman në thellësi të trojeve arbërore të Ilirikut! Prandaj, para sulmeve të parreshtura osmane ranë njëra pas tjetrës principatat, qytetet dhe kështjellat arbërore nën sundimin e huaj! Durrësi ra nën sundimin e Republikës italiane të Shën Markut, të cilin e dorëzoi Gjergj Topia! Më vonë nën sundim të huaj ra edhe Shkodra. Kurse disa princër arbëror u bënë vasalë të sulltanit, me kusht që të ruajnë pronat e tyre! Edhe më keq, disa princër arbëreshë ftuan ushtrinë osmane që t'u ndihmonte në luftë kundër princërve tjerë arbëreshë, për t'u grabitur pronat! Lekë Dukagjini ka qenë trim, por, fatkeqësisht, i pabesë e grindavec! Ky, për interesa vetjake

dhe nga xhelozia u lidh me armiqtë e Skënderbeut, vret në pabesi Lekë Zaharinë, princin e Danjës dhe kështu shkakton luftën e Skënderbeut me Venedikun më 1448! Për të luftuar Skënderbeun, Lekë Dukagjini lidhet me Venedikun dhe Sulltanin, por ndërhyrja energjike e Papës në përkrahje të Gjergj Kastriotit parandaloi gjakderdhjen midis ushtrisë së Skënderbeut dhe fiseve të Dukagjinëve, Spanëve e Perlatëve!

Hamza Kastrioti ishte nipi i Skënderbeut, por nga xhelozia dhe lakmia për pushtet e famë e tradhëtoi Gjergjin dhe u hodhë në taborrin armik të ushtrisë osmane! U kthye, pastaj, në Arbëri në ballë të ushtrisë osmane, u ndesh me ushtrinë e Skënderbeut, e humbi betejën dhe zu rob nga oficeri fisnik Zaharia Gropa i Ohrit. Por, me rastin e gjykimit të tij, Gjergj Kastrioti ia fali jetën, duke e dënuar me burgim të përjetshëm! Më vonë u la i lirë, por ai u arratis në Stamboll, ku u prit me përbuzje. Tradhëtari mbeti tradhëtar!

Moisi Golemi i Dibrës ndoqi rrugën e tradhëtisë së Hamza Kastriotit! Ky, poashtu, braktis ushtrinë e Skënderbeut, shkon te Sulltani, vihet nën komandë të një ushtrie të madhe osmane dhe i vërsulet Arbërisë për të shpartalluar ushtrinë arbërore të Skënderbeut! Por, pas betejës së përgjakshme në mes dy ushtrive, doli fitimtare ushtria arbërore, kurse Moisi Golemi iku në Adrianopol, ku pas poshtërimit dhe heqjes së gradave që i bënë atje u kthye në Krujë, dhe me litar rreth qafës ra në gjunjë dhe i kërkoi falje Skënderbeut, i cili ia fali jetën. Pas kësaj, Moisi Golemi vazhdoi luftën përkrah Skënderbeut kundër ushtrive osmane, derisa u zu rob nga turqit dhe u dënua me vdekje nga Sulltani.

III

Gjatë shekullit XVIII u fuqizuan ekonomikisht një numër familjesh feudale arbërore, që populli i quajti ”oxhaqe”, të cilët u lidhën më pastaj me Sulltanin dhe fituan titullin ”pashë”, kurse tokat e tyre që i zotëronin u quajtën ”pashallëqe”. Njëra nga arenat e luftës për

pushtet të këtyre ”oxhaqeve” u bë Shkodra. Tridhjetë vjet rresht vazhduan betejat midis anëtarëve të familjes feudale Begolli të Pejës, të emëruar nga Sulltani si sundimtarë të Shkodrës, dhe familjes shkodrane Çausholli! Nga këto grindje përfitoi i treti, Mehmet bej Bushati, i cili më 1757 fitoi titullin ”Pashë” nga Sulltani dhe nga ky vit filloi të sundojë në Pashallëkun e Shkodrës. Për të zgjeruar tokat e tij, Mehmet Pashë Bushati asgjësoi krerët e oxhaqeve rivale brenda Shkodrës! Më 1759 nënshtroi agallarët e Ulqinit dhe dogji bankat e detarëve ulqinakë! Më 1770 pushtoi krahinën e Zadrimës dhe Lezhën! Më vonë vrau Tahir dhe Ismail Toptanin dhe pushtoi Krujën! Kështu, me intriga, vrasje, djegëje e plaçkitje të bashkëkombasve të vet, Mehmet Pashë Bushati deri më 1775 arriti që ta sundojë gjithë Shqipërinë e Veriut dhe atë të Mesme, por gjithnjë në emër e për inetresa vasale të Portës së Lartë! Një tjetër ”pasha” shqiptar ishte edhe Ahmet Kurt Pasha, i cili u bë ”zot” i Pashallëkut të Beratit. Ky, përmes shpifjeve e intrigave, mundi ta bindë Sulltanin se, Mehmet Pashë Bushati ka tradhëtuar Portën e Lartë, prandaj Sulltani e helmoi atë, i cili vdiq më 1775! Në vitin 1764, kur Ahmet Kurt Pasha u vendos në Berat, Shqipërinë e kishte përfshirë një grindje dhe konfrontim ushtarak midis sunduesve shqiptarë të pashallëqeve të ndryshme shqiptare, siç ishin ata të Vlorës, Delvinës, Shkodrës dhe Ohrit! Për të zgjeruar pashallëkun e tij, Ahmet Kurt Pasha sulmoi Tiranën, por qytetarët e saj i kthyen pushkën ushtrisë së tij dhe ai u tërhoq, por pas një lufte të ashpër e të përgjakshme, me shumë viktima nga të dyja palët, të cilat ishin të gjithë shqiptarë! Poashtu, Ahmet Kurt Pasha i Beratit, herë pas here, zhvilloi luftime të ashpra edhe kundër Pashallëkut të Shkodrës së Bushatlinjve, por pa sukses! Këto luftime vëllavrasëse ai nuk i ndërpreu derisa vdiq, më 1787! Armiqësi dhe urrejtje ndërshqiptare gjer në vdekje!

Pas vdekjes së Ahmet Kurt Pashës, Pashallëku i Beratit ra në duart e Ibrahim Pashë Vlorës, kurse më

1809 nën Ali Pashë Tepelenën! Më 1740 sundimi i Delvinës kishte rënë në duart e Kapllan Pashës, i cili e përfundoi sundimin e tij 34 vjeçarë vetëm përmes luftërave e përleshjeve të përgjakshme me rivalët e tij shqiptarë, duke shkaktuar në këtë mënyrë viktima të mëdha njerëzore, shkatërrime materiale dhe duke mbjellë urrejtje e hakmarrje të mëdha brenda shqiptarëve!

Epiqendër e luftës për epërsi në Shqipërinë e Jugut, midis feudalëve e pashallarëve shqiptarë, u bë edhe Janina! Luftën, më në fund, e fitoi Ali Pashë Tepelena, i cili më 1786 vuri nën kontrollë Pashallëkun e Janinës. Ali Pashë Tepelenës babain, Veli Beun, sundimtar i Tepelenës, ia kishte vrarë Islam Beu, duke ia marrë edhe sundimin! Me forcimin e Ali Pashës, nëna e tij, Hankua, organizoi hakmarrjen për burrin e saj, Veli Beun! Ajo, me ndihmën e fshatarëve të Hormovës dhe të koxhabashit të tyre, Çaush Priftit, sulmoi dhe shfarosi familjen e Islam Beut!

Në Dibër të Madhe nga viti 1770 filloi të sundojë familja feudale Hoxholli, e cila prej Sulltanit mori fermanin për të sunduar Rekën e Dibrës së Epërme. Por, gjatë vitit 1786 u zhvillua beteja e Marovishtës, midis forcave të Ali Pashë Tepelenës dhe familjes Hoxholli të Dibrës, ku ranë 15 viktima me në krye kapedan Kondeshën! Një vit më pas, në verë të vitit 1787, Ali Pashë Tepelena, me 3000 ushtarë, u nis për në veri për të shtypur kryengritjen e Bushatliut! Kurse gjatë rrugës ai sulmoi dhe pushtoi Korçën dhe Ohrin! Pas Ohrit, Ali Pasha sulmoi dhe pushtoi edhe disa pjesë të Pashallëkut të Vlorës! Kurse më 1799, Ali Tepelena filloi ekspeditën ushtarake kundër krahinës së Sulit! Pasi rrethoi Sulin, bëri për vete kapedanin suliot, Kiço Boçari, i cili ishte i pakënaqur pse suliotët nuk e kishin zgjedhur për kapedan të tyre, por kishin zgjedhur kapedan Foto Xhavellën. Në këtë mënyrë Ali Pasha i përçau suliotët dhe e pushtoi krahinën malore të Sulit, duke shkaktuar një gjenocid të vërtetë mbi popullsinë suliote! Edhe krahina e Himarës u dogj dhe u gjakos shpesh nga forcat

ushtarake të Ali Pashë Tepelenës, derisa ra nën sundimin e tij gjakatar! Në fund, edhe Ali Pashë Tepelena e mbaroi jetën ashtu siç e përfunduan qindra e mijëra shqiptarë të tjerë në betejat ndërshqiptare të cilat i shkaktoi ai vetë gjatë sundimit të tij të gjatë despotik! Kështu, ai u bë me dy varre (kokën në Stamboll e trupin në Janinë), kurse shqiptarët dhe Shqipëria mbetën të varrosur për së gjalli në varrin e thellë të armiqësisë, përçarjes, grindjes, hakmarrjes, vëllavrasjes, gjakmarrjes dhe mbetën në katakombin e robërisë shekullore turke, që la pas sundimi i egër 30 vjeçar i Ali Pashë Tepelenës!

Në vitet 1700-1800, përveç shumë të tjerëve, në Perandorinë Osmane kanë sunduar këta shqiptarë: Mehmet Aliu në Egjipt, Pashvan Ogllui në Vidin, Mustafa Bajraktari vezir i madh (Kryeministër) në Stamboll, Bushatlinjtë në Shkodër, Ibrahim Pasha në Berat, Ali Pashë Tepelena në Janinë...etj. Gati tërë Perandorinë Turke në këtë kohë e sundonin shqiptarët dhe përsëri populli shqiptar dhe Shqipëria ishin të varfër, të shtypur mizorisht, pa liri e pavarësi kombëtare, pa shtetin e vet, sepse secili prej këtyre shqiptarëve "të mëdhenj" e me pushtet të lartë përpiqeshin t'i hanë kokën njëri-tjetrit, t'i grabisin pasurinë e fronin njëri-tjetrit dhe s'çanin kokën fare për popull, shtet e atdhe!

*****

Pas masakrës së njohur të Manastirit më 1830, ku tradhëtisht e tinëzisht u vranë nga ushtria turke rreth 1000 aktivistë e udhëheqës të dalluar shqiptarë dhe pas disfatës së shqiptarëve te Hani i Babunës më 1831, ku u vranë disa mijëra kryengritës shqiptarë, të cilët ishin futur me tradhëti në një rrethim të befasishëm, shqiptarët, duke mos harruar këto dy disfata të mëdha, u ngritën përsëri në luftë kundër ushtrisë pushtuese turke më 1843, të udhëhequr nga Dervish Cara i Tetovës, të cilët me sulm të rrufeshëm çliruan Shkupin. Por, siç ka ndodhur dhe ndodhë gjithmonë me udhëheqësit ushtarakë e politik shqiptarë, edhe në këtë rast ngriti krye kokëfortësia dhe mostoleranca e shqiptarëve, dolën në

shesh grindjet, xhelozitë dhe mosmarrëveshjet e shqiptarëve! Ushtria e Dervish Carës, pas marrjes së Shkupit, u nda në dy taborre kundërshtare: njëra palë ishte për Këshillin e Kryengritjes dhe vazhdimin e luftës çlirimtare (rryma radikale), kurse pala tjetër ishte për reformat dhe premtimet e proklamuara turke (rryma reformiste)! Mospajtimi dhe përleshja e armatosur midis këtyre dy rrymave, çoi deri në dështimin e Kryengritjes së Dervish Carës, i cili, me gjithë përpjekjet e tij, nuk mundi që t'i pajtojë apo neutralizojë këto dy rryma antagoniste politike. As patriotët intelektualë të asaj kohe nuk ishin në unitet mendimi e veprimi! Zef Jubani mbronte kërkesën për autonomi brenda Turqisë, kurse Thimi Mitko, Spiro Dine, Preng Doçi… etj., mbronin tezën e kryengritjes së armatosur antiturke dhe shkëputjen e Shqipërisë nga Turqia.

Nën ndikimin e forcave progresive, rezistenca shqiptare nuk pushoi kurrë, pa marrë parasysh gabimet, mosmarrëveshjet dhe tradhëtitë e njëpasnjëshme që bënin udhëheqësit e ndryshëm të kryengritjeve shqiptare. Më 1874 shpërthyen trazira të reja antiturke në Mirditë e në Malësi, por konsulli anglez dhe ai austrohungarez, e blenë me para dhe e njohën si kapedan të Mirditës Prengë Bibë Dodën, arritën që ta shkëpusin atë nga kryengritësit shqiptarë, duke e lënë kryengritjen pa udhëheqës, e cila pastaj u shua në gjak nga ushtria turke!

As Lidhja famëmadhe e Prizrenit (1878-1881) nuk qe imune ndaj virusit përçarës shqiptar! Qysh në fillim të veprimtarisë së saj politiko-ushtarake, në gjirin e saj u krijuan dy rryma antagoniste: rryma për Pavarësinë e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ymer Prizreni, Abdyl Frashëri, Sulejman Vokshi, Haxhi Zeka, Zija Prishtina…etj., dhe rryma për Autonominë e Shqipërisë në kuadër të Turqisë, e përfaqësuar nga Iliaz Pashë Dibra, Hasan Pashë Tetova, Ali Pashë Gucia, Abdullah Pashë Dreni, Shaban Beu,…etj. Dhe, si rezultat i kësaj ndarjeje, u dobësua Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe nuk arriti të fitojë as pavarësinë, as autonominë e Shqipërisë dhe as të

mbrojë Plavën e Gucinë që iu dhanë Malit të Zi nga Kongresi i Berlinit! Me gjithë sakrificat, heroizmin dhe qëndresën heroike të luftëtarëve popullorë, Lidhja Shqiptare e Prizrenit u shtyp me zjarr e hekur, kurse Shqipëria e cfilitur dhe e gjakosur mbeti edhe më tej nën robërinë e egër turke!

Nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit, virusi i përçarjes dhe mosmarrëveshjeve ndërshqiptare u bart te Lidhja Shqiptare e Pejës më 1899! Në mbledhjen e Pejës nuk ishin ftuar Hasan Ferri nga Gucia dhe Riza Beg Kryeziu nga Gjakova. Prandaj, Riza Begu, i tërbuar nga zemërimi i mospërfilljes së tij nga organizatorët e Lidhjes së Pejës dhe i damkosur si tradhëtar nga kjo Lidhje, iu drejtua Portës së Lartë, duke zbuluar para saj sekretet dhe qëllimet politiko-ushtarake të Lidhjes Shqiptare të Pejës, duke e dëmtuar në këtë mënyrë shumë këtë organizatë çlirimtare kombëtare! Përndryshe, në Kuvendin e Lidhjes së Pejës u paraqitën tri rryma politike: ajo autonomiste, austriake dhe turkofile! Duke dominuar rryma turkofile objektivat çlirimtare kombëtare të Lidhjes Shqiptare të Pejës nuk mundën të realizohen! Ishte ky edhe një dështim i rradhës në varganin e pambarim të përçarjeve dhe të dështimeve groteske të kryengritjeve shqiptare, të Shqipërisë e të Shqiptarëve!

Jo vetëm në fushën politike e ushtarake, por edhe në fushën e artit e të kulturës shqiptarët patën divergjenca e mospajtime të mëdha! Para Kongresit të Manastirit përdoreshin tre alfabete të gjuhës shqipe: alfabeti i Stambollit i vitit 1879, alfabeti i shoqërisë "Bashkimi" të Shkodrës i vitit 1899 dhe alfabeti i shoqërisë "Agimi" të Shkodrës i themeluar disa vite më vonë. Konfrontimi dhe përpjekja për dominim në mes këtyre alfabeteve, dhe të tjerëve, u shpreh shumë vrazhdë në Kongresin e Manastirit më 1908! Si rezultat i mosmarrëveshjeve të thella e intrigave të tjera, në këtë Kongres nuk morën pjesë: Faik Konica, Asdreni, Fan Noli, Çajupi etj.! Në këtë Kongres dolën në shesh tri pikëpamje të ndryshme të zgjidhjes së alfabetit, doli në shesh grindja

veri-jug, duke i dhënë Kongresit karakter politik! Kongresi i përfundoi punimet pa marrë ndonjë vendim të qartë se cili alfabet do të përdorej këtej e tutje për të gjithë shqiptarët! Formimi i alfabetit u shndërrua në proçes në zhvillim e sipër, prandaj një vit më pas, më 1909, u thirrë Kongresi i Dibrës, i cili nuk mundi t'ia vërë kapakun çështjes së alfabetit shqip, por aty u vendos që çështjen e alfabetit ta zgjidhë vetë populli dhe çdo krahinë veç e veç! Edhe në Kongresin e Elbasanit, që u mblodh po më 1909, pas atij të Dibrës, nuk u vendos alfabeti përfundimtar, sepse edhe aty u grindën dhe nuk mundën të merren vesh dy rrymat kundërshtare: rryma e intelektualëve, që ishte për alfabetin latin dhe rryma e intelektualëve, që ishin për alfabetin turko-arab! Alfabeti shqip mori formën përfundimtare që ka sot më 1912, me rastin e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë nga Ismail Qemal Vlora me shokë, më 28 nëntor 1912.

Udhëheqësit politik dhe ushtarakë shqiptarë të Kryengritjeve të viteve 1910-1912 nuk qenë në unitet mendimi e veprimi për mënyrën dhe format e zhvillimit të luftës për liri dhe pavarësi kombëtare! Kështu: Nikolla Naço ishte kundër Dervish Himës e Jashar Erebarës! Shahin Kolonja ishte në mospajtim me Dervish Himën! Disa udhëheqës ishin për pavarësi të Shqipërisë, kurse shumë të tjerë për autonominë e Shqipërisë! Pra, në gjirin e lëvizjeve politike e ushtarake shqiptare gjithmonë, në të gjitha kohërat, kanë vepruar të paktën dy rryma kundërshtare politike e luftarake, të cilat kanë bërë të mundur dështimin e të gjitha luftërave, kryengritjeve dhe përpjekjeve të popullit shqiptar, qoftë me pushkë e qoftë me penë, për të çliruar e bashkuar Shqipërinë! Kështu: Tajar Beg Tetova, udhëheqës në Shqipërinë e Jugut, ishte kundër politikës së Hasan Prishtinës e Bajram Currit! Riza Beg Kryeziu ishte kundër Hasan Prishtinës në Mbledhjen e Prishtinës më 2 gusht 1912 dhe hoqi dorë edhe nga autonomia e Shqipërisë! Idesë së "moderuar" të Riza Begut, fatkeqësisht, iu bashkangjit edhe Isa Boletini! Mosmarrëveshjet dhe zënkat midis udhëheqësve politik të

Kryengritjes së vitit 1912, çuan deri atje sa që Bajram Curri me luftëtarët e tij u detyrua që ta lëshojë Shkupin e çliruar nga forcat shqiptare në gusht 1912! Më 4 shtator 1912 qeveria turke e njohu autonominë e Shqipërisë, por paria shqiptare nuk e shfrytëzoi këtë rast, nuk e pranoi këtë ofertë strategjike, nuk formoi qeverinë shqiptare, kuvendin, gjykatat, ushtrinë kombëtare, policinë etj., siç veproi Lidhja Shqiptare e Prizrenit para 40 vitesh! Përkundrazi, një pjesë e parisë shqiptare i ndihmoi, direkt apo indirekt, ushtrisë serbe për pushtimin e Prishtinës, Kumanovës, Shkupit, Tetovës, Gostivarit dhe gjithë Kosovës e Shqipërisë së Veriut! Edhe paria shqiptare e Jugut nuk veproi më drejt, por me antagonizmat në gjirin e vet bëri të mundur pushtimin e Çamërisë dhe një pjese të madhe të Shqipërisë Jugore nga ushtria greke! Në këtë mënyrë, pjesa reaksionare, injorante, egoiste dhe tradhëtare e parisë shqiptare, nga autonomia e Shqipërisë etnike nën Turqi, që në perspektivë do të fitonte edhe pavarësinë shtetërore, e katandisi Shqipërinë në një çerek shteti të ”pavarur” të Traktatit famëkeq të Londrës më 1913!

Polemika e mospajtime ka pasur edhe midis Fan Nolit, Luigj Gurakuqit, Stavri Vinjaut, Çajupit e Kostë Çerkezit nga njëra anë dhe Ahmet Zogut, Faik Konicës, Mit’hat Frashërit, Abdyl Ypit e Mehdi Frashërit nga ana tjetër! Ka pasur luftë politike për supremacion midis Klubit të Stambollit dhe Klubit të Selanikut! Ka pasur divergjenca të thella e grindje të ashpra midis dy organizatave patriotike në mërgim: ”Vatra” dhe ”Shqipëria e Lirë”!

*****

Edhe pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912, fatkeqësisht, grindjet e xhelozitë midis udhëheqësve politik e ushtarakë shqiptarë nuk pushuan, por vazhduan me të njëjtin intenzitet, duke i sjellë dëme të pallogaritshme çështjes kombëtare shqiptare në përgjithësi dhe forcimit e konsolidimit të shtetit shqiptar në veçanti! Kështu, Esat Pashë Toptani nuk e njohu

shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë dhe e luftoi me tërbim Qeverinë e Vlorës! Akti i tij më i shëmtuar antikombëtar është dorëzimi i Shkodrës malazezëve prej tij më 22 prill 1913!!! Edhe pse Ismail Qemali e fali për dorëzimin e Shkodrës dhe e emëroi Ministër të Brendshëm, Esat Pashë Toptani nuk ishte i kënaqur, doli nga Qeveria dhe më 12 tetor 1913 formoi në Durrës një "Qeveri" të re për Shqipërinë e Mesme!!! Për këto dhe veprime të tjera ai ra në konflikt me Josif Bagerin e Dibrës, i cili në atë kohë nxirrte gazetën "Ushtari i Krujës" në Krujë. Pas një debati të ashpër midis tyre, Esat Pasha e dënoi me vdekje Josif Bagerin, prandaj ky u detyrua të largohet në drejtim të Kosovës, ku edhe vdes më 1915 në Prishtinë!

Marrëdhënie të acaruara kishte edhe midis Mehmet Pashë Derallës nga Tetova dhe Mit'hat Frashërit, që të dy ministra në Qeverinë e Vlorës! Mospajtimet dhe grindjet tipike të shqiptarëve u paraqitën edhe në Kongresin e Trieshtës më 1913, ku pas fjalosjes së madhe midis Faik Konicës e Nikollë Ivanajt, ky i dyti i kërkon dyluftim Faik Konicës! Pra, intelektualëve u ishin shterruar jo vetëm argumentet shkencore, por edhe fjalët ofenduese ndaj njëri-tjetrit, dhe tani i kishte ardhë rradha shpatës ose revoles për "marrëveshjen" e tyre përfundimtare!!!

Konfliktet dhe qërimi fizik i hesapeve në mes krerëve politik shqiptarë vazhdon me një egërsi të paparë edhe pas vitit 1920 e deri në fillim të Luftës II Botërore! Kështu, më 20 prill 1924, Ahmet Zogu, përmes veglës së tij, Isuf Reçit, vret në Tiranë Avni Rrustemin!!! Ahmet Zogu, si Kryeministër Qeverie, urdhëron vrasjen e Luigj Gurakuqit në Bari të Italisë, më 2 mars 1925!!! Më pas urdhëroi rrethimin për arrestimin ose vrasjen e Bajram Currit te Shpella e Dragobisë!!! Më vonë, më 1933, urdhëroi vrasjen e Hasan Prishtinës në Selanik!!! Len në varfëri e mjerim Shotë Galicën, duke mos i ofruar ndihmë mjekësore për shërimin e plagëve të saj të luftës antiserbe, nga të cilat ajo vdiq në Fushë-Krujë! Që nga vetëshpallja e

Ahmet Zogut ”Mbret i Shqiptarëve”, më 1 shtator 1928, dhe derisa iku nga Shqipëria, më 7 prill 1939, ai sundoi në Shqipëri vetëm përmes dhunës antipopullore, krimit politik ndaj kundërshtarëve të tij, dhe përmes diktaturës së pakufizuar monarkike!

IV

Edhe gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në Luftën e Dytë Botërore, shqiptarët nuk u bashkuan për të çliruar dhe bashkuar Shqipërinë etnike, por përkundrazi, si gjithmonë gjatë kthesave historike, ata u ndanë në dy-tre taborre ndërluftuese, gjatë ndeshjeve të armatosura të të cilëve rrodhi rrëké gjaku i pafajshëm i shqiptarëve!

Që në fillim të invadimit fashist të Italisë, shqiptarët u ndanë në dy grupe: në ata që e pritën me pushkë sulmin italian më 7 prill 1939, si Abaz Kupi e Mujo Ulqinaku me shokë, dhe në ata që e pritën me lule e bekime ushtrinë fashiste, si Xhafer Ypi e Shefqet Vërlaci me shokë!

Për të luftuar fashizmin, në 8 nëntor 1941, u formua Partia Komuniste e Shqipërisë. Kurse, po për këtë qëllim, më 16 shtator 1942, u mblodh Konferenca e Pezës, në të cilën morën pjesë të gjitha rrymat politike të vendit. Në këtë Konferencë u themelua Fronti Nacionalçlirimtar, në të cilin u bashkuan të gjithë shqiptarët pa dallim krahine, feje e ideje. Por, më vonë, në udhëheqjen politike të këtij Fronti dominoi PKSH-ja, prandaj në nëntor 1942 u krijua Balli Kombëtar në krye me Mit’hat Frashërin, Safet Butkën, Abaz Ermenjin etj. Balli Kombëtar dhe PKSH zhvilluan disa bisedime për të krijuar një organizatë të përbashkët çlirimtare, por pa sukses, sepse Balli ishte për një luftë për çlirim dhe bashkim kombëtar, kurse Partia ishte vetëm për çlirim nga fashizmi, kurse bashkimin kombëtar e lente për zgjidhje pas çlirimit!

Pas rënies së Musolinit, u mbajtë Mbledhja e Mukjes, në korrik 1943, ku morën pjesë të gjitha rrymat politike të vendit, në të cilën u vendos që të luftohet

bashkërisht për një Shqipëri të pavarur, të lirë, demokratike dhe etnike, që do të arrihej përmes luftës çlirimtare dhe të drejtës për vetëvendosjen e popujve. Mirëpo, gëzimi për këtë Marrëveshje historike zgjati pak, sepse PKSH-ja, me urdhër të PKJ-së (!), e hodhi poshtë Marrëveshjen dhe Vendimet e Mbledhjes së Mukjes për një luftë të përbashkët të të gjithë shqiptarëve për një Shqipëri të lirë, të bashkuar, etnike dhe demokratike!

Divergjencat midis Frontit Nacionalçlirimtar dhe Ballit Kombëtar u acaruan sidomos pas Konferencës së Dytë Nacionalçlirimtare të mbajtur në Labinot të Elbasanit, më 4-8 shtator 1943, me vendimet e së cilës PKSH-ja u distancua përfundimisht nga platforma politike e Konferencës së Pezës dhe Mbledhjes së Mukjes, si dhe u përcaktua për luftë të armatosur kundër Ballit Kombëtar!

Edhe zogistët dolën nga rradhët e Frontit Nacionalçlirimtar, pas vendimeve arbitrare ideologjike të Konferencës së Labinotit dhe, më 21 nëntor 1943, thirrën kongresin e vet dhe nën drejtimin e Abaz Kupit formuan Partinë e Legalitetit, e cila, veç tjerash, ishte për Shqipërinë etnike si mbretëri demokratike parlamentare në krye me mbretin Zogu I! Ishte anakronike e alogjike që të kërkohej të kthehet mbret përsëri Ahmet Zogu që kishte likuiduar fizikisht kundërshtarët e tij politik, që kishte sunduar me terror popullin e vet, që kishte grabitur thesarin e shtetit shqiptar dhe që kishte ikur para pushtimit fashist për të shpëtuar kokën e vet dhe duke lënë popullin pa krye, pa udhëheqës politik e ushtarak!

Pas një varg bisedimesh të pasuksesshme për bashkëpunim midis PKSH-së e Legalitetit, PKSH-ja në fund edhe zogistët i cilësoi si armiq dhe u shpalli luftë të armatosur! Kjo ndodhi më 7 dhjetor 1943, datë e cila faktikisht shënon fillimin e luftës së përgjakshme qytetare për pushtet ndërmjet shqiptarëve: të partizanëve të PKSH-së e të Frontit Nacionalçlirimtar nga njëra anë, dhe të ballistëve të Ballit Kombëtar dhe të zogistëve të Legalitetit nga ana tjetër e barrikadës! Kjo luftë e armatosur vëllavrasëse përfundoi me fitoren e pushtetit të

partizanëve dhe me humbjen e Shqipërisë etnike! Nga 31 dhjetori 1943 dhe deri më 2 janar 1944, u mbajtë Konferenca e Bujanit për Kosovën, e cila sanksionoi të drejtën e popullit shqiptar për vetëvendosje dhe shprehu vullnetin patriotik për bashkim me Shqipërinë. Por, vendimet e kësaj Konference u hodhën poshtë nga PKJ dhe u lanë në heshtje nga PKSH-ja!

Më 24 maj 1944 u mbajtë Kongresi i Përmetit i Frontit Nacionalçlirimtar, i cili të gjitha forcat e tjera politike, që nuk ishin në përbërje të Frontit, i shpalli zyrtarisht reaksionare e antikombëtare, pra, ndaloi pluralizmin politik dhe sanksionoi politikën dhe regjimin monist, njëpartiak në Shqipëri!

Më 23 nëntor 1944 u mblodh në Berat Plenumi II i KQ të PKSH-së, ku delegati jugosllav Velimir Stojniç dha orientime të reja që do të çonin në bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë! Për Kosovën dhe viset tjera të robëruara nga Jugosllavia dhe Greqia as që u bë fjalë! Udhëheqja e PKSH-së bëhej shurdhmemece kur ishte fjala për bashkimin kombëtar të Shqipërisë e të shqiptarëve!

Prandaj, nga viti 1945 e më tej vazhdoi gjenocidi e robëria sllavo-greke mbi Kosovën e Çamërinë, duke filluar nga masakra e Drenicës, masakra e Tivarit, e Tetovës, gjenocidi dhe shpërngulja e dhunëshme e çamëve, procesi famëkeq i Prizrenit, shpërnguljet e dhunëshme të shqiptarëve nga trojet e tyre nën Jugosllavi për në Turqi dhe deri te burgjet e Nishit, Beogradit, Lepogllavës e Goli Otokut! Në këtë kohë, nga gjenocidi e terrori ushtarak serbo-maqedono-malazez u likuiduan rreth 50.000 shqiptarë! Kurse finalizimi i pushtimit jugosllav të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare nën Maqedoni, Serbi e Mal të Zi u arritë në Konferencën famëkeqe të Prizrenit, në korrik 1945, në të cilën u miratua Rezoluta për Aneksimin dhe sundimin përfundimtar të këtyre trojeve nga Jugosllavia edhe juridikisht! Në këtë mënyrë, edhe ***de jure*** **e** ***de facto*** u shkel Rezoluta e Konferencës së Bujanit për vetëvendosje e bashkim me Shqipërinë, kurse ata shqiptarë të Kosovës që kundërshtuan Konferencën e

Prizrenit u likuiduan fizikisht ose politikisht, duke i dënuar me burgime shumë të gjata! Kurse PKSH-ja dhe Qeveria e Shqipërisë heshtën, sepse ata ishin të zënë me vazhdimin e luftës civile e politike për pushtet dhe për ruajtjen e pushtetit të dalë nga lufta antifashiste dhe vëllavrasëse qytetare që sa po kishte mbaruar dhe që tani vazhdonte në forma tjera, me anë të terrorit politik, shantazheve dhe burgosjeve masive të atyre që mendonin ndryshe nga komunistët!

PKSH-ja, gjatë gjithë zhvillimit të Luftës Antifashiste ishte nën ndikimin antishqiptar të emisarëve politik të PKJ-së, siç ishin: Dushan Mugosha, Milladin Popoviç, Velimir Stojniç, Svetozar Vukmanoviç – Tempo…etj.! Prandaj nuk bëri dhe nuk mund të bënte asgjë gjatë luftës për çlirimin dhe bashkimin e Shqipërisë etnike, si dhe për bashkimin e të gjithë shqiptarëve në një front të vetëm nacionalçlirimtar dhe nën një udhëheqje politike e ushtarake jashtë ideologjike! Prandaj shqiptarët e Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Çamërisë u lanë që të zhvillojnë luftë antifashiste nën komandën politiko-ushtarake të sllavo-grekëve! Dhe ishte tepër vonë kur PKSH-së i ra ndërmend për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, pas luftës së Dytë Botërore! Ishte tepër vonë, sepse nga njëra anë ishte instaluar e forcuar pushteti sllavo-grek në trojet shqiptare të Kosovës dhe të Çamërisë, kurse në anën tjetër ishte dobësuar forca goditëse e shqiptarëve të Shqipërisë nga lufta kundër fashizmit, si dhe nga lufta civile vëllavrasëse për pushtet midis ballisto-zogistëve dhe partizanëve! Poashtu edhe shqiptarët e Kosovës dhe të Çamërisë ishin shpartalluar, vrarë, shpërngulur e burgosur nga neofashistët sllavo-grekë!

Në këtë mënyrë, mbarimi i Luftës së Dytë Botërore i gjeti shqiptarët, si gjithmonë, të dobët ushtarakisht, të përçarë politikisht, të varfër ekonomikisht dhe në vazhdimësi të robërisë dhe kolonializmit sllavo-grek! Kjo tragjedi kombëtare u përsërit sepse PKSH-ja, gjatë Luftës Antifashiste, shkeli vendimet e Konferencës së Pezës dhe

të Mbledhjes së Mukjes! Sepse nuk e përfilli Rezolutën e Konferencës së Bujanit! Sepse PKSH-ja luftoi për marrjen e pushtetit në Tiranë dhe jo për çlirimin dhe bashkimin e Shqipërisë etnike! Sepse PKSH-ja u tregua naive dhe u besoi shumë premtimeve të komunistëve jugosllavë dhe internacionalizmit proletar dhe nuk u mbështet në ideologjinë kombëtare! Sepse shteti shqiptar pas Luftës II Botërore, për realizimin e bashkimit kombëtar, u mbështet te Bashkimi Sovjetik dhe jo te Anglo-Amerikanët! Historia dhe e sotmja i vërtetojnë qartë gabimet politike fatale taktike dhe strategjike të partizanëve shqiptarë, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore!

V

Për të mos e zgjatur më tej këtë histori të gjatë, të lashtë e të re grindjesh, konfliktesh, vëllavrasjesh, gabimesh historike dhe anomalishë shqiptare po theksojmë se, mosmarrëveshjet, urrejtja, armiqësitë dhe mostoleranca ndërmjet krerëve, parisë, udhëheqësve politik e ushtarakë shqiptarë gjatë gjithë historisë u shpreh më së shumti përmes dy rrymave kryesore politiko-ushtarake (edhe pse ekzistonin edhe nënrryma tjera): rrymës luftarake kombëtare dhe rrymës pacifiste kombëtare, apo rrymës për pavarësi dhe rrymës për autonomi. Këto dy rryma politike antagoniste, për fat të keq të shqiptarëve dhe të Shqipërisë etnike, po vazhdojnë të grinden e të luftohen në mes veti (me penë e pushkë), me po të njëjtën egërsi dhe urrejtje reciproke edhe në ditët e sotme të vitit 2004!!! Në vija të shkurtëra mosmarrëveshjet, përçarjet dhe konfliktet politiko-ushtarake të shqiptarëve, gjatë historisë së vjetër e të re, u reflektuan dhe reflektohen në mes të përkrahësve të Skënderbeut dhe Hamza Kastriotit, Moisi Golemit e Lekë Dukagjinit! Në mes ithtarëve të Ali Pashë Tepelenës dhe Hoxhollëve të Tepelenës! Midis Abdyl Frashërit dhe Iliaz Pashë Dibrës! Ndërmjet Haxhi Zekës dhe Riza Beg Kryeziut! Midis Ismail Qemalit dhe Esat Pashë Toptanit!

Në mes të Fan Nolit dhe Ahmet Zogut! Midis ballisto-zogistëve dhe partizanëve! Midis Mit'hat Frashërit dhe Enver Hoxhës! Ndërmjet Enver Hoxhës dhe Mehmet Shehut! Midis Sali Berishës dhe Fatos Nanos! Midis Ibrahim Rugovës e Fatos Nanos! Midis Sali Berishës dhe Rexhep Qosjes! Midis Ibrahim Rugovës e Adem Demaçit! Midis Ibrahim Rugovës e Hashim Thaçit! Midis Ali Ahmetit e Arbër Xhaferrit……, dhe anasjelltas!!!

Të gjithë këta udhëheqës politiko-ushtarakë të popullit tonë kanë qenë dhe janë njerëz, pra të gabueshëm, ndonëse kush më pak e kush më shumë. Për të vdekurit le ta thotë fjalën historia jonë kombëtare, shkencore dhe e paanëshme, kurse të gjallët le ta thonë fjalën e tyre vetë, me vepra, me punën e tyre të përditëshme politike kombëtare apo antikombëtare, duke bërë vetëkritikë publike apo në vetëvete për gabimet e bëra deri tani, me qëllim të mospërsëritjes së tyre në të ardhmen.

Shqiptarët, deri tani, e kanë vërtetuar se nuk e duan lirinë, bashkimin kombëtar dhe Shqipërinë etnike, të bashkuar, reale, natyrore,…! Sepse, po ta donin, do ta kishin, do të pajtoheshin e bashkoheshin mes veti rreth një qendre të vetme politiko-ushtarake, do të luftonin dhe do ta fitonin lirinë, ribashkimin kombëtar dhe Shqipërinë etnike. Shqiptarët ende nuk e kanë ndryshuar vetveten e tyre, prandaj nuk ka ndryshuar as gjendja e tyre politike, juridike, ekonomike dhe kombëtare! Kush ishim, nga vijmë dhe ku jemi të gjithë e dijmë, por kah shkojmë dhe kah duhet të shkojmë, ose nuk e dijmë, ose nuk duam ta dijmë!

Deri tani politikanët shqiptarë të trojeve shqiptare nën ish-Jugosllavi i kanë ndërruar shpesh taktikat dhe strategjitë e tyre politike të luftës për liri, pavarësi e bashkim kombëtar! Në vitet '70-të dhe '80-të të shekullit të kaluar veprohej e punohej për një Republikë Shqiptare në kuadër të Federatës Jugosllave, ku do të përfshiheshin të gjitha territoret shqiptare nga Manastiri në Preshevë dhe nga Presheva në Tivar. Por në vitet '90-të kjo kërkesë

u braktis dhe u thërrmua në disa kërkesa e strategji politike të vogla të politikanëve shqiptarë dhe partive të tyre politike! Kështu, Republika Shqiptare e Kosovës u rrudhë në Shtetin e Kosovës, që do të përfshi vetëm ish-KSA të Kosovës! Partia për Veprim Demokratik e Kosovës Lindore mbajti një Referendum popullor për vetëvendosje dhe bashkim me Kosovën, por kur erdhi koha që ky bashkim të bëhet përmes luftës çlirimtare të UÇPMB-së, kjo parti u tërhoq nga strategjia e vet politike, e mohoi vetveten, nuk e përkrahu luftën dhe u kënaq me një "autonomi kulturore" nën Serbi!

Partitë politike të Iliridës vetë e mbajtën një Referendum për Autonomi Politiko-Territoriale, për Republikën Autonome të Iliridës, dhe vetë e braktisën këtë rrugë e strategji politike, duke u kënaqur me statusin e "shtetformuesit" të shqiptarëve në IRJM! Luftën çlirimtare të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Iliridë, nuk e përkrahu as PDSH-ja dhe as PPD-ja! Ata e "përkrahën" këtë formacion politiko-ushtarak vetëm me qëllim të neutralizimit dhe të ndaljes së luftës, përmes Mbledhjes së Prizrenit dhe Marrëveshjes së Ohrit! Dhe kur këto dy parti e humbën garën politike për pushtet përballë Bashkimit Demokratik për Integrim, atëherë u "kujtuan" për "mangësitë" e Marrëveshjes së Ohrit, për "pamundësinë" e implementimit të saj, për "mosfunksionimin" e shteteve multietnike (edhepse vetë janë frymëzuesë dhe nënshkruesë të saj), u "kujtuan" për Shqipërinë etnike,...! PDSH-ja dy herë brenda një dekade ka luajtur me kartën politike të "nacionalizmit dhe radikalizmit të saj patriotik": së pari kur u shkëput si fraksion nga PPD-ja dhe fitoi pushtetin (pas bashkimit me Partinë Demokratike Popullore), dhe së dyti tani, pasi humbi pushtetin nga BDI-ja! Duam të besojmë se këtë herë PDSH-ja e ka përnjëmend dhe nuk lufton për pushtet dhe integrim multietnik, por për dinjitet kombëtar dhe për shtet etnik. Koha do ta vërtetojë shumë shpejt sinqeritetin dhe vendosmërinë, apo hipokrizinë dhe mashtrimin e saj, në realizimin e programit politik për

shtet etnik. Koha - ky gjykatës i pagabueshëm, i paanshëm dhe i pamëshirshëm!

Kurse Malësia e Madhe nën Mal të Zi heshti, sepse kurrë nuk e mori vesh se çka duan dhe për çka luftojnë shqiptarët e Kosovës, të Kosovës Lindore dhe të Iliridës! S'kishte si ta marrë vesh, kur as ata vetë nuk e ditën dhe ende nuk e dijnë se për çka luftuan dhe çka duan!!! Asnjë ushtri çlirimtare, asnjë parti politike relevante në Shqipërinë e lirë dhe në Shqipërinë e robëruar nuk kanë kërkuar dhe nuk kërkojnë bashkim kombëtar, ribashkimin e Shqipërisë etnike, as me paqë e diplomaci, as me luftë!!! Bashkimin kombëtar dhe Shqipërinë etnike e kërkon vetëm Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK) dhe Fronti për Bashkim Kombëtar të Shqiptarëve (FBKSH), por ata janë të margjinalizuar, të izoluar nga partitë parlamentare dhe qeveritë shqiptare të Tiranës dhe të Prishtinës, si dhe pa përkrahjen e duhur të kombit shqiptar! Është ky edhe një fakt se pushtetlinjtë shqiptarë dhe shqiptarët nuk janë për bashkim kombëtar dhe për Shqipërinë e bashkuar etnike!!! Të mos keqkuptohemi, ata janë për atë, por nëse ua sjellë, si byrekun në tepsi, Zoti nga qielli apo Amerika nga përtej Atlantikut! Atëherë, kush do ta bëjë Shqipërinë etnike, nëse jo shqiptarët dhe udhëheqësit e tyre, nëse jo qeveritë dhe institucionet shtetërore të tyre?! Vallë, a e don ky popull çlirimin e vet, bashkimin e vet, Atdheun e vet të lirë dhe të bashkuar?! Deri sot jo, nesër të shohim! Po ta donte, atëherë votuesit shqiptarë në Kosovë do t'ia jepnin votat LKÇK-së, LPK-së dhe UNIKOMB-it, kurse në Shqipëri populli votat do t'ia jepte Partisë së Unitetit Kombëtar. Por kjo nuk ka ndodhur gjer më sot! Sepse populli shqiptar, këtej e andej kufirit shqiptaro-shqiptar, nuk e don bashkimin kombëtar as në mënyrë paqësore e demokratike, përmes votës së tij të lirë dhe as përmes luftës së armatosur!!!

Në vend që LPK-ja të kërkojë bashkimin kombëtar – Shqipërinë etnike, ajo kërkon Unionin Shqipëri-Kosovë, duke kopjuar monstrën antishqiptare të Bashkimit

Evropian - Unionin Serbi-Mali i Zi! Kur dihet se unione mund të formojnë vetëm shtetet sovrane, kurse Kosova ende nuk është shtet! Dhe sa nënshkrime mblodhi për këtë ide? Vetëm 45.000! E çka çon peshë ky numër simbolik në krahasim me numrin prej afro 2 milionë të shqiptarëve të Kosovës?! Asgjë, përveçse ka efektin e një propagande politike partiake! Po ta deshnin shqiptarët e Kosovës këtë Union, atëherë LPK-ja do të duhej të importonte me mijëra kilometra letër nga vende të tjera të botës, që të arrijë të shënojë nënshkrimin e të gjithë shqiptarëve që do të ishin për këtë Union! Sipas kësaj logjike, që të bëhet bashkimi kombëtar dhe Shqipëria etnike, së pari duhet të bëhet shtet, porsi Kosova, edhe Ilirida, Kosova Lindore, Malësia e Madhe dhe Çamëria, që pastaj këto shtete shqiptare të kërkojnë Union me Unionin Shqipëri-Kosovë të LPK-së! Dhe ky Union-Shtet tani do të quhej: Unioni Shqipëri-Kosovë-Iliridë-Çamëri-Kosovë Lindore-Malësi e Madhe! E Shqipëri etnike, kur do të quhet shteti kombëtar i Shqiptarëve?! Asnjëherë, sepse asnjëherë nuk do të kenë "kaçik" shqiptarët që t'i formojnë 5 shtete, që të formojnë pastaj Unionin e shteteve shqiptare dhe që pastaj këtë Union ta emërtojnë Shqipëria etnike! Shqipëria etnike është e vetmja alternativë e zgjidhjes së çështjes kombëtare shqiptare. Të gjitha alternativat tjera ose janë zgjidhje parciale e arbitrare të çështjes kombëtare, ose janë lajthitje politike, ose janë të parealizueshme, ose janë politikë antikombëtare që zgjat robërinë dhe copëtimin e trojeve shqiptare!

Se shqiptarët luftojnë me turra-turra, me rend, pjesë-pjesë, veç e veç dhe të përçarë këtë e ka dëshmuar e gjithë historia jonë e lashtë dhe e re. Kush ka kujtesë të kthjellët, se shqiptarët harrojnë shumë shpejtë, e dijnë se, si gjithmonë edhe tani, shqiptarët, apo thënë më saktë – "fiset moderrne shqiptare" (!), i zhvilluan betejat e tyre çlirimtare të ndarë, të përçarë, veç e veç, njëri pas tjetrit e në nivel fisnor, lokal dhe krahinor!

Betejën çlirimtare e nisi “fisi” i madh shqiptar, por i përçarë, i Kosovës! Në fillim të luftës kishte dy Shtabe të Përgjithshëm dhe dy ushtri: UÇK dhe FARK! Kishte shumë komandantë dhe pak ushtarë! Dhe të gjithë ishin kundër Serbisë, por edhe kundër njëri-tjetrit! Prandaj, kjo UÇK, nga afro 2 milionë shqiptarët e Kosovës, mundi që në rradhët e saj, deri në qershor 1999, të rreshtojë diku 10-15 mijë ushtarë apo luftëtarë të lirisë! Pra, për çlirimin e Kosovës nuk luftoi as 1% e popullsisë së saj! Si mund të çlirohej Kosova me kaq pak luftëtarë?! Kjo vërtetoi politikën dhjetëvjeçare të LDK-së se, populli i Kosovës nuk e don luftën, por paqen! Se shqiptarët e Kosovës e duan lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, por përmes paqes dhe jo përmes luftës! Prandaj e lëshuan Kosovën në mënyrë aq masovike në mars-prill 1999, por UÇK-së nuk iu bashkuan! UÇK-ja nuk mundi të krijojë unitetin e popullit, nuk mundi ta bindë popullin që të luftojë për liri, nuk pati mbështetjen e shumicës së popullit, prandaj edhe nuk mundi ta çlirojë Kosovën! Atë që bëri UÇK-ja, me luftën e saj vërtetë titanike dhe heroike, ishte që i dha shkak dhe argumente NATO-s që të intervenojë ushtarakisht kundër Serbisë dhe i hapi rrugë vendosjes së protektoratit të OKB-së, përmes UNMIK-ut, në Kosovë. Lufta çlirimtare e UÇK-së dhe vendosja e UNMIK-ut në Kosovë, bënë të mundur kthimin e refugjatëve shqiptarë në Kosovë, bënë të mundur bashkimin e “fiseve” shqiptare të Kosovës dhe formimin e Popullit Kosovar, kurse Kosovarët pastaj përcaktuan Hymnin Kosovar, qepën Flamurin Kosovar dhe hapën horizonte të reja drejt pavarësisë së shtetit multietnik kosovar të Kosovës. Nga e keqja më e madhe - pastrimi etnik i Kosovës, kjo është e keqja më e vogël! Më mirë të ketë Kosovë-Shtet me kosovarë, se sa të mos ketë, as Kosovë dhe as kosovarë!

Betejën çlirimtare, shkëputje nga sundimi serb, pas mbarimit të luftës së Kosovës, e filloi “fisi” i vogël i Kosovës Lindore në vitin 2000, i cili për t’u dalluar nga “fisi” i madh i Kosovarëve, ia ndërron brenda natës emrin krahinës së vet dhe e quajtën “Lugina e Preshevës”! Dhe

ky “fis” i vogël shqiptar, tepër i vogël në krahasim me 9 milionë serbët, prej rreth 100 mijë banorëve, formoi ushtrinë e tij çlirimtare me emrin e gjatë, të çuditshëm e aspak melodik: UÇPMB! Pse vallë nuk e emëruan Ushtria Çlirimtare e Kosovës Lindore (UÇKL), apo të paktën me atë emrin e ri të krahinës së tyre: Ushtria Çlirimtare e Luginës së Preshevës (UÇLP)?! Apo, nëse përmendet vetëm Presheva, do të hidhërohej Bujanoci e Medvegja?! Po Tërnocin e Madh ku e lanë, edhe ai është një vendbanim i madh, mbi 10 mijë banorë, pse nuk e futën edhe atë në emërtimin e ushtrisë?! Kjo UÇPMB, që i kishte 2-3 mijë luftëtarë, luftonte për çlirim dhe bashkim me Kosovën, kurse veten nuk desh ta quajë Ushtria Çlirimtare e Kosovës Lindore! Këto lapsuse mund t’i bëjnë vetëm shqiptarët lokalistë, që ende vuajnë nga mentalitete fisnore mesjetare! Dhe me një numër kaq të vogël luftëtarësh donin të çlironin Luginën e tyre të Preshevës, të shkëputen nga Serbia milionëshe dhe të bashkohen me Kosovën! Deshën të bëjnë atë që nuk mundi ta bëjë Kosova prej 2 milionë banorësh! Dhe me gjithë vullnetin për të luftuar dhe dëshirën për t’u çliruar, UÇPMB-ja nuk mundi të arrijë asgjë, përveç viktimave njerëzore, plagëve të reja dhe dëmeve materiale që ia shkaktoi ushtria shoveniste serbomadhe! Lugina e Preshevës, njëherë për njëherë, mbeti nën sundimin dhe neokolonializmin serb! Ajo nuk mundet kurrë të çlirohet vetë nga Serbia, pa ndihmën dhe luftën e përbashkët të të gjithë shqiptarëve.

Pas dështimit të çlirimit të Kosovës Lindore, apo Luginës së Preshevës, siç i thonë sot politikanët e “moderuar”, betejës çlirimtare ia filloi “fisi” tjetër i madh i shqiptarëve të Iliridës! “Fisi” shqiptar i Iliridës ende nuk e ka të qartë se si quhet vendi i tij, apo krahina gjeografike ku jeton! Shqiptarët autoktonë Iliridës herë i thonë Maqedonia Perëndimore, herë Maqedonia Veri-Perëndimore, herë Maqedonia Shqiptare, herë Shqipëria Veri-Lindore dhe këto kohët e fundit kanë filluar ta quajnë edhe Lugina e Vardarit, duke marrë yrrnek nga Lugina e Preshevës! Prandaj, nga ky konfuzion etimologjik, ata

ushtrinë që krijuan më 2001, për të luftuar kundër IRMJ-së, e emërtuan Ushtria Çlirimtare Kombëtare (UÇK)! Dhe kjo ushtri, porsi simotrat e saj, UÇK dhe UÇPMB, në vlugun e fuqisë së saj i kishte diku 4-5 mijë luftëtarë! Kur dihet se numri i shqiptarëve të Iliridës është 800 000 - 1 000 000 banorë! UÇK-ja e Iliridës nuk pati përkrahjen e duhur të shumicës së popullit shqiptar dhe sidomos aspak, apo fare pak, përkrahjen e partive politike shqiptare të Iliridës! Prandaj, edhe objektivat programore të UÇK-së, për çlirimin e Iliridës, nuk u realizuan! Lufta u ndal në mes të rrugës, pa filluar ende siç parashihej!

Dhe kur t'i mbledhësh ushtarët e tri ushtrive çlirimtare shqiptare në një të vetme, ata nuk e tejkalojnë numrin e 22 000 luftëtarëve të lirisë! Kurse, vetëm Armata e Maqedonisë i kishte në ato vite rreth 50 000 ushtarë, pa llogaritur këtu ushtrinë serbomalazeze, si ushtria më e fortë e Ballkanit në atë kohë! E pra, dëshira mbetet dëshirë dhe realiteti mbetet realitet. Por, edhe serioziteti është seriozitet dhe hajgarja (shakaja) është hajgare! Dhe është fakt i trishtueshëm se shqiptarët e Kosovës, të Kosovës Lindore dhe të Iliridës nuk u treguan aspak seriozë para përgatitjes dhe gjatë zhvillimit të betejave të tyre për çlirim nga Serbia dhe Maqedonia, sepse ata paraprakisht nuk u bashkuan politikisht, ushtarakisht, organizativisht dhe finansiarisht ndërmjet veti, që të formojnë një udhëheqje të vetme politike, një front popullor të vetëm, një ushtri të vetme çlirimtare dhe një fond të vetëm finansiar dhe pastaj të fillonin luftën çlirimtare në të gjitha hapësirat shqiptare të robëruara përnjëherë. U shkelën Tezat për Frontin Popullor të Republikës së Kosovës të Kadri Zekës! Nuk u formua kurrë ky Front, por u formuan tri ushtri pa udhëheqje të mirëfilltë politike! Njëfarë udhëheqjeje politike ato patën, por ato quheshin "Drejtori Politike", prapa së cilave fshihej vetëm një parti politike – Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK)! Nuk mund të mobilizohet një popull pa formuar frontin popullor, ku do të organizohen të gjithë shqiptarët pa dallim krahine, feje, ideje e partie politike! Asnjë parti

politike, kushdoqoftë ajo, sado e madhe dhe e mençur të jetë ajo, nuk mund ta bëjë kurrë vetë mobilizimin dhe udhëheqjen e popullit drejtë lirisë, çlirimit dhe bashkimit kombëtar. Sepse çdo grup, organizatë, parti apo front i vetëm shqiptar, që do të nisë i vetëm luftën për çlirim dhe bashkim kombëtar do të dështojë, sepse i duhet të luftojë në dy fronte: kundër pushtuesëve sllavo-grekë dhe kundër shqiptarëve që nuk janë për luftë çlirimtare! Kështu, LPK-ja e "fitoi" luftën, kurse LDK-ja e "fitoi" paqen! Ndërsa, Kosova dhe shqiptarët nuk e fituan as luftën dhe as paqen, as lirinë dhe as pavarësinë, as shtetin kosovar dhe as bashkimin kombëtar!!!

Të mos përsëriten gabimet e së kaluarës, sepse do të përsëriten edhe dështimet! I forti ose të vret, ose të fal, kurse i ligu as të vret dhe as nuk të fal! Deri sot politikanët, udhëheqësit dhe liderët shqiptarë s'janë treguar as të fortë dhe as të ligj! Ata, ende, as nuk e kanë falë dhe as nuk e kanë vrarë njëri-tjetrin! A ka burrë e filozof, a ka Perëndi e Zot, që mundet t'ua caktojë diagnozën politike e kombëtare prijësve dhe liderëve tanë?! Vetëm uniteti politik brendashqiptar, vetëm shtrirja burrërore dhe e sinqertë e dorës së pajtimit midis udhëheqësve politik shqiptarë dhe partive që ata udhëheqin do të bënte të mundur që t'i thyejmë prangat e robërisë, që t'i mundim pushtuesit dhe kolonizatorët e Shqipërisë etnike dhe vetëm kështu do të bënim çlirimin dhe bashkimin kombëtar. Rrugë tjerë nuk ka. Të gjitha përpjekjet tjera arbitrare e të vetmuara janë iluzioniste dhe të pasuksesshme.

U zhvilluan tri kryengritje të shqiptarëve gjatë viteve 1998-2001, që u ngjanin shumë kryengritjeve shqiptare antiturke të viteve 1908, 1910 dhe 1911. Por Kryengritja e Përgjithshme e vitit 1912 për liri, pavarësi dhe bashkim kombëtar ende s'ka shpërthyer, prandaj ende s'jemi të lirë, të pavarur dhe të bashkuar në një shtet etnik kombëtar!

Politikanët shqiptarë harruan se pa bashkim politik nuk ka as bashkim ushtarak dhe pa bashkim politiko-ushtarak nuk ka as çlirim dhe bashkim kombëtar, nuk ka Shqipëri etnike! Dhe, fatkeqësisht, nuk pati unitet politiko - ushtarak të shqiptarëve dhe të partive të tyre politike as para dhe as gjatë betejave luftarake të viteve 1998-2001, por pati përçarje, armiqësi, prapaskena, pati eksperiment..., prandaj edhe nuk pati çlirim dhe bashkim kombëtar! Është paradoksale dhe fatale, por është fakt i pa kontestueshëm se, shqiptarët nuk i bashkoi as pushtimi e robëria sllavo-greke, as kolonizimi e gjenocidi i armiqëve, as lufta çlirimtare, as paqa demokratike dhe as pena e pushka e lirisë!!! Dhe tani shtrohet pyetja hamletiane: Vallë, kush, kur dhe si mund t'i pajtojë e bashkojë shqiptarët, qoftë edhe përkohësisht, derisa ata të fitojnë lirinë, pavarësinë dhe bashkimin e tyre të vërtetë kombëtar?! A ka politikan, filozof, sociolog, psikolog e antropolog, me gradë shkencore, që mund t'i japë përgjigje kësaj pyetjeje? Nuk pati dhe nuk ka pajtim dhe unitet vëllazëror e patriotik midis shqiptarëve, prandaj vazhdoi e vazhdon edhe më tej pushtimi, robëria e neokolonializmi i shqiptarëve dhe trojeve të tyre etnike, por tani në forma të reja, me emra të rinj dhe me terminologji të re politiko-juridike!

Lufta e ashpër politike, armiqësia dhe xhelozia në mes udhëheqjeve të partive politike kosovare vazhdon edhe sot me të njëjtën egërsi, si para dhe gjatë luftës, e cila shprehet përmes grindjeve të përditëshme në media të shkruara dhe elektronike, në seancat e mbledhjeve të Kuvendit të Kosovës dhe përmes krimit të shpeshtë politik! Kjo luftë politike e ashpër dhe e pakompromis, kjo urrejtje organike reciproke e pashpjegueshme (!), po të mos ishin ndërkombëtarët në Kosovë, që moti do të ishte shndërruar në një luftë të përgjakshme civile e vëllavrasëse për pushtet e dominim, si ajo e viteve 1944 - 1945 në Shqipëri! Apo si ajo e marsit të vitit 1997, po në Shqipëri! Shkalla e unitetit dhe e bashkëpunimit ndërshqiptar nuk është aspak më stabile dhe më e mirë

edhe në Shqipëri, Iliridë, Kosovë Lindore dhe në Malësi të Madhe! Anembanë Shqipërisë etnike vlon si kazan armiqësia, shpërthen si vullkan urrejtja dhe bën kërdinë tradhëtia e shqiptarëve kundër shqiptarëve!!!

Shqiptarët, në të gjitha trojet e Shqipërisë etnike, i ndanë një mal i lartë me armiqësi e përçarje dhe një det i thellë me grindje dhe urrejtje reciproke! Ky "mal" duhet sa më parë të bëhet shkrumb e hi dhe nga hiri të mbi, jo mal përsëri, por një fushë e gjerë me lule të miqësisë dhe unitetit ndërshqiptar. Ky "det" duhet të shterrohet gjer në fund dhe të mbushet me pajtim e dashuri të shqiptarëve për shqiptarët, të cilët vetëm në këtë mënyrë do të mund të fitojnë lirinë e pavarësinë, do të bëjnë bashkimin kombëtar, tokësor e shtetëror të Shqipërisë etnike. Burimi i robërisë së Shqipërisë etnike është te përçarja dhe armiqësia e shqiptarëve! Kurse burimi i lirisë së Shqipërisë etnike është te pajtimi dhe uniteti i shqiptarëve. Shqiptarët e kanë në dorë, që të vendosin vetë, se në cilin „burim" do të shkojnë të pijnë "ujë".

Për t'u bërë Shqipëria Etnike duhet që të bashkohen shpirtërisht, politikisht, ekonomikisht dhe ushtarakisht të gjithë shqiptarët anembanë botës. Duhet një ushtri kombëtare prej më se gjysmëmilioni ushtarësh, sepse duhet të luftohet kundër 4 shtetesh kolonialiste përnjëherësh! Për Shqipërinë etnike duhet të luftojnë të gjithë shqiptarët e kësaj dhe "asaj bote", të gjallë e të vdekur! Shqiptarët e vdekur, si dhe dëshmorët dhe heronjtë e rënë të këtij populli duhet patjetër të "ringjallen", që të zgjojnë nga gjumi i përmortshëm shqiptarët e gjallë, që t'ua rikujtojnë shqiptarëve harrestarë se janë të robëruar, të kolonizuar e të pushtuar! T'ua rikujtojnë shqiptarëve deviatorë se, përse u derdh nga ata gjaku arbëror ndër shekuj e mijëvjeçarë…, që t'i ringjallin shqiptarët e vdekur për së gjalli! Vetëm po të ndodhë ky fenomen natyror dhe kjo mrekulli hyjnore, vetëm atëherë mund të çlirohen dhe të bashkohen Shqiptarët dhe Shqipëria etnike.

Kështu, derisa shqiptarët nuk i bashkojnë forcat, zemrat, mendjet dhe armët e tyre, jo si fise e popull, por si komb, nuk do të fitojnë kurrë lirinë, nuk do të formojnë kurrë Shqipërinë Etnike, por do të rrokullisen e zvarrisen ndër shekuj e mijëvjeçarë, si gjer tani: disa në liri (Shqipëria londineze), disa nga robëria në liri (Kosova shtet), disa nga robëria në gjysmëliri (Ilirida), dhe disa nga robëria në robëri (Çamëria, Kosova Lindore dhe Malësia e Madhe).....!

.....

Shkruar në Janar - Mars 2004,
Publikuar në Faqet e Internetit:
RTVZIK.Com – më 31 Mars 2004,
ILIRIA.Net – më 1 Prill 2004,
LAJMET.com (Liria Kombëtare) – më 1 Prill 2004.

Botuar, si Fragment (pjesa e fundit), me titull: A E DUAN SHQIPTARËT BASHKIMIN KOMBËTAR?!, në revistën e pavarur - PASQYRA, Nr.79, 21 Prill 2004, Prishtinë.

“ZGJIDHJA” E ÇËSHTJES SHQIPTARE
(Fantazi dhe ëndërr)

Fantazia është kategori e vetëdijes njerëzore. Çdo njeri i ndërgjegjshëm fantazon. Fantazia është një e drejtë e secilit, e cila, ashtu si edhe shpresa, nuk mund të prangohet dhe të ndalohet nga asnjë lloj force, ajo shuhet krahas vdekjes së njeriut.

Fantazia nuk është vetëm ëndërr e parealizueshme, ajo nuk është vetëm imagjinatë e sëmurë dhe as trillim gjërash a ndodhishë të paqena, që nuk kanë ndodhur dhe që nuk mund të ndodhin kurrë.

Fantazia është, në të njëjtën kohë, edhe aftësi për të krijuar ose për të përfytyruar diçka të re, e cila do të ndodhë në të ardhmen e afërt apo të largët. Fantazia është edhe aftësi intelektuale, parashikuese, vizionare dhe largpamëse e ngjarjeve apo fenomeneve natyrore dhe shoqërore që mund të zhvillohen në të ardhmen, duke u bazuar gjithnjë në ligjet e shkruara dhe të pashkruara të natyrës dhe të shoqërisë njerëzore.

Fantazia, pra, i posedon të dyja anët e medaljes. Ajo është edhe ëndërr edhe zhgëndërr, edhe iluzion edhe realitet, edhe mashtrim edhe vërtetësi, edhe dështim edhe realizim, edhe e realizueshme edhe e parealizueshme, edhe vizionare edhe katastrofale,…

Fantazia është pronë e të gjitha kategorive të njerëzve. Është pronë e njerëzve të thjeshtë dhe e atyre të shkolluar, pa dallim race, gjinie, feje dhe ideje. Është pronë e politikanëve dhe e apolitikëve, pronë e patriotëve dhe e demokratëve, pronë e revolucionarëve dhe e reaksionarëve,…

*****

Demokratët predikojnë rrugën paqësore të zgjidhjes së çështjes shqiptare, të çlirimit dhe të bashkimit kombëtar. Revolucionarët e përkrahin rrugën paqësore, por mbrojnë dhe i besojnë rrugës luftarake të zgjidhjes së çështjes shqiptare. Të dy palët kanë të drejtë, kanë të njëjtin ideal, dhe të dy palët e kanë shumë të

vështirë që t'i shkojnë deri në fund dhe me sukses të plotë rrugës së tyre që kanë zgjedhur. Tani për tani asnjëra rrugë nuk çon në zgjidhjen e tërësishme, por parciale, të çështjes kombëtare shqiptare.

Është fjala për pesimizëm, disfatizëm e skepticizëm, apo për realizëm objektiv? Apo, edhe njëra edhe tjetra? Apo asnjëra? As ne nuk e dijmë. Mos harroni, jemi duke fantazuar. Fantazia është pa të holla, është gjëja më e preferushme e njerëzve të varfër dhe e popujve të robëruar e të pafuqishëm. Vazhdojmë, pra, me fantazinë.

Kriza jugosllave filloi në Kosovë, do të zgjidhet në Kosovë, jo kundër Kosovës, por ka gjasa të zgjidhet kundër vullnetit të popullit shqiptar dhe trojeve të tij nën ish-Jugosllavi. Pse dhe si?

Populli shqiptar dhe trojet e tij nën ish-Jugoslla janë të ndara në tri republika sllave: Serbi, Maqedoni, Mal të Zi dhe në një republikë të robëruar shqiptare. Republika e Kosovës, aktualisht, ka kufinjtë administrativë të ish-Krahinës Autonome të Kosovës. Këta kufinj, momentalisht, nuk i njeh as bota, as kombi shqiptar. Bota nuk i njeh për shkaqe të cilat i di ajo vetë, kurse kombi shqiptar nuk i njeh sepse ata nuk shprehin aspiratat e tij historike kombëtare dhe se nuk përfshijnë brenda tyre të gjitha trojet shqiptare nën ish-Jugosllavi.

Përderisa Republika e Kosovës i ka dofarë kufinjsh administrativë, trojet tjera shqiptare nën Maqedoni, nën Serbi e nën Mal të Zi nuk i kanë as kufinjtë e tyre administrativë, as politikë dhe s'kanë as republikë, as autonomi politike dhe as autonomi kulturore. Kosova nuk është e bashkuar, populli shqiptar nën ish-Jugosllavi është i copëtuar, dhe ky realitet i hidhur lind atë që mund të quhet – ***çështja kosovare***, e cila pastaj, së bashku me ***çështjen çame***, formojnë çështjen e madhe politike – ***çështjen kombëtare shqiptare***.

Pa zgjidhjen e çështjes kosovare dhe të çështjes çame, nuk mund të zgjidhet në asnjë mënyrë as çështja shqiptare. Dhe, sipas mendimit tone, na falni – sipas fantazisë sonë, deri tani nuk është bërë asgjë, apo është

bërë tepër pak për zgjidhjen e çështjes kosovare dhe asaj çame. Deri tani vetëm është teorizuar e fantazuar rreth çështjes kombëtare shqiptare, duke mos përcaktuar asgjë konkrete se si do të arrihet deri te bashkimi kombëtar, se si dhe në ç'mënyrë do të zgjidhet e mund të zgjidhet çështja kosovare dhe ajo çame, të cilat janë çelsi i zgjidhjes së çështjes shqiptare. Askush nuk ka dhënë ndonjë mendim të qartë se si mund të bashkohen trojet e copëtuara shqiptare nën ish-Jugosllavi me Republikën e Kosovës.

Gjermania u bashkua, por ishin dy Gjermani me kufinj shtetëror të njohur nga OKB. Kurse në rastin tonë konkret, të çështjes së bashkimit kombëtar, situata qëndron ndryshe. Ne nuk i kemi dy republika, dy shtete, as vetëm dy Shqipëri, por ne i kemi gjashtë Shqipëri: Shqipëria në Shqipëri, Shqipëria në Kosovë, Shqipëria në Maqedoni, Shqipëria në Serbi, Shqipëria në Mal të Zi dhe Shqipëria në Çamëri.

Ekzistimi i shumë Shqipërive nuk është pasuri, por tragjedi kombëtare. Dhe tragjedia merr përmasa katastrofale nga fakti se vetëm njëra Shqipëri është e rrethuar me kufinj të pranuar nga OKB, tjetra është me kufinj të papranueshëm administrativë, kurse katër Shqipëritë tjera janë pa kufinj, si han me dy-tri porta. Çështja e kufinjve të këtyre shumë Shqipërive të ndara është ajo nyja gordiane më delikate dhe më e ndërlikuar për zgjidhje, e cila në të njëjtën kohë, e bën të pazgjidhshme në tërësinë e saj çështjen kombëtare shqiptare, ashtu siç aspiron kombi ynë. Mjerisht çështja shqiptare, edhe kësaj rradhe, do të zgjidhet pjesërisht e jo tërësisht! Jo moré! Mos u çmende? Jo, po fantazoj. Ëndërroj një ëndërr tragjike. Inshallah (dhashtë Zoti) mbetet vetëm ëndërr e nuk bëhet realitet!

Diku, në fillim të kësaj fantazie, thamë se: ***as paqja e demokratëve, as lufta e revolucionarëve nuk do të arrijnë ta realizojnë bashkimin e plotë kombëtar, nuk do të mund ta zgjidhin përfundimisht çështjen shqiptare.***

Pse?!

Që çështja shqiptare të zgjidhet përfundimisht, në rrugë paqësore, duke u arritë bashkimi kombëtar i popullit shqiptar dhe trojeve të tij të copëtuara në një Shqipëri Etnike, duhet që këtë bashkim ta lejojnë dhe ta pranojnë shumica e popujve të botës, pra, OKB. Por, meqenëse OKB-në e përbëjnë edhe një numër i konsiderueshëm shtetesh armiqësore të Shqipërisë dhe të shqiptarëve, të cilët shtete nuk janë faktorë të papërfillshëm politikë, atëherë detyrohemi të fantazojmë se, as OKB nuk është dhe nuk do të jetë e gatshme që ta zgjidhë përfundimisht dhe drejt çështjen kombëtare shqiptare.

Që çështja shqiptare të zgjidhet drejt dhe përfundimisht me rrugë revolucionare, nevojitet që kombi shqiptar të jetë i bashkuar në ideal, i bashkuar politikisht, të jetë i fuqishëm ekonomikisht dhe ushtarakisht. Nevojitet që kombi shqiptar të jetë më i fortë nga çdo aspekt se armiqtë dhe pushtuesit e tij shovenistë. Por, fatkeqësisht, kombi shqiptar as nuk është më i bashkuar, as nuk është më i fuqishëm se armiqtë e tij shekullorë.

Fantazia jonë thotë se kombi shqiptar, historikisht, nuk ka fituar as në paqë dhe as në luftë. Ideologët serbë thonë se ata humbin në paqë e fitojnë në luftë. Ata vërtetë me luftë erdhën nga Karpatet e u ngulitën në trojet ilire dhe po me luftë e zgjeruan shtetin e tyre me pushtimin e tokave shqiptare. Ata, serbët, me luftë ende po zgjerohen me toka kroate e boshnjake. Ata njëmend kanë fituar në luftë e me luftë. Të paktën deri sot! Dhe kjo ***deri sot***, mos harroni, është një periudhë kohore mijëravjeçare. Kaluan, pra, më se njëmijëvjet qysh se sllavët po fitojnë në luftë kundër shqiptarëve. Populli shqiptar është një humbës i madh. Ai ka humbur vazhdimisht, edhe në luftë, edhe në paqë. Ai humbi gati gjithë Gadishullin Ilirik. Edhe atë çerek të tij që i ka mbetur, rrezikon që ta humbë nga

sulmet e pandërprera të ortodokësve sllavo-bizantinë dhe nga mosuniteti i tij.

Që tragjedia jonë kombëtare të vazhdojë edhe përtej shek.XX, që troje të tëra shqiptare të mbesin edhe më tej nën zgjedhë të huaj, historia, edhe kësaj rradhe, na gjeti të papërgatitur, të pabashkuar politikisht, të pafuqishëm ekonomikisht e ushtarakisht dhe me aleatë të pasigurt në botë! Dhe historia është e pamëshirshme, ajo nuk të fal, ajo të shkel, kalon mbi popujt që flejnë si mbi varreza! A s'u shndërruan në varreza nga historia popuj të tërë në Ballkan si: thrakët, maqedonët antikë, karianët, lelegët, kaukanët,...etj?!

*****

Populli shqiptar nën ish-Jugosllavi zgjodhi rrugën paqësore për çlirim dhe bashkim kombëtar jo se deshi, jo se ishte dhe është i sigurt se ajo të çon në liri, por ai e zgjodhi këtë rrugë nga zori, nga pafuqia e tij që të zgjedhë rrugën revolucionare, luftarake e nacionalçlirimtare. Nga pafuqia e tij ai, për herë të parë në historinë e tij mijëravjeçare, doli kundër historisë së tij.

I padituri, i pafuqishmi dhe fukaraja, zakonisht i lidhin duart kryq dhe i drejtojnë sytë kah qielli, kah Zoti dhe shtetet e fuqishme, por ndihma nuk u vjen as nga qielli dhe as nga toka. Lum kush është i fortë dhe mjer kush është i dobët, sepse për fatin e të dobëtit gjithmonë vendosin të fortët. A nuk vendosën për ne Fuqitë e Mëdha në Shën Stefan, në Berlin, në Londër dhe në Paris? Vendosën, por vendosën shumë keq! Kush na garanton neve se për popullin shqiptar nuk do të vendosin të tjerët përsëri nesër, sikurse dje, por tani në Hagë, Nju Jork apo gjetiu?

Kështu e ka historia: kur s'vendos vetë, vendosin të tjerët për ty, por jashtë vullnetit dhe aspiratave tua kombëtare!

Epilogu i kësaj fantazie tmerruese, që të mjegullon sytë dhe të zë frymën, mund të përfundojë edhe kështu, gjatë "zgjidhjes" së çështjes kombëtare shqiptare:

Në Konferencën Ndërkombëtare të Paqes për Ballkanin, mbajtur diku në Evropë, apo në OKB, vendoset:

-Jugosllavia shpallet shtet i vdekur,

-Sllovenia, Kroacia, Bosnja, Serbia, Mali i Zi, Maqedonia dhe Kosova (me kufinjtë aktualë administrativë) shpallen shtete të pavarura dhe sovrane,

-Republika sovrane e Kosovës, nëse do, mund të bashkohet me Republikën e Shqipërisë,

-Pakicës kombëtare shqiptare në Maqedoni, Serbi, Mal të Zi e Greqi, t'u sigurohen dhe t'u garantohen të drejtat njerëzore, liria e fjalës, e shtypit, e mendimit, e besimit, e qarkullimit dhe e shkollimit në gjuhën amtare..., të sanksionuara në dokumentet e OKB-ës dhe KSBE-së (tani OSBE-së).

Me kaq Konferencën Paqësore për Ballkanin e shpallim të mbyllur, kurse krizën jugosllave dhe çështjen shqiptare të zgjidhur.

Rroftë "paqa", "drejtësia" dhe forca!

Me fat "bashkimin", popull shqiptar!

Kur u shkëputa nga fantazia dhe ëndërrimi, kulloja i tëri në djersë, por, pasi u kthjellova dhe u binda se vërtet kisha qenë në kllapi, bërtita i gëzuar: O Zot, sa mirë që qenka një ëndërr e llahtarshme, se sa një realitet i tmerrshëm!

Dhashtë Zoti, shqiptari dhe i forti, që kjo ëndërr dhe fantazi personale të mos shndërrohet në realitet dhe tragjedi kombëtare.

Amin!

.....

Shkruar në Nëntor 1991,
Botuar në KUSHTRIMI I LIRISË,
organ i Organizatë Revolucionare Shqiptare (ORSH),
Viti I i botimit, Nr.1, Dhjetor 1991, Mërgim.

ÇDO SHQIPTAR
ËSHTË LUFTËTAR I LIRISË

Çdo shqiptar është luftëtar i lirisë, pavarësisht nga ideja, feja, ideologjia, gjinia e krahina. Është kështu, sepse në gjirin e kombit shqiptar ka patriotë, atdhetarë e luftëtarë lirie të fesë muslimane, katolike, ortodokse dhe sekteve të tjera fetare më të vogla. Është kështu, sepse në gjirin e kombit shqiptar ka patriotë, atdhetarë e luftëtarë të lirisë me ideologji borgjeze, komuniste, kapitaliste, liberale, socialiste, socialdemokrate, demokristiane, majtiste, djathtiste, të qendrës,...etj. Është kështu, sepse në gjirin e kombit shqiptar ka patriotë, atdhetarë e luftëtarë të lirisë të gjinisë femrore e mashkullore dhe nga të gjitha krahinat etnike shqiptare të Shqipërisë dhe nga diaspora.

Feja, ideja dhe ideologjia e çdo shqiptari, para së gjithash, është shqiptarizmi, atdhetarizmi, ndjenja e lirisë dhe dashuria ndaj atdheut - është Shqipëria e Ribashkuar Etnike. Patrioti, demokrati dhe shqiptari i vërtetë nuk i ndan luftëtarët e lirisë dhe dëshmorët e kombit mbi baza partiake, fetare, krahinore apo ideologjike. Luftëtarët e lirisë janë vetëm luftëtarë lirie dhe askush nuk mundet dhe nuk guxon t'i ndajë ata në baza ideologjike, fetare, politike, krahinore, partiake, gjinore, racore,...etj. Luftëtari i lirisë, i çlirimit dhe i bashkimit kombëtar shqiptar është vetëm luftëtar atdhetar dhe asgjë më shumë e asgjë më pak. Luftëtari i lirisë nuk është as komunist, as demokrat borgjez, as fashist, as liberal, as socialdemokrat, as i majtë e as i djathtë, as i bardhë e as i zi, as i kuq e as i gjelbërt..., dhe aq më tepër ai nuk është ekstremist dhe terrorist, por është vetëm luftëtar patriot i lirisë dhe i Shqipërisë Etnike.

Jeta dhe gjaku i çdo shqiptari që lufton dhe bjen në altarin e lirisë për bashkim kombëtar është i shenjtë, pa dallim të besimit fetar, apo bindjeve të tij politike dhe ideologjike. Në gjirin e çdo populli të botës ekzistojnë rrymat e ndryshme fetare, politike dhe ideologjike, pra

edhe ato komuniste, prandaj kombi ynë nuk mund të bëjë assesi përjashtim nga ky fenomen natyror, shoqëror dhe njerëzor. Ata të cilët duan të luftojnë për liri, pavarësi, demokraci, dekolonizim dhe ribashkim të Shqipërisë, por pa pjesëmarrjen e ish-komunistëve, ata janë demagogë dhe përçarësit më perfidë të kombit tonë dhe anasjelltas, ata ish-komunistë që duan të bëjnë bashkimin kombëtar vetë, duke përjashtuar dhe injoruar shqiptarët me ideologji tjetër politike, janë poashtu demagogë, përçarës e antikombëtarë.

Jemi në robëri, nën okupim e copëtim territorial dhe jemi në luftë për çlirim e bashkim, prandaj sot në gjirin e kombit shqiptar, nuk ka më: komunistë, marksistë-leninistë, enveristë, stalinistë, maoistë, titistë, ballistë, zogistë, borgjezë, kapitalistë, demokratë, diktatorë, proletarë, majtistë, djathtistë..., por ka vetëm: patriotë dhe pseudopatriotë, ka luftëtarë të lirisë dhe pacifistë, ka trima dhe frikacakë, ka demokratë dhe pseudodemokratë, ka shqiptarë dhe shqipfolës,...!

Shumica e partive politike që sot veprojnë në pozitë apo opozitë, si në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e në Kosovën Lindore janë fraksione të ish-PPSH-së, ish-LKK-së, ish-LKJ-së dhe ish-LKM-së. Këto parti politike, udhëheqja e tyre dhe thuajse të gjithë anëtarët e këtyre partive janë ish-komunistë, të ish-partive komuniste, të ish-regjimeve komuniste në Shqipëri dhe Jugosllavi. Dallimi i vetëm i tyre ka qenë në emër – në Jugosllavi janë quajtur titistë, kurse ata në Shqipëri enveristë, por në thelb të dy palët kanë qenë me ideologji komuniste. Asgjë nuk ka ndryshuar tek këto parti politike, tek udhëheqësit e tyre pse ato e quajnë sot veten demokratë e antikomunistë, dhe pse i kanë emërtuar partitë e tyre nga komuniste në socialdemokrate, në socialiste apo në demokratike. Mentaliteti, mënyra e të menduarit dhe të vepruarit të këtyre ish-komunistëve titistë dhe ish-komunistëve enveristë ka mbetur i pandryshuar.

Prandaj, t'i lëmë akuzat, etiketimet e njollosjet reciproke ideologjike e partiake dhe t'i bashkojmë forcat, mendjet e zemrat tona; ta bashkojmë popullin politikisht dhe ushtarakisht në luftën finale për liri, bashkim kombëtar dhe demokraci. Guri i provës për të gjithë ish-komunistët titistë dhe ish-komunistët enveristë sot, se ata kanë qenë dhe janë patriotë e kombëtarë shqiptarë, është lufta për çlirim, dekolonizim dhe ribashkim kombëtar, është lufta për Shqipërinë e Ribashkuar Etnike.

Në këto kohë krizash e udhëkryqesh kombëtare shqiptare, kur sot a kurrë është shtruar për zgjidhje çështja jonë kombëtare - Ribashkimi i Shqipërisë, të merremi me etiketa ideologjike, me distancime e denoncime politike në stilin ky është komunist, ai liberal, tjetri demokrat borgjez, ai tjetri fetar e ky tjetri ateist..., s'bëjmë asgjë tjetër pos që thellojmë përçarjen kombëtare, tradhëtojmë luftën për liri dhe bashkim kombëtar - pra, bëjmë vetëvrasje kolektive kombëtare!

Kur të bëhet çlirimi i trojeve të pushtuara shqiptare nga greko-sllavët dhe të kemi formuar Shqipërinë e Bashkuar, atëherë komunisti shqiptar le të bëhet më komunist se Marksi, demokrati borgjez shqiptar le të bëhet më demokrat se Bushi, katoliku shqiptar le të bëhet më katolik se Papa i Vatikanit, muslimani shqiptar le të bëhet më islamik se Muhamedi, kurse nacionalisti shqiptar le të bëhet më nacionalist se Mit'hat Frashëri..., por ama të gjithë do të jemi vëllezër shqiptarë dhe do të bëjmë gara politike e demokratike për pushtet, kurse ai që do të na legjitimojë për pushtet do të jetë sovrani popull me votën e tij të vullnetit të lirë.

Jemi në gjendje lufte për jetë a vdekje me armiqtë shekullorë të Shqipërisë Etnike, prandaj nuk kemi kohë të merremi as me analiza filozofike, as me kundërshtime ideologjike, as me polemika politike, as me studime historike, as me të kaluarën biografike të njerëzëve. Jemi në gjendje lufte dhe lufta kërkon punë e jo llafe. Jemi në gjendje lufte dhe lufta kërkon luftëtarë të penës dhe të pushkës. Jemi në gjendje lufte dhe lufta kërkon bashkim

dhe solidaritet në mes të shqiptarëve e jo përçarje dhe ndarje ideo-politike apo fetaro-krahinore. Jemi në gjendje lufte dhe lufta kërkon pará, bukë dhe municion. Jemi në gjendje lufte dhe lufta kërkon të luftosh me armë në dorë deri në fitore, deri në çlirimin e pëllëmbës së fundit të Shqipërisë Etnike.

Jemi nën okupim dhe në luftë për çlirim, prandaj ne e ndjekim dhe do ta ndjekim pa u luhatur këtë rrugë të drejtë të lirisë, pa kthyer kokën majtas-djathtas, pa dëgjuar dhe duke injoruar të gjitha akuzat monstruoze ideo-politike reciproke që po bëhen ndërmjet politikanëve dhe veprimtarëve kombëtarë shqiptarë. Ne duhet të përgjigjemi për atë që bëjmë dhe themi, dhe ne të gjithë, pa përjashtim, kemi thënë e themi se jemi vetëm luftëtarë të lirisë e të ribashkimit kombëtar, jemi atdhetarë (patriotë) e kombëtarë (nacionalistë), jemi ilirë e shqiptarë që ideal të vetëm kemi çlirimin dhe bashkimin e Nënës sonë - Shqipërisë. Kush nuk i beson sot Betimit tonë, do t'i besoj nesër veprës sonë - Bashkimit Kombëtar.

Patriotët, demokratët, shqiptarët dhe luftëtarët e vërtetë nuk duhet të luftojnë njëri-tjetrin, nuk kanë nevojë që të etiketojnë ndonjë individ, grup apo parti politike, t'i denoncojnë apo emërtojnë si antikombëtare dhe tradhëtare, sepse çdo individ, grup apo parti politike që dëmton interesat kombëtare për çlirim, dekolonizim dhe ribashkim kombëtar, ata individë, grupe apo parti me veprimtarinë e tyre destruktive antishqiptare e etiketojnë, e demaskojnë dhe e emërtojnë vetëveten si antikombëtare e tradhëtare.

Pra, çka i bën vetëvetes s'ta bën askush, as armiku! Çdokush mikun dhe armikun e ka në vetëvete, në trurin dhe në zemrën e vet. Është e kotë të kërkojmë armiq jashtë vetëvetes, nëse ne jemi vetë armiq të vetëvetes dhe të kombit tonë! Mos të fajësojmë të tjerët se na quajnë tradhëtarë, nëse ne vetë ia ngjisim vetëvetes në ballë këtë etiketë me punën tonë të përditëshme antikombëtare. Mos të fajësojmë faktorët politik ndërkombëtarë për politikë antishqiptare, nëse ne vetë si

popull dhe si komb jemi të përçarë e të armiqësuar mes veti dhe nuk bashkojmë forcat, mendjet dhe zemrat tona për çlirim dhe bashkim kombëtar. Kongreset dhe konferencat e Fuqive të Mëdha europiane nuk e kanë copëtuar dhe ndarë Shqipërinë Etnike në 5-6 copa, këtë e kanë bërë vetë shqiptarët me përçarjen e tyre, me armiqësinë, bajraktarizmin, krahinarizmin dhe lokalizmin e tyre të shëmtuar e të pashëruar! Kongreset dhe konferencat e huaja, s'kanë bërë tjetër gjë, veçse e kan konfirmuar, e kanë firmosur dhe vulosur këtë përçarje, këtë ndarje dhe copëtim brendashqiptar.

Patriotë e demokratë, të majtë, të djathtë e të qendrës, të gjithë jeni shqiptarë, ushtarë të Atdheut dhe luftëtarë të lirisë, prandaj pajtohuni dhe bashkohuni për të bërë bashkimin e kombit, për të bërë Ribashkimin e Shqipërisë!

.....

Shkruar në Shkurt 2003,
Botuar në *RIBASHKIMI I SHQIPËRISË,*
organ i Frontit për Bashkim Kombëtar
Shqiptar (FBKSH), Nr.2, (4), Mars 2003, Tiranë.

KUSHTRIM PËR BASHKIM!

Kushtrimi është thirrja që i bëhet popullit në kohë paqeje për qëndresë, mosnënshtrim e rezistencë, kurse në kohë lufte kushtrimi është thirrje që i bëhet popullit për të rrëmbyer armët dhe për t'u ngritur në luftë të armatosur kundër armikut pushtues.

Historia mijëravjeçare e Ballkanit është historia e luftërave dhe e përleshjeve të përgjakshme ndëretnike e ndërshtetërore. Këtë ligj të pashkruar, për fat të keq, nuk mund ta ndryshojë as ky shekulli ynë i ri i mijëvjeçarit të tretë të erës sonë. Prandaj, duhet të mos dehemi e mashtrohemi nga shpresat dhe premtimet e tepruara të pëllumbave të paqes, por të zgjohemi e të qartësohemi nga vringëllimat e armëve dhe krrokama e korbave që po çirren ditë e natë mbi tokën, vatrën dhe qiellin tonë. Në Ballkan, deri më sot, asnjë çështje kombëtare e ndërshtetërore nuk është zgjidhur me paqë, por me luftë.

Dekada e fundit e këtij shekulli është ndër sprovat dhe kthesat më të rëndësishme të historisë sonë kombëtare. Në këtë fundshekull kombi shqiptar është gjendur përsëri para provimit të madh të historisë që me zgjuarsinë, guximin dhe vendosmërinë e tij të dëshmojë vitalitetin dhe autoktoninë e tij mbi këto troje; të dëshmojë se vërtetë është pasardhës i Ilirëve antikë e legjendarë; të dëshmojë se është një komb që e meriton jetën, lirinë dhe bashkimin e tij kombëtar. Prandaj, të besojmë, të shpresojmë, të luftojmë që të mund të dëshmojmë. Është koha e fundit që pushtuesve tiranikë t'u thuhet stop. Koha e kërkon që armiqve pushtuesë sllavo-grekë t'u tregohet gjoksi, sepse situata e sotme politike nuk kërkon vetëm urtësi e durim, por edhe guxim dhe veprim revolucionar e luftarak. Rruga demokratike dhe paqësore që kemi zgjedhur për të arritur në liri dhe bashkim kombëtar është rruga më e lehtë, më komode dhe më e dëshirueshme për popullin tonë dhe për çdo popull të robëruar, por në të vërtetë nuk është rruga e lirisë, as e pavarësisë dhe e bashkimit kombëtar. Për

Ballkanin e ballkanasit ende është rruga luftarake ajo që i çon popujt e kolonizuar në dekolonizim. Rruga jonë është rruga e luftës së vendosur për vetëvendosje, liri dhe bashkim kombëtar.

Historia, ne shqiptarëve, në kulmet më dramatike të zvillimit të saj, na ka gjetur gjithmonë të ndarë, të përçarë, të papërgatitur, të pabashkuar dhe të armiqësuar me njëri-tjetrin! Të jemi të gjithë të ndërgjegjshëm dhe të vetëdijshëm se, kemi përballë e mbi shpinë armiq shumë të egër, shekullorë dhe të fortë. Ndaj, të gjitha energjitë tona mendore e fizike, morale e materiale t'i drejtojmë dhe t'i shprazim mbi ta e kundër tyre. Të mos harxhojmë energjitë tona luftarake për luftë të brendshme politike, ideologjike, fetare apo krahinore. Të mos merremi me njëri-tjetrin, sepse atëherë s'do të merremi me armiqtë pushtuesë të trojeve tona etnike, se atëherë nuk do të fitojmë lirinë dhe bashkimin kombëtar!

Të bindemi njëherë e përgjithmonë se konfrontimet, polemikat dhe sulmet joparimore, hakmarrëse e anakronike në mes të partive dhe forcave tjera politike shqiptare, në këto rrethana pushtimi e copëtimi të trojeve etnike shqiptare, janë baraz me tradhëti kombëtare, sepse jo vetëm që zgjasin robërinë dhe varfërinë, por rrezikojnë edhe ekzistencën tonë biologjike shqiptare!

Mjaft jemi grindur, përçarë dhe vrarë shqiptari me shqiptar, familja me familje, fisi me fis e krahina me krahinë, sepse veprime të kësaj natyre na kanë lënë në këtë gjendje pushtimi, robërimi, copëtimi, varfërimi dhe mjerimi të padurueshëm kombëtar! T'i lëmë mënjanë ndasitë fetare, krahinore, politike e ideologjike dhe të mbështetemi sup më sup te njëri-tjetri, të forcojmë unitetin kombëtar dhe të marshojmë përpara fitimtarë në rrugën e lirisë, të pavarësisë dhe të bashkimit kombëtar!

Të mësojmë, më në fund, nga pësimet tona historike dhe nga sukseset e të tjerëve. Të mësojmë, më në fund, nga historia jonë e përgjakshme dhe t'i ruhemi asaj që mos të na gjejë edhe kësaj rradhe të papërgatitur dhe të përçarë, sepse, si gjithmonë, do ta paguajmë

shumë shtrenjtë. Të mos gabojmë e dështojmë edhe kësaj rradhe, se nuk do të na e falë as historia dhe as brezat shqiptarë që do të vijnë. Nuk do të na falin as fushat e malet shqiptare, as gjaku dhe varret e dëshmorëve. Do të na mallkojë trualli ynë i përgjakur ndër shekuj e mijëvjeçarë nga luftëtarët e lirisë!

Të zgjohemi, të organizohemi, të mobilizohemi dhe të rreshtohemi në ushtrinë mbarëkombëtare! Të përgatitemi dhe të nisemi shtigjeve luftarake të lirisë, nëse njëmend duam të çlirohemi e të bashkohemi si komb dhe si shtet! Të mos heshtim, të mos frikësohemi, të mos tërhiqemi nga fronti i luftës për liri, se njëherë kemi lindur dhe njëherë do të vdesim, por vdekja e çdo shqiptari le të ketë kuptim dhe përmbajtje fisnike të idealit të lirisë dhe të bashkimit kombëtar! Armiqtë me këmbëngulje po synojnë që të përjetësojnë sundimin e tyre mbi trojet tona! Prandaj, që ne të ekzistojmë, të jetojmë, të mbijetojmë dhe të çlirohemi nga kthetrat barbare të pushtuesve sllavo-grekë duhet patjetër të qëndrojmë, të bashkohemi, të organizohemi dhe të luftojmë. Jemi në rrugë drejtë lirisë, ndaj ta ndjekim atë me vendosmëri e unitet, me qartësi e largpamësi, me guxim e trimëri deri në fund, deri në realizimin e aspiratave tona historike kombëtare, deri në ribashkimin e Shqipërisë etnike!

Koha punon për ne, koha po ecë me ne, por edhe ne duhet të punojmë dhe të ecim me kohën, që mos të na shkelë koha, që mos të na gjykojë populli dhe historia. Ora e madhe historike e lirisë dhe e bashkimit kombëtar po bie me alarm dhe kushtrim, kush ka veshë e dëgjon! Kush është shqiptar e shikon!

Koha nuk pret më shumë, prandaj, zgjohuni shqiptarë! Pajtohuni, bashkohuni dhe organizohuni në armatën tuaj kombëtare dhe me armët në duar, nisuni shtigjeve të lirisë! Marshoni të vendosur, krenarë e guximtarë drejtë çlirimit dhe bashkimit kombëtar.

Zgjohu shqiptar! Ngritu shqiptar! Nisu shqiptar! Marsho shqiptar! Mos duro! Mos u mashtro! Mos u nënshtro! Mos u ndal shqiptar! Qëndro! Lufto! Edhe

drejtësia, edhe perëndia, edhe liria janë me ty – o shqiptar!

Përpara drejt fitores, drejt çlirimit, drejtë lirisë, drejtë bashkimit të Shqipërisë etnike!

Përpara shqiptar!

.....

Shkruar në Nëntor 1991,
Botuar në KUSHTRIMI I LIRISË, organ i Organizatës Revolucionare Shqiptare (ORSH), Viti I i botimit, Nr.1, Dhjetor 1991, Mërgim.

PËRMBAJTJA

"Horoskopi Shtetformues" Shqiptar:
Shqipëria Etnike - në vitin 2012 apo 2512?! 5

Sqarim për lexuesit 6

I - ÇËSHTJA KOMBËTARE

1.Gjendja historiko-politike e trojeve shqiptare 7
2.Dialektika e ngjarjeve 13
3."Kombi Kosovar" 22
4.Faktori i brendshëm dhe i jashtëm politik 31
5.Mosuniteti i shqiptarëve 36
6.Shumë fé, një Atdhé! 40
7.Urime festat - Gëzuar robërinë! 51

II - KOSOVA

1.Pacifikimi dhe zgjimi i Kosovës 55
2.Kosova – rast unik dhe precedent! 65
3.Maskat dhe maskarenjtë 74
4.Kot e kanë të gjithë...! 83

III - ILIRIDA

1.Ilirida 86
2.Maqedonia Etnike dhe Shqipëria Etnike 95
3.Maqedonia, drejt europës pa Iliridën! 102
4.Republika Federative e Vardarit
- alternativa e vetme paqësore 107
5.Kosova–shtet, radhën e ka Ilirida! 115

IV - BASHKIMI DHE LUFTA

1.Bashkimi politik dhe ushtarak i shqiptarëve 125
2.Faktorizimi i luftës çlirimtare për shqipërinë etnike 128
3.Zaret u hodhën..., AKSH ekziston! 132
4.Luftës i prin dhe luftën e fiton, ai që e fillon i pari! 137

V - SHQIPËRIA ETNIKE

1.Shqipëria Etnike dhe Prometheu 142
2.Shqipëria Etnike duhet të bëhet nga shqiptarët 148
3.Shqipëria Etnike duhet të bëhet sot, nesër do të jetë vonë! 158
4.Shqipëria Etnike – proces dialektik 164
5.Ribërja e Shqipërisë Etnike varet nga shqiptarët 171
6.Zgjohu, ngritu Shqipëri! (Poezi) 175

VI – SHTOJCË

(Nga libri: Nga Libri: Shefki Ollomani -NË RRUGË DREJT LIRISË, ShB "Shkupi", Shkup 2004)

1.Shqiptarët dhe mallkimi i historisë 178
2.Çka i ndan dhe çka i bashkon shqiptarët? 190
3.Shqiptarët – Nga robëria në liri dhe nga robëria në robëri! 198
4."Zgjidhja" e Çështjes Shqiptare 230
5.Çdo shqiptar është luftëtar i lirisë 236
6.Kushtrim për bashkim! 241